



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 22, 23 DHE 29 DHJETOR 2016**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 22, 23. I 29. DECEMBRA 2016. GODINE**

**DHJETOR - DECEMBAR
2016**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seancat e mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017.
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-130 për shërbime,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-100 për ndihmën shtetërore,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-116 për ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe Ligjin nr. 04/L-168,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-090 për sponsorizime dhe donacione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit,
9. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-158,
10. Debat parlamentar sipas kërkesës së deputetit Glauk Konjufca, i mbështetur edhe nga 9 (nëntë) deputetë tjerë lidhur me arrestimet e aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Dnevni red

1. Vreme za izjave van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodnih sednica,
4. Prvo razmatranje Nacrt zakona br. 05/L-125 o Budžetu Republike Kosova za 2017. god.
5. Prvo razmatranje N/zakona br. 05/L-130 o uslugama,
6. Drugo razmatranje N/zakona br. 05/L-100 o državnoj pomoći,
7. Drugo razmatranje N/zakona br. 04/L-101 o fondu penzijske štednje Kosova, izmenjen i dopunjen Zakonom br. 04/L-115 i Zakona br. 04/L-168,
8. Drugo razmatranje N/zakona br. 05/L-090 o sponzorisanju i donacijama u oblasti kulture, omladine i sporta,
9. Razmatranje izveštaja Komisije za ekonomski razvoj, infrastrukturu, trgovinu i industriju u vezi nadgledanja sprovođenja Zakona br. 03/L-163 o rudnicima i mineralima, izmenjen i dopunjen Zakonom br. 04/L-158,
10. Parlamentarna rasprava, prema zahtevu poslanika Glauk Konjufca, podržan od 9 (devet) ostalih poslanika u vezi hapšenja aktivista Pokreta “Vetëvendosje”.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 19 dhjetor 2016.

Fjalën e ka kërkuar zoti Ismet Beqiri, edhe zoti Pal Lekaj, në ndërkohë.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti kryeministër, ministra,

Kolegë deputetë,

Unë propozoj një mocion, përkatësisht propozim për Shqyrtimin e dytë të Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës, por para se të bëj këtë unë propozoj që pika për Deklarime jashtë rendit të ditës dhe Koha për pyetje parlamentare sot të mos mbahen, të hiqen dhe të shkojmë drejtpërdrejt në buxhet.

Grupi ynë parlamentar, në bazë të nenit 84 të Rregullores së Kuvendit, shmangie nga Rregullorja e Kuvendit, propozon që shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017 të bëhet në procedurë të përshpejtuar, shmangie nga afatet procedurale të parapara me nenin 57, paragrafët 3, 8 dhe 9 të Rregullores së Kuvendit.

Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017 të bëhet në seancën plenare sot, më 22 dhjetor, pas përfundimit të seancës së parë, gjegjësisht miratimit në leximin e parë të këtij projektligji.

Kërkohet nga Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017 dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime para seancës së caktuar, pra për sot, nëse merr vendim Kuvendi, më 22 dhjetor.

Po ashtu propozoj që të futet menjëherë pas buxhetit Ligji për faljen e borxhit, është afati i kufizuar dhe janë vetëm tri amendamente, të futet si pikë menjëherë pas miratimit të parë të Projektligjit për buxhetin si dhe kërkoj që pika e dhjetë sot të hiqet nga rendi i ditës, në bazë të nenit 50 të Rregullores së Kuvendit dhe kjo pikë të mbahet në një seancë tjetër. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Pal Lekaj, fjala për ju. Ndërkohë ka propozime edhe zoti Bekim Haxhiu, pastaj në bazë të procedurës i votojmë këto propozime.

PAL LEKAJ: I nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

I nderuar kryeministër, ministra,

Deputetë të nderuar,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Në bazë të nenit 49 të Rregullores së Kuvendit, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës propozon që në seancën plenare, më 22 dhjetor 2016, të shqyrtohet si çështje urgjente ndërtimi i murit në mënyrë ilegale në pjesën veriore të Mitrovicës.

Duke marrë parasysh se interpelanca me kryeministrin e Republikës së Kosovës, zoti Isa Mustafa, sipas kërkesës së gjashtë deputetëve nënshkrues në lidhje me ndërtimin e murit në mënyrë ilegale në pjesën veriore të Mitrovicës nuk ka mundur të radhitet për seancën e sotme plenare, si dhe duke u bazuar se jemi në përfundim të sesionit vjeshtor, shtyrja e çështjes lidhur me ndërtimin e murit në mënyrë ilegale në pjesën veriore të Mitrovicës do të ketë pasoja të paparashikueshme.

Në bazë të nenit 49, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit propozoj që të vihet në votim propozimi si çështje urgjente për plotësimin e rendit të ditës të seancës së sotme plenare me pikën: Ndërtimi i murit në mënyrë ilegale në pjesën veriore të Mitrovicës.

Kemi parashtruar edhe kërkesën për interpelancë të kryeministrit të Kosovës, por nëse kjo hyn në rend dite, ne do ta tërheqim interpelancën. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Leka! Atëherë Bekim Haxhiu, e ka fjalën edhe Zafir Berisha, mundësisht në emër të grupeve parlamentar një të jetë, të mos jenë dy.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe në konsultim me kolegët dhe me kryetarin e Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport është kërkesë që të futet Projektligji për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në sport dhe dukurive të tjera negative.

Komisioni parlamentar e ka përfunduar punën, disa nga komisionet edhe e kanë përfunduar punën e tyre. Prandaj, kërkojmë që pasi është Ligji për sponsorizime sot, të përfundojmë edhe Ligjin për parandalimin e dhunës në sport dhe në këtë formë të përmbylлим këtë vit me dy ligje për botën e sportit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zafir apo Valdete, apo të dytë. Zafir Berisha e ka fjalën.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryetar!

Në emër të “Nismës”, natyrisht lidhur me idetë edhe propozimin e kryetarit të Grupit të LDK-së ne si Grup Parlamentar mendojmë se nuk duhet të hiqen dy pikat nga rendi i ditës, nuk është faji ynë pse ju jeni marrë me fushata zgjedhore dhe me çështje të tjera dhe nuk keni mbajtur mbledhje të rregullta dhe natyrisht tendenca që këto dy pika të hiqen nga rendi i ditës është për t’u shqetësuar, për shkak se shumë probleme, të cilat i preokupojnë qytetarët e Kosovës nuk po trajtohen në Kuvend dhe natyrisht ne qëndrojmë pas asaj që tha kryetari i Grupit Parlamentar të Aleancës, zoti Pal Lekaj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Janë 20 vetë, Visar, të lutem veç dorën. Dauti ose Visari, ua jap fjalën gjithsesi, po nuk i kam vërejtur, 20 vetë i kam.

DAUT HARADINAJ: Nuk po marr shumë kohë, kryetar, po sinqerisht ju them që u bënë diku më shumë se gjashtë javë që ka pyetje parlamentare për kryeministrin, për ministrin e Mbrojtjes, për ministrin e Punëve të Brendshme, për ministrin e Shëndetësisë, të Arsimit, të gjitha këto janë tema vitale, të cilat ndërlidhen edhe me parashikimet buxhetore.

Për shembull, kam pyetje për kryeministrin, pse nuk e bëni Ligjin për transformimin e FSK-së në Forcat e Armatosura, ligj i cili nuk kërkon ndryshime kushtetuese. Buxheti është i ndarë, të gjitha, unë mendoj që kjo është interes nacional.

Kemi pyetje të cilat janë në interes të qytetarëve, zoti kryetar i Kuvendit, vetëm shikoni në çfarë gjendje e keni Stacionin e Policisë nr. 4, që i kontrollon edhe i mbikëqyr mbi 250 mijë banorë të regjionit të Prishtinës. Këto tema duhet gjetur kohë dhe të na lejohet të bëjmë pyetje parlamentare. Nëse e shihni këtë me të vërtetë është për të ardhur keq, nëse shkoni, e shihni objektin e kryeinspektoratit është në gjendje të mjerueshme, nëse shkoni e këqyrni Sekretariatit e Këshillit të Sigurisë Kombëtare, është në gjendje të mjerueshme, nëse i këqyrni zjarrfikësit janë për gjynah të Zotit. Pse nuk duhet të diskutohet: në parlament mos diskutoni, në rrugë mos protestoni, çka tani, muret po ju dalin në mëngjes pa i parë. Të diskutojmë dhe t’i trajtojmë temat, të cilat janë në interes edhe për ju, edhe për qytetarët e Kosovës dhe natyrisht shpresojmë edhe në mirëkuptim në parashikimet buxhetore.

KRYETARI: Faleminderit! Urdhëro, kryetari i Lëvizjes “Vetëvendosje”, fjala për ju.

VISAR YMERI: Këtu u bënë disa propozime për ndryshim të rendit të ditës për këtë seancë dhe mendoj që proceduralisht prapë është e gabuar, edhe si kohë, edhe si propozime. Pra, edhe mënyrën se si e drejtuar deri tash seancën është absolutisht e gabuar dhe nuk e di vërtet kur do të mësohesh ta drejtosh një seancë, se nuk është kush e di çfarë dije. Kur ka propozime për ndryshim të rendit të ditës duhet shkuar me rend sipas grupeve të shprehen edhe qëndrimet e tyre, kështu bëhet zakonisht, dhe pastaj eventualisht shkohet në votë.

E dyta, propozimet për ndryshim të rendit të ditës bëhen pas dy pikave të para, kjo është po ashtu proceduralisht edhe praktikë e deritashme e Kuvendit. Kur do të ndryshosh pika të rendit të ditës, mund t'i ndryshosh prej katër e tutje, me pajtim të Kuvendit, jo pikën një dhe dy. Ato janë pika që i takojnë secilës seancë dhe në asnjë mënyrë nuk bënë të hiqen. Pra, ne jemi kundër këtij propozimi që u shpreh nga Ismet Beqiri.

Po ashtu, është absolutisht e papranueshme se prej që ka ardhur kjo Qeveri në pushtet buxheti diskutohet me procedurë të përshpejtuar, unë këtë gjë nuk mund ta kuptoj.

Herën e parë arsyetoheshin se u krijua Qeveria në fund të vitit 2015, e rrjedhimisht nuk patëm si t'ia bëjmë ndryshe. Herën e dytë, herën e tretë, cili është arsyetimi. Pra, një buxhet i cili është përpiluar që sa kohë dhe, në fund, në Kuvend diskutohet ose propozohet të diskutohet brenda një dite, si ligji më i rëndësishëm i vendit për vitin 2017. Pra, kjo ose është mungesë absolute e profesionalizmit, ose unë mendoj se e vërteta është dëshira dhe nevoja e Qeverisë që këto gjëra të mos diskutohen në Kuvend, pra t'i kalojmë me procedurë të përshpejtuar, në mënyrë që paratë siç janë ndarë në buxhet të mbesin ashtu pa e pasur Kuvendi mundësinë të diskutojë dhe të ndërhyjë në këtë ligj. Kjo është e papranueshme për ne, pra, buxheti duhet të diskutohet me vëmendje që i takon, e jo të ngutemi në të.

Dhe, për fund, pika dhjetë nuk bën të hiqet në asnjë mënyrë, sepse ky debat parlamentar është kërkuar tash e një kohë. Pra, Kryesia e Kuvendit e ka shkelur edhe procedurën, edhe afatet kur nuk e ka trajtuar këtë debat përbrenda 30-ditëshit që kërkohet me Rregullore dhe tash prapë po kërkohet të shtyhet kjo pikë për një afat të pacaktuar. Prapë po kërkohet që Kuvendi t'i shkelë procedurat e veta dhe kjo nuk bën të ndodhë e as nuk pranojmë të ndodhë.

Për sa i përket kërkesës së Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës ne jemi dakord që ajo të futet si pikë e rendit të ditës dhe të diskutohet, sepse natyrisht është edhe çështje urgjente edhe jashtëzakonisht e rëndësishme me të cilën duhet të merret Kuvendi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zenun, mbase nuk më mëson edhe ti, Arben veç ty të kam pasur mësues, m'u ka bërë edhe Visari tash mësues për t'i udhëhequr seancat, o, ju jeni shumë të mençur, por populli nuk po e di.

Më së pari ende as Zenuni s'e ka marrë fjalën, Visar, nuk të kam zvogëluar, po ngadalë, t'i edhe kështu je i madh, pastaj "6+". Janë vetëm propozimet që po i jap unë një herë, pastaj i bartim, në fund të fundit, proceduralisht shkojmë në votim, ju e vendosni, unë s'e kam ndërmend t'i vendos. Zenun Pajaziti, kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, por kisha kërkuar edhe a do të procedojmë me votim se tash janë pyetjet, do ta pyes pastaj prapë secilin kryetar të grupit parlamentar ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. A do të shkojmë në votim, se do të shkojmë në votim për këto.

I kemi disa propozime, unë do ta vë secilin prej saj pastaj një nga një.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Kryeministër, zëvendëskryeministra,

Kabinet i Qeverisë,

Kolegë deputetë,

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, po ashtu kërkoj që të futet në rend dite një njoftim për plotësim në Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë. Në vend të deputetit Fadil Demakut propozohet deputeti Fatmir Shurdhaj. Zonja Ganimete Musliu të vazhdojë të jetë zëvendëskryetare e komisionit dhe po ashtu, meqenëse e mora fjalën tash është koha e qëndrimit, e deklarimeve për sa u përket propozimeve që u dhanë.

Meqenëse këtu pati kërkesa që të jemi më të vëmendshëm për punën e buxhetit, mendoj dhe pajtohem me propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të LDK-së që duhet të hiqen sot në këtë seancë dy pikat e para të rendit të ditës, në mënyrë që deputetët të kenë më shumë kohë të përqendrohen në buxhet. Mendoj që është krejtësisht normale dhe e arsyeshme kjo dhe po ashtu edhe pika tjetër që ka të bëjë për debatin.

Si grup parlamentar e mbështetim këtë propozim, në mënyrë që t'u japim kohë deputetëve që të fokusohen shumë sot në buxhetin. Po ashtu, sa i përket propozimit të zotit Pal Lekaj, mendoj që ndoshta do të ishte mirë nëse ka ndonjë pajtim brenda nesh që në qoftë si debat, qoftë si interpelancë, kjo të bëhet nesër, meqenëse e kemi një seancë ku do të adresohet presidenti. Do të kemi kohë, do të jetë moment më i mirë që një pjesë të debateve pra ta shtyjmë për nesër. Nëse ka ndonjë dakordim, ne mund të pajtohemi në këtë drejtim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Do të kaloj te partitë politike, më fal kryetar nuk u shprehët për Ligjin për faljen e borxheve, ishte një propozim nga kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës edhe nga zoti Bekim Haxhiu, Ligji për parandalimin e dhunës në sport. A t'i fusim sot, pastaj do të shkojmë në votim.

Para se të dilni edhe te qëndrimet e interpelancës, zoti Pal Lekaj, ndërkohë ne edhe bashkëbiseduam me kryeministrin e Republikës së Kosovës, ai e ka shprehur gatishmërinë e plotë që në një seancë plenare të futet pjesa e çështjes, e cila ka të bëjë për murin në veri dhe ajo do të ishte më e mira të ishte në orët e pasdites nesër. Kjo është kërkesa edhe e kryeministrit ta kemi parasysh, por jo që të shkojë më larg, nesër.

Në orën 14:00, apo në 15:00? Vetëm ta kemi parasysh, të bëj edhe një njoftim të kryeministrit, çka është mirë ta kemi parasysh si vetiniciativë e kryeministrit për çështjen e tillë. Urdhëro, zoti Pal Lekaj.

PAL LEKAJ: Kryetar, ne si grup pajtohemi që nesër të mbahet seanca pasdite sa i përket murit ilegal në veri të Mitrovicës.

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar! Unë do ta fus në votim prapë, a ka mundësi të shkojmë me grupe parlamentare, vetëm t'i marr qëndrimet e propozimeve, se unë nuk do ta anashkaloja asnjë grup parlamentar.

Zoti Pajaziti, vetëm është çështja Ligji për faljen e borxheve, Projektligji për parandalimin e dhunës në sport, këto dy janë. Edhe ky qëndrimi vetëm të jetë qëndrim i grupit parlamentar.

ZENUN PAJAZITI: Po, ne e mbështetim si grup parlamentar.

KRYETARI: Faleminderit! Ismet Beqiri, kryetar i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit! Po ashtu, ne e mbështetim që interpelanca për çështjen e murit të mbahet nesër në orën 15:00 dhe po ashtu i mbështetim edhe propozimet që u bënë nga deputeti Bekim Haxhiu që të futet Projektligji për parandalimin e dhunës në sport. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Albulena Haxhiu e ka fjalën në emër të Grupit Parlamentar Lëvizja “Vetëvendosje”.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Së pari, më duhet të them që kjo seancë është dashur të fillojë në orën 10:00 dhe tash jemi afër orës 11:00 dhe është komplet e panevojshme ose e paarsyeshme, sepse çdoherë po vonohemi kështu për shkak se brenda kësaj ore do të kryheshin edhe deklarimet jashtë rendit, edhe pyetjet parlamentare.

E dyta, është e pakuptueshme se si këtu në këtë seancë po propozohen që të hiqen nga rendi i ditës disa pika për shkak se s'paskeni kohë që t'i shqyrtojmë. Në ndërkohë po shtohen pika tjera, nuk e kuptoj këtë logjikë të mbrapshtë të partive të mazhorancës.

Dhe, tjetra, sa i përket propozimit të Ismet Beqirit për heqjen nga rendi i ditës së pikës 10. Dua t'ia kujtoj Ismet Beqirit që të vetmit që e kanë të drejtën për ta hequr këtë pikë nga rendi i ditës është Lëvizja “Vetëvendosje”, sepse ne jemi sponsorizuesit e kësaj pike. Pra, unë ju kisha lutur që të konsultoheni edhe me Administratën e Kuvendit, përkatësisht sekretarin e Kuvendit për faktin se në interpretim të Rregullores së Kuvendit nuk ka të drejtë që një çështje, të cilën ne e kemi sponsorizuar, të kërkohet nga një grup tjetër parlamentar që të hiqet nga rendi i ditës.

Pra, ne kërkojmë që kjo pikë, pra pika 10, të mos vendoset fare në votim, sepse LDK-ja nuk ka të drejtë ta bëjë një propozim të tillë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Pal Lekaj për propozimet tjera. Zonja Teuta Haxhiu, fjala për ju.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Domethënë sa i përket propozimit të kolegut zotit Bekim Haxhiu ne pajtohemi ngaqë Ligji për sponsorizime dhe dhunën në sport është vonuar shumë, domethënë për fajin e Qeverisë njëkohësisht edhe për fajin e vetë pozitës, të cilët nuk kanë qenë të gatshëm që dy vjet e sa të kalojnë këto ligje.

Prandaj, ne pajtohemi që sot të hyjë në rend të ditës dhe të kalojnë në mënyrë që t'i kontribuojmë, pra sportit edhe ashtu që është në gjendje shumë të brishtë. Faleminderit!

KRYETARI: Edhe Projektligji për faljen e borxheve? Ok! Faleminderit! Nga "Nisma", zonja Valdete Bajrami, fjala për ju.

VALDETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!

Zafiri e tha, por unë prapë po e përsëris: "Nisma për Kosovën" është kundër heqjes së pikës së parë dhe të dytë të rendit të ditës.

Është për të të ardhur keq se si koalicioni i ka votat për t'i hequr këto dy pika, por kur po vjen puna për çështje të rëndësishme koalicioni nuk po i ka votat. Ju e dini që në seancën e fundit, më 28 tetor, i keni votuar qysh në seancën që e lamë pas. Domethënë, kjo tregon se sa jeni duke i dhënë seriozitet hapësirës së zërit opozitar dhe zërit të qytetarëve që ta shfrytëzojnë këtë periudhë për t'i deklaruar të gjitha dështimet që kjo Qeveri i ka pasur.

Prandaj, jemi kundër kësaj pike dhe nuk guxoni t'i hiqni përderisa ne kemi çka të themi për punën dhe mospunën tuaj.

KRYETARI: Për hir të korrektësisë së publikut, këto janë vetëm qëndrime politike. Proceduralisht, ne veprojmë në respektimin e Rregullores së Kuvendit, unë po e shoh që shpeshherë po kontestohet mbarëvajtja e punimeve të seancës, për hir të opinionit publik, këto janë vetëm qëndrime politike.

Seanca parlamentare i heq dhe i sjell çfarë të dojë. Ju do ta vendosni, në fund do ta votoni. "6+" ju kisha lutur! Lista serbe? Urdhëroni, zoti Slavko Simiq!

SLAVKO SIMIĆ: Hvala, predsedniče!

Poslanica grupa Srpske liste podržava predlog Demokratske partije Kosova i Demokratskog saveza Kosova. Zahvaljujem!

KRYETARI: Në ndërkohë po insiston, pasi iu ka përmendur emri sekretarit për Lëvizjen “Vetëvendosje”. Unë nuk do ta lexoj të gjithën, referohuni ju nenit 50 të Rregullores së Kuvendit për çështjen në fjalë. Sido që të jetë, për hir të korrektësisë.

“6+”, zonja Duda Balje, fjala për ju.

DUDA BALJE: I parlamentarna Grupa “6+” podržava prolog PDK-a.

KRYETARI: Faleminderit! Unë do t’i ndaj në dy pjesë votimet, heqja e pikës të parë dhe të dytë nga rendi i ditës me propozim të kryetarit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Do të votojmë me aklamacion, apo si?

Kush është për heqjen e pikës së parë dhe të dytë nga rendi i ditës?
Ju lutem, kush është për?

Jemi 92 deputetë janë të pranishëm në sallë. Kush është për, ju lutem me ngritje të dorës?
A mund të procedojmë, Administrata?
Kush është kundër? 53 kanë qenë për.
Kundër? 21 deputetë janë kundër.
A ka abstenim? Nuk ka!

Në sallë janë 92 deputetë të pranishëm. Kanë votuar 53 për t’i larguar dy pikat e rendit të ditës një dhe dy dhe 21 deputetë kanë votuar kundër. Kështu që me vendimin e seancës plenare largohen pikat një dhe dy nga rendi i ditës sot. Jemi te propozimet, futja në rend të ditës:

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për faljen e borxheve, propozim i Ismet Beqirit, kryetar i Grupit Parlamentar,
2. Shqyrtimi i dytë të Projektligjit për parandalimin e dhunës në sport, propozim i Bekim Haxhiut.

Të nderuar kolegë deputetë, kjo mund të futet në qoftë se e përfundoni ju sot edhe në qoftë se votohet për seanca komisioni parlamentar duhet ta sjellë raportin, pa e sjellë raportin kot e kemi votuar. Por, ne do ta votojmë në qoftë se e sjell, pastaj pasdite e procedojmë. Do të thotë, edhe propozimi juaj:

3. Heqja e pikës së dhjetë, po ashtu propozim i kryetarit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe

4. Debati parlamentar lidhur me murin në veri për ditën e nesërme, në orën 15:00.

Po shkojmë që të gjitha këto propozime, t'i votojmë bashkërisht.

Kush është kundër? Po doni një nga një, ok! Në rregull!

Atëherë, shkojmë kështu: futja në rend të ditës - Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për faljen e borxheve.

Kush është kundër? Do ta marr të mirëqenë, të gjithë janë për këta çka nuk votojnë në qoftë se e kanë pajtueshmërinë e seancës në çdo votim.

Atëherë, futet pikë e rendit të ditës: Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për faljen e borxheve.

Shkojmë me pikën e dytë: Heqja e pikës së dhjetë.

Kush është kundër për ta hequr pikën 10? 21 deputetë janë kundër.

Abstenim, a ka? Kush është për? Më mirë të votojmë, se kemi shumë deputetë. Për? Ngriheni dorën për heqjen e pikës së dhjetë.

21 janë kundër. Abstenim s'ka.

Kush është për?

94 deputetë janë në sallë. Në qoftë se nuk i kemi 60 deputetë në votim, ne nuk e numërojmë fare. 30 vetëm janë lajmëruar për. Do të shkojmë ta votojmë edhe një herë, është shansi i dytë, ose mbetet kjo.

Të nderuar kolegë deputetë, nuk ka vendimmarrje me 51 deputetë. Mbetet pikë e rendit të ditës, në qoftë se nuk votohet. Atëherë, a shkojmë në mënyrë elektronike? Shkojmë në mënyrë elektronike. Nuk ka interpretim.

Të nderuar kolegë deputetë, jemi në propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zotit Ismet Beqiri, heqja e pikës 10-të nga rendi i ditës. Lus regjinë dhe deputetët të përgatitemi për votim. Votojmë tash!

80 deputetë kanë votuar, 59 janë për heqjen e pikës 10-të nga rendi i ditës, 13 janë kundër, 8 kanë abstenuar, edhe dy i kemi atëherë 61. Hiqet nga rendi i ditës pika 10.

Propozimi i Bekim Haxhiut, shqyrtimi i dytë i Projektligjit për parandalimin e dhunës në sport, duhet të bëhet me shmangie nga Rregullorja, në qoftë se futet si pikë e rendit të ditës, do të thotë jemi në votim. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

81 deputetë kanë votuar, 71 janë për shmangie nga Rregullorja për futjen në rend dite Shqyrtimin e dytë të Projektligjit për parandalimin e dhunës në sport, 7 janë kundër, 3 abstenime, me dorë janë dy për. Do të thotë kemi të bëjmë me 73 vota për, futet si pikë e rendit të ditës.

Jemi në votimin e propozimit të kryetarit të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zotit Pal Lekaj, debat parlamentar, nesër seancë e re parlamentare për murin në veri. Lus kolegët deputetë të përgatiten për votim!

Kryeministri i Republikës së Kosovës ka kërkuar që të kemi debat nesër në orën 15:00. Ka qenë pranim. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

87 deputetë kanë votuar, 83 janë për, 4 janë kundër dhe kemi asnjë abstenim. Nesër do të kemi seancë të rregullt plenare, debati për murin në Mitrovicë në orën 15:00.

Më lejoni, para se të vazhdojmë me seancën plenare, i nderuar kryetar i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Ismet Beqiri, e keni ngritur leximin e parë dhe të dytë sot, pa e kryer leximin e parë nuk mund të kalojmë. Atëherë, duhet seancë të rregullt plenare sot të kemi. A dëshironi të kemi votim edhe për këtë?

Lus regjinë deh deputetët të përgatiten për votim, seancë të sotme plenare pas përfundimit të kësaj, për leximin e dytë të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2017. Votojmë tash!

Kemi 88 deputetë në mënyrë elektronike dhe 2 me dorë, 90 deputetë që kanë votuar, 64 në mënyrë elektronike plus 2 me dorë janë për, që të kemi seancën plenare sot për Projektligjin e Buxhetit leximi i dytë për vitin 2017, 66 për do të thotë, 24 kundër, 1 abstenim. Sot do të kemi seancë plenare pas përfundimit të kësaj seance për leximin e dytë të Buxhetit.

Zoti Slavko simiq, fjala për ju. Si grup parlamentar, ju kisha lutur. Nuk është ai pak, ka njoftim. Ju lutem, kolegë të nderuar deputetë, pak mirëkuptim, kemi bashkëjetuar ka dy vjet. Urdhëroni, zoti Simiq, çfarë ke për të thënë. Urdhëro! Ju lutem, mos të krijojmë situatë. Daut të lutem! Çdokush ka të drejtë ta shprehë mendimin. Zoti Simiq, urdhëro, vazhdoje fjalën!

(Reagime në sallë)

SLAVKO SIMIĆ: Ja vas molim za malo poštovanje!

Hvala predsedniče!

Poštovani predsedniče Vlade,

Poštovane kolege poslanici,

U samom početku želeo bih da obavestim predsednika Skupštine da od 20 decembra ove godine Poslanički klub broji 9 članova, s time što su isključeni s poslaničkog kluba zbog cele političke krize unutar Srpske Liste, gospodin Nenad Rašić i gospodin Adem Hodža.

Dozvolite mi da vam se obratim u vezi povratka Srpske liste u današnjem radu skupštinske sednice.

Poštovane kolege,

Posle duže vremena danas nas vidite u skupštinskim klupama i želim da znate da politički uslovi za nas povratak još uvek zaista realno nisu ispunjeni, jer svi moraju da budu svesni koliko je teško vratiti se u institucije gde se politički ignorišu potrebe vaše zajednice i gde se politički ignorišu prava vaše zajednice.

Poručujem kolegama iz parlamenta, članovima Vlade i međunarodnoj zajednici da je ovo poslednji pokušaj provere demokratije na Kosovu. Shvatite nas i prihvatite kao partnere ali ne samo na papiru, kao što je to do sada i bilo.

Svi zajedno moramo menjati sve naboje, počevši od naše komunikacije i uvažavanja naših mišljenja. Srpska lista će preko svojih političkih predstavnika nastaviti dosledno da se bori za prava srpske zajednice i borićemo se isključivo preko centralnih institucija i tako ispuniti naš cilj a to je jače institucionalno pozicioniranje i poštovanje svih prava srpskog naroda, koji živi ovde na Kosovu.

Želim takođe da znate, da Srpska lista nastavlja snažno da bude protiv Zakona o Trepči i Zakona o strateškim investicijama, zakoni koji su usvojeni bez konsultacija sa srpskom zajednicom i koja je bila izuzeta iz svakog procesa odlučivanja. Dakle, sigurno da su to zakoni koji ugrožavaju interese i opstanak Srba na Kosovu, ali da bismo bili u mogućnosti da branimo naše vitalne interese mi moramo da se vratimo i borimo ovde u institucijama i dalje da pružamo otpor ovim zakonima, koji zaista nisu dobri za srpsku zajednicu.

Samo preko našeg direktnog učešća možemo da budemo u poziciji da branimo interese našega naroda i da zajednički sa našim partnerima radimo za bolju budućnost svih građana. Naši koalicioni partneri treba da znaju da samo iskrenim i zajedničkim radom možemo prevazići ključne probleme i tako razvijamo naše zajedničke interese a naš zajednički interes treba da bude gradnja naše budućnosti i povratak poverenja našim građanima koji ovde žive.

Želim da poručim koalicionim partnerima da ću sigurno, kao šef parlamentarne grupe Srpske liste, konstantno vršiti pritisak gotovo na svakoj sednici skupštine i tražiti da se do kraja ispoštuje koalicioni dogovor, a isto tako da se ispoštuje i dogovor postignut u Briselu u vezi formiranja Zajednice srpskih opština. To je prioritet našeg budućeg rada i našeg budućeg delovanja a isto

tako očekujem da naši koalicioni partneri, Demokratska partija Kosova i Demokratski savez Kosova ispoštuju dogovore i odmah pokrenu proces formiranja Zajednice srpskih opština.

Srpska lista će veoma biti aktivna i dati sve od sebe da se ispoštuje osnovni princip Briselskog sporazuma, koji se tiče zajednice srpskih opština i da se nastavi proces koji će dovesti do njenog skorog formiranja.

Vi, gospodine Mustafa i vi gospodine Kadri Veselji, nadam se da ćete najzad prvobitno da ispoštujete srpski narod koji živi na Kosovu, nadam se da ćete da ispoštujete naš koalicioni dogovor i ispunite sve vaše obaveze, koje proizilaze iz Briselskog sporazuma.

Takođe, očekujem da i vi preuzmete odgovornost, koji je preuzeo i predsednik Vlade Republike Srbije, gospodin Aleksandar Vučić, koji odgovorno implementira i poštuje sve principe Briselskog sporazuma, čak i one oko kojih je pristajao na teške kompromise. Očekujem da prestanete da koristite kao izgovor opoziciju, jer i u Beogradu postoji opozicija, ali gospodin Aleksandar Vučić ume da se bori sa tim, jer ima viziju budućnosti i ima viziju pomirenja.

Osim toga, danas smo u procesu glasanja za Budžetsku godinu, odnosno Budžetsku 2017-u godinu i smatramo da je naše prisustvo danas u procesu kreiranja i odobrenja budžeta ključno što se tiče javnih investicija u srpskim sredinama i ministarstvima na čijem čelu su poslanici, odnosno naši članovi vlade.

Vreme za gubljenje i prepucavanja u medijumima više nema, zato moramo da se vratimo poslu da bismo ispunili sve ono što smo obećali našim građanima. Zato, još jednom ponavljam, predsedniče Vlade, mislim da je krajnje vreme da se krene u proces formiranja zajednice srpskih opština, da budete odlučniji, da preuzmete odgovornost a mi ćemo stati uz vas i dati vam punu podršku, uključiti se u taj proces i želim da kažem i albanskoj javnosti i svim albanskim političkim liderima da prestanu da pružaju otpor Briselskom sporazumu, da prestanu da pružaju otpor Zajednici srpskih opština, jer ključ opstanka srpskog naroda koji ovde treba da živi na Kosovu i da živi zajedno i da gradi budućnost sa Albancima jeste buduće formiranje Zajednice srpskih opština. Zahvaljujem!

KRYETARI: Faleminderit, kryetar i Grupit Parlamentar i Listës serbe! Faleminderit për kthimin! Kishim kërkuar që të gjithë të vijnë në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Shteti ynë është i përbashkët, obligimet janë të përbashkëta, ky është vendi ku mund t'i shprehim edhe shqetësimet edhe pakënaqësitë, të cilat mund të jenë edhe për edhe kundër. Kështu që, kthimi në institucione inkurajoj edhe kolegët tjerë deputetë, që të vijnë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, të punojmë bashkërisht për forcimin e institucioneve, për forcimin e shtetit të Kosovës. Faleminderit!

Kolegë deputetë, Visar Ymeri dhe Teuta Haxhiu, një prej Grupit Parlamentar se s'bën më shumë. Faton, dëshiron ti apo kryetari? Urdhëro, kryetar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, edhe Teuta Haxhiu pastaj e merr fjalën dhe futemi në seancë.

VISAR YMERY: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës, Tash, këtë pikë të rendit të ditës po e quajmë “njoftime”, jo deklarime. Por, sidoqoftë edhe unë e kam një njoftim, që në harkun kohor të një jave i patëm dy rezultate, secilin më katastrofik se tjetrin. E kam fjalën për dy gjëra që kanë ndodhur gjatë kësaj jave, në njërën anë licencimi i paligjshëm i Telekomit shtetëror të Serbisë brenda Kosovës, si dhe në anën tjetër zhvatja e 30 milionë erove në Arbitrazh nga kompania “Dardafon”, e njohur si Z-Mobile.

Secili nga rezultatet e kanë fillin shumë më herët se tash, por me të dyja këto procese lidhet, pa dyshim Hashim Thaçi dhe klani “Pronto” i PDK-së. Prej shpalljes së pavarësisë, e madje edhe më herët, në vend se të mbylleshin operatorët ilegalë të Serbisë në Kosovë dhe të aplikohet Rezoluta e Kuvendit për aplikimin e kodit +355 në Kosovë, kjo çështje u fut në negociata me Serbinë. Dhe, natyrisht se ku negocion me Serbinë sektorë të kësaj rëndësie strategjike për sovranitetin dhe ekonominë e vendit, në fund përfundon duke zyrtarizuar kompaninë famëkeqe të Serbisë në Kosovë dhe duke marrë njëkohësisht një kod gjeografik, që e fut telekomunikacionin e Kosovë nën atë të Serbisë.

Në anën tjetër, historia e kontratës kriminale që është bërë në mes të PTK-së dhe Dardafonit apo Z-mobile është diskutuar edhe në këtë Kuvend. Dhe, atëbotë, ministri Ahmet Shala, personazhi që ia realizoi Hashim Thaçit të gjitha punët e pista në ekonomi, deklaronte se gjithçka është bërë sipas ligjit, ani pse Z-Mobile, një kompani private, do të përdorte gjithë infrastrukturën e kompanisë publike dhe do të merrte 73% të fitimit kundrejt 27% që ia linte PTK-së.

Për këtë kontratë të dëmshme u patën hapur edhe hetime të bujshme që u mbyllën në heshtje nga EULEX-i. Teksa çdokush me mendje normale do të priste përfundimin dhe shkëputjen me themel të kësaj kontrate skandaloze, ndodh krejt e kundërta. Kjo kompani, bashkë me eksponentë të pushtetit sajojnë precedent të mosrespektimit të kontratës që do të duhej të hetohej dhe ndërtohet një rast kundër kompanisë publike në arbitrazh, rast i cili rezultoi në fund me një gjobë 30-milionëshe kundrejt PTK-së, e si fitim për një kompani private, pra për klanin “Pronto”, në këtë rast të përfaqësuar nga kompania “Devolli”.

Vetëm ta kemi parasysh. Një ministër tjetër i punëve të pista të Hashim Thaçit dhe të PDK-së, Besim Beqaj, e pati shitur kështu dhe rrjetin tonë të shpërndarjes dhe të energjisë elektrike për vetëm 26 milionë euro.

Secila prej këtyre që i përmenda më lart, e plot të tjera, duhet dhe do të jenë objekt i hetimit të detajuar. Paratë që ia keni zhvatur këtij vendi, me kontrata të këtij lloji, apo me marrëveshje me

partnerët tuaj në Serbi jo vetëm që s'do t'i gëzoni, po do të detyroheni t'i ktheni shumëfish. Nuk do të ketë asnjëherë as amnisti e as vjetërsim të këtyre krimeve dhe krimeve të ngjashme që i ka bërë ky klan, të cilat po e shkatërrojnë Kosovën. Faleminderit!

KRYETARI: Zonja Teuta Haxhiu, urdhëroni, merreni fjalën! Në ndërkohë i kisha ftuar kolegët deputetë të kthehen në seancë, të vazhdojmë me buxhetin.

TEUTA HAXHIU: Kryetar i Kuvendit, pak më herët këtu u votua që dy pika të rendit të hiqen nga rendi i ditës.

Ju lejuat pak më parë që ta marrë fjalën një deputet i Republikës së Kosovës sado që trupin e ka brenda Republikës së Kosovës, konkretisht në Kuvendin e Kosovës, por mendjen dhe politikat janë nga Beogradi.

Këtu, në foltoren e Kuvendit të Republikës së Kosovës, pra para deputetëve, para Qeverisë tha që ne kemi ardhur këtu, sepse na ka dërguar Vuçiqi.

Kush është Vuçiqi këtu? Këtu është Republika e Kosovës. Ju, deputetë të Listës serbe, sado që keni mbetur tash në 5 deputetë, duhet të dini, jeni brenda Republikës së Kosovës.

Nëse doni të jeni atje në Beograd, shkoni atje. Atje konkurroni për deputetë.

Qeveria e Republikës së Kosovës, ju kryetar, nuk do të duhej, pra, as t'i jepni fjalën, e aq më tepër të flitet për Ligjin për Trepçën. Ka përfunduar! Ka përfunduar ajo kohë dhe asnjëherë mos mendoni se do të kthehet. Ka përfunduar, sepse vota i është dhënë këtu, në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Politikat mund t'i bëni, mund t'i keni sugjerimet nga Vuçiqi. Ndoshta ato gjejnë prehje te Edita, te kryeministri dhe te Qeveria, por kurrë jo këtu, brenda kësaj hapësire.

Nuk guxoni e as nuk doni të mendoni për Asociacionin e komunave serbe. Gjykata e ka dhënë një vendim dhe është një ëndërr për juve. Harrojeni!

Lidhuni me komunitetin këtu, në Kosovë. Jo të mendoni për komunitetin serb në Beograd. Nëse jeni deputetë që mbron interesat e komunitetit serb në Kosovë, duhet të tregoni se jeni deputetë për interesin e tyre, e jo të vini me politika dhe këtu ta shfrytëzoni, ta keqpërdorni foltoren e Kuvendit dhe të thoni se Vuçiqi na ka dërguar këtu, prandaj po vijmë me dirigjimin e Vuçiqit.

Dhe Qeveria, edhe kryetari i Kuvendit këtu, e miraton një gjë të tillë. Kjo është skandaloze, të nderuar deputetë.

Këtu po luhet me ndjenja tona. Po luhet me të gjithë ne deputetët. 2-3 deputetë të Listës serbe po luajnë me ndjenjat tona.

Këtu është Republika e Kosovës. Duhet ta harrojnë, të nderuar dhe mos e keqpërdorni as ju pozitën, kryetar, as Qeveria të lejojë të lejojë, pra edhe një herë t'i mbyllë sytë para këtyre fjalëve, para këtyre informatave, të cilët po bëjnë politikë, por po tregojnë edhe një herë se ata janë kthyer me sugjerimin e Vuçiqit. Sikurse shumë herë, agjendën në Bruksel e ka vënë në pah Vuçiqi dhe normalisht se të gjitha bisedimet që kanë rrjedhur deri më sot kanë shkuar në agjendën e Vuçiqit. Pra, është miratuar edhe prej Qeverisë, fatkeqësisht Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Pra, edhe një herë Lista serbe duhet të kthehet dhe o të mendojë për qytetarët serbë në Kosovë, o të shkojë në Beograd, atje le të bëhen deputetë.

KRYETARI: Faleminderit! Sikur të kishim qenë në shekullin XIX e kishim shpallur edhe një herë pavarësinë. Më mirë, qetë dhe të mos shkohet në ekstreme të tilla, sepse s'jemi duke u ndihmuar institucioneve e as shtetit të Republikës së Kosovës. Mund të flasim, por vetëm po e dëmtojmë këtë vend.

Sido që të jetë, vazhdojmë seancën.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ka marrë vendim që ta bëjë këtë propozim për Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe në vend të deputetit Fadil Demaku, propozohet deputeti Fatmir Shurdhaj.

3. Miratimi i procesverbalit nga seancat e mëparshme

Nëse keni vërejtje në procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 30 nëntor dhe 1 dhjetor 2016, urdhëroni!

Nuk ka vërejtje. Konstatohet se Kuvendi e miratoi procesverbalin e seancës plenare, të mbajtura më 30 nëntor dhe 1 dhjetor 2016.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017

Të nderuar kolegë deputetë, në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar ta miratojë.

Procedimi i mëtejshëm vazhdon si vijon.

E ftoj ministrin e Financave, zotin Avdullah Hoti, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe ta arsyetojë projektligjin. Urdhëroni, zoti ministër!

MINISTRI AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

I nderuar kryeministër,

Kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni të prezantoj para jush Propozim-buxhetin për vitin 2017, i cili reflekton përkushtimin tonë në adresimin e sfidave zhvillimore si dhe në zbatimin e reformave dhe projekteve specifike bazuar në objektivat e Qeverisë për zhvillim ekonomik dhe mirëqenie sociale.

Procesi i përgatitjes së këtij buxheti ka filluar me kornizën afatmesme të shpenzimeve që është aprovuar në muajin prill të këtij viti.

Bazuar në këtë kornizë ne kemi përgatitur instruksionet buxhetore për të gjitha organizatat, kemi zhvilluar dëgjime buxhetore me të gjitha organizatat dhe sivjet për herë të parë dëgjimet buxhetore janë zhvilluar edhe me shoqërinë civile për të marrë opinionet dhe vlerësimet e tyre.

Si rezultat i këtij procesi, buxheti për vitin 2017 adreson prioritetet zhvillimore të deklaruara nëpërmjet dokumenteve strategjike që tanimë i kemi në fuqi, duke filluar prej programit qeverisës, prej strategjisë kombëtare për zhvillim, programit të reformave ekonomike që e dorëzojmë në Komisionin Evropian çdo vit, kornizën afatmesme të shpenzimeve dhe plot strategji të tjera sektoriale.

Të nderuar deputetë,

Me gjithë ecuritë pozitive, vitet e fundit ne normalisht kemi shumë sfida për t'i adresuar, prandaj në këtë kontekst është e natyrshme që kërkesat për financim të jenë më të larta se sa mundësitë që ne i kemi për financim.

Parimet mbi të cilat është ndërtuar ky buxhet përfshijnë: ruajtjen e qëndrueshmërisë fiskale; sigurimin e financimit për projektet që janë në vijim e sipër; ruajtjen e një rezerve fiskale që është në nivele të mjaftueshme; rritjen e shpenzimeve kapitale, si zëri më produktiv buxhetor dhe eliminimi i barrierave dhe ofrimin e insentivave fiskale që avancojnë konkurrueshmërinë e sektorit privat.

Më lejoni të theksoj se ky buxhet ka pajtueshmëri të plotë të Fondit Monetar Ndërkombëtar. Ne jemi në program me këtë Fond deri në maj të vitit të ardhshëm dhe rrjedhimisht duhet të respektojmë dakordimin dhe kornizën që e arrijmë me ta sa u përket të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore.

Mbi këtë dakordim me Fondin Monetar dhe duke pasur parasysh ecuritë makro-fiskale, ne kemi përgatitur Projekt-buxhetin për vitin 2017.

Ne kemi marrë parasysh trendin e rritjes ekonomike në vitet e fundit që është një kapërcim i madh në dy vjetët e fundit, me një normë ekonomike rreth 4%, që është më e larta në rajon. Parashikimet tona janë që edhe viti 2017 do të ketë një normë së paku 4.4%, duke mos marrë parasysh plot projekte të mëdha kapitale që mund ta çojnë këtë rritje ekonomike përtej 4.4%, në veçanti potencialet që krijon tani Ligji për investime strategjike, Ligji i ri për Trepçën, kapacitetet e reja në energji dhe në fusha të tjera dhe plot reforma ekonomike e fiskale që i kemi ndërmarrë, si dhe reformat e reja, të cilat jemi tani duke i përgatitur.

Ne sivjet kemi pasur një kapërcim në këtë drejtim, që është treguar në Raportin e të bërit biznes të Bankës Botërore, ku kemi pasur kapërcim në rastin e reformave për pagesën e taksave për 34 vende, ndërkaq në rastin e Doganave për 8 vende.

Në vijim më lejoni të prezantoj shkurt projeksionet e të hyrave dhe të shpenzimeve.

Të hyrat e rregullta buxhetore për 2017 janë planifikuar 1 725 000 000 euro. Kjo përfaqëson një rritje prej 6% në raport me këtë vit dhe është një rritje prej 28%, krahasuar me fillimin e mandatit të kësaj Qeverie.

Kjo rritje ka ardhur 95% nga rritja e të hyrave të rregullta buxhetore të mbledhura nga tatimet vendore nga Administrata Tatimore dhe nga Doganat, të cilat në këto dy vjet kanë mbledhur 38 000 000 euro më shumë se sa më parë.

Kjo në total është një rritje në veçanti tek Administrata Tatimore prej 40% krahasuar me fillimin e mandatit të kësaj Qeverie dhe në Dogana për 27%, që është 239 000 000 më shumë se sa në fillim të mandatit.

Normalisht, një pjesë e madhe e të hyrave vjen edhe nga luftimi i ekonomisë joformale, ngase, siç po shihni, përqindjet e rritjes së të hyrave të rregullta buxhetore janë më të larta se sa norma e rritjes ekonomike vjetore.

Dhe këto rritje në të hyra vijnë pavarësisht efektit që kemi nga politikat fiskale, nga shumë lirime që kemi krijuar për të lehtësuar kushtet e të bërit biznes dhe nga implementimi i MSA-së nga prilli i këtij viti, që në total neve na i kanë reduktuar të hyrat për rreth 60 000 000 euro, por që e kanë rritur fuqinë blerëse të konsumatorëve dhe kanë përmirësuar kushtet e të bërit biznes.

Ndërkaq, të hyrat e tjera jotatimore mbesin pak a shumë të njëjta me këtë vit, duke qenë një burim i qëndrueshëm për financimin e shpenzimeve të atyre organizatave buxhetore që kanë të drejtë t'i përdorin këto të hyra të rregullta jotatimore.

Sa i përket shpenzimeve në vitin 2017 Propozim-buxheti parasheh shpenzime prej 2 000 000 000 euro dhe kjo është një rritje prej 38% krahasuar me fillimin e mandatit të kësaj Qeverie.

I kemi pasur dy objektiva kryesore kur e kemi projektuar këtë nivel të shpenzimeve. E para, që të vazhdojmë mbajtjen e shpenzimeve rrjedhëse nën kontroll, dhe si rrjedhim ne i kemi mbajtur shpenzimet rrjedhëse si përqindje e bruto prodhimit vendor nga 20,3% në 19,8% që bie në vitin e ardhshëm, ndërkaq të krijojmë hapësirë shumë më të madhe për investimet kapitale, por që janë mirë të targetuara nëpër sektorë sa u përket efekteve në ekonomi, në punësim, në ambient, në ambientin për biznes në përgjithësi, në potencialin zhvillimor, në kualitetin e jetës së qytetarëve dhe në çështje të tjera.

Buxheti për vitin 2017 mundëson që ne të implementojmë përfundimisht sigurimin shëndetësor, ku për vitin e ardhshëm kemi ndarë 17 000 000 euro, të implementojmë plotësisht Ligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti, të implementojmë plotësisht kompensimin për përvojën e punës për punëtorët në sektorin publik, të mbajmë lart nivelin e subvencioneve në bujqësi, me rritjen e investimeve kapitale tash në bujqësi, për të përmirësuar produktivitetin në këtë sektor; të ofrojmë pensione për veteranë dhe kategoritë e tjera të luftës, të akomodojmë plotësisht shpenzimet që kanë organizatat e ndryshme buxhetore sa i përket agjendës euro-integruese të Kosovës dhe të mbajmë lart financimin për sektorin e rendit dhe ligjit si përkushtim i kësaj Qeverie për të vendosur rend e ligj dhe për të luftuar informalitetin dhe dukuri të tjera negative.

Në buxhetin e vitit 2017 ne i adresojmë këto projekte specifike nëpër disa prej sektorëve më të rëndësishëm.

Në fushën e shëndetësisë është paraparë ndërtesa e Mjekësisë së sportit, Klinikës së fiziatriisë, Klinika e ortopedisë, disa spitale nëpër regjione, Qendra emergjente në Prishtinë dhe projekte të tjera.

Në fushën e arsimit parauniversitar parashihet ndërtimi i 15 shkollave të reja nëpër komuna dhe financimi i plot projekteve që janë në vijim për vite me radhë.

Në arsimin e lartë parashihet ndërtimi i disa objekteve të universiteteve në vlerë prej 4,8 milionë eurosh dhe në veçanti po përmend ndërtesën e Fakultetit Ekonomik në Prishtinë, Konviktin e Studentëve në Qendrën e Studentëve në Prishtinë dhe ndërtesën për dy fakultete në Universitetin e Mitrovicës.

Në infrastrukturë vazhdojmë financimin e plotë të autostradës Prishtinë-Hani i Elezit. Është ndarë buxhet adekuat për të përfunduar projektet rajonale të rrugës Mitrovicë-Pejë, rrugën Komoran-Drenas-Skenderaj, rrugën për Podujevë dhe rrugë të tjera që janë të rëndësishme nacionale.

Planifikojmë të fillojmë autostradën për Gjilan. Për ndërtimin e rrugëve të reja janë ndarë 16 000 000 euro, për mbi 90 projekte që lidhin fshatrat dhe regjionet e Kosovës anembanë.

Për Forcën e Sigurisë janë paraparë pajisje për ristrukturim të Forcës së Sigurisë në shumën prej 18,5 milionë eurosh.

Investime në infrastrukturën sportive janë paraparë për të përmbyllur projektet e sallave dhe fushave sportive që kanë filluar tash e sa vjet, ndërtimin e stadiumit nacional në Prishtinë, pishina olimpike dhe objekte të tjera që mundësojnë ndërkombëtarizimin e sportit.

Në fushën e trashëgimisë kulturore janë paraparë projekte prej 2,4 milionë eurosh.

Në bujqësi parashihen projekte për rritjen e produktivitetit dhe punësimit në bujqësi, siç janë sistemet e ujitjes, pyllëzimi dhe ngritja e kapaciteteve në Ministrinë e Bujqësisë për të implementuar programin “Ipar” të Komisionit Evropian.

Në fushën e ambientit janë 9.1 milionë euro në menaxhimin e burimeve ujore, në veçanti për rregullimin e shtretërve të lumenjve në 20 komuna. Akumulimi i ujit liqë, në lumin Ibër në Mitrovicë, janë ujërat e zeza në lumin Bistrica në Prizren dhe është Fabrika e ujërave të zeza në Pejë.

Në fushën e mbeturinave janë ndarë 3 milionë euro për projekte të ndryshme.

Kemi ndarë 4 milionë euro për të përkrahur projektet kapitale të ndërmarrjeve publike në gjithë Kosovën.

Vazhdojmë të mbështesim Trepçën në projektet kapitale me vlerë prej 1,7 milion euro.

Kemi ndarë buxhet pak më të lartë për shpronësime nëpër të gjitha institucionet publike që kanë nevojë të shpronësojnë tokë private për projekte me interes publik.

Për projekte të efikasitetit të energjisë kemi ndarë 6,5 milionë euro.

Për projekte në sektorin e ushqimit dhe veterinës, siç është Fabrika për riciklimin e mbetjeve, pastaj projekti për luftimin e etheve hemorragjike, regjistrimi i stokut të bagëtive dhe projekte të ndryshme.

Në fushën e financave projekti më i madh kapital është ndërtesa për Agjencinë e përbashkët të Doganës dhe të ATK-së si dhe investime në sistemin e AIT-së për të avancuar më tutje teknologjinë informative sa i përket ndërlidhjes së sistemeve që ka Dogana, Administrata Tatimore, Thesari dhe buxheti i shtetit.

Parashihet ndërtimi dhe funksionalizimi i disa zonave ekonomike në mbarë Kosovën.

Në Administratën Publike parashihen ndërtimi i objektit të Institutit për Administratë Publike.

Në fushën e rendit dhe të ligjit parashihet ndërtimi i objekteve të prokurorive dhe gjykatave nëpër qendra të ndryshme të Kosovës.

Stacione të reja të policisë që u përmend më herët dhe projekte të tjera.

Kemi ndarë 3,5 milionë euro si kontribut i Qeverisë së Kosovës për projekte që mbështeten me programin IPA dhe kemi ndarë 7 milionë euro për projekte për kthim dhe integrim të të kthyerve, si dhe shumë projekte nëpër sektorë të ndryshëm.

Nëse i shkojmë këto shpenzime sipas kategorive ekonomike, do të vëreni që është përmirësuar struktura e shpenzimeve, pasi pagat dhe mëditjet që arrijnë në 570 milionë euro, rriten vetëm me 3,8%, mallrat dhe shërbimet rriten me 8,2%, subvencionet dhe transferet më 1,7%, ndërkah rritjen më të madhe e kanë investimet kapitale që krahasuar me këtë vit rriten me 45% dhe krahasuar me fillimin e mandatit të kësaj Qeverie rriten me 77%.

Me këtë qasje të investimeve kapitale ne rrisim pjesëmarrjen e investimeve publike në bruto prodhimin vendor nga 7%, sa ka qenë në fillim të mandatit, në 11% të bruto prodhimit vendor dhe total investimet publike dhe private arrijnë në 2 miliardë euro gjatë vitit të ardhshëm. Si përqindje e bruto prodhimit vendor investime totale, pra publike dhe private, rriten nga 25% në 31% të prodhimit vendor.

Sa i përket buxhetit në nivel të organizatave i kemi dhënë rëndësi në veçanti atyre projekteve kapitale që i përmenda më herët dhe institucionet e rendit dhe të ligjit, për shembull, Këshillit Prokurorial i është rritur buxheti me 12%, Këshillit Gjyqësor me 5%, Ministrisë së Punëve të Brendshme me 3%, Forcës së Sigurisë me 9%, nëpër ministri përkatëse, në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë me 34% për shkak të zonave ekonomike, në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, të

Punëve të Brendshme që përmenda më herët, të Drejtësisë dhe të Punëve të Jashtme dhe nëpër sektorë të tjerë pa hyrë në detaje.

Sa i përket buxhetit të komunave, ju informoj që për herë të parë komunat i kanë aprovuar buxhetet e tyre, të gjitha komunat pa përjashtim sipas qarkoreve buxhetore të lëshuara nga Ministria e Financave.

Buxheti total i komunave për vitin e ardhshëm do të jetë 440,2 milionë euro që është një rritje prej 15 milionë krahasuar me këtë vit dhe që është rritje krejtësisht për shkak të rritjes së granteve qeveritare nga rritja e të hyrave të rregullta buxhetore që kemi pasur.

Buxheti i komunave merr pjesë me 22% në shpenzimet e përgjithshme qeveritare dhe unë jam i sigurt që ky buxhet u siguron komunave mbulimin e nevojave elementare të tyre që e kanë.

Është zbatuar me përpikëri formula e granteve për ndarjen e buxhetit për komuna.

Tani më lejoni të flas shkurt për deficitin buxhetor që është e rregulluar me ligj, pra është obligim ligjor që ne t'i përmbahemi atij.

Për vitin 2017 ne kemi planifikuar një deficit buxhetor 1,5% të bruto prodhimit vendor, që është mjaft nën limitin prej 2%, siç është me ligj dhe ky deficit do të mbulohet nga emetimi i letrave me vlerë brenda vendit në shumë prej rreth 100 milionë eurosh dhe pjesa tjetër janë të shpërndara nëpër organizata të ndryshme buxhetore.

Kostoja e huamarrjes në tregun vendor është në rënie në dy vjetët e fundit edhe për shkak të rritjes së kredibilitetit të financave publike, pra rritjes së kërkesës për letra me vlerë, por edhe për shkak të rritjes së përgjithshme të tregut financiar në Kosovë.

Këtë vit, pra në vitin 2017, ne e shfrytëzojmë plotësisht klauzolën e investimeve që është paraparë me Ligjin për menaxhimin e financave publike, të aprovuar në këtë Kuvend në fillim të vitit.

Ne kemi paraparë projekte të ndryshme që të financohen nëpërmjet klauzolës së investimeve në vlerë prej 105 milionë eurosh.

Dy projekte kryesore janë Linja hekurudhore dhjetë dhe rrugët rajonale, të dyja të financuara nga BERZH-i.

Janë disa projekte që janë në procedurë e sipër, për të cilat disa marrëveshje tashmë janë nënshkruar dhe presin ratifikimin nga Kuvendi për t'u implementuar në terren.

Gjithashtu në financimin total kemi paraparë mjete që presin të pranojmë nga AKP-ja në shumën prej 88 milionë eurosh, të gjitha këto të shpërndara për investime kapitale nëpër sektorë të ndryshëm.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni edhe një herë të theksoj që ky buxhet është në linjë të plotë me objektivat e Qeverisë për rritje të qëndrueshme ekonomike, është i dakorduar me partnerët tanë ndërkombëtarë, FMN-në, në veçanti për shkak të programit që kemi me ta.

Unë ju falënderoj për vëmendjen dhe në përputhje me Ligjin për menaxhimin e financave publike ju ftoj që ta aprovoni këtë buxhet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar ministër! Fjalën e ka kryeministri i Republikës së Kosovës, zoti Isa Mustafa.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Ministri i Financave prezantoi në mënyrë detale buxhetin për vitin 2017.

Qeveria e Republikës së Kosovës e ka miratuar këtë buxhet para një kohe. Kemi trajtuar të gjitha kërkesat zhvillimore dhe kërkesat e tjera, në mënyrë që ato t'i mbështesim nëpërmjet këtij buxheti dhe si kryeministër i vendit vlerësoj se ne kemi arritur që Republikës së Kosovës në vitin 2017 t'i ofrojmë një buxhet, i cili siguron zhvillim dhe i cili reflekton në mënyrë të drejtpërdrejtë programin tonë qeveritar, programin e koalicionit qeveritar si përkushtim tonin të përbashkët për zhvillimin e vendit, si përkushtim për rritjen ekonomike, për krijimin e vendeve të reja të punës, për mirëqenie sociale dhe po ashtu edhe për ruajtjen e stabilitetit makroekonomik të vendit.

Ky projektligj po ashtu u tha edhe nga ministri i Financave, është rezultat i një bashkërenditje me Fondin Monetar Ndërkombëtar, por edhe me institucionet e tjera financiare ndërkombëtare, në mënyrë që të krijojmë kushte të qëndrueshme buxhetore dhe fiskale, të sigurojmë rritje ekonomike në të ardhmen, të shfrytëzojmë fondet që na i akordojnë institucionet financiare ndërkombëtare dhe të cilat do të orientohen për krijimin e një infrastrukture, që mundëson zhvillim ekonomik.

Unë vlerësoj se puna dyvjeçare e këtij koalicioni ka dhënë rezultate konkrete në përmirësimin e aktivitetit ekonomik në vend.

Në vitin e kaluar kemi pasur një rritje ekonomike prej 4,1 për qind dhe këtë vit presim që rritja

ekonomike të jetë më e lartë dhe po ashtu planifikojmë rritje edhe më të lartë ekonomike në vitin 2017.

Kjo rritje ekonomike prej 4,1 për qind, e realizuar deri më tani, është mbi rritjen ekonomike të vendeve në regjion dhe po ashtu është më e lartë se rritja ekonomike në vendet e Bashkimit Evropian, mirëpo gjithmonë pa e pasur parasysht bazën zhvillimore të atyre vendeve, e cila është e pakrahueshme me bazën zhvillimore të vendit tonë.

Po ashtu, mund të them se indikatorët zyrtarë statistikorë flasin për rënie të normës së papunësisë, që është e rëndësishme shumë të madhe për ne. Mirëpo, duhet të nënvizojmë se edhe përkundër kësaj, të gjithë ne jemi të vetëdijshëm se duhet të punojmë më shumë për tërheqjen e kapitalit të jashtëm, për investime private, si dhe investime publike, të cilat krijojnë infrastrukturë për investime private dhe punësim dhe lehtësojnë komunikimin, ulin koston e qarkullimit të mallrave dhe transportit dhe e bëjnë vendin tonë më atraktiv për investime të jashtme.

Me këtë dëshiroj të them se ky buxhet është refleksion i reformave dhe i avancimit të parametrave makroekonomikë, është po ashtu refleksion i përmirësimit të ambientit në përgjithësi të të bërit biznes në vendin tonë, i cili ambient u konfirmua edhe me raportin e fundit të Bankës Botërore, që theksoi se Kosova ka bërë progres sa i përket kësaj.

Nëpërmjet këtij buxheti, për herë të parë prej mbi 2 miliardë euro, Qeveria synon ta rrisë investimin në fushën kapitale në mbi 700 milionë euro, ose mbi 45 për qind në vitin e ardhshëm, në krahasim me këtë që kemi pasur këtë vit. Ne vlerësojmë se këto investime do të ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen ekonomike të vendit. Rritja e investimeve kapitale, siç u tha, do të përkrahet nga huamarrja, por rritja e bruto produktit vendor, ose GDP-së, është mjaft e lartë, apo dyfish më e madhe sesa borxhi publik, prandaj kjo situatë në asnjë rast nuk e rëndon ngarkesën e bruto produktit vendor me borxhin publik, sepse Kosova edhe ashtu mbetet vendi me nivelin më të ulët të borxhit, ose të pjesëmarrjes së borxhit në bruto produktin vendor.

Po ashtu, ky buxhet ruan nivelin e deficitit brenda rregullave fiskale, përkatësisht nën rregullën fiskale prej 1,5 për qind, dhe ne kemi hapësirë edhe më të madhe të këtij deficiti, që është plotësisht në harmoni me kriteret që para nesh i ka shtruar Fondi Monetar Ndërkombëtar.

Çështja e zhvillimit ekonomik dhe krijimit të vendeve të reja të punës është dhe mbetet prioritet i kësaj Qeverie, prandaj konsideroj se pas miratimit të këtij buxheti, Republika e Kosovës do të ketë edhe një potencial jashtëzakonisht të rëndësishëm të përshpejtimit të zhvillimit ekonomik të vendit.

Të nderuar deputetë,

Masat e reformave fiskale si dhe politikat e tjera ekonomike që kemi ndjekur, përfshirë edhe faljen e borxheve, kanë ndikuar që të kemi një rritje konstante të të hyrave tatimore dhe të hyrave jotatimore. Këtë vit do ta përfundojmë me rritje substanciale të të hyrave tatimore dhe atyre jotatimore, dhe presim që të kemi rritje më të lartë në vitin 2017. Kjo flet se politikat fiskale janë bërë të përshtatshme për zhvillimin e biznesit, se vazhdimisht po rritet efikasiteti i administratës doganore dhe tatimore, se po ulet evazioni fiskal, përfshirë edhe veriun e vendit, dhe se kemi filluar t'i zgjidhim problemet, me të cilat ne kemi hasur deri më tani sa i përket evazionit fiskal.

Ajo që duhet të punojmë më tutje është që të bashkërendisim procedimin më të shpejtë të procesit të privatizimit, sepse është një proces që duhet të kryhet shumë më shpejt se sa po bëhet deri më tash, të punohet në zgjidhjet e lëndëve që trajtohen nga Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme për privatizimet dhe kthimin e këtyre mjeteve në buxhet të destinuara për zhvillim.

Si kryeministër jam i bindur se ky buxhet arrin objektivat e veta në shumë fusha. Veçmas buxheti synon dhe siguron më shumë mjete për të mbështetur investimet që kemi trashëguar, sidomos ato të autostradës për Shkup. Siguron mjete për investime të reja në infrastrukturë karshi zotimeve tona të marrëveshjeve të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor që ka të bëjë edhe me rikonstruktimin e hekurudhës, përkrah bujqësinë si një prej objektivave zhvillimore të vendit, përkrah forcimin e institucioneve të ligjit dhe shtyllës së drejtësisë, hap mundësi të reja në shëndetësi, ruan trendin e rritur të investimeve në arsim, nxit sektorin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme si bartëse kryesore të zhvillimit ekonomik dhe të punësimit dhe po ashtu ky buxhet rregullon proporcionet themelore ndërmjet investimeve kapitale, ndërmjet pagave dhe mëditjeve si dhe transfereve sociale.

Buxheti, po ashtu, ka pasur një konsideratë të veçantë për nevojat e komunave, përkatësisht pushtetit lokal, që të mbështesë zhvillimin e infrastrukturës rrugore, shëndetësore, arsimore, sportive dhe kulturore në nivel lokal. Ky buxhet, po ashtu, do të përcillet me efektet pozitive të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, të cilat do të jenë shumë më të mëdha se sa që janë efektet nga disa ngarkesa doganore, për të cilat ne do të heqim dorë sipas kësaj marrëveshjeje, por në përgjithësi efektet e MSA-së në buxhet do të jenë pozitive e afatgjate, sepse ato ndërlidhen me zhvillimin ekonomik dhe me sigurimin e bazës më të fortë zhvillimore në të ardhmen, që është bazë e veçantë e buxhetit, që nuk ndërlidhet me një buxhet shpenzues, por me një buxhet që ka karakter zhvillimor. Faleminderit!

Unë kërkoj nga ju që të përkrahni këtë buxhet, ta aprovojme dhe të fillojmë sa më shpejt me implementimin e tij. Meqenëse unë jam këtu, vetëm t'ju njoftoj se gjatë javës kam bërë një ndryshim te anëtarët e Qeverisë, zonja Miliana Jevtiq, e cila është sot këtu, është tani ministre e Pushtetit Lokal dhe ajo po merr pjesë në Kabinetin qeveritar në këtë seancë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar kryeministër!

Ndërkohë shpesh herë kemi mysafir që i përcjellin punimet e seancës plenare, në emrin tim dhe tuajin dëshiroj ta përshëndes deputeten e Kuvendit të Republikës së Kroacisë, zonjën Ermina Lekaj. Faleminderit për praninë!

(Duartrokitje)

Faleminderit!

Fjalën e ka kryetari i Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, zoti Naser Osmani, e ftoj të paraqesë raportin e Komisionit Funkcional. Faleminderit!

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

I nderuar kryeministër, ministra,

I nderuar ministër i Financave,

Të nderuar deputetë,

Përgatitja e Projektligjit vjetor të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2017 është pasqyrim i kërkesave ligjore të parapara me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Projektbuxheti përmban kornizën makro fiskale për vitin 2017-2019 që pasqyron të dhënat për rrjedhat makroekonomike aktuale, për treguesit makroekonomikë dhe trendin e të hyrave dhe shpenzimeve si dhe ndikimet ekonomike në periudhën afatmesme.

Përveç pjesës tekstuale, projektligji përmban edhe pjesën tabelare me të dhënat për të hyrat dhe shpenzimet e përgjithshme sipas burimeve dhe strukturës së tyre për vitin 2017 dhe parashikimet për dy vjetët e ardhshme.

Ajo që duhet vlerësuar në këtë draft-buxhet është parashikimi për rritjen e të hyrave dhe shpenzimeve, duke u mbështetur në indikatorët e rritjes ekonomike.

Në bazë të dhënave për vitin 2016, rritja ekonomike parashikohet të jetë 4% deri në fund të vitit.

Ndërsa rritja reale ekonomike për vitin 2017 parashikohet të jetë 4,4%, duke konsideruar përmirësimin e kushteve kreditore si rezultat i rënies së interesave, vazhdimi i dërgesave nga diaspora, rritjen e konsumit dhe të investimeve private, rritjen e investimeve publike si dhe nëpërmjet klauzolës së investimeve, rritjen e importeve investuese si dhe politikat fiskale më të mira.

Në parashikim nuk janë marrë për bazë zhvillimet e kapaciteteve të reja të prodhimit të energjisë, aprovimi i Ligjit për investime strategjike, Ligji për Trepçën, që të gjitha këto që do të krijojnë mundësi për një rritje më të mirë ekonomike.

Gjithashtu Ministria e Financave ka adresuar rreziqet në parashikimin ekonomik, si varësia nga remitencat, ndryshimet e çmimeve, humbjet nga marrëveshja e tregtisë së lirë si dhe administrimi i politikave me kosto shtesë.

Parashikimi i konsumit për vitin 2017-2019 për 4,3% është real, duke konsideruar rritjen e konsumit për 4% në vitin 2016.

Ndërsa parashikimi i investimeve në një rritje mesatare për periudhën 2017-2019 prej 8% kanë konsideruar rritje të investimeve në vitin 2016, si dhe rritjen e investimeve publike nga 500 milionë, sa është në vitin 2016, në 723 milionë në vitin 2017.

Parashikimi i importeve dhe eksporteve në periudhën 2017-2019, respektivisht 5,3% dhe 4,7%, krahasuar me vitin 2016 është një parashikim real që reflekton një ngadalësim të eksporteve nga ecuria e çmimeve ndërkombëtare, ndërsa importet nga ecuria e konsumit dhe investimeve.

Të hyrat e vitit 2017 janë parashikuar një miliard e 725 milionë euro, ose 91 milionë euro më shumë se buxheti i rishikuar i vitit 2016, që paraqet një rritje prej 6,5%.

Të hyrat kanë një trend ulës në raport me bruto produktin vendor, nga 27,1% në vitin 2016, në 26,9% në vitin 2017.

Parashikimi i të hyrave vlerësohet të jetë real, bazuar në performansën pozitive të të hyrave në periudhën 9-mujore të vitit 2016 dhe parashikimin e rritjes ekonomike nominale në 6,5% për vitin 2017. Si dhe marrjen e masave të vazhdueshme për uljen e ekonomisë informale si dhe të evazionit tatimor nëpërmjet forcimit të administratës tatimore dhe ngritjes së kapaciteteve të agjencive të të hyrave.

Sa i përket strukturës së të hyrave, të hyrat e përgjithshme dominohen nga të hyrat e rregullta tatimore që janë parashikuar një miliard e 512 milionë euro dhe do të jenë 102 milionë euro më të larta krahasuar me buxhetin e vitit 2016 dhe marrin pjesë me 85,8% në të hyrat totale, apo 23% e të hyrave në raport me bruto produktin vendor.

Të hyrat e mbledhura në kufij apo nga Dogana parashihen të jenë një miliard e 5 milionë euro, një rritje prej 59 milionë eurosh, ndërsa të hyrat vendore 370 milionë euro, që është një rritje prej 30 milionë eurosh.

Të hyrat jotatimore në total pritet të jenë rreth 201 milionë, pjesëmarrja e tyre në raport në bruto produktin vendor është 3.6%.

Në kuadër të këtyre të hyrave, të hyrat e organizatave buxhetore në nivelin qendror janë parashikuar të jenë 100 milionë euro, që është 4 milionë më tepër se në vitin 2016.

Të hyrat nga organizatat e nivelit lokal 54 milionë euro, nga taksat koncesionare siç është aeroporti “Adem Jashari” janë paraparë 9 milionë euro, renta minerale 33 milionë euro dhe të hyrat nga dividenda 5 milionë euro.

Po ashtu, do të ketë mbështetje direkte buxhetore nga grantet e përcaktuara të donatorëve në shumën prej 12 milionë eurosh.

Projeksionet për shpenzimet buxhetore për vitin 2017 janë bazuar në planifikimin e të hyrave dhe nivelin e detyrueshëm të deficitit buxhetor në 2% të bruto produktit vendor.

Shpenzimet në total për vitin 2017 janë paraparë 2 miliardë e një milion, ose 15,5% më shumë krahasuar me buxhetin e rishikuar të vitit 2016.

Kjo rritje e lartë është kryesisht rezultat i rritjes së shpenzimeve kapitale në 723 milionë, nga 500 milionë euro sa kanë qenë në buxhetin e rishikuar të vitit 2016 dhe paraqet një rritje prej 44,6%.

Shpenzimet rrjedhëse janë parashikuar të jenë një miliard e 273 milionë, krahasuar me një miliard e 221 milionë euro në buxhetin e rishikuar të vitit 2016, ose një rritje prej 4,3%.

Sa i përket shpenzimeve të tjera, për paga dhe mëditje janë planifikuar 570 milionë euro, 21 milionë euro më tepër se në vitin 2016.

Për mallra dhe shërbime 224 milionë euro, ose 17 milionë euro më shumë se në vitin 2016.

Subvencione dhe transfere 474 milionë, ose 8 milionë euro më shumë se në vitin 2016, nga të cilët transfere sociale janë 474 milionë euro dhe subvencione për ndërmarrje publike 10 milionë euro.

Pjesëmarrja e kategorisë së shpenzimeve kapitale është në vlerën 723 milionë euro, që është për 223 milionë më shumë se në vitin 2016.

Në parashikimin e shpenzimeve buxhetore, Ministria e Financave ka konsideruar nivelin e rritjes në raport me bruto-produktin vendor nga 27,1% në 2016, në 33,2% në vitin 2017, një tendencë në ulje të shpenzimeve rrjedhëse për paga, subvencione dhe transfere totale në raport me bruto-

produktin vendor. Ndërsa një trend i rritjes së shpenzimeve kapitale nga 8,3% të bruto-produktit vendor në vitin 2016, në 11,3% të bruto produktit vendor në vitin 2017.

Një nivel relativisht i konsideruar, në 3% të bruto produktit vendor të shpenzimeve kapitale të financuara në kuadër të klauzolës së investimeve dhe nga mjetet e likuidimit. Në parashikimin e vitit 2017 bilanci i përgjithshëm parashikohet 299 milionë euro, nga të cilat neto financimi i brendshëm në shumën 99 milionë euro me një huazim të ri të brendshëm rreth 100 milionë euro, dhe neto financimi i huaj në shumë prej 200 milionë eurosh, përfshirë edhe financimin në kuadër të klauzolës së investimeve për 105 milionë euro, ku për periudhën 2017-2019 është paraparë fillimi i implementimit të një numri projektsh kapitale në fusha të ndryshme.

Llogaritja e bilancit sipas rregullës fiskale është parashikuar 95,3 milionë euro. Në raport me bruto produktin vendor deficitit sipas rregullës fiskale rezulton në 1,5%, duke kontribuar kështu me një rritje të kursimeve të sektorit publik dhe forcimin e stabilitetit makroekonomik. Bilanci bankar do të arrijë vlerën 355 milionë euro, nga të cilat 46 milionë euro janë si rezerva për ruajtjen e asistencës emergjente për likuiditet të sistemit financiar.

Dua të përmend edhe disa elemente pozitive të buxhetit për vitin 2017.

1. Buxheti i vitit 2017 tregon një parashikim real të rritjes ekonomike dhe të treguesve të investimeve të konsumit, të eksporteve dhe importeve;
2. Një kontribut në uljen e shpenzimeve rrjedhëse dhe rritjen e shpenzimeve kapitale në raport me bruto produktin vendor;
3. Zvogëlimin e presionit për rritjen e shpenzimeve rrjedhëse, kryesisht për paga dhe totalin e kategorisë së subvencioneve e transferove;
4. Kursimet nga ulja e shpenzimeve rrjedhëse, si shpenzimet për paga, subvencione dhe transfere në raport me bruto produktin vendor, kanë krijuar mundësi për financimin e programeve të reja dhe të investimeve publike;
5. Uljen e deficitit buxhetor dhe deficitit sipas rregullës fiskale nga 1,6 të bruto produktit vendor në vitin 2016, në 1,5 të vitit 2017;
6. Mundësinë e financimit të shpenzimeve kapitale, zhvillimore nga klauzola e investimeve dhe mjeteve të likuidimit në shumë prej 193 milionë eurosh;
7. Financimi i projekteve kapitale, prioritet të Qeverisë si autostrada Prishtinë - Hani i Elezit, projekti i rrugës M2 për Mitrovicë dhe M3 për Pejë, autostrada për Gjilan, rruga për Podujevë, si dhe rritjen e ndjeshme të investimeve për përmirësimin e infrastrukturës lokale, sportive dhe arsimore.

Në fund, Komisioni për Buxhet dhe Financa do të marrë në konsideratë sugjerimet e deputetëve që do të dalin nga kjo seancë dhe do të punojnë me përkushtim në këtë afat të limituar kohor që sa më mirë të bëjnë amendamentimin në kuptimin e asaj që të kemi një buxhet të harmonizuar për funksionimin e institucioneve të Republikës së Kosovës në dobi të qytetarëve të saj.

Komisioni e ka dhënë rekomandimin me shkrim dhe u ka bërë thirrje deputetëve që rekomandimin e komisionit ta përkrahin me votë pozitive. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Në bazë të regjistrit janë paraqitur 30 deputetë për të diskutuar për buxhetin. Normalisht, fillojmë me deputetët që paraqesin qëndrimet e grupeve parlamentare. Safete Hadërgjonaj flet për Grupin Parlamentar të PDK-së.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Projektbuxheti përfshin prioritetet, të cilat synohen të realizohen sipas programit qeveritar dhe nëpërmjet burimeve financiare, publike me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe mirëqenies së qytetarit. Nëse shohim brendinë e këtij buxheti, lë shumë për të dëshiruar sa i përket materializimit të prioriteteve të Qeverisë, harmonizimit me strategjinë kombëtare për zhvillim, programin për reforma ekonomike, mekanizmin për stabilizim asociim, si dhe mosharmonizimin me strategjitë sektoriale, gjë që mbetet çështje parësore për Qeverinë në të ardhmen të bëjë më shumë në këtë drejtim.

Projektbuxheti për vitin 2017 shumë pak ndryshon nga ai i viteve të mëparshme. Nëse analizohen shifrat në brendinë e këtij projekti, krijon përshtypjen se ky buxhet është hartuar sipas një praktike rutinë dhe shumë kode buxhetore janë përshtatur nga buxheti i vitit të kaluar. Sipas planifikimit të këtij buxheti, diferenca në mes të hyrave dhe të dalave është mbuluar me borxhe, gjë që nuk ka ndodhur në vitet e kaluara.

Në projektbuxhet duhet të argumentohen pse janë vendosur treguesit dhe nëpërmjet çfarë rrugësh garantohet arritja e këtyre treguesve. Nuk mund të jetë buxheti real pa analizën e trendeve fiskale, pa analizën sa janë reale supozimet makroekonomike, sa janë reale projeksionet e të hyrave buxhetore. Ne si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike kemi kërkuar që projektbuxhetit t'i bashkëngjitet korniza makrofiskale, të cilën Qeveria e ka sjellë në ndërkohë dhe ka bërë mirë që e ka sjellë, sepse këtë e kërkon edhe Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi.

Nëse analizohet mirë korniza makrofiskale vërehet se rritja e treguesve të të hyrave ka ardhur si rezultat i politikave fiskale afatshkurtra, pa ndonjë strategji të caktuar që paraqet një rrezik për financat publike, një pakënaqësi, por edhe frikë të bizneseve, të cilat i paguajnë tatimet e tyre në buxhet.

Në kornizën afatmesme të shpenzimeve që ka ardhur në Kuvend, në prill të këtij viti asnjë euro nuk është paraparë të realizohet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, kurse në buxhet 88 milionë euro janë ndarë për investime kapitale, për çka vërehet se i është dashur Qeverisë të rrrumbullakojë 2 miliardë euro buxhetin e dedikuar për shpenzime. Dëshira jonë është të themi se kemi buxhet 3 miliardë, 4 miliardë, 5 miliardë euro, por mundësitë dhe realiteti është ndryshe. Në fakt, buxheti është 1 miliard e 725 milionë euro, që është rritur në krahasim me vitin 2016 për 91 milionë euro, pra vetëm 5,5% më shumë krahasuar me vitin 2016, që është rritje më e vogël krahasuar me rritjen që është bërë në vitin 2016 krahasuar me vitin 2015, për 160 milionë, apo 11%, apo krahasuar me rritjen që është bërë në vitin 2015, krahasuar me vitin 2014, për 125 milionë euro.

Rritja e shpenzimeve në 2 miliardë e 1 milion euro ka ardhur si rezultat i rritjes së huazimeve, rritjes së borxheve dhe kalkulimeve se do të realizohen të hyra nga Agjencia Kosovare e Privatizimit nëpërmjet likuidimit që janë mjete vështirë të realizueshme. Mjetet për klauzolën e investimeve pa u miratuar në Kuvend huat për projektet që parashikohen të realizohen me kredi është vështirë të realizohen.

Për vitin 2016 nuk kemi të dhëna se si huamarrja e jashtme është materializuar në buxhet me realizimin e projekteve kapitale, por mënyra se si është planifikuar financimi i projekteve kapitale në vlerë prej 315 milionë eurosh, duke përjashtuar projektet në vlerë 408 milionë euro që janë paraparë të realizohen nga buxheti, që janë 80 milionë më të ulëta se në vitin 2016 është vetëm sa për të kalkuluar me shifra në buxhet, sepse janë vështirë të realizueshme, për të mos thënë të parealizueshme.

Rritja e buxhetit duke rritur borxhet nuk është e shëndetshme për ekonominë tonë, nuk është mirë që gjeneratat e ardhshme të paguajnë koston e punës sonë, rritja e borxhit për 177 milionë euro më shumë në krahasim me vitin e kaluar është trend i përshpejtuar i rritjes, i cili nuk reflekton në mënyrë pozitive, sidomos kur efektet e rritjes së këtyre borxheve nuk i japin rezultatet e tyre në të mirë të mirëqenies së qytetarit.

Të nderuar deputetë,

Në pjesën tekstuale të këtij projektbuxheti është përfshirë neni 18. Ne si grup parlamentar jemi që ky nen të fshihet. Shtetet e zhvilluara dhe me traditë në financat publike, të cilat e kanë sistemin e “free balancit” përafërsisht siç e kemi ne, nuk e kanë këtë nivel të planifikimit të shpenzimeve rrjedhëse. Planifikimi në nënkategori veçse e komplikon sistemin e pagesave, është i parealizueshëm.

Nuk jemi të fusim nene të pazbatueshme që nesër të marrim vërejtje nga institucionet ndërkombëtare, e sidomos të kritikohemi nga Raporti i Progresit për shkak të moszbatueshmërisë së neneve të caktuara të projektligjeve, edhe ashtu kemi problem në zbatueshmërinë e ligjeve. Po

ndalem te shpërndarja e investimeve sipas ministrive, ku peshën kryesore të investimeve e zë Ministria e Infrastrukturës me rreth 258 milionë e 428 mijë euro, apo 36% të investimeve të përgjithshme me një pjesëmarrje prej 11% në bruto produktin vendor.

244 milionë janë projekte të bartura nga viti 2016, kurse 14 milionë euro janë të parapara projekte të reja për këtë vit. Mbi 90 projekte të reja janë të planifikuara vetëm në shumën prej 50 mijë euro, e në fakt, fjala është për projekte milionëshe.

Shtrohet pyetja: si realizohen këto projekte nëse ne e miratojmë nenin 13, paragrafi 6 të këtij projektligji. Në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve vërehet se mosrealizimi i projekteve gjatë vitit 2016 nuk janë bartur këto projekte në vitin 2017. Janë hequr pothuajse të gjitha projektet kapitale të planifikuara të përealizuara në vitin 2016, për çka ne si Grup Parlamentar kemi kërkuar të rikthehen në buxhet.

Ministria e Shëndetësisë që, në fakt, duhet ta kemi prioritet, duke ditur situatën në të cilën është shëndetësia e Kosovës, buxheti është rritur vetëm 272 mijë e 160 euro. Numri i të punësuarve është rritur për 27, kurse masa e pagave është zvogëluar për 922 mijë e 855 euro, çka do të thotë ulja e kësaj përqindje të pagave nuk është e cekur në ndonjë sqarim në buxhet.

Ministrisë së Drejtësisë nuk i janë ndarë mjetet, të cilat faktikisht ka nevojë kjo ministri. Në vazhdimisht po theksojmë se duam rend dhe ligj, e në fakt nuk u kemi dhënë kurrfarë rëndësie institucioneve të drejtësisë për t'i fuqizuar me buxhet. Janë shtuar vetëm mjete në subvencione dhe transfere për 1 milion e 500 mijë euro, kurse buxheti, në fakt, ka mbetur i njëjtë me buxhetin e vitit të kaluar.

Në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë janë zvogëluar mjetet për 414 mijë e 487 euro, derisa ne përballemi me problemin e madh të cilësisë së arsimit. Kurse, ka pasur zvogëlim edhe në investimet kapitale për 1 milion e 656 mijë euro. Nëse e analizojmë buxhetin komunal vërejmë se janë ndarë 440 milionë e 230 mijë euro, për paga dhe mëditje janë ndarë 250 milionë, apo 56%, për mallra dhe shërbime 40 milionë, apo 9%, kurse për investime kapitale 130 milionë apo 29%.

Vërehet se është bërë një ndarje joproporcionale e buxhetit për komunat, sidomos për projektet, të cilat janë të orientuara nga niveli qendror për komunat e caktuara.

Bazuar në këto shqetësime që i theksova më lart dhe shumë shqetësime që i kanë deputetët e Grupit Parlamentar të PDK-së, ne kemi bashkëpunuar me partnerin e koalicionit për të bërë plotësim-ndryshimet e duhura në buxhet me qëllim të përmirësimit të shpenzimeve buxhetore, ashtu që buxheti të jetë i qëndrueshëm dhe të japë efektet në zhvillimin ekonomik në të mirë të

jetës së qytetarëve dhe të mos rrezikojmë stabilitetin e qëndrueshëm fiskal, duke u kujdesur që të jemi në kufijtë që janë harmonizuar me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Ne si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Atëherë, përfundoje!

SAFETE HADËRGJONAJ: Ne si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e përkrahim projektbuxhetin për vitin 2017. Vota jonë do të jetë pro rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe do ta miratojmë buxhetin me plotësim-ndryshimet, të cilat do të kemi mundësi t'i bëjmë në Komisionin për Buxhet dhe Financa. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Për Grupin Parlamentar të Lidhjes Demokratike flet deputetja Besa Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Zoti kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Siç e dimë të gjithë, procesi i përgatitjes së këtij buxheti ka filluar me përgatitjen e kornizës afatmesme të shpenzimeve, e cila është aprovuar në muajin prill të këtij viti. Duke u bazuar në këtë kornizë kanë filluar instruksionet buxhetore. Të gjitha organizatat buxhetore kanë dorëzuar kërkesat e tyre për financim, në këtë rast Ministria e Financave ka organizuar dëgjimet buxhetore me përfaqësues të të gjitha institucioneve buxhetore të Republikës së Kosovës. Pra, Ministria e Financave dhe organizatat buxhetore janë pajtuar dhe janë kuptuar në mes vete për nevojat e financimit, por edhe për mundësitë buxhetore të Republikës së Kosovës.

Këtë e theksova, sepse për Lidhjen Demokratike të Kosovës janë krejtësisht të paqarta dhe të papranueshme reagimet, kundërshtimet dhe shtyrja e kësaj pike të rendit të ditës deri sot, duke e ditur se buxheti është ligji më i rëndësishëm i çdo vendi, njëkohësisht edhe për Republikën e Kosovës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Projeksionet e të hyrave dhe shpenzimeve për vitin 2017 janë kështu: gjithsej të hyra vendore janë 1 miliard e 725 milionë euro. Të hyrat tatimore janë 1 miliard e 512 milionë euro, të hyra jotatimore janë 201 milionë euro dhe mbështetje buxhetore nga grandet janë 12 milionë euro. Gjithsej parashikohet, planifikohen pra shpenzime në total prej 2 miliardë e 1 milion eurosh. Dhe, ky projeksion i shpenzimeve parashikohet të jetë kështu: pagat dhe mëditjet 570 milionë

euro, mallra dhe shërbime 224 milionë euro, subvencione dhe transfere 474 milionë euro, rezerva rrjedhëse 5 milionë euro. Total i shpenzimeve rrjedhëse pra është 1 miliard e 273 milionë euro.

Ndërsa, për shpenzimet kapitale buxheti i rregullt është 530 milionë euro, shpenzim kapital të financuar që të planifikohet nga AKP-ja janë 88 milionë euro dhe shpenzime kapitale të financuara nga klauzola e investimeve janë 105 milionë euro. Totali i shpenzimeve kapitale me plus 4 milionë euro nga rezerva parashikohet të jenë 723 milionë euro. Pra, gjithsej shpenzimet rrjedhëse dhe shpenzimet kapitale, duke përfshirë edhe shpenzimet nga grandet e përcaktuara 12 milionë dhe kthimin që e mundësojmë me 11 milionë euro, na dalin që 2 miliardë e 1 milion euro do të jenë shpenzime për vitin 2017.

Të nderuar kolegë deputetë,

Buxheti për vitin 2017 bazohet në parimin e financimit të qëndrueshëm, në njërën anë dhe alokimin e shpenzimeve për financimin e prioriteteve të Qeverisë që tanimë janë të deklaruara nëpërmes dokumenteve strategjike, siç është strategjia kombëtare për zhvillim, programi i Qeverisë, programi për reforma ekonomike, korniza afatmesme e shpenzimeve, e kështu me radhë. Ky propozim buxhet ka pajtimin e plotë në të gjitha pozicionet kryesore buxhetore me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Kjo është tejet e rëndësishme, duke qenë se ne kemi relacione programore me këtë institucion dhe rrjedhimisht përgatitja dhe aprovimi i buxhetit duhet të dakordohet paraprakisht me FMN-në, si dhe nuk duhet të harrohet asnjëherë se kjo Qeveri e ka marrë mandatin me marrëdhënie të ndërprera me Fondin Monetar Ndërkombëtar, por performansa e mirë e planifikimit, menaxhimit dhe shpenzimit të buxhetit ka bërë që të rinovohen raportet me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Prandaj, kjo performansë, të nderuar kolegë deputetë, na e mundëson të hyjmë në kredi zhvillimore. Të dhënat e deritashme të indikatorëve makroekonomikë janë mjaftë inkurajuese për rritjen ekonomike në vend, si dhe ambientin e përgjithshëm ekonomik. Në bazë të raporteve preliminare për vitin 2016 të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, si dhe duke u bazuar edhe në vlerësimet e Ministrisë së Financave ne presim që në vitin 2016 ekonomia jonë të ketë rritje reale prej 4 deri 4,1%. Kjo rritje është konfirmuar edhe nga projeksionet, institucionet e jashtme kredibile, siç është FMN-ja.

Ecuritë pozitive të vitit të kaluar dhe të këtij viti pritet të vazhdojnë edhe në vitin 2017, por me një normë më të lartë të rritjes ekonomike, pra prej 4,4%. Ashtu sikurse në vitet e fundit, kjo normë e rritjes prej 4,4% pritet të jetë ndër më të lartat në rajon dhe në periudhën afatmesme ritmet e rritjes ekonomike pritet të jenë përafërsisht të njëjta. Rritja e parashikuar prej 4,4% për vitin 2017, si dhe parashikimet për periudhën afatmesme bazohen në skenarin bazë të projeksioneve makroekonomike dhe, si i tillë, ky skenar nuk merr parasysh një numër të projekteve dhe iniciativave me potencial të lartë zhvillimor, siç është zhvillimi i kapaciteteve të reja për prodhimin e energjisë, potencialet e krijuara, pra, nga Ligji për investime strategjike, si

dhe potencialet e krijuara nga Ligji i ri për Trepçën, që e kemi aprovuar së bashku të gjithë. Domethënë, në bazë të këtyre duhet të planifikojmë që rritja të jetë edhe më e lartë se sa 4,4%.

Të nderuar kolegë,

Buxheti i vitit 2017 ka dy objektiva: që të vazhdojmë me projektet për t'i mbajtur shpenzimet rrjedhëse në nivel të qëndrueshëm, kjo pasi që, siç e dimë, për paga dhe mëditje subvencionet dhe pensionet janë rritur shumë më shpejt, pra përpara kësaj qeverisje se sa janë rritur të hyrat tatimore dhe shumë më shumë se sa është rritur ekonomia e vendit dhe kjo gjë tashmë është në kontroll, nuk do të ndodhë. Objektivi tjetër është krijimin e hapësirës më të madhe për më shumë shpenzime kapitale në buxhetin e vitit të ardhshëm, meqë këto investime janë mënyra më e mirë e shpenzimeve të parasë publike që garanton një kthim për gjeneratat tona të ardhshme.

Rritja e konsiderueshme e buxhetit për vitin 2017 dhe vlerësimet për vitet vijuese bëjnë të mundur implementimin në reformat që lidhen me sigurimet shëndetësore, implementimin e plotë të Ligjit për skema pensionale të financuara nga shteti, implementimin e plotë të kompensimit për përvojën e punës për punonjësit publikë, mbarëvajtjen e nivelit të subvencioneve në bujqësi, ofrimin e pensioneve për veteranët dhe kategoritë e tjera të luftës në vlerë prej 50 milionë eurosh, akomodimin e shpenzimeve të nevojshme që dalin nga obligimet e agjendës integruese të Kosovës dhe rritjen e mbështetjes financiare për sektorët e sigurisë, prokurorinë dhe gjyqësinë.

Gjithashtu, me buxhetin e vitit 2017 do të implementohen shumë projekte infrastrukturore, rritja e buxhetit për shpenzime kapitale bazë mundëson financimin e mëtejshëm të autostradës Prishtinë - Hani i Elezit, rritje të financimit për blerjen e pajisjeve të nevojshme për ristrukturimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Policisë së Kosovës, financimin e rrugës regjionale M2 për Mitrovicë dhe asaj M3 për Pejë, investimet e tjera për përmirësimin e infrastrukturës lokale, sportive dhe arsimore, projektet të cilat krahasuar me vitin e kaluar kanë shënuar rritje të ndjeshme.

Rritje të mbështetjes financiare për projektet kapitale që kanë për qëllim përmirësimin e produktivitetit dhe rritjen e punësimit në sektorin e bujqësisë, si dhe projekteve të tjera infrastrukturore, e posaçërisht atyre që lidhen me nevojat e komunitetit, duke financuar me qindra projekte të niveleve lokale. Pra, nëpërmes këtij draft-buxheti parashihet edhe buxhetim shtesë për projektet kapitale që do të financohen nëpërmjet klauzolës për investime dhe të hyrave të njëhershme që pritet të vijnë nga AKP-ja.

Në këtë pikë dua t'ju them se implementimi i projekteve të parapara me financim nëpërmjet klauzolës për investime dhe mjeteve të AKP-së do të fillojë vetëm atëherë kur të jenë nënshkruar kontratat ose mjetet e AKP-së të jenë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Nëse i shikojmë shpenzimet sipas kategorive ekonomike, në të gjitha kategoritë do të ketë rritje në krahasim me vitin 2016, por natyrisht rritjen më të madhe do të kenë shpenzimet për investime kapitale.

Pra, në paga dhe mëditje parashikohet që të ketë rritje nga viti 2016 për vitin 2017, 3,8%; në mallra dhe shërbime do të ketë ngritje për 8,2%; në subvencione dhe transfere do të ketë ngritje krahasuar me vitin 2016, 1,7% dhe në investime kapitale, po e theksoj, do të ketë rritje krahasuar me vitin 2016, 45% dhe kjo thotë shumë, të nderuar kolegë.

Buxheti i komunave në vlerën prej 440,2 milionë euro u ka siguruar komunave financim të plotë të obligimeve të tyre ligjore për qytetarë, formula e grandeve nëpër komuna është zbatuar në përpikëri për të siguruar barazi në shpërndarje të Buxhetit...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Përfundoje Besë, sa më shpejt!

BESA GAXHERRI: Komunat kanë marrë 10% të Buxhetit të përgjithshëm si dhe grande specifike për arsim, shëndetësi dhe për kompetenca të zgjeruara të komunave.

Të nderuar kolegë dhe qytetarë të Republikës së Kosovës,
Buxheti, të cilin e propozoj sot për aprovim, është dokumenti kryesor zhvillimor i zhvillimit të politikave ekonomike të këtij vendi, i cili si i tillë do të sigurojë vazhdimin e rritjes ekonomike dhe rrjedhimisht edhe përmirësimin e kualitetit dhe standardit të jetës së shtetasve tanë. Pra, me të drejtë mund të cilësohet si buxhet mbështetës i zhvillimit ekonomik të vendit. Duke u mbështetur në eksperiencën, përkushtimin dhe korrektësinë e kryeministrit dhe ministrit të Financave, Republika e Kosovës po hyn në periudhën apo etapën e zhvillimit real ekonomik. Prandaj, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës ju fton që ta votoni Projekt-buxhetin për vitin 2017. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kryetari i Lëvizjes “Vetëvendosje”, Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit!

Qytetarë të nderuar të Republikës së Kosovës,

Mendoj që ajo që dëgjuam deri tash në këtë Kuvend, nga përfaqësuesit e Qeverisë, për sa i përket Buxhetit, është një rrëfenjë, një tregim, të cilin e kemi dëgjuar vazhdimisht prej se jemi në Kuvend dhe prejse e diskutojmë këtë temë. Pra, sa herë që diskutohet Buxheti, ai paraqitet si pikënisja e një ndryshimi rrënjësor, për sa i përket zhvillimit ekonomik dhe rritjes së mirëqenies për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Dhe, ne për çdo vit fillojmë zhvillimin ekonomik dhe për çdo vit përfundojmë pa të, siç kemi përfunduar në vitet e kaluara, siç po përfundojmë vazhdimisht. Kjo është fatkeqësia e këtij vendi, që asgjë nuk ndryshon në politikat qeveritare karshi zhvillimit ekonomik dhe duke i bërë politikat e njëjta dhe aplikuar masat e njëjta, me të njëjtat linja buxhetore, me të njëjtat fonde, pretendojmë se këtë radhë do ta kemi më mirë. Pra, sipas definicionit të Ajnshtajnit për budallakinë, ajo është përdorimi i mjeteve të njëjta me shpresë se do të kesh rezultate të ndryshme. Dhe, kjo është çfarë po na ndodhë edhe më këtë buxhet, se unë këtu e dëgjova edhe zotin Mustafa, i cili tha që rritja ekonomike në Kosovë, edhe këtë vit, edhe vitin e ardhshëm, jo që është më e madhja në rajon, po është pak më e madhe se në vendet e BE-së, natyrisht si përqindje. Pra, nëse këtu do të jetë rritja 4% e ta zëmë vendet e BE-së e kanë 1,5; 2... e kështu me radhë, atëherë Kosova po zhvillohet me një trend më të shpejtë se sa vendet e Bashkimit Evropian, që i bie se kështu e kemi fituar njëlloj stabiliteti dhe njëlloj qëndrueshmërie ekonomike për të ardhmen, që tregon se Kosova do ta ketë një të ardhme të ndritur. Praktikisht, kjo është ajo që deshi ta thotë, siç e kuptova unë, zoti Mustafa.

Ndërkohë, që në realitet krejt tjera gjëra ndodhin. Pra në realitet, edhe po të jetë kjo rritje ekonomike e kësaj përqindjeje, prapë Republika e Kosovës nuk është duke u zhvilluar e aq më pak duke krijuar mirëqenie të ngritur për qytetarët e Republikës së Kosovës, sepse ekonomia jonë është jashtëzakonisht e dobët dhe ka një kthim jashtëzakonisht të ulët e aq më pak, për shkak edhe të mos shpërndarjes së barabartë të pasurisë, ka një ndërhyrje jashtëzakonisht të pabarabartë dhe të padrejtë në mirëqenien e qytetarëve dhe në këtë drejtim, pra, mirëqenia e qytetarëve dhe ekonomia në përgjithësi nuk janë duke u zhvilluar përkundër rritjes, sepse rritja duhet të dekonstruktohet. Pra, kur të dekonstruktohet ajo rritje e kuptojmë se çka në fakt po paraqitet si rritje ekonomike në Kosovë, se rritja e transaksioneve me mall e me para me vendet e rajonit, e cila reflekton edhe në buxhet, nuk është rritje ekonomike, nuk është zhvillim i Republikës së Kosovës e nuk është as mirëqenie për qytetarët. Pra, këtu ka hapësirë për të mashtruar me numra dhe këtë hapësirë vazhdimisht Qeveria e përdor.

U tha këtu edhe më herët, e dëgjova më vëmendje edhe qëndrimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, i cili, dorën në zemër, faktikisht tha që ky buxhet nuk vlen as për pesë para. Pra, praktikisht qëndrimi i Grupit Parlamentar, shprehur nga zonja Hadërgjonaj, tha që letra në të cilën është shtypur buxheti është më e vlefshme, se sa të dhënat dhe përmbajtja e këtij buxheti dhe pastaj tha që do ta votojmë. Pra, mendoj se kjo është përtej hipokrizisë.

Neve sot na ka ardhur këtu një buxhet, i cili për herë të parë, thuhet, e kalon shifrën prej 2 miliardëve, si shpenzime. Shikuar na aspekti i këtyre shifrave dhe nga ajo që u tha deri më tash këtu, kjo do të duhej të ishte një arritje vërtet e madhe. Dhe, natyrisht po të kishte qenë arritje e madhe do të duhej t'i gëzoheshim të gjithë, por kur shikohet më hollësisht, se si kjo Qeveri po synon ta arrijë këtë rritje, ose t'i financojë shpenzimet prej 2 miliardë eurosh, atëherë kuptohet që ky buxhet vërtet nuk meriton të kalohet e as kjo Qeveri të përgëzohet, se nuk mund të përgëzohet

një qeveri e cila, ta zëmë, edhe këtë radhë vetëm 10% të buxhetit planifikon ta mbledh nga tatimi në të ardhurat personale dhe tatimi në të ardhura të korporatave, ndërkohë që shumica e të hyrave planifikohet të mbledhet nga dogana, ku natyrisht për çdo euro që e mbledhim 3 euro i çojmë jashtë vendit, pjesa më e madhe e tyre në Serbi.

Kjo as nuk është për tu krenuar, as për tu gëzuar e as për tu brengosur, sepse kjo tregon, në fakt, që struktura ekonomike e Kosovës planifikohet nga Qeveria, mbetet e njëjta, ajo që kemi deri tash. Dhe, ajo që kemi deri tash, qartazi nuk është ekonomi që po i përmbush as nevojat bazike të qytetarëve e lëre më diçka më shumë. Në këtë drejtim, prapë po them, vazhdimi i kësaj situatë në aspektin ekonomik të Republikës së Kosovës dhe në aspektin e mirëqenies së qytetarëve të Republikës së Kosovës nuk po e bën Kosovën vend të jetueshëm, por po e bën Kosovën një vend, prej të cilit interesimi për të ikur po rritet shumë më shumë.

Pra, sipas zotit Mustafa, këta qytetarë që po e lëshojnë Kosovën po ikin prej zhvillimit dhe mirëqenies në Kosovë në Bashkimin Evropian, ku paska stagnim dhe rrugë drejt mjerimit. Pra, prapë po e huqin qytetarët. Se ky Buxhet, kur shikohet me vëmendje, po flas vetëm për pjesën e të hyrave, është megjithatë buxhet që varfëron qytetarin e Republikës së Kosovës. Zbërthimi i tatimeve që mbledhen në Republikën e Kosovës e tregon këtë më së qarti. Pra, për vitin 2017 nga të ardhurat nga korporatat do të mbledhen 84 milionë euro, nga të ardhurat personale, tatimi në të ardhurat personale 135 milionë euro, ndërkohë që nga tatimi në vlerë të shtuar 748 milionë euro, që i bie praktikisht që tatimi në vlerë të shtuar, e dimë të gjithë, është tatim në konsum, nga konsumi askush nuk është i lirë, pavarësisht a janë të punësuar, pavarësisht a janë në skema sociale, pavarësisht a e mbajnë familjen me remitencat nga jashtë, të gjithë konsumojnë dhe duke konsumuar të gjithë kontribuojmë në 728 milionë euro.

Pra, jo ata që kanë më shumë të japin më shumë, po pikërisht ata që kanë më së paku, kërkohet që të kontribuojnë më së shumti në Buxhetin e Republikës së Kosovës. Dhe, kështu varfërimi shkon duke u zgjeruar dhe duke u rritur. Aq më tepër, që dihet se për shkak të mangësisë së ushqimit, për shkak të kushteve të jetesës, atëherë nevoja për të konsumuar te ata që kanë më pak është më e madhe, madhësisë së familjes, e kështu me radhë. Rrjedhimisht, i bie që pikërisht ata janë përgjegjësit kryesorë për financimin e Buxhetit të Kosovës.

Dhe, tash do të thuhej “Në rregull, ne i mbledhim tatimet për t’i shpenzuar ato për shoqërinë.” Dakord, këtë e bën buxheti. Po, pastaj ku po shpenzohen këto? Po mbledhen nga të varfrit e po shpenzohen në projekte me kompanitë, korporatat, qofshin vendore a ndërkombëtare super të pasura. Pra, mbledhim nga pak nga shumica e qytetarëve e u japim shumë një pakice. Ky është buxheti, sepse kjo është logjika e Qeverisë. Logjika e kësaj Qeverie sikur e qeverisë së mëparshme, është që në vend se pasuria publike të shpërndahet barabartë tek të gjithë, ajo koncentrohet në duart e disave edhe formalisht e legalisht, që besa edhe nga aspekti i korrupsionit, e ilegalisht, të dyja këto e kryejnë të njëjtin funksion.

Po ashtu, te tatimet në të ardhura qartazi edhe për shkak të ndryshimeve tatimore që janë bërë në vitin 2008, ajo që mund të quhet një klasë e mesme, që fatkeqësisht po shkon në zhdukje këtu në Kosovë, e bart barrën kryesore pastaj të financimit të kësaj pjese të Buxhetit. Dhe, kështu prapë e kemi, edhe të varfrit edhe klasa e mesme e bartin përgjegjësinë kryesore për financimin e Buxhetit, ndërkohë që nga ai përfitojnë vetëm të super-pasurit. Dhe kjo, në funksion të zhvillimit ekonomik dhe të rritës së mirëqenies, siç po na thotë Qeveria, por në fakt efekti është e kundërta e asaj që po premtonte Qeveria.

Po ashtu, si mund të përgëzohet një qeveri, ose një buxhet që ka sjellë kjo qeveri, e cila në një vit të vetëm pretendon t'i shpenzojë 88 milionë euro nga paratë e fondit të privatizimit, para këto për të cilat janë shitur, privatizuar e shkatërruar qindra fabrika e ndërmarrje tjera shoqërore, në ndërtimin e të cilave kanë marrë pjesë dhe kanë investuar gjenerata të tëra. Dhe tash, kjo qeveri për një vit po do ta shpenzojë një pjesë të madhe të këtij fondi. Pra, ajo që është ndërtuar me gjenerata, po keqpërdoret përbrenda një viti nga një pjesë e kësaj gjenerate. Ose, edhe tjetra që u përmend këtu, me këtë buxhet shpenzimet dy-miliardëshe planifikohen që të mbulohen nga rritja e borxhit publik, edhe të brendshëm edhe të jashtëm, diku 360 milionë euro gjithsej, që i bie prapë, me fondin e privatizimit po e keqpërdorim djersën e së kaluarës, me borxhet po e keqpërdorim djersën e së ardhmes, pra gjeneratat që do të vijnë e që do të duhej të paguajnë këto borxhe për keqpërdorimin që po bëhet në këtë drejtim. Dhe, këtu me "keqpërdorim" nuk po nënkuptoj domosdoshmërisht korrupsionin, e shpjegova edhe më herët, keqpërdorim për mua është edhe keq-menaxhimi edhe keq-alokimi i fondeve buxhetore në mënyrë formale dhe publike, jo në drejtim të zhvillimit ekonomik, po që besa, në dëmtim të tij, sepse kjo Qeveri e di mirë, siç ka ndodhur edhe vitet e kaluara, edhe këtë vit, këto projekte dhe të hyra të parashikuara janë të keqprojektuara dhe unë mendoj që ky keqprojektim është bërë i qëllimshëm, jo vetëm këtë vit, edhe vitet e kaluara, jo vetëm me këtë qeveri, edhe me qeveritë e kaluara.

Pra, vazhdimisht ne kemi pasur projekte të të hyrave shumë më të mëdha, të cilat në fund të vitit kanë rezultuar të mos jenë reale dhe pastaj është dhënë faji, ta zëmë, te nënperformanca e mbledhjes së fondeve, kur në fakt unë mendoj që problemi është te keqprojektimi i qëllimshëm fillestar. 100 milionë euro, 102 milionë euro, për çdo vit kemi përfunduar duke mbledhur qindra milionë më pak, se sa që janë projektuar në fillim të vitit.

Dhe kështu, kjo ka shkuar në dëm të projekteve, për të cilat ka votuar ky Kuvend, që të investohen. Pra, shkurtimet buxhetore janë bërë për shkak të mosmbledhjes së të hyrave dhe në anën tjetër kanë rezultuar me mospërfundim, ose lënie në gjysmë, ose mosfillim fare, të disa prej...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Edhe një fjali!

VISAR YMERI: ...dhe mendoj që është shumë e qartë, këtë buxhet duhet ta vlerësojmë, në fund të fundit, edhe në bazë të një strategjie plani të cilin e ka përpiluar dhe miratuar kjo qeveri për zhvillimin ekonomik, ku këta i kanë vendosur disa prioritet.

Pra, hajde ta zëmë se nuk është e rëndësishme se çfarë thotë “Vetëvendosja”, çfarë thotë AAK-ja, çfarë thotë “Nisma”, çka thonë të tjerët, çka thotë edhe PDK-ja në këtë rast, por a është e rëndësishme që ta vlerësojmë buxhetin, atëherë, në përputhje me atë që e ka thënë Qeveria. Dhe, nëse shikohet me kujdes, në disa prej shtyllave edhe pse janë vendosur si prioritet, asnjëherë buxheti nuk është orientuar në ato prioritet, as në arsim, as në shëndetësi, as te industria dhe infrastruktura, madje, madje edhe përkundër miratimit të Ligjit të “Trepçës” këtu shihet qartë që në buxhetin e vitit 2017 nuk ka asgjë të re, përpos shumave që janë parashikuar në vitin 2016 e të cilat po ashtu, ishin të jenë nga buxheti i vitit 2015. Pra, në projektet...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Fjalën e ka Pal Lekaj, në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

PAL LEKAJ: I nderuar kryesues,

Qeveri, edhe pse kryeministri s’po mund t’i menaxhojë ministrat, sepse 60% të tyre nuk janë këtu, ndoshta kanë ndonjë ndejë diku tjetër, por nuk janë në ulëset e tyre e sidomos, kur debatohet për një ligj, që është me rëndësi jetike për qytetarët. Ky është serioziteti i qeverisë së sotme.

Sa i përket asaj që dëgjova nga zonja Gaxherri, më bëri përshtypje që Kosova është parajsë, por kur e dëgjova zonjën Hadërgjonaj, thash me të vërtetë këtu është mjerim dhe ky buxhet nuk dihet si do të votohet. Dhe, tani qytetarët kujt t’i besojnë? Prandaj, e keni humbur besimin tek qytetarët, sepse kur të është në pyetje buxheti nuk i takon një partie, por u takon qytetarëve. Dhe, të jeni të bindur, koalicion, që e keni humbur besimin tek qytetarët. Me këtë buxhet, jo vetëm që pasurohen qytetarët, por varfërohen.

Qytetarë të Kosovës,

Medie dhe ju kolegë deputetë,

Në këto 50 faqe që i kanë shkarravitur me numra e shkronja, nuk bëhet fjalë për një dokument të rëndësishëm, bëhet fjalë vetëm për letra propagande për mashtrime, që qytetarët kanë qe dy vjet që i dëgjojnë dhe e dinë cila është jeta e vërtetë e tyre – varfri e papunësi në rritje, fatura të energjisë më të larta, shporta ushqimore më e shtrenjtë e rrjedhimisht më e varfër.

Sipas këtij planifikimi të buxhetit të vitit 2017 projektet zhvillimore janë paraparë përmes kreditimit, huamarrjes dhe kjo është një problem shumë i madh, se ngarkon buxhetin e vitit

2017/2018 dhe vitin 2019 e në mënyrë zinxhirore ju vetëm me borxhe do ta lini Kosovën veçse s' do të jeni sigurisht në qeveri, por të ballafaquar me këto çfarë vet po mbledhni.

Buxheti i planifikuar nga Qeveria Mustafa po i thonë me vlerë mbi 2 miliardë euro, ndërsa sa e dëgjuam tjetrën parti, që thotë është 1 720 e sa mijë euro, prandaj ku janë, ku janë ato para, ku do t'i merrni? Me siguri se është huaja që i keni shty që t'i mashtroni qytetarët. Duke bërë që të mbyllën bizneset, nga se për të shtuar borxhet e veta Qeveria do të detyrohet të rrisë tryshinën për mbledhje taksash e tatime do të rriten një mori tarifash, pra krejt kjo që do të shlyejmë borxhe të kësaj qeverie, që e ka rritur veten, por jo numrin e qytetarëve të punësuar.

Të nderuar qytetarë,

Nëse kemi parasysh trendin e rritjes, që nga këto proklamime ta kuptoni se do të ketë vetëm rritje të shpenzimeve për luksin e këtyre e asgjë tjetër. nëse të hyrat do të rriten për 5%, shpenzimet do të shkojnë në mbi 15%, pra dy herë më shumë do të ketë shpenzime, se sa të hyra. Kryeministri duhet të tregojë drejtë, se norma e rritjes së të hyrave për vitin 2017 do të jetë më e ultë se në këtë vit, kuptohet nëse ky do të jetë në pushtet bashkë me këta lojtarë të Qeverisë.

Qytetarë të Kosovës,

E gjithë Qeveria, por jo deputetët, nuk flasin në këtë buxhet për fondin prej 1,5 miliardësh, ky është fondi me të cilin LDK e PDK premtuan hapjen e 320 mijë vendeve të punës të reja. Pse sot nuk e përmendin atë fond e punësimet që i kanë premtuar? Sot në këtë buxhet e përmendin vetëm se do të marrin rreth 100 milionë nga KPA-ja. Nuk jam kundër nëse ato do të futeshin në punë për të gjeneruar punë, por këta as nuk bëjnë të parën as të dytën, këta në formë krejt joligjore do t'i marrin ato të holla, sikur edhe viteve të kaluara, ta zëmë në këtë vit ia kanë marrë 66 milionë, asnjëherë nuk i kanë treguar pse. Por, a e dini pse. Për t'i paguar, hiç më pak se 21 ministra, 51 zëvendësministra, mbi 170 këshilltarë politikë, rreth 300 punonjës kabinetesh, po aq edhe shoferë e body-guarda. Të gjithë këta do t'i kushtojnë Buxhetit, të cilin e mbushni ju, qytetarë të Kosovës, mbi 20 milionë euro.

A është normale kjo kur e dimë gjendjen reale të qytetarëve në terren, të cilët mbi 15% janë në varfri ekstreme, mbi 50% pa punë, 60 nga këta janë prej 16 deri në 25 vjet. Kurse, qeveritarët bashkë me kushërinjtë e farefisin janë duke jetuar në luksin e krijuar prej xhepave të të varfërve e të popullit. Të paktën, mos flisni të pavërteta. E vërteta është se ju nuk po qeverisni për Kosovën, por vetëm për dialogun me Serbinë dhe jo vetëm nuk qeverisni, por vazhdoni me paturpësi të bëni propagandë.

Meqë, ra fjala për dialogun me Serbinë, a nuk na thoni, nëse keni planifikuar ndonjë buxhet për të fasaduar murin që e lejuat tu ndërtohet para hundëve e i cili nuk po shkrihet si "fluskë bore", por po bëhet akull e po lëshon rrënjë aty. Dhe sot, në këtë seancë, kërkoni të përdorni buxhetin në mënyrën më të shëmtuar për të bërë propagandë përballë qytetarëve, atyre që sot janë

fundosur në pikën e hallit për bukën e gojës, ndërsa ju dilni, sorollateni me gërshtë në dorë e shitni përralla, përrallat e radhës për Kosovën e mirë ku jetojnë dhe për mirëqenien e lartë që ua ka sjellë “koalicioni i elefantëve”.

Kjo është vetëm propagandë ndaj qytetarëve që nga mëngjesi deri në darkë. Disa gjëra për ata që në të vërtetë do të duhej të konsideroheshin themeli i zhvillimit të vendit.

Të respektuar bujq e ju që do të doni të keni një biznes të vogël apo të mesëm, kjo qeveri s’do të ketë të holla për subvencionet tuaja, as për ju që mendoni të hapni biznese të reja, nuk do të kenë çfarë të shpërndajnë, vetëm nëse e harxhojnë edhe atë pak rezervë shtetërore që ka mbetur. Këta edhe atë punë e bëjnë, e kanë dëshmuar në shumë raste.

Me këtë buxhet nuk do të ketë aktivitete ekonomike-zhvillimore, as nuk do të rritet punësimi, as prodhimet, as eks porti, rreth 61 000 000 euro është vlera e projekteve të reja kapitale, të cilat supozohen të mbështeten nga niveli qendror i Kosovës gjatë vitit 2017, apo vetëm 3% të mjeteve nga totali i 2 000 000 000 eurove.

Kjo Qeveri është fajtores për papunësinë e të rinjve dhe protestat e tyre. Është fajtores për media jo të lira. Është fajtores kur na rrahën, therën e vdesin të rinjtë në shkollë. Është fajtores për ata që përdorin edhe drogë. Është fajtores për gjuhën e tyre në shkollë e në rrugë. Është fajtores edhe kur mësimdhënësit përdorin dhunë ndaj nxënësve dhe e kundërta, nxënësit ndaj mësimdhënësve. Është fajtores kur ata nuk studiojnë. Është fajtores kur ata përfundojnë studimet e nuk punojnë. Është fajtores për murin në veri. Është fajtor për rrezikun nga ndarja e Kosovës. Është fajtores për mosliberalizimin e vizave. Është fajtores për korrupsionin e krimin që e kanë ngufatur jetën në këtë vend. Është fajtores për mungesën e ushtrisë së Kosovës. Është fajtores që përmbi...

(Ndërprerje nga regjia)

...2 070, prandaj fajtorit nuk duhet t’i jepet mundësia tjetër. Fajtori duhet të dënohet, e ne ju lusim që ju, kolegë deputetë, ta dënoni këtë Qeveri duke mos e kaluar buxhetin.

Kosova e qytetarit, jo e qeveritarit! Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Enver Hoti për grupin “Nisma”.

ENVER HOTI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Kryeministër,

Të nderuar ministra,

Mendoj se seanca për trajtimin dhe shqyrtimin e buxhetit do të duhej të ishte një ndër seancat dhe është pa dyshim një ndër seancat më të rëndësishme të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Por sikur të kishim përpara një projekt-buxhet, i cili do të garantonte zhvillim dhe mirëqenie për qytetarët e vendit. Por, në fakt, po përsëritet si në të kaluarën që ky buxhet do të sjellë vetëm dështim, varfëri dhe mirëqenie jo të mirë për qytetarët e vendit.

Të nderuar deputetë,

Do të filloj me rritjen e paralajmëruar në këtë projekt-buxhet ose të deklaruar prej 91.000.000 eurove e që, për mendimin tonë, është si rezultat i rritjes së TVSH-së nga 16% në 18% dhe jo si rezultat i zhvillimit ekonomik apo i luftimit të ekonomisë joformale.

Diferenca mes të hyrave dhe shpenzimeve në shumën prej 276 000 000 eurove, që Qeveria pretendon t'i marrë nga huamarrja, jemi të bindur se vendin do ta fusë në borxhe publike.

Po ashtu, nëpër shumë ministri në këtë projekt-buxhet ka projekte të paadresuara dhe që lënë mundësinë e hapur për të investuar sipas dëshirës së ministrave dhe jemi të bindur se kjo do të ketë pasoja në të gjitha fazat e realizimit të atyre projekteve si në planifikim, po ashtu edhe në realizimin e tyre, sepse si zakonisht, projektet e tilla realizohen në prag dhe gjatë fushatave elektorale me sprinter procedura, që të mund të grabitet ndonjë votë dhe besoj se qytetarët e kanë të qartë se çka ndodh me ato projekte dhe cili është fati i atyre projekteve që me qindra-mijëra euro shpenzohen dhe projektet mbesin gjithmonë në gjysmë të rrugës dhe të perealizuar.

Po ashtu vlen të theksohet se ndarja jo e drejtë për disa komuna dhe zona është e papranueshme dhe, për pasojë, disa komuna përfitojnë dukshëm më shumë investime dhe në disproporcion krahasuar me numrin e popullsisë apo madhësinë gjeografike.

Kjo është e padrejtë, është dënim i qytetarëve të disa zonave dhe atë në mënyrën më të rëndë, duke e ndaluar të drejtën e barabartë në qasjen e buxhetit për vendin.

Po ashtu, shihet qartë se hartimi i buxhetit nuk është transparent, nuk është bërë në mënyrë transparente dhe nuk ka lidhje konkrete të politikave strategjike në buxhetin e shtetit.

Tani, të nderuar deputetë, ne nga deklaruesit e partive në pushtet dëgjuam se nga bashkëpunimi i tyre kanë arritur një harmonizim apo pajtueshmëri për realizimin e këtij buxheti, por unë për votimin e këtij buxheti mendoj se aty ka disa pazare, të cilat këta i kanë bërë dhe sigurisht që mbetet të shohim pas këtij kalimi që do të jetë këtu dhe se ku janë ato, do të shihet më tutje.

Ne mendojmë se pazaret kur bëhen kështu natën, sigurisht se nuk del gjë e mirë prej tyre, por do të shihet në kohë dhe do t'i trajtojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin “6+”, Myfera Shinik e ka fjalën!

MÛFERA SERBICA-ŞINIK: Faleminderit, kryesues!

Teşekkür ederim,

6 + Parlamenter Grubu olarak 2017 bütçesini incelediğimizi ve ilk görünüşte geçen yıla oranla ciddi bir artışın olduğunu görmekteyiz. 2017 yılı bütçesine baktığımızda bir önceki vergi yılına göre vergi gelirlerinin 102 milyon euro yani 2016 yılına oranla yüzde 7 lik artış ile 1.051 milyar euro olacağı öngörülmektedir. Kurumsal vergilerden elde edilecek gelir 2016 vergi yılına oranla yüzde 14 lik bir artış göstererek 84 euro seviyesinde olacaktır. Kişisel vergi gelirlerinde ise yüzde 6 lık bir artışla 135 euro seviyesinde olması beklenmektedir. Kartma değer vergisinde öngörülen toplam rakam yüzde 9 buçuk artışa 748 milyon eurodur. Bunların yanında gümrük vergilerinde ise bir önceki yıla oranla yüzde 14 lük bir düşüş öngörülmektedir. 2017 yılı bütçesinde öngörülen gider kalemlerine baktığımızda geçtiğimiz yıla nazaran 223 euro artış göstererek sermaye yatırımlarında öngörülen 723 milyon euroluk harcama ilk dikkat çeken noktalardan biridir. Bu rakam sermaye yatırımlarında yüzde 45 lik bir artış öngörüldüğü anlamına gelmektedir ve bu ciddi bir artıştır. Sermaye yatırımları çerçevesinde Trepçe maden ocağına ve enerji alanında yapılacak yatırımların yanında Kosova Güvenlik Gücüne yapılan 18 milyon euroluk yatırım da dikkat çeken gider kalemleri arasındadır. Ayrıca Avrupa standartlarına sahip olacak şekilde Priştine şehir standyumunun yeniden inşa edilmesi, Priştine Üsküp otoyolu projeleri de ülkemize değer katacak projelerden bazılarıdır. Bu projeleri de içinde barındıracak olan sermaye yatırımları dış borçlanma ile gerçekleştirilmesi öngörülmektedir. Dış borçlanma seviyesinin 2017 yılında yüzde 12 den yüzde 18 e çıkacak olması olumsuz bir gösterge olarak gözüktüğü de ülkemiz adına herhangi bir risk teşkil etmemektedir. Komşu ülkelere baktığımızda dış borçlanmanın gayri safi yurt içi hasıla oranı Sırbistanda yüzde 60, Makedonyada ise yüzde 70 olduğunu görülecektir.

Bu yıl itibariyle sağlık sigorta fonunun hayata geçirilmesi, ülkemiz adına ciddi bir gelişme olacaktır. Sağlık sistemimizin gelişmesi ve vatandaşlarımızın kaliteli sağlık hizmetleri almasının güvencesi olarak sağlık sigorta fonu ile vatandaşlarımızın bu konudaki yükü hafifleyecektir.

Değerli milletvekilleri “6+” Parlamenter Grubu adına 2017 yılı bütçesine yönelik bazı taleplerimize dikkatimizi çekmek istiyorum. 2017 yılı Bütçesi Kanun Taslağının 12. Maddesi gereğince Başbakanlık bünyesindeki topluluklar ofisi ile Topluluklar ve Geri Dönüş Bakanlığı bütçelerinin her topluluğa ne kadar bütçe ayrıldığını net olarak belirtecek şekilde yeniden programlanması ve Hükümet tarafından onaylanmasını talep ediyoruz. Bundan önceki yıllarda topluluklara yönelik eşit olmayan ve adaletsiz bütçe dağılımını bu yılda tekrarlanmaması adına bu talebin yerine getirilmesi birinci önceliğimizdir. Aksi halde bütçenin onaylanması sürecinde tavrımızın olumsuz yönde olması ve bütçeye red oyu verme alternatifimizi de ciddi bir şekilde değerlendirmeye almamız kaçınılmaz olacaktır. Çünkü Bütçe Kanununun 12. Maddesi sadece tek bir topluluğa ait değildir. Bunun yanında Prizren ve Mitroviça başta olmak üzere diğer şehirlerde

de topluluklara yönelik kültür merkezleri projelerine ağırlık verilmesi, Kosovadaki çoğunluk olmayan toplulukların kültürlerini yaşatmalarına katkılar sunacaktır. Örneğin bu yılki bütçede Priştine Türk Kültür Merkezi için amandmanımızı sunacağız. Aynı zamanda Üniversite öncesi Eğitim Yasasının 27. Maddesine göre Kosova Eğitim, Bilim ve Teknoloji Bakanlığının ders kitaplarını ücretsiz dağıtmalıdır, bu maddeye dayanarak yardımcı ders kitapları, iş defterleri, öğretmen kitapçıkları için de ek bütçe talep etmekteyiz. Bununla birlikte “6+” Parlamenter Grubu olarak bu doğrultuda bütçedeki toplulukları ilgilendiren projeler konusunda önerge değişikliklerimizi komisyona sunacağımızı bildirirken bütçenin ilk okunuşunu “6+” Parlamenter Grubu olarak desteklediğimizi de bildirmek isteriz.

Teşekkür ederim!

KRYESUESI: Faleminderit! Kolegë të nderuar, i dëgjuam deklaratat e shefave të grupeve ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

Tash do të kalojmë te diskutimet e deputetëve veç e veç. Është mirë të merremi vesh të punojmë, sepse janë rreth 30 deputetë që kanë kërkuar të bisedojnë. A doni të mbetet koha prej 10 minutash si mundësi apo doni ta shkurtoni. Kjo ishte nën një.

Nën dy. Dikush thotë të lexohet lista. Unë tash do ta lexoj listën qysh është e regjistruar, e ju si grupe bëni preferencat dhe i sillni. Por, është e pamundshme atëherë të bëhet rend me grupe të ndryshme.

Unë po ju them se lista e deritanishme, qysh duket, është: Daut Haradinaj, Faton Topalli, Shpejtim Bulliqi, Besa Baftija, Shqipe Pantina, Besim Beqaj, Blerim Grainca, Time Kadrijaj, Ali Berisha, Salihe Mustafa, Shaip Muja, Labinotë Demi-Murtezi, Xhevahire Izmaqu, Hajdar Beqa, Bekim Haxhiu, Fatmir Rexhepi, Shukri Buja, Abdyl Ymeri, Naim Fetahu, Luljeta Veselaj-Gutaj, Emilija Rexhepi, Bali Muharremaj, Qerim Bajrami, Veton Berisha, Mytaher Haskuka, Aida Dërguti, Nehat Baftiu, Rexhep Selimi, Albulena Haxhiu, Teuta Haxhiu, Zafir Berisha, Flora Brovina, Donika Kadaj-Bujupi, Agim Aliu, Ismajl Kurteshi, Salih Morina, Naser Osmani, Lahi Brahimaj, Murat Hoxha dhe Armend Zemaj.

Kjo është lista. Pra, ju tregoni çka po doni, a po doni t’i thërras me rend? Do të thotë, doni të jetë për 10 minuta. Në rregull!

Tash, kush e do fjalën lidhur me këtë problem? Naser Osmani!

NASER OSMANI: Faleminderit, kryesues!

Po shikoni shumicën, jo pakicën! Ne vendosim për këtë çështje dhe ju kisha lutur juve si kryesues dhe deputetët që ta kenë parasysh se komisioni duhet të tërhiqet dhe të kryejë punën.

Nëse ka shumë diskutues, do të vonohet dhe komisioni atëherë do të jetë nën presion të madh kohor.

Unë lus ta qitni në votim dhe diskutimi të jetë maksimal 5 minuta dhe të ketë hapësirë më të madhe komisioni ta kryejë punën e vet.

KRYESUESI: Po mirë, të mos i mbajmë moral njëri-tjetrit. Unë kërkoja, meqë ka shumë diskutues, a doni të pjesëtohet kjo kohë ndryshe, dhe ju vendosni, e unë as s'po vendos as që e kam ndërmend të vendos.

(Ndërhyrje)

Po unë e di që kur bisedoni vetë, tani diskutimi i tjetrit po ju duket shumë i gjatë, si ta kaloni, se e di, unë jam moti këtu. Urdhëro, Haxhiu!

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

E para, zoti kryesues, në fillim të kësaj seance u hoqën nga rendi i ditës deklaratimet dhe pyetjet parlamentare. Tash po kërkohet që të shkurtohet koha ose minutat që Rregullorja e Kuvendit i lejon për deputetët, e që janë 10.

Ne, si Grup Parlamentar kërkojmë të respektohet Rregullorja e punës së Kuvendit. Në qoftë se ajo i lejon 10 minuta për deputetë, atëherë 10 minuta i kërkojmë dhe kjo të mos pakësohet.

Nuk është faji i opozitës, zoti Osmani, që ju po kërkon që buxhetin, që është ligji më i rëndësishëm në vend, ta kaloni me procedura të përshpejtuara. Përgjegjësinë për këtë e ka Qeveria dhe mazhoranca.

Pra, ne kërkojmë që kjo të mos zvogëlohet, sepse nëse ju s'keni çfarë për të thënë, ka shumëçka të thotë opozita. Faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë, Albulena, e di që je juriste dhe e di që e këqyr Rregulloren si unë, po edhe unë e shikoj dhe e mbaj mend. Neni 40 thotë, diskutimi i deputetit në mbledhje plenare zgjat deri në 10 minuta, nëse Kuvendi nuk vendos ndryshe. Kaq.

Unë s'po vendos. Veç, Kuvendi nëse vendos, jo unë. Kjo ishte nën një.

E dyta, është edhe problemi i rendit. Ju po kërkon rend, dhe ua lexova qysh është rendi, e atëherë filloj e thërras me regjistër dhe mos u hidhëroni, jo unë isha para, isha prapa.

(Ndërhyrje)

Na e sillni listën, sa veta janë këtu?

(Ndërprerje)

Fjalën e ka Daut Haradinaj.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryesues!

E para, sa i përket diskutimit, meqenëse koalicioni është dakorduar dhe ne s’jemi për ta tërhequr fjalën deputetët e koalicionit, pse duhet të flasin ata nëse jeni dakorduar? Pikërisht, do të thotë, është zgjidhje e mirë.

Ne meqenëse s’jemi pajtuar, i shprehim shqetësimet, kështu që, pavarësisht nëse s’mund t’i thuash për 5 minuta, një javë të flasësh s’mund të thuash asgjë.

Kthehemi në temë. Safetja s’qenka këtu. Për besë, gjynah që s’është zëdhënësja e Aleancës sa bukur ka folur, po t’i hiqet ajo pjesa e fundit.

Do të thotë, e bëri një shpjegim dhe, në fund, tha prapë do ta votoj. Paramendo!

I nderuar kryesues,

Kryeministër,

Deputetë,

Vërtet sot, kërkoj falje nëse u nxitova pak për Listën serbe, e cila e mori fjalën jashtë rendit të ditës, pas votimit se nuk do të ketë diskutime të hapura, nuk do të ketë pyetje parlamentare dhe në të njëjtën kohë i jepet njërit fjala, i cili edhe këtu prezantoi qëndrimin e Beogradit, e jo qëndrimin e një deputeti të Parlamentit të Kosovës dhe aq më tepër tha: “Shpresoj që kryeministri dhe kryetari i Kuvendit të mbajnë fjalën në marrëveshjen e arritur”.

Do të ishte shumë me interes për opinionin publik të dihet çfarë është ajo marrëveshje e re tash, sepse s’e di çka i nxiti. Çka pati?

Meqenëse jemi duke folur për buxhetin, dhjetëra herë jemi duke shtruar pyetje parlamentare dhe të cilat nuk na lejohen për t’i shtruar këtu, dhe të gjitha pyetjet kanë të bëjnë me ditën e sotme dhe ndarjen buxhetore në nivel të Kosovës, sepse unë mendoj që buxheti është i popullit të Kosovës.

Kemi bërë pyetje pse është ndalur rryma në 32 vende të Kosovës, asnjëherë nuk është dhënë përgjigje. Në të njëjtën kohë, në 32 vende të Kosovës është ndalur rryma, asnjëherë s’është përgjigjur askush.

Kemi bërë pyetje pse studentëve u jepen konvikte mbi baza politike e partiake të koalicionit, ndëshkohen studentët në periferi të Kosovës.

Kemi bërë pyetje për ministrin e FSK-së se deri ku ka shkuar procesi i transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës, dhe po them se është shumë interes nacional kur i shihni trendet se çka po ndodh rreth Kosovës dhe më gjerë, Kosovës i duhet urgjentisht ta ketë ushtrinë e vet.

Kemi bërë pyetje pse nuk e keni ndrequr urën e Kramovikut tash e tre vjet? Se është një urë që frekuentohet prej 625 000 banorëve dhe askush s’e qanë kokën për atë punë.

Kemi bërë pyetje pse nuk është bërë ligji për pensionimin e parakohshëm për Policinë e Kosovës, i cili ligj dëshmon qartë dhe hapur se e kemi policinë më të vjetër, ju them sigurt, në regjion, por ndoshta edhe më gjerë. E kjo do të thotë se u pamundësojmë të rinjve tanë që janë në uniformë avancimin.

Nëse flasim për FSK-në, s’ka asnjë dilemë, duhet përgëzuar ato trupa që e kanë bërë një punë të jashtëzakonshme dhe, pse jo, edhe vetë ministrin Demolli.

Dhe, nëse flasim për buxhetin për FSK-në, është një buxhet i gatshëm për ta transformuar këtë forcë. Dhe, në rast se Lista serbe nuk do ta pranojë transformimin ose ndërrimet kushtetuese, pse kolegë të mi nuk e bëjmë një ligj thjesht dhe ia ndërrojmë misionin FSK-së, sepse kapacitetet buxhetore, e kemi kryesuesin e komisionit këtu, e di shumë mirë që të gjitha kërkesat që i ka parashtruar qoftë Ministria, qoftë FSK-ja janë bërë gati.

Atëherë, është urgjencë për t’ia ndërruar misionin, deri në rendin dhe plotësimin e kushteve që shpresoj shumë shpejt edhe Kosova s’ka nevojë ta bëjë partnere e hise gjithmonë Listën serbe.

Kemi bërë edhe pyetje të tjera. Për shembull, e kisha bërë edhe një pyetje për ministrin e Financave: Qysh, ministër, rruga Plavë-Deçan me 50 000 euro? A mund të na thoni, çka bëhet me 50 000 euro për një rrugë nacionale që e lidh Plavën e Gusinë me Deçanin? 50 000 euro as vijën e bardhë, ministër, nuk mund ta bëjmë. Vijën e bardhë në midis nuk mund ta vendosim, e të mos flasim për investim kapital.

Nëse hyjmë te Policia, u fol shumë.

Po ua lexoj shkurt e shpejt, rritja e buxhetit është 1 625 000 euro.

Mos harroni, të gjitha janë bartje. Asnjë rritje nuk është, nuk qëndron, nuk është e vërtetë.

Te operacionet, pajisje trafiku, 120 000 të bartura nga viti 2016.

Te operacionet speciale, 434 000 të bartura, zero nga viti 2016.

Te autobлиндat, topat ujë, limuzina të blinduara e tjera, 689 000 euro, zero cent të reja.

Te njësitet hetimore, pajisjet teknike për vrojtim 170 000 të bartura, asnjë cent të reja.

Pajisje forenzike 60 000 të bartura, zero cent të reja.

Pajisje për hetim të krimit teknologjik-informativ 150 000, zero cent të reja.

Për pajisje hetuesie, konfidenciale 220 000 të bartura, zero cent të reja.

Te shërbimet mbështetëse, totali i buxhetit 5 638 870 euro. Të gjitha të bartura nga viti 2016 zero cent të reja, te policia kufitare totali i buxhetit 8 milionë e 840 mijë euro, zero cent të reja. Pyetja është: A guxon Policia e Kosovës t' i shpenzojë mjetet, apo janë vetëm të shkruara në letër dhe Policia nuk guxon t' i shpenzojë këto? Shumë e vërtetë, kush po thotë se nuk është e vërtetë, kemi bërë analizë detale, të gjitha i ke deri në detaje.

Derisa fliste më parë e dëgjova Safeten kur tha se buxheti real i Kosovës është një miliard e 725 milionë. Unë e kam edhe një pyetje për ministrin e Financave: ministër, nëse janë hua, me çfarë interesi do t' i ktheni, për sa kohë, ku do t' i merrni saktësisht? Nëse do t' i merrni në Agjencinë e Privatizimit, a do ta ndërroni ligjin? Nëse i merrni në Trustin Pensional, a do ta ndërroni ligjin? Se këto janë kundërligjshëm, ju s'keni drejtë t' i merrni përderisa nuk e ndërroni ligjin, e shumë e shumë pyetje të tjera. Shpresoj që edhe kolegët e mi do t' i shtrojnë.

Unë për fund mund të them që ky vit nuk ka qenë bash vit i mirë për ne, shpresoj që viti tjetër të jetë vit më i mirë.

Përfundimisht e kemi Kosovën pa ushtri, pa shëndetësi të mirëfilltë, pa viza, pa arsim cilësor, të mos të themi më të keqin, pa ndonjë drejtësi, e cila edhe vitin e ardhshëm nuk ka buxhet shtesë, pa UNESCO dhe të gjitha këto shpresoj që nuk i ka fajet opozita, edhe për demarkacionin, siç e quajti zoti Kelmendi dje, interesa fshatareske, se ky është bërë shumë parisien kohët e fundit, e po harron që është Kelmend i Rugovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Faton Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Ky është buxheti i tretë i Qeverisë Mustafa, Thaçi, Veseli dhe shpresoj të jetë i fundit.

Nëse buxheti i vitit 2015 ishte më shumë buxhet i Partisë Demokratike të Kosovës se sa i LDK-së, këto dy buxhete të fundit dhe sidomos ky, e këtë e tha edhe kryeministri, është buxheti i përbashkët, është krejt dituria që partitë e koalicionit e kanë mbledhur për ta shfaqur në buxhet.

E di që shumica e qytetarëve të Kosovës kurrë nuk e kanë pasur në dorë buxhetin dhe nuk e kanë analizuar ligjin më të rëndësishëm që e aprovon Kuvendi çdo vit. 500 faqe buxhet, me shumë numra, me shumë emra projektesh, emra spitalesh, miliona të ndarë për subvencione, grante, rroga, pensione, mallra dhe shërbime të krijojnë përshtypjen e një mekanizmi gjigant dhe vështirë për t'u kuptuar nga qytetarët që nuk janë ekonomistë. Por qytetarët e bëjnë analizën ndryshe.

Qytetari nuk merret me buxhetin e vitit që vjen, por merret me buxhetin e këtij viti, sepse e di, duke e pasur parasysh se çfarë ka ndodhur këtë vit, e di çka e pret edhe vitin e ardhshëm, sepse e di që metodat e punës janë të njëjta, Qeveria është e njëjtë, sukseset dhe dështimet janë po ashtu të njëjta. Fjalën sukses e përdora vetëm për shkak të modestisë, sepse kjo Qeveri ka pasur vetëm dështime.

E di që nuk është orë mësimi sot, por buxheti ka pasoja të drejtpërdrejta për jetën e secilit qytetar dhe unë do t'i ftojta të gjithë qytetarët që janë pranë ekraneve televizive ta analizojnë bashkë këtë projektbuxhet dhe të shohim se ku qëndrojmë, duke i shtruar disa pyetje shumë të thjeshta.

Pra, i ftoj ta bëjmë analizën së bashku.

Kjo Qeveri premtoi dhe po premton që me politikat ekonomike që shprehen nëpërmjet këtij buxheti do të krijojë mijëra vende të reja të punës. Kryeministri tha që do të krijojë edhe mirëqenie qytetare, do të kemi stabilitet ekonomik, e kështu me radhë.

Unë të pyes ty, Naim, që je pranë televizionit, ty Agim, Shpresë, Shpend, Hasan, a është punësuar gjatë këtij viti ndokush prej familjes tënde? Nëse nuk është punësuar askush, atëherë e ke lehtë ta kuptosh që politikat ekonomike të proklamuar me shumë pompozitet nga zoti Mustafa nuk sollën ndonjë ndryshim konkret për ty.

Po ti, baca Hasan, po, po, pikërisht për ty e kam fjalën, që merr pension. A të mjaftojnë paratë për bukë, a të mjaftojnë për barna, a të mjaftojnë për rroba? E ty, Shpend, a të mjaftojnë ndihmat sociale? Nuk po të pyes as për rroba, as për ilaçet, nuk po të pyes as për shpenzimet për mësim, thjesht po të pyes a të mjaftojnë të hollat e ndihmës sociale për bukë? Ose, më thjesht, a po ngihesh me bukë, o vëlla? 67 cent kjo Qeveri i ka caktuar për ndihma sociale në ditë për çdo njeri që merr ndihma sociale. Ky është sukcesi. Po t'i, zoti mësues, a i mban katër fëmijë me 400 euro në muaj? Po ti, polic, zyrtar i administratës, kamerier, taksist, murator, elektrikist, shitës në pompën e benzinës me 170 euro në muaj, a mund të mbijetosh me rrogën që e merr pa hyrë në

borxh në gjysmën e muajit? Po ti, ushtar i UÇK-së, si e kalon muajin me 170 euro? Po ti, student, çfarë perspektive ke, çfarë perspektive të ka sjellë kjo Qeveri dhe si jeton?

Kjo është analiza e thjeshtë e buxhetit që e bën qytetari, është shumë e thjeshtë. A ka ndryshuar diçka në jetën time gjatë këtij viti? Nëse nuk ka ndryshuar gjatë këtij viti, s'ka për të ndryshua asgjë as vitin e ardhshëm.

Pra, në qoftë se të gjithë qytetarët e Kosovës janë të kënaqur me punësimin, me çmimet, me rrogat, me rrugët, me shërbimet mjekësore, me ndihma sociale, me infrastrukturën e përgjithshme, atëherë duhet t'ia heqin kapelën Kadri Veselit dhe Isa Mustafës dhe t'i falënderojmë për politikën e mira që zhvilluan nëpërmjet ndarjes së buxhetit në vitin 2016.

Nëse nuk jeni të kënaqur dhe unë besoj që shumica e qytetarëve të Kosovës nuk janë të kënaqur, fajtor është ndarja e buxhetit që e bëri kjo Qeveri vitin e kaluar. E me këtë ndarje të buxhetit ky fakt ju pret edhe në vitin 2017. Vetëm që këtë vit duhet ta shtrëngoni rripin edhe më shumë. Pra, fajtorët i dini, besoj se edhe dini çka duhet të bëni me ta?

Ky është buxhet i skamjes. Qeveria e Kosovës ja që nuk po e ngre mirëqenien sociale, siç ka premtuar, por është bërë garanti i varfërisë në Kosovë.

Sipas Projektbuxhetit për vitin 2017, 410 mijë e 651 qytetarë të Kosovës detyrohen të jetojnë me nga 3.18 euro në ditë. Në këtë numër janë të përfshirë qytetarët që marrin pensionet bazë të moshës, 130 mijë, pensionet kontribut pagues të moshës, 39 mijë, personat me aftësi të kufizuara, 19 mijë, fëmijët me aftësi të kufizuara, 2745, familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës, 12 mijë e 965, pensionistët e Trepçës, 3418, pensionistët e Trupave Mbrojtëse të Kosovës, 898, pensionistë të Forcave të Sigurisë, 162, persona të verbër, 3258 dhe persona me asistencë sociale, 115 mijë e 231, respektivisht gjithsej 327 mijë e 838 qytetarë, apo 19,5% e popullsisë në Kosovë.

Nëse numrit të qytetarëve që jetojnë nga pensionet dhe asistencë sociale i shtojmë edhe shifrën prej 82 mijë e 813 të punësuarve në nivele të ndryshme të shtetit të Kosovës, atëherë numri total i qytetarëve që jetojnë prej të ardhurave të siguruara nga shteti, pra nga buxheti, është 410 mijë e 651.

Ndoshta mund të thuhet që Qeveria e Isa Mustafës bën një lloj përpjekje për të ofruar një baraspeshë sociale, por barazia që ofron Isa Mustafa është barazi në varfëri, nuk është barazi në pasuri.

Ky buxhet, ashtu si dhe ai i dy vjetëve të fundit, është buxhet i shpërndarjes së varfërisë.

Tmerrësisht e rëndë është situata për përfituesit e skemave sociale. Qeveria e Kosovës ka ndarë për këtë kategori 27,8 milionë euro. Numri i përfituesve prej kësaj skeme, sipas statistikave të tremujorit të tretë të vitit të kaluar, është 115 mijë e 231. Shuma vjetore që merr secili prej tyre, po flas për shumën vjetore, është 241,25 euro në vit, respektivisht 20,1 euro në muaj, apo 0,67 centë në ditë.

Problemi nuk është sepse shteti po mban me paratë tona 410 mijë qytetarë, por pse po i mban qytetarë të varfër, pa u siguruar mirëqenie sociale, pa krijuar kushte që ata të jetojnë më mirë.

Sa i përket shëndetësisë, gjendja është edhe më e rëndë. Kjo Qeveri ka ndarë 55.6 milionë euro, kjo i bie për secilin qytetar të Kosovës nga 32,7 euro në vit, respektivisht 2,72 euro në muaj, apo 0,9 centë në ditë. Pra 9 centë në ditë për shëndet i garanton kjo qeveri qytetarit të Kosovës. Kjo është mirëqenia sociale, siguria që Qeveria e Kosovës i ofron qytetarëve të Kosovës.

Mbaj në mend që para dy vjetësh, kur e solla një bukë në Kuvend dhe kërkova prej deputetëve ta votojnë një amendament, i cili u siguron atyre që jetojnë me ndihma sociale të kenë mundësi për t'i blerë tri bukë gjatë ditës, Ismet Beqiri, i cili mjerisht nuk qenka këtu, tha: “Mos bë teatër”. Në fakt, dy vjet më vonë mund të them po, që këtu po bëhet teatër dhe pjesa teatrale që po luhet këtu është një komedi, ndërsa teatri i vërtetë po ndodh në familjet e Kosovës që janë shumicë dhe ajo që po ndodh është një tragjedi, ku njerëzit janë të detyruar të përballen me varfërinë.

KRYESUESI: Faleminderit! Shpejtim Bulliqi e ka fjalën.

SHPEJTIM BULLIQI: Faleminderit, zoti kryesues!

I respektuar kryeministër, ministra,

Të respektuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Në radhë të parë dua të përgëzoj Qeverinë për arritjen e rumbullakimit të buxhetit për vitin 2017, i cili ka arritur shumë mbi dy miliardë euro, që mendoj është një progres i kësaj Qeverie.

Të nderuar,

Të zgjedhur të popullit,

Ju lutem për pak vëmendje në lidhje me një shqetësim, të cilin dua ta ndaj me të gjithë ju.

Unë përveç tjerave, si deputet i këtij Kuvendi, ju bëj me dije që vij nga një pjesë e Fakultetit të Shkencave Matematiko Natyrore, fakultet ky i cili po të pyesë dikush ku ndodhet, nuk ka adresë, sepse nuk ka objekt të vetin edhe sot e kësaj dite ndodhet në suazat e objektit të Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Prishtinës.

Dua të pyes të gjithë ata që kanë pasur dhe kanë ndikim në vendosjen e prioritetëve për godina dhe hapësira shkollore. A ka nevojë shteti ynë për një Fakultet të Shkencave Matematiko-

Natyrore, ku merren diplomat për biologji, për fizikë, për gjeografi, për kimi dhe për matematikë.

Është i vetmi fakultet në nivel vendi që ofron studime për këto fusha, pa të cilat nuk mund të paramendohet shkollimi parauniversitar.

Si ka mundësi që kjo shoqëri të ndajë mjete për godina prej shkollave fillore deri në fakultet për shumë vende dhe fusha, por nuk gjenden të tilla për Fakultetin e Shkencave Matematiko Natyrore. Kështu, për shembull, Fakulteti Ekonomik dhe Juridik, ne e dimë të gjithë që ka gjithandej Kosovës dhe po gjendet buxhet për të bërë një ndërtim të një objekti për këto fakultete. Jo se nuk kanë nevojë këto dy fakultete, sepse sigurisht kanë nevojë, por në qoftë se e marrim dhe e analizojmë edhe një çështje më banale që e shoh në këtë buxhet, në Agjencinë Pyjore të Kosovës, po i përmend vetëm tri kode buxhetore që janë paraparë me këtë buxhet, ku thuhet: “Rinovimi i objektit të gjuetisë në parkun e Blinajës”.

Deputetë të respektuar,

Janë ndarë hiq më pak se gjysmë milioni euro për ta meremetuar këtë objekt të gjuetisë edhe të rregullohen disa rrugica brenda parkut të Blinajës, hiq më pak, po e përsëris, se gjysmë milioni euro dhe nuk ka mundësi të sigurohen mjete për ndërtimin e objektit të Fakultetit të Shkencave Matematiko-Natyrore në Universitetin e Prishtinës.

Ju lutem, ndjeni edhe gjeni pak kohë dhe ejani vizitoni ambientet punuese ku zhvillohet mësimi në pesë departamentet e këtij fakulteti dhe binduni vetë. Kjo vlen sidomos për ministritë, Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Financave, por pse jo, jeni të mirëseardhur edhe ju, të respektuar deputetë të Kuvendit të Kosovës.

Ju lutem, të keni konsideratë një gjë të tillë, sepse aty e gjithë Kosova dhe shumë të rinj si nga jashtë, ashtu edhe nga Kosova kanë marrë mësimet në këto pesë disiplina shkencore, të cilat janë të domosdoshme për mbarëvajtjen e arsimit parauniversitar.

Dhe, krejt për fund, do të kërkoja nga ministrat përkatës, por edhe nga ju, të respektuar deputetë të Kuvendit të Kosovës, që të shfrytëzohet mundësia të gjenden mjete financiare dhe të sigurohen, në mënyrë që Fakulteti i Shkencave Matematiko Natyrore, përkundër faktit që është paraparë me një kod buxhetor diku prej 200 mijë eurosh, të sigurohet shuma e mjaftueshme që të paktën në vitin buxhetor 2017 të ketë mundësi të rifillojë ndërtimi i objektit për studentë të këtij fakulteti dhe të zgjidhet një herë e përgjithmonë nevoja e studentëve të këtij fakulteti. Faleminderit për vëmendje dhe përkrahje.

KRYESUESI: Faleminderit! Pushim i drekës deri në orën 14:30. Faleminderit!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti

KRYESUESI: Besa Baftija e ka fjalën.

BESA BAFTIJA: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës!

Edhe këtë vit nuk pritet që të ketë përmirësime në shërbimet shëndetësore, sepse buxheti i ndarë për këtë sektor është i pamjaftueshëm i pamjaftueshëm dhe nuk i plotëson as për së afërmi nevojat e institucioneve shëndetësore publike, që do të thotë se shëndetësia për këtë Qeveri mbetet prioritet vetëm në letër.

Ndonëse e dimë se me shumën prej 170 milionë e 504 mijë eurosh nuk plotësohen nevojat dhe kërkesat e institucioneve shëndetësore, është dashur së paku të kihen parasysh prioritetet e këtyre institucioneve, gjë që nuk ka ndodhur. Si, për shembull, duke e ditur se në çfarë gjendjeje gjenden shërbimet shëndetësore në kuadër të qendrave korrektuese të burgjeve, siç është fjala në Prizren, në Pejë dhe Gjilan, për këtë departament kemi zvogëlim të buxhetit për vitin 2017 për 126 mijë euro. Ndonëse shuma për këtë departament për vitin 2016 ka qenë edhe ashtu e ulët që është sjellë rreth një milion e gjysmë.

Buxheti për SHSKU-në apo Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës në total për vitin 2017 është rreth 80 milionë euro, që është i pamjaftueshëm, sepse këtu parashihen shtatë spitale të përgjithshme të Kosovës, prej kësaj shume për mallra dhe shërbime janë ndarë diku afro 11 milionë euro.

Nga kjo kategori paguhen barnat dhe materiali shpenzues, e siç e dimë, kjo shumë as për së afërmi nuk e përmbush listën esenciale të barnave, sepse që të kemi furnizim 100% të listës esenciale dhe materiali shpenzues nevojiten diku edhe 20-25 milionë euro shtesë.

Prandaj, pacientët prapë do të duhet të sigurojnë prej penjve deri te gjilpërat, ashtu siç kanë bërë tash e 17 vjet.

Në këtë projektbuxhet nuk figurojnë mjete shtesë për mjekët specialistë, të cilëve u është bërë zgjidhje vetëm për tre muaj. Shtrohet pyetja: Çka më tutje për këta mjekë? Sigurisht ju nuk i sistemoni në punë, atëherë këtyre nuk u mbetet tjetër vetëm ta lëshojnë Kosovën dhe të shkojnë në vendet e BE-së, ku i trajtojnë ashtu siç e meritojnë.

Moskrijimi i kushteve për trajtim të pacientëve me sëmundje të rënda në spitalet tona po vazhdon të mos trajtohet me prioritet nga Ministria e Shëndetësisë. Ndonëse po ndahen shuma milionëshe, për këtë vit janë ndarë 5.8 milionë për trajtime jashtë institucioneve publike, prapë çdo ditë po shohim kërkesa në rrjetet sociale nga familjarët për ndihmë financiare për trajtim

jashtë institucioneve publike, që domethënë kjo nuk është zgjidhje, sepse prapë nuk po përfitojnë të gjithë ata që kanë nevojë.

Fondi i sigurimeve shëndetësore, si njëri ndër projektet kryesore sa i përket sektorit shëndetësor, nuk është përfshirë në buxhet, ndonëse Qeveria ka vendosur që prej 1 janarit të mbledhë premiumet nga pagat e qytetarëve. E, në anën tjetër, nuk janë përmbushur kriteret që i parasheh ligji për të filluar sigurimet shëndetësore.

Prandaj, ne i paralajmërojmë qytetarët se pas vjedhjes disavjeçare të infrastrukturës së sistemit informativ shëndetësor, tani po bëhet edhe mashtrimi i radhës në mbledhjen e premiumeve, ndonëse janë dhënë mbi 7 milionë deri më tash për Shërbimin Informativ Shëndetësor dhe nuk është as për më së afërmi funksional.

Prapë, Ministria e Shëndetësisë për këtë vit ndan diku 3,5 milionë euro, e shuma të tilla pritet të ndahen edhe vitet 2018-2019.

Nuk di edhe sa milionë do të ndahen buxhet për sistemin informativ shëndetësor, e çdo Qeveri që po fillon nga e para po zhvat miliona për këtë sistem, në vend që të kërkojë llogari fillimisht për miliona të keqpërdorur më parë.

Kemi spitale që janë ndërtuar me donacione të huaja, ku investimet kanë arritur diku 7 milionë, siç është Spitali i Vushtrrisë, i cili në mungesë të stafit ka gjasa të mbyllet.

Në anën tjetër, kjo Qeveri nuk është në gjendje të ndajë buxhet për mjekë specialistë, nga të cilët edhe ashtu ka shumë të papunë.

Në buxhetin që është ndarë për shëndetësi më tepër u është dhënë prioritet investimeve kapitale në këtë sektor, se sa kujdesit të shërbimeve shëndetësore te niveli primar, sepse shuma e ndarë për mallra dhe shërbime, ku thashë hyjnë barna dhe materiali shpenzues, mbetet e njëjtë.

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Me këtë ndarje buxhetore, ku shëndetësia mbetet e lënë pas dore dhe ku nuk pritet që të ketë përmirësime të shërbimeve shëndetësore, ne nuk mund ta votojmë këtë Projektligj për buxhetin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Blerim Grainca.

BLERIM GRAINCA: Zoti kryesues,
Të nderuar kolegë deputetë,

Zakonisht buxhetet po përcillen me shumë interesim dhe shumë diskutime, gjë që mendoj që është krejt normale, edhe kur ka vërejtje e sugjerime, kjo është një shenjë e demokracisë, edhe kur kjo vjen edhe nga Selvia, kështu që nuk ka asnjë gjë të keqe. Më lejoni të them që buxhetin unë e shoh si një buxhet të mundësive dhe potencialeve që ka për momentin vendi ynë, prandaj edhe të gjitha projektet e planifikimit dhe sugjerimet që janë në të i shoh si të arritshme dhe të realizueshme për arsye se ky buxhet siguron një disiplinë financiare, siguron një menaxhim të mirë të fondeve publike dhe siguron një prosperitet që bazohet në zhvillim ekonomik me mundësi dhe garanci për rritje dhe të punësimit.

Përkundër të gjitha gjërave pozitive që ka në këtë buxhet, mendoj se janë edhe disa projekte që do të duhej të ishin brenda këtij buxheti dhe do të duhej që edhe pse nuk kanë kosto të madhe duhej të ishin futur me kohë në buxhet. Më lejoni të përmend disa nga to, të cilat i kemi diskutuar paraprakisht edhe me ministrin e Financave: para një kohe bukur të gjatë edhe LDK-ja edhe vetë ekspertët e partisë tonë e kanë pasur si synim hartimin e studimit të fizibilitetit për projektin e kamotshëm të Ibër-Lepencit, përkatësisht për pjesën e Lepencit.

Është një projekt që siguron ujë të pijshëm, ujë për ujitje dhe ujë industrial për të gjithë rrafshin e Kosovës. Është një projekt që nuk ka kosto të madhe, studimi i fizibilitetit do të mund të bëhej me një vlerë prej 200 milionë eurove, prandaj zoti ministër mendoj që do të ishte mirë të shikonim mundësinë që gjatë leximit, mes dy leximeve ta futni në buxhet edhe këtë projekt.

Po ashtu, është një projekt tjetër, një studim tjetër i fizibilitetit që mendoj se ka rëndësi mjaftë të madhe për ekonominë e vendit tonë, e ai është studimi i fizibilitetit për projektin apo për lidhjen në gazsjellësin “Tap” që është furnizim me gaz, në këtë rast do të bëhej nga Shqipëria. Mendoj se një studim i fizibilitetit që do të kushtonte rreth 200 mijë euro do na krijonte mundësi më të mëdha për të parë arsyeshmërinë dhe nevojën që ka vendi ynë për t’u kyçur në këtë gazsjellës që kalon nëpër Republikën e Shqipërisë.

Mendoj se duke u lidhur në këtë projekt ne kemi mundësitë që për ekonominë tonë të krijojmë favore, sepse kostoja e gazit është më e lehtë se kostoja e naftës dhe mazutit dhe gjërave tjera që mund të përdorë industria tek ne, dhe po ashtu edhe për amvisëri mund të kemi beneficione të jashtëzakonshme. Nuk po e shoh ministrin e Transportit këtu, por megjithatë më duhet të them se në këtë projekt po ashtu është lënë anash përmes projektit të autostradës i është bërë e padrejtë qytetit të Ferizajt, për arsye se ishte lënë vetëm një hyrje gjithë qytetit dhe mendoj se është dëmtuar edhe ekonomia, edhe qarkullimi i lirë i qytetarëve dhe banorëve të Ferizajt. Prandaj, e kemi diskutuar që kjo çështje të gjenden variante për të financuar edhe një hyrje për qytetin e Ferizajt, sepse kështu si është e ka shumë larg qyteti kyçjen, duhet të kyçet te pjesa e Lipjanit, përkatësisht mbi Bondsteel.

Po ashtu, këto ditë është aktuale edhe mjaftë shqetësuese edhe çështja e ambientit. Mendoj se Ministria e Transportit duhet të rrisë vlerën që e ka paraparë, realisht s'ka paraparë asgjë tek pjesa ku lidhet me kontrollin e gazrave që lirojnë automjetet, gjegjësisht e ka zero, rekomandoj që kjo të rritet për arsye se kërkon një kosto të jashtëzakonshme dhe prek edhe jetën dhe shëndetin e qytetarëve çdo ditë.

Po ashtu, tek Ministria e Bujqësisë mendoj se duhet të rritet vlera për pjesën që lidhet me pyjet, gjegjësisht me pyllëzimin e sipërfaqeve të reja zoti ministër, tek Ministria e Bujqësisë në këtë pikë nuk kemi fare mjete të parapara, gjegjësisht janë zero. Besoj që gjatë dy leximeve do kemi mundësi që këto 4-5 çështje t'i fusim në buxhet dhe nuk janë projekte që rrisin shumë vlerën, nuk e ndryshojnë shumë strukturën. Të gjitha këto nuk kanë kosto 700-800 mijë euro, prandaj mendoj që nuk është ndonjë vlerë që nuk mund të përballohet. Është për tu përgëzuar fakti për shembull se kemi rritje të buxhetit në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, kemi një rritje prej 37% dhe që shkon në favor të promovimit të investimeve, në favor të rritjes së iniciativës private.

Mirëpo, po ashtu kemi edhe rritje edhe te vetë Ministria e Infrastrukturës e megjithatë nuk janë përfshirë disa projekte që kanë interes edhe nacional, edhe projekte lokale dhe rajonale. Mendoj që theksi i gjithë kësaj ane veçanërisht do të fokusohem te këto dy studimet e fizibilitetit dhe tek krijimi i mundësisë edhe për një kyçje edhe për një rrugë alternative nga autostrada për qytetin e Ferizajt. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Shaip Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Buxheti sot që miratohet përkundër komplimenteve që po i japim krijohet përshtypja që duhet t'i prodhojmë edhe do medalje të arit që tu japim projektueseve të buxhetit, por nuk është i tillë.

Ka shumë vërejtje të cilat ndoshta unë jam i gabuar, por duhet të parashtroj disa probleme, të cilat unë i kam evidentuar dhe janë të projektuara në buxhet për problemin e shëndetësisë i cili ka për vitin që vjen buxhet më të vogël dhe arsyeshmëria është se ky buxhet është i mjaftueshëm ndërsa kualiteti i shërbimit shëndetësor po kërkohet më i madh dhe rrjedhimisht ata që nuk kanë buxhet nuk mund të japin as kualitet, por një formë tjetër të arsyeshmërisë të cilën e japin projektuesit e këtij buxheti dhe Ministria e Shëndetësisë thonë se sigurimet do të fillojnë të mbliidhen dhe unë nuk e kam të qartë se ato sigurime si do të mbliidhen, si do të shpërndahen, si do të menaxhohen dhe si do të projektohen dhe në çfarë drejtimesh.

Prandaj, mënyra e shpjegimit që po jepet dhe mënyra e projektimit të buxhetit që është deri në vitin 2018 që kolegja deputete kur tha që sistemi i informimit shëndetësor nuk do të jetë funksional, unë kam thënë që 3-4 vjet që sistemi i informimit shëndetësor nuk është funksional

dhe çfarë sistemi të sigurimit po doni të mbledh. Ndërsa, në projeksionet buxhetore të donatorëve, sistemi i informimit shëndetësor së bashku me bashkëpjesëmarrjen qeveritare është deri në fund të vitit 2018 nuk do të jetë funksional. Një sistem jo funksional i informimit shëndetësor nuk mund të garantojë sigurim shëndetësor, prandaj ne po mashtrojmë çdo vit, unë po them të mos mashtrojmë, por ne të biem me këmbë në tokë.

Ky sistem i shëndetësisë, unë po kërkoj që shëndetësia vërtetë vitin e ardhshëm dot të jetë edhe më në kaos, do të jetë më e dëmtuar, do të jetë më e goditur qysh nga aspekti publik, qoftë nga aspekti i shërbimeve kualitative të mundshme që duhet t'i jep qytetarëve të Kosovës. Unë i lus edhe fansat e Facebook-ut të cilët mundohen mandej të krijojnë opinione të ndryshme, ata fansa politik, të cilët mundohen të japin epitete të njëanshme, por mënyra e menaxhimit të shëndetësisë është shumë shqetësuese, është jashtëzakonisht shqetësuese.

Ne e shohim në mungesë të forcimit të sistemit shëndetësor po merremi shumë me mjekët, ndërsa sistemin po e maskojmë duke mos e quajtur veten se është jo funksional dhe një fajtor po duhet të gjendet diku edhe ato hapësira të funksionit po gjenden tek mjekët, sot është në skenë vetëm mjeku e nuk është sistemi. Dhe, prandaj për këtë punë janë fajtor qeveritë dhe Qeveria dhe duhet të merret shumë seriozisht ky problem në të kundërtën ky buxhet nuk mund të jetë i mjaftueshëm as i dobishëm për shëndetësinë e një shteti i cili nuk investon në shëndetësi dhe në arsimim ai shtet nuk mund të bëjë as polici, as drejtësi, as ushtri.

Prandaj, kjo është çështje indirekte e cila reflekton edhe në kuadrin shoqëror edhe mentalitetin shoqëror të popullatës. Ne jemi të pakujdesshëm ose të pamjaftueshëm për të ngrit sistem shëndetësor me vetëdije a pavetëdije nuk po e kuptoj, nuk ka nevojë që të inatoset dikush, por ne duhet të themi kjo Ministri e Shëndetësisë është e paafte. Ne nuk po themi bjerini dikë tjetër, bjerini edhe 10 tjerë ose bjerini edhe 10 menaxherë tjerë, nëse ka nevojë, por jo të lihet shëndetësia në këtë formë çfarë është duke e trajtuar.

Ministri i Financave e dinë fort mirë që janë disa ligje, të cilat janë miratuar në Republikën e Kosovës dhe të cilat do të kenë implikime financiare. Nuk janë parashtruar në projekte këto, e kam fjalën për rentën minerale e cila ne duhet të bëjmë domosdo edhe ndryshim ligjit, edhe shpjegimi qeveritar sot është dashur të vijë zyrtarisht, nuk ka ardhur. Ne sigurisht si deputetë në bazë të procedurave dhe Rregullores duhet ta kemi dhe renta minerale do t'ju takojë në bazë të edhe për shkak të Ligjit të Trepçës, të cilin e kemi kaluar, por edhe për shkak të Ligjit të Obilqit si zonë e veçantë ne duhet të taksojmë rentën minerale dhe e kemi kërkuar që 20% të mbetet në komuna renta minerale apo taksa në mineral për ekstra-buxhetet në komuna dhe kjo do të reflektojë sigurisht se çfarë mënyre e ka projektuar Ministria e Financave nuk e dëgjova këtu si arsyeshmëri.

Monitorimi i shumë ligjeve, të cilat ne do t'i miratojmë në vitin e ardhshëm, unë mendoj që ky buxhet do të ketë probleme, të cilat nuk do të jep mundësi. Vërejtjet tjera, të cilat janë tek Kodi pesëshifror i komunave për mallra dhe shërbime, ku parashihet mbi 25% të shfrytëzimeve nga kryetarët e komunave nëse ka qenë vërejtje nga Asociacioni i Komunave të Kosovës që ajo të shihet sipas propozimit të tyre kishte qenë mirë Ministria e Financave të jep një arsyeshmëri para neve deputetëve jo vetëm të parashihet në mënyrë të tillë, sepse mund të ketë edhe performansë të dobët edhe nga menaxhimi komunal i kryetarëve të komunave.

Në fund fare, meqenëse ne kemi përfunduar zgjedhjet në Drenas dhe është konkludim i të gjitha partive politike se atje ka ende nevojë që të investohet, atje ende ka nevojë që të investohet në Drenas duke filluar nga LDK-ja e deri tek AAK-ja dhe "Vetëvendosja" dhe ne si fitues, Partia Demokratike, kërkoj një konsensus që ju t'i ndani edhe 1 milion euro Drenasit më tepër si komunë, në të cilën atje nuk është investuar 70 vjet, dhe buxheti i projektuar për kokë të banorit nuk ka qenë i mjaftueshëm për sanimin e infrastrukturës së munguar, kanalizimeve e ndriçimeve në atë komunë.

Prandaj, ju kërkoj që në amendamentim edhe të jeni të gjithë unik që t'ia shtojmë edhe një milionë euro shtesë nga të gjitha këto që i ka komuna e Drenasit, sepse kemi thënë të gjitha partitë në fushatë dhe sot nëse duan qytetarët të na shohin bëhuni zemërmirë edhe mobilizohuni e jo vetëm fushata, por mobilizohuni faktikisht që t'ia shtojmë edhe 1 milionë euro Drenasit, sepse ajo zonë 70 vjet nuk është investuar dhe nuk shihet dhe ka ra ajo teoria që ne dhe kotecet i kemi me asfalt në Drenas e kjo ka ra shumë në ujë, sepse janë turpëruar shumëkush kur e kanë parë si është gjendja, edhe janë turpëruar ndoshta edhe me neve që vazhdimisht kemi kërkuar që të ketë atje shtesë më shumë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, Time Kadriaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Të nderuar deputetë.

Autostrada dhe asfaltimi i rrugëve mbeten top prioritet i Qeverisë së Kosovës në përcaktimin e politikave buxhetore. Një orientim i tillë i është dhënë edhe buxhetit për vitin 2017, ku prej 2 miliardë eurosh të planifikuara rreth 730 milionë euro do të shkojnë në investime kapitale apo për ndërtimin e rrugëve. Ne të gjithë pajtohemi se asfalti dhe rrugët janë të nevojshëm për qytetarët e Kosovës, por qytetarët kanë nevoja tjera ato nevoja kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik në ndërmarrje të vogla dhe të mesme, me fuqizimin e sektorit privat dhe krijimin e parakushteve për vende të reja të punës.

Investimi në ndërtimin e rrugëve bëhet edhe në mungesë të ideve për projekte tjera. Institucionet shtetërore të Kosovës më së lehti i orientojnë investimet në infrastrukturë rrugore, të cilat përveç

që kanë karakter ekonomik kanë edhe karakter politik, ndërsa nuk po investohet për gjelbërimin e ambientit në Kosovë, sepse ju e keni parë kohëve të fundit se ndotja e ajrit në Kosovë e konkretisht në Prishtinë, është një shqetësim i madh i cili falë miqve tanë u bë publike, sepse institucionet tona prapë si në vitet e kaluara kanë tentuar të fshehin këtë të vërtetë të hidhur.

Parametri tjetër tregon se investimet po mungojnë edhe në investimet rrugore nuk janë i vetmi kriter që të tërheqin investitorët. Ne kemi pasur rënie të madhe të investimeve të huaja, të cilat janë shumë të domosdoshme. Ka shumë shifra fiktive të cilat vetëm janë përshkrim teorik, matematikor, nuk është aspak zhvillimor, i gjithi është i varur nga vjelja në kufi dhe nga doganat, i cili brenda Kosovës vetëm korrupsionin e rrit, asnjë segment tjetër.

Prandaj, mos tentoni të shiteni se po bëni punë të madhe duke e proklamuar një buxhet të tillë, sepse nuk është e vërtetë, por është veçse edhe një mashtrim i juaji i radhës ndaj qytetarëve, sikur ishte mashtrimi për 300 mijë vende të punës, sikur që ishte mashtrim liberalizimi i vizave, sikurse që ishte mashtrim Ligji për sigurimet shëndetësore, sikur që ishte mashtrim Ligji për transformimin e FKS-së në Ushtri të Kosovës, sikur po i mashtroni veteranët sot, sikur po i goditni familjet e dëshmorëve duke ua ndalur pensionin, në fakt do të duhej ta godisni informalitetin që e keni nga koka në këmbë e jo kategori të luftës me arsyetimin se po e bëni mbushjen e buxhetit.

Edhe buxheti për invalidët e luftës, nuk duhet të cungohet. Po ashtu, i keni lënë në mëshirë të fatit komunat e Dukagjinit, shumicën prej tyre të zënë, për shembull ta zëmë Komunën e Junikut ju nuk i ndani as 1,5 milion euro, janë pra shumë pak kur e kemi parasysh mundësinë e të hyrave vetjake, sepse është komunë e vogël. Çka mund të bëjë një komunë me kaq pak buxhet?

Bujqësia është një ndër sektorët kryesorë për zhvillimin ekonomik të vendit, kjo për arsye se rreth 90% e popullsisë posedon tokë kultivuese, ndërsa nga mungesa e mbështetjes së Qeverisë vetëm 30% e popullsisë është e angazhuar në fushën e bujqësisë, ndërsa ju vazhdoni të thoni se bujqësinë e keni prioritet.

Me rreth 55 milionë euro nuk mund dhe nuk do të duhej të thoni që bujqësia do të zhvillohet hovshëm as për së afërmi s'do të jetë ashtu, mjerisht. E duke e parë këtë trend nuk besoj aspak ama aspak hiq se ju do të arrini të bëni diçka konkrete dhe reale për ecjen përpara të sektorit të bujqësisë. Doganat e Kosovës janë burim kryesor i arkës së shtetit, këtë vit dogana ka tejkaluar për 22 milionë euro parashikimet buxhetore të projektuara në buxhetin e këtij viti, por për vitin 2017 mbetet një sfidë për të arritur projeksionin që tashmë Qeveria e ka vendosur me draft buxhetin e vitit 2017. Dogana duhet të inkasojë hiç më pak se 1 miliardë r 100 milionë euro, por Dogana do të ketë një sfidë për të arrit projeksionin që ende është draft, është hyrja në fuqi e Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim. Me këtë marrëveshje shumë mallra do të jenë të liruara nga pagesa e taksës doganore nga 9 deri në 8%, ndërsa pajisjet e IT-së do të lirohen nga taksat

doganore përveç lirimeve të mallrave me MSA do të ballafaqohen edhe me lirime për disa mallra të tjera që do të lirohen nga TVSH-ja.

Kështu se si do të realizohen ato mjete që i keni paraparë në buxhet. Buxheti i planifikuar për shëndetësinë në Kosovë për vitin 2017, nuk parasheh ngritje. Ky buxhet ka mbetur i njëjtë në këtë vit, që kap vlerën prej 180 milionë euro me buxhetin e ndarë për vitin e ardhshëm shëndetësia do të vazhdojë të përballet me shumë sfida sikurse edhe vitet paraprake.

Lista esenciale pas 16 vite dhe prej planifikimit asnjëherë nuk është përmbushur 100%, ndërsa sa i përket Deçanit janë ndarë disa mjete për disa projekte, mirëpo ato mjete dhe projekte janë ndarë me shuma aq të vogla sa që këto projekte nëse nuk përkrahen në këtë projektbuxhet do të vazhdojnë të mos realizohen edhe me vite të tëra. E kemi projektin asfaltimi i rrugës “Dëshmorët e Deçanit” në Deçan që lidhet me Manastirin, projekte kapitale për nivelin qendror në funksion me numër kaq, shuma e propozuar në Projektligjin e buxhetit për vitin 2017 është 143 mijë euro. Kërkojmë që këtij projekti të paraparë me këtë buxhet t’i shtohet shuma në vlerë prej 100 mijë euro shtesë për këtë vit.

Këtë ta arsyetojmë se pse realizimi i këtij projekti për qytetarët e Deçanit është shumë e rëndësishme kjo do të ndikonte edhe në zhvillimin e turizmit.

Pikë tjetër ose projekt tjetër e kemi financimi i investimeve kapitale komunale në Komunën e Deçanit për 500 mijë euro. Kodi buxhetor 631180, dhe ne kërkojmë që kësaj shume t’i shtohet për projektin e ujësjellësit për 10 fshatra t’i shtohet edhe 150 mijë euro për këtë vit.

Dhe, një propozim tjetër është ndërtimi i rrugës “Ura e Demës” qendër, Carrabreg në Komunën e Deçanit zgjerimin e kësaj rruge që për këtë vit janë ndarë 400 mijë euro, ndërsa ne kërkojmë edhe 370 mijë euro për këtë vit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Shqipe Pantina e ka fjalën.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

Tashmë u tha se Ligji për buxhetin padyshim është ligji më i rëndësishëm i cili shqyrtohet, diskutohet dhe në fund miratohet ose jo, brenda një viti kalendarik.

Është e kuptueshme se është projektligji i cili më së shumti ka numra brenda përmbajtjes së tij, mirëpo aq shumë është degraduar dhe aq shumë është kufizuar ky projektligj numra dhe në fakt edhe kjo është vetëm një pasqyrë që neve na ka ndjek prej fillimit të kësaj legjislature. Gjithçka është kufizuar edhe është bërë numra, nuk ka më synime, nuk ka prioritete, nuk ka as procedura demokratike, por gjithçka matet dhe shihet me numra.

Edhe projektligji të cilin ne po e shqyrtojmë përveç numrave ka shumë pak, për mos me thënë aspak shpjegime se çfarë nënkuptojnë ata numra: si është arritur deri te këta numra? Dhe, çka pasqyrojnë në fund të fundit? Cilat janë prioritetet? Cilat janë synimet e kësaj Qeverie, të cilat ajo mandej i ka përkthyer edhe në formë numrash.

Prej diskutimeve që i patëm edhe sot shumë deputetë në fakt e prezantuan edhe veten si numra, duke i harruar edhe bindjet e tyre, duke e harruar edhe arsyet tjera pse janë këtu. Pse po e them këtë? Deputetët, vendimet e tyre i marrin përmes votës, në fund ata vendosin me mënyrën si votojnë e shumë më pak me atë se çka thonë këtu në Kuvend. Ajo çka ndodhi sot, të paktën deri tash prej disa prej deputetëve të koalicionit që unë e pash është se e kanë kuptuar se ky projektligj është gabim, ka shumë gabime, jo që e kanë kuptuar, por e thanë me zë të lartë se ky ligj është i keq, ky ligj, ky projektligj nuk sjell diçka të mirë për qytetarët e vendit. Bile edhe e mbështetën me argumentet dhe me faktet e tyre pse mendojnë se ky projektligj nuk është i mirë, nuk sjell diçka pozitive për qytetarët, por në fund thanë po e miratojmë këtë projektligj.

Tash unë nuk e kuptoj në fakt cila është përgjegjësia publike që ne e kemi si deputetë, me vetëdije të plotë duke i treguar edhe qytetarëve se kjo është diçka e keqe, por në fund po ua sevojme juve si diçka të keqe, sepse diçka tjetër ndoshta e mirë personale fshihet prapa kësaj. Tash, pse kjo është kufizuar në numra edhe nuk po respektohet asnjë lloj procedure e mos të flasim për gjithë procesin demokratik, por është parë edhe me procesin e hartimit dhe miratimit të këtij projektligji.

Më në fund, pas tre vjetësh Qeveria për herë të parë e solli në Kuvend Ligjin me kohë, që t'i jepte kohë të mjaftueshme edhe komisionit, por edhe deputetëve ta shqyrtojnë projektligjin në qetësi dhe pastaj ta formulojnë opinionin, mendimin dhe në fund vendimin e tyre nëse duan ta mbështesin apo jo. Mirëpo, çka ndodhi? Fillimisht, për tri mbledhje radhazi projektligji nuk hyri në rend të ditës në komision. U zvarrit aty njëherë procedura, pastaj në komision u diskutua aq shumë dhe pati aq shumë vërejtje jo mes deputetëve të pozitës dhe opozitës, por mes vetë deputetëve të koalicionit qeverisës, sa që në fund u krijua përshtypja se projektligji nuk do të kalojë.

Në fund, ai kaloi dhe edhe pse të gjitha diskutimet edhe këtu e hedhin poshtë atë që e tha kryeministri se ky projektligj është hartuar nga partnerët e koalicionit. Diskutimet e deputetëve këtu na dëshmojnë të kundërtën, se nuk ka pasur dhe, tash ta shohim në fund nëse deputetët vërtet do të votojnë kundër mendimit e ndoshta edhe vullnetit të tyre. Por, të paktën, neve na treguan se nuk ka pasur një marrëveshje, nuk ka pasur dakordim në mes partnerëve të koalicionit. E tash, është diskutuar shumë se ky buxhet është 2 miliardë, e thanë kolegët tjerë se a është apo jo 2 miliardë, s'po ndalem më shumë, por shumica dhe në fakt më shumë se 1/3-a e gjithë Buxhetit, pjesës për investime kapitale, prapë shkon në rrugë, në asfalt. Në fakt, unë do të thosha se as në asfalt nuk shkon, 1/3-a e këtij buxheti është në tenderë, aty hapen tenderë por

është gabim dhe nuk do të ishte mirë që të mashtrohen qytetarët, se do të ndërtohen rrugë, sepse vitin e ardhshëm nuk do të ndërtohen 70 rrugë, siç i ka paraparë me këtë buxhet, do të hapen 70 tenderë, por nuk do të ndërtohen rrugë.

Nuk qenka ministri Zharku këtu, se ndoshta ai do të na shpjegonte se si është e mundur që më shumë se 50 projekte shumë e kanë fiks 50 mijë euro. Parashihet që një pjesë, këto janë projekte që bashkëfinancohen prej komunave, por si po ndodhka që rruga Lubizhdë - Storobisht e Prizrenit të kushtojë vetëm 50 mijë euro, rruga Gjonaj - Bishtazhin 50 mijë euro, rruga Prizren - Velesht 50 mijë euro, rruga Svark - Rud në komunën e Malishevës 50 mijë euro. Pra, janë rreth 50 projekte që kushtojnë fiks 50 mijë euro. A janë të barabarta këto rrugë, a kanë projektin e njëjtë, gjatësinë e njëjtë apo ministri synon t'i hapë 50 tenderë, por jo të ndërtojë 50 rrugë të reja. Për më tepër, ministri ka vendosur që numrin e tenderëve ta rrisë, nuk janë 50, janë gati 90 tenderë, e them tender sepse nuk do të ndërtohen rrugë dhe ja se përse, ta zëmë, rruga Mushtisht - Shtërpçë shuma totale e gjithë këtij projekti është 1 milionë euro, mirëpo ministri për vitin 2017 i ka ndarë vetëm 100 mijë euro, 500 mijë euro ministri ka menduar t'i ndajë në vitin 2019, por edhe nëse nuk kemi zgjedhje në pranverë, ashtu siç po flitet, kjo qeveri jetën më të gjatë që mundet ta ketë është deri në vitin 2018. Tash, si guxon ky ministër dhe kjo qeveri ta fusë në borxh qeverinë e ardhshme, e cila ndoshta do ta ketë një prioritet tjetër, nuk do të dëshirojë të ndërtojë më asfalt, por do të dëshirojë të rrisë, ta zëmë performancën e nxënësve, që vitet tjera kur PISA ta bëjë vlerësimin të paktën të dalë diçka më mirë, sepse me asfalt e dimë se kjo nuk do të ndodhë.

Dhe, nuk është ky projekti i vetëm me të cilin ministri Zharku e fut në borxhe, do të thotë nënshkruan kontrata, e merr 10%-shin dhe pastaj ndërtimin e rrugës ia len qeverisë e cila do të vijë në pushtet në vitin 2019. Ngjashëm është, ta zëmë, edhe rruga Babush-Tërn-Lubovc-Kosharë dhe Slivovë. Projekti kushton 1 milion euro, për vitin 2017 janë paraparë 100 mijë euro, 500 mijë euro për vitin 2019. Shembuj të tillë ka sa të duash përgjatë gjithë Ministrisë së Infrastrukturës, e cila, siç thash, vetëm rrugë nuk do të ndërtojë, sepse shumica e këtyre rrugëve edhe me këtë buxhet parashihet të ndërtohen brenda 3 vjetësh. Tash, qytetarët do të ballafaqohen me kantierë ndërtimi, me hapje gropash nëpër rrugë edhe për tre vjet e praktika na ka treguar, se në fakt as tre vjet nuk ka mundur të ndërtohen rrugët, por rreth pesë vjet ata kanë pasur kokëçarje e probleme me rrugë për të cilat vetëm janë hapur, por asnjëherë nuk janë ndërtuar.

Por, tash të gjitha këto projekte që i përmenda janë ato që fillojnë në vitin 2017, do të thotë në vitin 2016 shumat për këto projekte kanë qenë zero. Janë një sërë projektesh tjera, që janë të bartura prej vitit 2016 e për të cilat prapë nuk ka shpjegim, ta zëmë vetëm një shembull, asfaltimi i rrugës Skenderaj - Rexhëmetaj - Alimus shuma e bartur prej vitit 2016 është 162 mijë euro. I gjithë projekti i cili po ashtu, përfundon në 2019-ën është 362 mijë euro, por as këtu nuk ka asnjë dokument të bashkëngjitur, asnjë aneks i cili shpjegon. Dhe, kjo është diçka që përcillet në të gjitha ministrinë, në të gjitha buxhetet, se kjo shumë që po bartet prej vitit 2016 a është shuma që

ka qenë e alokuar në 2016 e njëjtë dhe e njëjta shumë po alokohet edhe në vitin 2017, sa ka qenë shuma e përgjithshme e vitit 2016, sa është shpenzuar nga kjo shumë e caktuar për vitin 2016 dhe sa prej saj po mbetet të bartet në vitin 2017 dhe pse po ndodhë kjo?

Në secilin projektligj që ne kemi shqyrtuar, përveç projektligjit bazë, do të thotë përveç përmbajtjes së projektligjit, neve na është ofruar edhe një dokument tjetër e i cili është memorandum shpjegues, i cili...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fatmir Rexhepi e ka fjalën.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Natyrisht që debati që po zhvillohet, përveç vlerësimeve dhe diversiteteve që i kemi brenda paraqet edhe konstatime të ndryshme, prandaj edhe unë duke lexuar buxhetin do të shpreh disa nga vlerësimet e mia, që të jap një kontribut për politikën që u prezantuan këtu dhe për projektin që e kemi përpara të Buxhetit të shtetit për vitin 2017.

Qysh në fillim do të them, që e përkrah në tërësi fjalën hyrëse të ministrit, lidhur me gjithë procesin dhe me gjithë strategjinë e ndërtimit të Buxhetit, por edhe për politikën dhe synimet që i ka në implementimin e këtij projektbuxheti, që do të jetë një disiplinë e jashtëzakonshme në menaxhimin e financave publike për vitin që na pret, prandaj edhe i jap përkrahje të plotë.

Treguesit e projektbuxhetit brenda këtyre letrave, që i kemi përpara, flasin për politikën dhe klasifikimet buxhetore, të cilat po t'i lexojmë drejtë ato flasin për një qëndrueshmëri makro-fiskale, në radhë të parë, flasim për një qëndrueshmëri makro-ekonomike në radhë të dytë. Flasim po ashtu, për të hyrat buxhetore të cilat mbështeten në politikën e një qeverie, e cila ka vlerësuar drejt potencialin ekonomik të vendit, flasim po ashtu për shpenzimet e projektuara që janë në harmoni me mundësitë, por edhe janë harmonike për gjithë sektorët që përfshihen brenda këtij buxheti.

Të kemi parasysh disa të dhëna për t'i krahasuar dhe për të nxjerrë vlerësime sa më të drejta dhe më të arsyeshme, të cilat kanë të bëjnë se respektohet limiti dhe nuk arrihet as minimumi i asaj, kur është në pyetje deficit i buxhetit që parashihet në buxhetin aktual. Pastaj borxhi publik, që është po ashtu, i prezantuar brenda këtij buxheti, flet për politikën e drejtë dhe shpeshherë kemi kritika se borxhi publik po rritet në normën që do të tejkalojë disa përqindje në kuadër të produktit të brendshëm të vendit apo kategori që dëshirojnë njerëzit t'i matin këtu.

Por, unë po e them këtë dhe po i marr dy shembuj, sidomos e kam për ata ekonomistë që e kanë kryer fakultetin ekonomik me meritë. E di shumë mirë që edhe kur është borxhi publik më i vogël se ajo që parashihet këtu, por edhe kur është më i madh, në qoftë se i ka dy synime të qarta, ai e ka qëllimin e mirë. E para, në qoftë se marrim buxhetin publik do të jetë edhe më i madh se ky që është, edhe me shifra shumë më të mëdha, por kur qëllimi i këtij buxheti nuk ka për qëllim që të financojë veprimtari joproductive, veprimtari jozhvillimore, veprimtari joinvestuese, atëherë ajo është projektbuxhet që garanton që edhe këto borxhe futen në një kthim në projekte të cilat do të jenë shumë rentabël në të ardhmen dhe të krijojnë shumë më shumë të hyra buxhetore dhe të mira në buxhetin e shtetit në vitet në vijim. Prandaj, këto krahasime mund ta lejojnë që buxheti, gjegjësisht borxhi publik të jetë edhe shumë më i madh se që është ky.

Prandaj, politika e drejtë është ajo sikur në rastin kur kemi në Japoni shumëfish borxhi publik është më i madh për disa fish që lejojnë normat apo standardet, me të cilat maten statistikat botërore, ndërsa ato shkojnë në projekte zhvillimore dhe në projekte produktive. Por, kur e marrim rastin e Greqisë, kur ato shkojnë për shpenzime të tjera, bie fjala, për paga pa meritë, për subvencione publike, për çështje të tjera, atëherë shteti falimenton. Ajo nuk është e lejueshme.

Unë mendoj, që këtu jemi brenda standardeve dhe ka shumë mundësi më të mëdha dhe unë në të ardhmen, që edhe pse rritet kjo, politikat dhe strategjia të orientohet në projekte dhe investime që garantojnë këtë zhvillim dhe kthimin e këtyre mjeteve në të hyra shumë më të mëdha buxhetore.

Ana tjetër është tek strategjitë që janë përdorur apo orientimet buxhetore të fondeve, kur është fjala për fondet në pajtim me institucionet tjera ndërkombëtare në investime kapitale, pra duhet të përkrahen dhe është shumë mirë që është bërë kjo. Nuk ka zhvillim tjetër, në qoftë se nuk i shfrytëzojmë edhe këto фонде, edhe këto mundësi.

Orientimi tjetër në zvogëlimin e shpenzimeve apo subvencioneve për ndërmarrjet publike në zvogëlimin për shpenzimin për mallra, shërbime dhe gjëra të tjera, mendoj që janë shumë pozitive dhe me vend për një projektbuxhet, i cili mundëson një objektivë dhe një qëllim tjetër.

Në anën tjetër, është shumë me rëndësi se brenda këtij projektbuxheti, po qe se e lexojmë drejt, e kemi edhe ruajtjen e balancës apo ekuilibrit financiar dhe të mos kalojmë prapun, i cili na e krijon një shoqëri socio-parazite, të cilën nuk guxojmë ta lejojmë në asnjë mënyrë. Shtrohen kërkesa enorme brenda vitit dhe është çudi që shoqëria jonë dhe ne heshtim, me kërkesa pa mbulesë, me kërkesa për lloj-lloj fondi, lloj-lloj subvencionimi edhe për të ardhura të pamërituara prej të gjitha kategorive të ndryshme, të cilat është e pamundur t'i bartë ekonomia e këtij vendi. Nuk mundet sektori prodhues, sektori i cili krijon, sektori i cili prodhon, sektori i cili krijon buxhet, nuk krijojnë administratat, nuk krijojnë këto... kjo shoqëri parazite. Prandaj, ne duhet të jemi të qartë në këtë punë dhe, unë e përkrah plotësisht. Sado që duket hap i vogël, unë e përkrah se është shumë me vend ruajtja e balancës.

Po ashtu, u tha konstatimi nga kryeministri këtu, që duhet ta përkrahim të gjithë dhe në parim duhet ta vlerësojmë, se orientimi i buxhetit me qëllime zhvillimore duhet të jetë synim i të gjithë neve, jo me orientim shpenzuese. Pra, është një alfa dhe omega, të cilën Qeveria po provon që të vejë një disiplinë të re, një model të ri, një metodë të re të përgatitjes por dhe të implementimit në zbatimin apo në shfrytëzimin e këtij buxheti për vitin tjetër.

Prandaj, unë duke i dhënë përkrahje të fortë këtij ritmi, kësaj nisme, lidhur me projektbuxhetin, mendoj se po qe se realizohet në tërësi dhe ruhet kjo dinamikë, atëherë kjo është një mundësi jo vetëm 4% të kemi rritje të GDP-së, por unë mendoj që kjo do të jetë një shkallë e mirë, një bazë e mirë, që viti 2018 apo deri në vitet tjera të kemi gradualisht për çdo vit të rrisim edhe 5, 6 edhe 7%, që është synim i të gjithë njerëzve, është synim i të gjithë politikanëve në Kosovë.

Kështu që, duhet si hap i parë ta marrim parasysh se të hyrat e projektuara dhe politikat në implementimin e tyre do ta japin një mundësi të tillë. Për fund, unë personalisht po e përkrah, edhe një herë po e them këtë, për arsye se ky projektbuxhet dhe projekti i ndërtimit të autostradës Prishtinë-Gjilan-Bujanoc është ai që e korrigjon një gabim dhjetëvjeçar që ka ndodhur në këtë Parlament edhe nga qeveritë e kaluara, sepse kjo është një e mirë që tregon për investimet dhe një shpërndarje harmonike e drejtë në të katër anët e Kosovës, në perëndim, në veri, në jug dhe lindje. Sado që, është e fundit, por vetëm projekti për të filluar ndërtimi i kësaj autostrade vitin e ardhshëm, unë mendoj që e korrigjon atë padrejtësi dhjetëvjeçare që ka ndodhur brenda një dekade në infrastrukturën me interes nacional, sepse ajo ka pasur një impakt shumë të madh në moszhvillimin e këtij regjioni, pra të Anamoravës dhe pjesës lindore të Kosovës.

Prandaj, unë mendoj që një punë më e madhe, një përkushtim më i madh i të gjithë neve dhe sidomos, edhe një herë po e them, t'i japim shans implementimit të drejtë dhe menaxhimit të mirë, në mënyrë që viti 2020 Kosovën ta gjejë me 7 e 8% të rritjes ekonomike. Kështu mund ta zvogëlojmë papunësinë, kështu mund të bëjmë punësime më të mëdha. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka Salihe Mustafa.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ligji për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë është miratuar nga Kuvendi më 25 të vitit 2016. Në këtë ligj është paraparë që zbatimi i këtij ligji të fillojë në janar të vitit 2017, mirëpo në projektbuxhetin për vitin 2017, që e kemi para nesh, nuk është paraparë ndarja e mjeteve për zbatim të këtij ligji.

Përmes medieve kemi dëgjuar që ministri ka premtuar, se ky ligj do të zbatohet mirëpo nuk figuron në projektbuxhet, andaj unë kërkoj nga Komisioni për Buxhet dhe Financa tash gjatë

leximit të dytë, në harmoni me ministrin, të gjejnë mënyrën e ndarjes së mjeteve për zbatim të këtij ligji, duke i njohur problemet me të cilat ballafaqohet ky komunitet. Ose, nëse keni formulë tjetër, zoti ministër, zoti ministër, se si do të fillojë zbatimi i këtij ligji, të na njoftoni sot në Kuvend.

Gjithsesi, ky ligj duhet të fillojë të zbatohet, duhet të gjendet mënyra e ndarjes së mjeteve për këtë ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! E ka fjalën Ali Berisha.

ALI BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje për të gjithë deputetët!

Që në fillim dua të theksoj, se është e pajustificueshme vonesa e sjelljes së Buxhetit në Kuvend, pasi që Ligji për financa publike determinon kohën deri kur Buxheti duhet të sillet në Kuvendin e Kosovës.

Ky projektbuxhet as për së afërmi nuk i merr për bazë premisat kryesore, në të cilat bazohet buxheti i një vendi e që janë prioritetet strategjike. Nuk ka analizë të mirëfilltë të ndryshimit të trendëve të shpenzimeve dhe nuk merr për bazë procesin e harxhimeve nga viti paraprak.

Nëse analizojmë këtë buxhet, që në shikim të parë shihet një diskrepancë në mes të të hyrave dhe shpenzimeve. Të hyrat e planifikuara 1 725 000 000 euro, ndërsa të dalat 2 001 000 000. Kjo diferencë për mbulim të shpenzimeve parashihet të mbulohet nga borxhi publik dhe huazimet, që kap shumën prej 276 milionë euro dhe mbulim të deficitit primar, kurse huamarrja kap shumën 362 milionë, që parasheh deficit si përqindje e bruto produktit vendor prej 5,63%.

Kjo është në kundërshtim me rregullin fiskal, që deficitin parashihet të jetë maksimalisht 2%, bazuar në bruto produktin vendor. Bazuar në këtë Kosova edhe pse nuk ka shumë borxhe, pasi që është shtet i ri, trendët e rritjes së borxheve në Kosovë janë jashtëzakonisht të mëdha. Shpenzimet, gjithashtu është planifikuar të bëhen duke u bazuar në marrjen e 88 milionëve nga AKP-ja, kur dihet që për këtë nuk e parasheh Ligji për AKP-në. Prandaj, nuk mund të quhet buxhet i rregullt dhe buxhet real.

Shpërndarja, shpenzimet kapitale të financuara sipas klauzolës së investimeve, që janë 105 milionë, janë më tepër projekte të supozuara sesa reale. Gjithashtu, në kuadër të këtij 105 milionëshi të investimeve sipas klauzolës së investimeve, shuma prej 77 milionë i dedikohen Ministrisë së Financave, pa një qartësi se ku do të financohen ato.

Te investimet kapitale, sidomos ato madhore, siç janë auto-rrugët, buxhetet janë të pamjaftueshme për përfundimin e shpejtë të tyre dhe qytetarët e shumë regjioneve edhe për

shumë vite do të presin që të kenë një qarkullim më të mirë në rrugët e tyre, sidomos në zonën e Dukagjinit.

Një numër i madh i projekteve kapitale, qoftë edhe ato milionëshe, vitin e ardhshëm fillohen me nga 50 mijë euro dhe është jashtë çdo logjike, por që bëhen kryesisht, gjoja se po e fillojmë një projekt nëpër komuna të ndryshme e dihet se është viti zgjedhor e ato projekte nuk dihet se kur do të përfundojnë.

Nëse shikojmë buxhetin për arsim, ky buxhet nuk ka investime të caktuara, sidomos në atë që është prioritet strategjik i arsimit në ngritjen e cilësisë në arsim. Me këtë buxhet të planifikuar nuk do të ketë rritje të cilësisë në arsim. Shembull konkret, Universiteti Haxhi Zeka në Pejë, që ka 6 fakultete, mësimi mbahet në dy gjuhë, ka 12 mijë studentë, ndërsa ka një buxhet jashtëzakonisht të limituar për mbarrëvajtjen e procesit të mësimit në atë universitet. Dhe, nëse lihet në këtë buxhet, atëherë vihet në pyetje mbarrëvajtja e mësimit njëvjeçar në universitetin Haxhi Zeka.

Nëse analizojmë projekt-buxhetin për shëndetësi, shëndetësia edhe pse e proklamuar si prioritet, kjo nuk argumentohet me ndarje buxhetore. Problemet në shëndetësi janë jashtëzakonisht të mëdha, ndërsa buxheti i planifikuar është vetëm 6,7%, që është buxhet më i ulët në regjion, bazuar në buxhetin e përgjithshëm të shteteve të ndryshme.

Investimet në preventivë në shëndetin publik dhe shërbimet primare shëndetësore, si bazë e mirë e parandalimit të sëmundjeve investohet shumë pak. Shërbimi primar shëndetësor është në gjendje jashtëzakonisht të keqe, pasi që është lënë në mëshirën e komunave e sidomos në ato që janë komuna të varfra, ky sistem është pranë kolabimit.

Sistemi i informimit në shëndetësi investimet i ka minimale dhe problemet me këtë qasje dhe me këtë buxhet do të shpërfaqen në momentin e fillimit të zbatimit të sigurimeve shëndetësore.

Për një sektor të rëndësishëm të shëndetësisë, që është Inspektorati Shëndetësor, që monitoron dhe kontrollon me mijëra institucione shëndetësore ndahen vetëm 291 mijë euro dhe kjo as për së afërmi nuk i plotëson nevojat për funksionimin e këtij institucioni, që është jashtëzakonisht i rëndësishëm për të gjitha institucionet e Kosovës.

Buxheti që ndahet për pacientë që shërohen jashtë vendit është jashtëzakonisht i vogël dhe qysh tash kemi një deficit prej 3 milionë për vitin 2017.

Investimet kapitale në spitale janë asimetrike, nuk janë të barabarta me punën që bëjnë spitalet në nivel Kosove. Shembull konkret, Spitali i Gjakovës “Isa Grezda”, i cili është spitali më i skajshëm që ofron shërbime shëndetësore dytësore dhe nuk ka investime të mirëfillta kapitale për

përmirësimin e punës në këtë spital. Aty pacientët emergjentë trajtohen në korridore. Pacientët e hemodializës trajtohen në kushte jashtëzakonisht të vështira, ndërsa 586 punëtorë shëndetësorë nuk kanë një vend se ku t'i mbajnë konsiliumet shëndetësore për konsultime mjekësore për pacientë.

Gjithashtu, ndarjet për paga dhe mëditje nuk e pasqyrojnë nevojën e institucioneve, kur dihet se në spitalin e Vushtrrisë dhe të Mitrovicës ka pasur investime, ndërsa ka mungesë të madhe të stafit e këto i bëjnë jofunksionale këto spitale ku është investuar shumë.

Gjithashtu, buxheti për shëndetësi nuk i adreson dhe nuk bënë përpjekje për përmirësim të shërbimeve shëndetësore, probleme që adresohen edhe në raportin e progresit.

Dhe në fund, nëse i shikojmë ndarjet buxhetore për investime kapitale nëpër komuna shihet një ndarje joproporcionale. Disa komuna edhe pse kanë numër të përafërt të banorëve ndarjet e buxhetit për komuna të caktuara nuk është i njëjtë. Shembull konkret, Peja dhe Ferizaj. Bazuar në këtë mund të konkludojmë, se ky buxhet nuk është real. Nuk realizon pritjet e qytetarëve për zhvillim ekonomik, nuk rritë mundësinë për punësim dhe me të drejtë, siç po e quajnë edhe shumë ekspertë të buxhetit, është buxhet më tepër elektoral. Faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë, fjalën e ka Besim Beqaj.

BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Ne sot e kemi në lexim të parë dhe në analizë Buxhetin e Republikës, i cili është, të themi, projeksioni i qartë për një vit lidhur me shfrytëzimin e parasë publike, i cili në kushte normale kërkon elementin e parë dhe ai është ruajtja e stabilitetit makro-fiskal të vendit dhe mendoj se buxheti, të cilin e kemi para vetes, e ka vazhduar traditën që shteti të ruajë stabilitetin makro-fiskal, duke marrë parasysh se kemi një raport të pranueshëm në mes të investimeve publike, kapitale dhe investimeve apo shpenzimeve operative.

Ajo që është shumë e rëndësishme, ne kemi një rregull fiskal dhe një klauzolë të investimeve, dy gjëra të cilat na e përcaktojnë se deri në ç'nivel mund të shkojmë me deficit primar të buxhetit dhe që këto të dyja vazhdojnë të respektohen dhe e kemi një buxhet, i cili është në harmoni edhe me programin e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe që vazhdon tradita e bashkëpunimit me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Për hir të korrektesisë dua të them se raporti paraparak me Fondin Monetar Ndërkombëtar nuk ka qenë i shkëputur, por është raport-program i mbyllur dhe Qeveria aktuale ka rinegociuar një

program të ri, me të cilin unë besoj se me buxhetin që e kemi para vetes do të jemi brenda parametrave dhe do të tregojmë një përgjegjësi të mjaftueshme institucionale në raport me ruajtjen e programit.

Ajo që është gjithashtu e rëndësishme vazhdon të mbahen në nivel të pranueshëm edhe shpenzimet operative dhe kemi një rritje të buxhetit, e cila është relativisht e kujdesshme. Kur them rritje e kujdesshme e buxhetit, duhet të them se i kemi edhe të hyrat të cilat janë stabile, të njëhershme, po edhe të hyra të cilat bëhen mbi bazën e huazimeve, por huazimet e mëdha brenda kornizave ligjore.

Dua ta përkujtoj Kuvendin dhe qytetarët se mbi bazën e Ligjit për investimet mbi menaxhimin e financave publike shteti ynë ka mundësi të shkojë deri në 40% të borxhit të jashtëm nga GDP-ja dhe, që ne, edhe më tutje edhe me këtë buxhet do të jemi diku rreth 15%.

Ritmi ndoshta është pak i shpejtuar, por sigurisht se nevojat e vendit janë shumë të mëdha dhe besoj që në këtë drejtim ky veprim justifikohet.

Është parë se rritja e buxhetit shkon relativisht krah për krah me rritjen ekonomike, edhe pse parashihet një rritje pak më e madhe rritja e buxhetit se sa rritja ekonomike, kjo për shkak të aktivitetit, i cili është duke u marrë në drejtim të mbledhjes apo shtrirjes sa më horizontale të buxhetit.

Ajo që është e rëndësishme, është se buxheti përmban projekte të rëndësishme kapitale, që shkojnë për mirëqenien e qytetarëve në Republikën e Kosovës dhe normalisht se qytetari i Kosovës, komunat e Kosovës dhe i tërë vendi ynë kanë shumë më shumë nevojë për investime, por buxheti duhet kuptuar se është çështje e mundësive financiare dhe e politikave fiskale, të cilat duhen të jenë tejte të kujdesshme në momentin kur mblidhet buxheti.

Pra, nuk është çështje e dëshirave momentale, por është çështje e mundësive të cilat i ka shteti ynë me nivelin e zhvillimit ekonomik dhe mundësinë për të tërhequr taksa nga qytetarët e vendit.

Besoj se prej Prizrenit, që është një rast ku kemi investime të fuqishme kapitale, qoftë në nivelin e turizmit, qoftë në nivelin e infrastrukturës, apo edhe në trajtimin e komuniteteve të ndryshme, siç është rruga Prizren-Reçan, e cila edhe më herët është ngritur nga zonja Emilija Rexhepi dhe që është një projekt i rëndësishëm së veçantë dhe Partia Demokratike i ka dhënë mbështetje të fortë gjatë gjithë kësaj kohe dhe besoj se nuk shkon vetëm për një komunitet të Prizrenit, si komunitet i shqiptarëve, por është një trajtim i të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe është një bashkëpunim dhe fuqi e madhe për komunitetin boshnjak në ato anë.

Dua të vë theksin edhe te specialistët dhe specialistët, për të cilët është reflektuar në buxhet. Duhet pasur parasysh se e kemi një numër të madh dhe është një buxhet diku rreth 3 000 000

euro, i cili është ndarë për këtë kategori dhe kjo tregon se Qeveria ngadalë po shkon drejt riprioritetizimit të vet, në atë që duhet të shkohet ndoshta në të ardhmen edhe më shumë në prioritetet që duhen për shëndetësinë.

Spektori i drejtësisë është foruar, siç e keni parë, kemi edhe rritjen e numrit të punonjëseve. Po ashtu, edhe sektori i bujqësisë është rritur me investime, të cilat janë bërë në prioritetet kapitale që janë drejtpërdrejt përkrahje e të gjitha atyre investimeve që janë bërë me vite në tëra në subvencione dhe të cilat kanë filluar të japin rezultatet e veta dhe pasqyra ekonomike e vendit tonë po ndryshon në kuptimin e kapaciteteve të saj prodhuese e eksportuese dhe që normalisht në investime kapitale ka nevojë që këto projekte të shkojnë edhe në infrastrukturë, e cila është e nevojshme për të qenë sektori më produktiv.

Pra, mbi këtë bazë, edhe mbi bazën e mundësive të cilat i kemi, ne në këtë vit kemi krijuar një hapësirë për vitin 2017 për të hapur projekte afatgjata. Këtu u diskutua edhe rreth atyre se a duhet të jenë projektet njëvjeçare apo Qeveria duhet të hyjë në marrëdhënie kontraktuale trevjeçare? Normalisht se projektet kapitale të rëndësisë vitale të shtetit nuk janë projekte që mund të realizohen as për 6 muaj, e as për 1 vit, por kërkohet hapësirë më e madhe kohore dhe kjo është plotësisht e justifikueshme.

Të them edhe një herë se nevojat janë shumë më të mëdha. Prioritetizimi ndoshta për vitin e ardhshëm, që nga rishikimi i buxhetit e deri te buxheti për vitin 2018 ndoshta duhet të shkojë shumë më fuqishëm drejt shëndetësisë, drejt edukimit dhe projekteve të tjera të cilat kanë të themi impakt edhe të karakterit makro-ekonomik dhe makro-ndikues në kuptimin e jetës së qytetarëve.

Pra, po them se është edhe një instrument jashtëzakonisht i rëndësishëm. Ligji i buxhetit në nenin 24 ka të përfshirë edhe veteranët, të cilëve, parimisht u garantohej pagesa dhe janë bërë kategori mbi bazën e ligjit, i cili është i harmonizuar më herët dhe kjo kategori do të vazhdojë të paguhet pa asnjë lloj problemi edhe në vitin 2017.

Pra, mbi këtë bazë dëshiroj t'i ftoj të gjithë deputetët ta votojnë, sepse është një projektligj i cili mundëson zhvillimin e mëtutjeshëm, mundëson vazhdimin e politikave të mira qeveritare, të cilat janë bërë, por gjithsesi duhet thënë se në të ardhmen e afërt, po flas për vitin 2018 e tutje, duhet ta rishikojmë pozicionin e prioritetëve të cilat shteti ynë duhet t'i ketë, sepse besoj shumë fuqishëm që shëndetësia, edhe një herë ta theksoj, dhe edukimi janë dy sektorë, të cilët duhet të kenë më shumë fokus në vitet e ardhshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Rexhep Selimi e ka fjalën, përgatitet Armend Zemaj.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, Profesor!

Do të duhej ndoshta për të mirën e një të ardhmeje më stabile edhe ekonomike të Kosovës që ky buxhet të refuzohej edhe nga vetë deputetët e mazhorancës, duke u nisur edhe nga fjalimet dhe vërejtjet që i kanë deputetët e mazhorancës për këtë projektbuxhet.

Sado qoftë, unë nuk dua ta bëj tash ekspertin e ekonomisë, sepse nuk jam i tillë, e as i financave, por duke u përqendruar në fushën e sigurisë, nga ato financa dhe atë buxhet që e ka paraparë Qeveria e Kosovës vijmë në përfundim, pa mëdyshje, se ky buxhet ose Projektligj për buxhetin e vitin 2017 nuk garanton zhvillim në fushën e sigurisë, as për Policinë dhe as për Forcën e Sigurisë së Kosovës, respektivisht për ushtrinë e Kosovës.

Nuk dua të zgjas shumë, por dua të ndaj me ju vetëm një fakt për Policinë dhe një tjetër për ushtrinë.

Kur e shohim sa ka paraparë buxhet Qeveria e Kosovës për Policinë, neve na bie të përsërisim vetveten, atë që e kemi thënë vjet për buxhetin e vitit 2016, çka kemi thënë parvjet për buxhetin e vitit 2015, e kështu me radhë.

Pra, na është dashur ta përsërisim vetveten se Qeveria po gabon në këto fusha, për shkak se gabimin e njëjtë e ka bërë edhe vetë Qeveria. Pra, nuk kemi mundur tash, thjesht, nëse Qeveria ka gabuar, ne të mos e përsërisim atë çfarë do të duhej ta bënim ndryshe.

Mirëpo, duke u nisur nga kërkesat që i ka Policia e Kosovës për zhvillimin e saj, për infrastrukturën, dallimi në mes të kërkesave të Policisë dhe asaj çfarë ka paraparë Qeveria e Kosovës për Policinë e Kosovës, respektivisht për Ministrinë e Punëve të Brendshme, është 43 000 000. Pra, shpërputhje mes kërkesës së Policisë dhe asaj çfarë ka paraparë Qeveria e Kosovës është 43 000 000. Nuk është thjesht një shpërputhje më e vogël se kaq.

Kurse sa i përket Forcës së Sigurisë së Kosovës, duke parë se çfarë ka paraparë Qeveria e Kosovës për zhvillimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, ne tashmë e dimë një gjë të sigurt. Ajo çfarë garanton Qeveria e Kosovës është që ne nuk do të kemi ushtri as në vitin 2017, sepse edhe po të kishte vullnet, i cili mungon te mazhoranca, nuk ka buxhet, dhe pa buxhet nuk mund të bëhet, nuk mund të zhvillohet as Forca e Sigurisë së Kosovës, e jo më të themelohen edhe Forcat e Armatosura të Kosovës. Sepse, Qeveria e Kosovës prapë është kujdesur që për zhvillimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës të parashohë një buxhet shtesë në barasvlerë me gjysmë kilometri asfalt të autostradës së Kosovës. Fiks kaq! 5 000 000 euro janë barasvlerë me gjysmë kilometri autostradë që e shtron “Bechtel Enka” në Kosovë.

Dhe, duke e ditur se kaq e vlerëson zhvillimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës Qeveria e Kosovës, atëherë ne e dimë edhe qëllimin se a ka vërtet Qeveria e Kosovës qëllim të zhvillojë këtë forcë apo nuk ka?

Si përfundim, unë mendoj se të gjitha proklamimet e deritanishme, vit pas viti, që Qeveria e Kosovës po përpiqet ta bëjë ushtrinë e Kosovës janë thjesht deklarata të pabaza dhe të kota.

Prandaj, ky buxhet veç një gjë e garanton, që ne për vitin 2017 as nuk do të kemi rritje të kapaciteteve të sigurisë për Policinë e Kosovës dhe as nuk do të kemi ushtri të Kosovës apo rrjedhimisht Forcë të Armatosur të Kosovës. Kështu që, do të ishte mirë, dhe edhe një herë bëj thirrje që këtë Projektligj për Buxhetin e vitit 2017, ashtu siç do të bëjë opozita në përgjithësi, ashtu siç do të bëjë Lëvizja “Vetëvendosje”, ta refuzoni edhe ju në të mirë të një të ardhme më stabile ekonomike të vitit që po hyjmë. Pra, të gjitha ato letra që i keni harxhuar për të përgatitur këtë projektbuxhet, është mirë t’i çoni në riciklim.

KRYETARI: Salih Morina, le të bëhet gati Shukrije Bytyqi.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër Mustafa,

Të nderuar ministra,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne sot po e diskutojmë projektbuxhetin e Republikës së Kosovës të paraparë për vitin 2017, që është në një vlerë prej 2 001 000 000 Ky projektbuxhet bazohet plotësisht në dokumentet strategjike që i ka aprovuar Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës, përfshirë edhe Strategjinë kombëtare për zhvillim, Programin qeverisës dhe Programin për reformë ekonomike, Kornizën afatmesme të shpenzimeve dhe strategjinë sektoriale.

Pra ky buxhet zhvillimor, që është në harmoni me programin e përbashkët qeverisës dhe rezultatin e një pune të rëndësishme të ministrave dhe kryeministrit Mustafa, vjen si rezultat i konsultimeve mjaft të gjata dhe substanciale me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe është i hartuar në mbështetje të plotë nga Fondi Monetar dhe Komisioni Evropian.

Me këtë buxhet parashihet rritje prej 3% për paga, 8% shpenzime operative, 1,7% subvencione e transfere dhe 45% investime kapitale, gjë që nuk ka ndodhur me buxhetet e tjera. Pra, kemi një rritje të dukshme të investimeve kapitale që në përqindje shkon 45%.

Buxheti i Kosovës për vitin 2017 prej 2 001 000 000 është buxhet i shtetit të Republikës së Kosovës. Nuk është buxhet i asnjë partie politike dhe me këtë buxhet edhe një herë po dëshmohet se Qeveria, e udhëhequr nga kryeministri Mustafa, punon për interesa të qytetarëve të Kosovës.

Për këtë buxhet paraprakisht janë konsultuar të gjitha organizatat buxhetore, përfshirë edhe komunat dhe ndarja e mjeteve është bërë në mënyrë të balancuar.

Ne të gjithë, si deputetë, vijmë nga një komunë apo nga një regjion dhe njëkohësisht ka kërkesa të ndryshme me të cilat ballafaqohemi ne drejtpërsëdrejti me terrenin, mirëpo të gjitha kërkesat të cilat i kanë paraqitur komunitat janë harmonizuar me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, e njëkohësisht janë harmonizuar me programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Me këtë projektbuxhet synohet të arrihen dy objektiva kryesore: të krijohet hapësirë më e madhe për investime kapitale, gjë që shuma më e madhe e buxhetit është e ndarë dhe është e paraparë për investime kapitale dhe, në formën tjetër, t'i mbajë nën kontroll shpenzimet rrjedhëse.

Pra, ky buxhet do të ndikojë në një rritje ekonomike më të lartë se sa që ka qenë deri më tani.

Unë i ftoj të gjithë kolegët deputetë që ta votojnë këtë buxhet në leximin e parë dhe pastaj të amendamentohet për leximin e dytë dhe njëkohësisht t'i jepet edhe votimi në total të këtij buxheti. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Shukrije Bytyqi e ka fjalën dhe le të bëhet gati zonja Emilija Rexhepi!

SHUKRIJE BYTYQI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Planifikimi i projektbuxhetit të konsoliduar të Kosovës në periudhën afatmesme trevjeçare 2017-2019 është buxhet i varfër dhe nuk premtun dhe as garanton zhvillim ekonomik, nuk reflekton objektivat e paraqitura në Programin kombëtar për reforma në ekonomi, pasi që shumë objektiva të paraqitura në këtë program nuk gjejnë mbështetje në këtë projektligj për vitin fiskal 2017.

Po ashtu, buxheti i vitit 2017 lë pa adresuar dhe pa financuar shumë sfida të rëndësishme, të rekomanduara dhe evidentuara nga Raporti i Progresit për vitin 2016, si reforma në drejtësi, reforma në administratën publike, luftimi i krimit, korrupsionit, e të tjera.

Duke u bazuar në figurat financiare të prezantuara në buxhetin e vitit 2017, konkretisht në programet dhe nënprogramet e planifikimeve të investimeve publike të planifikuara, të menaxhuara e të shpërndara si projekte kapitale nga Qeveria qendrore janë të shpërndara dhe të bazuara në prioritet të objektivit strategjik me ndikim pozitiv në zhvillim ekonomik, por këto investime orientohen dhe shpërndahen konkretisht në këto komuna që udhëhiqen nga partitë politike në pushtet.

Në këtë projektbuxhet mungon përkrahja nga Qeveria aktuale për investime publike dhe projekteve inovative që kanë për bazë zhvillimin ekonomik.

Ky projektbuxhet nuk është bazuar në prioritetet dhe objektivat që pretendojnë një mirëqenie më të mirë për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Në planifikimin e shpenzimeve buxhetore për vitin 2017 shkon 78% e buxhetit, që është ndarë për institucionet qendrore, ministri, agjencie e të tjera, ndërsa vetëm 22% janë ndarë për institucionet lokale.

Kjo nënkupton se politikat buxhetore të kësaj Qeverie janë që buxhetin ta centralizojë nën menaxhimin e saj dhe konkretisht buxhetin e investimeve kapitale, ku shihen edhe nga tabelat e poshtëshënuara në buxhet, që do të thotë se 78% shkon për institucionet qendrore, ndërsa vetëm 22% në ato lokale.

Në disa komuna ka ngritje të investimeve kapitale, kurse në disa prej tyre ka rënie. Ne nuk jemi kundër investimeve në komunat që është ngritur buxheti, por jemi kundër rënies së buxhetit në disa komuna, duke përfshirë Prishtinën, Prizrenin, Malishevën, Dragashin, e të tjera.

Nga të gjitha këto gjetje negative në Projektbuxhetin 2017-2019, mendojmë se ky projektligj është mirë të kthehet në rishqyrtim dhe të kihet për bazë këto vërejtje:

- Rishikim i planifikimeve të shpenzimeve dhe strukturim i tyre, të bazuar në nevoja e prioritetet, jo kopje e vitit aktual;
- Shpërndarja buxhetore të jetë shpërndarje proporcionale;
- Shpërndarja e granteve qeveritare dhe të respektohet çelësi i shpërndarjes sipas numrit të banorëve;
- Rishikimi i shpenzimeve të kategoritë e ekonomisë së pagave, mëditjeve dhe mallrave e shërbimeve, e tjera;
- Monitorimi i shpenzimeve të kategoria ekonomike “subvencione dhe transfere”;
- Rishikimi i planifikimit të investimeve publike të ministritë e linjave, të përkrahen dhe të financohen projekte të komunave nga këto investime, si dhe
- Rishikimi dhe rritja e investimeve kapitale, të ulja e buxhetit të pagat, mëditjet, mallrat dhe shërbimet;
- Të respektohen dhe të zbatohen rekomandimet e Raportit të Progresit, siç janë: reformat në administratën publike, reformat në drejtësi, luftimi i krimit e korrupsionit, luftimi i ekonomisë informate dhe evazioni fiskal, përmirësimi i shërbimeve shëndetësore, rritja e cilësisë në arsim, e të tjerë.
- Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Emilija Rexhepi dhe le të bëhet gati Bali Muharremaj.

EMILIJA REĐEPI: Zahvaljujem se predsedniče!

Uvaženi premijeru, predstavnici Vlade,

Kolege poslanici,

Poštovani građani,

Nacrt zakona budžeta za 2017. Godinu je u potpunosti neprihvatljiv za predstavnike manjinskih zajednica gde im se skoro u svim opštinama gde oni žive, počev od Prizrena, opština Peć, Istok, Leposavića, Mitrovice u samom startu ograničava ono što su u prethodnim godinama imali. Osvrt dajem na infrastrukturne projekte i kapitalne investicije.

S obzirom da je naš premijer ovde danas prisutan, ja bih se osvrnuo, poštovani premijeru, na član 12. Budžeta koji govori o korišćenju sredstava za zajednice, gde tačka 1. govori da dodeljeni budžet Kancelarije za pitanja zajednica u okviru Kancelarije premijera, iz kategorije - subvencije i transfera, kao i dodeljeni budžet za Ministarstvo za zajednice i povratak za kapitalne projekte, koriste se u skladu sa programom za zajednice usvojen na sednici Vlade.

Mi imamo veliki problem unazad nekoliko godina i vi to dobro znate, iznosili smo u nekoliko puta i ovu problematiku ovde u Parlamentu i što se tiče kapitalnih projekata, Ministarstvo za zajednice i Ured kancelarije vaše, ima milionsku cifru tih projekata koji su postali samo vlasništvo srpske zajednice.

Ja vas molim da izvršite jednu analizu i korigujete to i da predstavnici Bošnjaka, predstavnici Turaka, predstavnici Aškalija, Roma, Egipćana i sve druge zajednice koje žive na Kosovu imaju dostupna ta sredstva koja su od prioritete važnosti za sve nas.

Takođe želim uputiti kritiku Ministarstvu za javnu administraciju gde se i dalje ne poštuje Zakon o zaposlenosti manjinskih zajednica u javnim institucijama.

I pored toga što je Komisija za zajednice napravila radnu grupu koja će kontrolisati zaposlenost manjinskih zajednica i sa pismenom formom obaveštavati Parlament, ja vas molim još jednom da imate to u obzir i da bude posebna stavka budžeta za tu komisiju koja će raditi na terenu.

Ministarstvo za poljoprivredu i dalje ograničava predstavnike manjinskih zajednica da konkurišu za projekte kapitalnih investicija, za razvoj poljoprivrednih grana, za podstrek svih naših poljoprivrednika u svim sredinama gde žive Bošnjaci, pre svega akcenat je na Prizrenski kraj – Župski kraj, ali takođe i predsednik Parlamenta je sam obećao predstavnicima Leposavića odnosno Bošnjacima koji žive u selu Rvatska da će ove godine imati iverća ulaganja što se tiče poljoprivrednih projekata.

Ja želim da se još jednom javno zahvalim ministru za ambijent zato što smo zaustavili netransparentnu i nelegalnu izgradnju hidrocentrala u Župskom kraju, koja je bila u samom startu

dominantna, ali takođe želim da apelujem na to Ministarstvo da utiče odnosno ima razvojni bolji plan za Prevalac, da ima razvojni bolji plan za pijaču vodu u tom kraju, u Župskim selima, i za konstituisanje svih kanalizacionih mreža po svim našim selima da bi ušli u sistem vodovoda.

Zahvaljujem se mom kolegi Besim Bećaj, koji je dao podršku ispred PDK-a Grupe za izgradnju puta Prizren – Rečane i skoro je ministar finansija Avdulah Hoti i ministar Lutfi Žarku sa ministrom Rasim Demirijem... Ne znam da li je to bila predizborna lokalna kampanija, jer je posvećen jedan politički subjekat, a znate lepo koliko je postotak Bošnjaka Gore ima i za koga oni glasaju, ali u svakom slučaju hvala ministre na toj vašoj inicijativi. Samo trebate da nam objasnite svima nama i našim građanima - da li će taj projekat biti saniranje tog puta, rekonstrukcija tog puta i izgradnja nekih potpornih zidova ili će biti izgradnjaj tunela. Ja znam da sam prošle godine razgovarala sa ministrom za infrastrukturu i on je rekao da su to milionske cifre kada je u pitanju infrastruktura i da moramo uključiti međunarodni faktor kako bi došli do te sume novca.

U svakom slučaju, ta inicijativa je podržana i jako je bitno da taj put prođe zbog sigurnosti i bezbednosti svih građana koji koriste taj put.

Što se tiče ostalih ministarstva, velike kritike idu na račun Ministarstva za ekonomski razvoj i Ministarstvo za trgovinu i industriju, ali i lokalnih opština koje nemaju dobar ekonomski razvojni plan za manjinske zajednice.

Nemaju dobar pristup za investitore koji žele ulagati u tim krajevima, niti mi imamo neka ovlašćenja da donosimo te investitore kako bi smo otvorili nova radna mesta odnosno fabrike koje bi zapošljavale naše ljude a samim tim bi zaustavili i migraciju našeg stanovništva sa ovih krajeva.

Sve sam ovo govorila upravo iz razloga zato što se proces decentralizacije i dalje za Bošnjačku zajednicu nalazi u status-kvo, iako nam je puno puta obećano da će to biti. I kada bi samo imali svoje opštine poput opštine u Žubi, odnosno Rečane, onda bi naš strateški plan bio razvojni ekonomski plan tog kraja u sve zaštitne mehanizme lokalnih institucija.

Mi ćemo i dalje vršiti stalan pritisak na Vladu po pitanju procesa decentralizacije i dobijanja svojih opština.

Želim ovde izneti jedan pozitivan primer i zahvaliti se ministru za kulturu Kujtimu Šalja, imam kolege Antonu Ćuniu koji nam pomogao da dobijemo jedan veliki projekt koji se već realizuje, a to je izgradnja kulturnog bošnjačkog centra u Prizrenu. I želim izraziti veliku zahvalnost ispred svih Bošnjaka opštine Prizrena, jer je to nacionalni projekat i jako je bilo teško doći do izgradnje tog projekta. Zahvaljujem!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Bali Muharremi, e ka fjalën, ndërkohë të bëhet gati zonja Aida Dërguti.

BALI MUHARREMI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë të Parlamentit të Kosovës,

Buxheti i shtetit si një akt ligjor pa dyshim se paraqet bazën më të rëndësishme legale dhe kushtetuese për financimin dhe mbarrëvajtjen e gjithë sistemit shtetëror.

Buxheti i propozuar nga Qeveria e Kosovës për vitin 2017 nuk është 2 miliardë e një milion euro, siç deklarohet nga Qeveria, por është një miliard e 725 milionë euro, aq sa janë të hyrat burimore.

Dallimi mes kufirit të hyrave dhe kufijve të shpenzimeve është 266 milionë euro, pra qartas shihet se është buxhet deficitar dhe zbrazëtia e tij synohet të plotësohet nga burimet e jashtme nëpërmjet huave publike, të brendshme dhe të jashtme, si 100 milionë euro nga emetimi i letrave me vlerë, kryesisht mjetet nga Trusti i Pensioneve 100 milionë euro nga kreditë e jashtme dhe 88 milionë euro nga mjetet e Fondit të mirëbesimit.

Të gjitha këto mjete që merren hua do të kthehen me kamata. Të hyrat buxhetore sipas rregullave konsiderohen vetëm të hyra të pakthyeshme.

Forma të tjera të hyrave, si kreditë, huat, vetëkontributet e të tjera janë mjete plotësuese me obligim kthimi. Përveç kësaj, këto kategori si të hyra buxhetore nuk janë të sigurta dhe nuk kanë bazë ligjore. Për t'i tërhequr këto mjete duhet ndryshuar disa ligje, si ato të Trustit të Pensioneve, Ligjit të Agjencisë së Privatizimit.

Pastaj për huat e jashtme duhet kërkuar ratifikim nga Kuvendi. Për të gjitha këto veprime nuk është ndërmarrë asnjë hap para se të dërgohet në miratim Ligji për buxhetin, pra edhe këto të hyra nuk janë të sigurta.

Lind pyetja: Sa ka pasur nevojë për projekte të hyra nga huat? Sipas raportit të Auditorit Gjeneral për buxhetin e vitit 2015, fondet e destinuar për investime kapitale në vlerë prej 430 milionë euro janë realizuar vetëm 415 milionë, meqenëse për vitin 2016 nuk përfunduan dhe nuk kemi informacione, por dihet se këto kategori ka vonesa edhe në shpenzime.

Po ashtu në vitin 2015 ishin aranzhuar 105 milionë euro kredi të jashtme, janë tërhequr vetëm 45 milionë euro dhe prej tyre janë shpenzuar vetëm 6 milionë euro.

Andaj, hyrja në borxh nga ana e Qeverisë pa përgatitje paraprake tregon një performansë të dobët për shpenzimet publike.

Buxheti për vitin 2017 është deficitar, me bilanc primar negativ, i projektuar prej 276 milionë euro, kur i shtohet edhe 26 milionë euro për pagesa të interesave, del se të jetë negativ për 299 milionë euro.

Shikuar për kah struktura e vet nuk është buxhet zhvillimor, investimet kapitale nga burimet e rregullta përbëjnë vetëm 30%, kurse paga dhe mëditje janë 33% dhe transfero sociale janë 27.5%.

Kur jemi te investimet kapitale, vetëm infrastruktura rrugore absorbon 257 milionë, plus 29 milionë shpronësimet, del se vëmendje i është kushtuar vetëm infrastrukturës rrugore. Ne jemi të vetëdijshëm për rëndësinë e ndërtimit të rrugëve, por mendojmë se fondet publike duhet të ndahen në mënyrë proporcionale për nevojat e zhvillimit.

Këtu do të theksoj nevojat për përmirësimin e shëndetësisë, të arsimit, ambientin, zhvillimin ekonomik dhe për vende të reja të punës.

Tenderomania e Qeverisë së Kosovës ka kaluar tani në gjykatat e arbitrazhit. Nëse deri tani korrupsioni dhe krimi i organizuar ka ndodhur nëpërmjet tenderëve milionësh përbrenda institucioneve dhe shtetit të Kosovës, tani vetëm arbitrazhi për tastin e Telekomit të Kosovës duhet t'i japë 30 milionë euro një kompanie të telefonisë mobile. Po ashtu tani kur vjen kjo e AKSOS-it kundër Qeverisë së Kosovës mbi 400 milionë euro.

Kjo tregon se korrupsioni dhe krimi i Qeverisë është sofistikuar, por ka ndodhur edhe po zhvillohet nëpërmjet Gjykatës së Arbitrazhit, edhe kjo hua përpara prej 300 milionë eurosh është për t'u mbuluar këto krime e këtë korrupsion që është në rritje çdo ditë.

Po ashtu mbetet për t'u analizuar struktura e projekteve kapitale për investimet nëpër komuna. Kur jemi te parashikimi i buxhetit për komunat vërehet një diskriminim dhe pabarazi e dallimit të madh.

Unë vij nga rajoni i Prizrenit, i cili përmban përafërsisht 500 mijë banorë. Ky buxhet ka paraparë investime kapitale vetëm 6 milionë euro, që pjesëtuar për kokë banori bën rreth 13 euro.

Ndërsa sipas të dhënave të sakta Qeveria e Kosovës nga ky rajon merr në vit vetëm prej AQF-së së regjionit të Prizrenit diku 17 milionë euro brenda një viti.

Në këtë rajon bën pjesë Suhareka, ku janë paraparë investime vetëm 980 mijë euro, Rahoveci diku një milion e 659 mijë euro, Dragashi 300 mijë dhe deri tash ka qenë edhe Malisheva po ashtu 300 mijë euro, tash ka kaluar kuptohet në rajonin e Gjakovës.

Të nderuar deputetë,

Do të ndalem pak më konkretisht në komunën e Therandës, aty ku kam bazën. Theranda ka 90 mijë banorë, të paraparë për investime kapitale janë vetëm 980 mijë euro, që për kokë banori i bije vetëm afro 11 euro.

Ndërsa Qeveria nga kjo komunë e vetëm prej biznesit, prej të hyrave të AQF-së prej regjionit të Prizrenit merr diku 6 milionë euro. Domethënë i japim 6 e i marrim vetëm një.

Kësaj do të veçoj me rëndësi investimet në zonat industriale, ku mund të gjenerohen vendet e reja të pune. Lidhja e një arterie rrugore me zonën industriale në Shirokë me autostradën “Ibrahim Rugova” do të lehtësonte edhe zhvillimin e bizneseve në këtë zonë.

Edhe pse është bërë mjaftë në ndërtimin e shkollave, duhet ta pranojmë, në komunën tonë, konkretisht në fshatin Leshan ka mbetur një objekt që as për së afërmi nuk i plotëson kushtet, objekti aktual është ndërtuar në vitin 1948 dhe numëron mbi 350 nxënës. Një ashtu kemi shkollën në fshatin Reçan që s’i plotëson kushtet as për së afërmi.

Nuk di ndoshta këtu e kam një pyetje për ministrin, pasi që shkolla në fshatin Leshan është paraparë me buxhetin e vitit 2015, kanë qenë të ndara 300 mijë euro për vitin 2016 edhe 150 mijë për vitin 2017, mirëpo edhe më tutje nuk janë në planifikimin e buxhetit të vitit 2016, por nuk janë as në planifikimin e vitit 2017.

Kolegë të nderuar,

Komuna jonë njihet si vatër e rëndësishme kulturore me artistë të lëmenjve të ndryshëm, por këtij komuniteti edhe qytetarëve të Therandës u mungon shumë Pallati i Kulturës, sepse ekzistuesi është në gjendje të mjerueshme dhe jofunksional. Andaj, është shumë e nevojshme ndërtimi i objektit të ri, edhe për këtë objekt është hera e tretë në buxhetin e vitit 2015, në buxhetin e vitit 2016 e ashtu edhe në buxhetin e vitit 2017 kemi kërkuar, po asnjëherë nuk kemi arritur të marrim mjete për një objekt të ri.

Edhe pse kanë kaluar 17 vjet nga lufta, prej së cilës komuna jonë doli shumë e dëmtuar si në ekonomi familjare, po veçmas me njerëz, e kësaj radhe po theksoj veçmas familjen Berisha, e cila pësoi shumë, propozoj që t’i ngrihet një memorial përkujtimor kësaj familjeje.

Dhe, në fund, propozoj që të bëhet ndarja dhe planifikimi më real i buxhetit të Republikës së Kosovës, i cili do të ndahet në mënyrë të barabartë për qytetarët e këtij vendi. Përndryshe, ky

buxhet me këto defekte të natyrës materiale në një Kuvend me deputetë të përgjegjshëm nuk do të duhej të votohej, pa marrë parasysh pozitë apo opozitë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja nënkryetare, fjala për ju, të bëhet gati zoti Qerim Bajrami.

AIDA DËRGUTI: Faleminderit!

Zonja dhe zotërinj,

Nga pikëpamja e Qeverisë është e pakuptimit që edhe institucioni i Kuvendit t'i alokojë mjetet të taksapaguesve për kategorinë e "subvencioneve dhe transferove".

Subvencionet zakonisht përdoren për të stimuluar ose mbështetur individ apo subjekte të caktuara në raste specifike kur përballja me shpenzime të rezultuara bëhet e vështirë dhe pa asnjë mbështetje nga jashtë.

Si rregull, mbështetja eventuale aranzhohet nëpërmjet ministrisë përgjegjëse, duke bërë këtë si funksion të ekzekutivit, e asesi të legjislativit.

Edhe në rastet kur punonjësit e Kuvendit përballen me shpenzime e norme financiare, qoftë për arsye shëndetësore apo edukim të mëtutjeshëm, adresa e duhur është ministria që mbulon atë fushë.

Rrjedhimisht caktimi i këtij pozicioni në shpenzimet e Kuvendit mund të ketë vetëm dy qëllime, qoftë keqpërdorimin e brendshëm duke alokuar mjete për individ të caktuar jashtë normave dhe procedurave, qoftë për keqpërdorim politik duke subvencionuar grupe të caktuara të shoqërisë me synim përfitimet politike.

Po ashtu duhet të ceket se deri më tani Kuvendi ka bërë tri shkelje me përdorimin e këtij pozicioni buxhetor që edhe më shumë e përforcojnë nevojën e fshirjes complete të kësaj kategorie.

Mjetet janë alokuar me preferencë politike për zyrtarë të Kuvendit, deputetë jashtë procedurave të parapara, duke ndërhyrë në autorizimet e Ministrisë së Shëndetësisë.

Së dyti, këto mjete janë alokuar për mbështetje të individëve që më së paku kanë nevojë, qoftë për shkak se kanë nivel të ardhurave të mjaftueshme apo më të larta në vend, si dhe kanë të deklaruar shumë të mjaftueshme të kursimeve që nënkupton mundësi të përballimit individual me koston e trajtimit mjekësor jashtë shtetit.

Dhe, shkelja e tretë ka qenë vendimmarrja e centralizuar te kryetari i Kuvendit, edhe pse në buxhet definohet qartë që mjetet për subvencione dhe grande janë pozicion i anëtarëve të Kuvendit, e assesit të kryetarit të Kuvendit.

Përgjatë viteve shihet një trend i rritjes së vazhdueshme të mjeteve të ndara në vijën buxhetore “subvencione dhe transfere”.

Buxheti për vitin 2014 i ka pasur 30 mijë euro, për vitin 2015 po ashtu 30 mijë euro, për vitin 2016 kanë qenë 120 mijë euro, ndërsa për vitin 2017 parashihen 140 mijë euro.

Po e përsëris se ekzistenca e kësaj vije buxhetore brenda buxhetit të Kuvendit është një ndërhyrje në rolin ekzekutiv që është i përcaktuar për Qeverinë, e jo për Kuvendin e Kosovës.

Po që se e bëjmë një krahasim me vendet e rajonit, si Shqipëria, Maqedonia, Kroacia, Sllovenia, Mali i Zi e Serbia, apo madje nëse e krahasojmë edhe me Gjermaninë, si shtet anëtar i BE-së, asnjëri nga parlamentet e këtyre vendeve nuk e kanë paraparë vijën buxhetore të “subvencioneve dhe transferëve”.

Andaj, propozoj që Kuvendi ta anulojë këtë pikë buxhetore dhe mjetet e njëjta t’ua kalojë ministrive që mbulojnë si rregull “subvencionet dhe transferet”, e në këtë rast kjo do të ishte Ministria e Shëndetësisë apo Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Zoti Qerim Bajrami, fjala për ju, ndërkohë jam duke u munduar t’i përfundoj kolegët e opozitës, që të mund të bëjmë marrëveshje me kolegët e pozitës nga tre minuta më shpejt, se shumica janë vetëm kolegë të pozitës.

Të bëhet gati Lëvizja “Vetëvendosje”, Donika Kadaj-Bujupi.

ĆERIM BAJRAMI: Zahvaljujem, predsedavajući!

Poštovani premijeru,

Poštovani ministri,

Poštovani poslanici,

Budžet koji predviđa Zakon o budžetu za 2017. Godinu je jako ambiciozan tim prije što predviđa 2 milijarde evro po prvi put u istoriji Republike Kosova, dakle jedan iskorak od preko 300 miliona evra.

U svakom slučaju mi kao parlamentarna grupa “6+” već smo najavili da ćemo u načelu za prvo čitanje podržati Nacrt budžeta a da ćemo u međuvremenu imati niz naših primedbi odnosno predloga za izmene i dopune.

S obzirom da o tome govorila šefica našeg grupe, ja ću se ovde osvrnuti samo na nekoliko segmenta koji po nama sporni i u ovom nacrtu budžeta.

Za jedan je već govoreno a to je poštovani premijeru i poštovani ministri i zajednice za Povratak iz Ministarstva za zajednice i povratak koji na žalost nije ovde prisutan i šef kancelarije privredu premijera za zajednice takođe nije ovde prisutan ali verujem da prati ovo našu diskusiju, jeste što se u dve predhodne godine krši bukvalno Zakon u budžetu Republike Kosova od te dve institucije koje nisu sprovele odredbe Zakona o budžetu. A to je da se sredstva namenjena u ove dve visoke institucije, dakle podjele ravnomjerno prema prezentima ne većinskih zajednica na Kosovu. Na žalost to nije učinjeno ni u ovoj godini. Vlada Kosova nije donela odluku o načinu raspodjele sredstava iz Ministarstva zajednice i povratak i iz Kancelarije za zajednice.

Smatramo i zahtevamo da se s obzirom da je ove godine u članu 12. kao što već spomenuto u stavu 2. predviđa da bez takve odluke Vlade neće biti ni trošenje tih sredstava, što je dobro učinjen jedan iskorak, i biti dakle ovo realizirano u praksi i da će se neće dozvoliti odjela odnosno potrošnja tih sredstava prema nagodaženju ministarstava, odnosno kancelarije.

Ovo je zahtev svih predstavnika iz ostalih ne većinskih zajednica i po ovoga se u načelu svih slažemo.

Takođe, već o tome govoreno ali ovom prilikom da kažem.

S obzirom da ne većinske zajednice imaju svoga odjela i u Ministarstvu obrazovanja, imaju svoga odjela i u Ministarstvu kulture, poljoprivrede i tako dalje, mi ovde nemamo zasevde stavke u budžetu koje predviđaju finansiranje naših specifični stvari. Ali ovoga puta dakle insistiram da se omogući deo budžeta iz tih ministarstva zasebno iz Ministarstva kulture i iz Ministarstva poljoprivrede i za ne većinske zajednice. Da se o kriterijuma u kojima godinama razgovaramo recimo za Ministarstvo poljoprivrede izvidi mogućnost da se oni prilagode i potrebama oni sredina u kome žive ne većinske zajednice jer tamo se razvija jedan vin poljoprivrede i stočarstvo.

Također, kad je u pitanju dakle podjela ispred Ministarstva kulture da ja ovde spomenem da jako dobro što je Ministarstvo kulture preuzela obavezu finansiranja dogradnje Bošnjačkog kulturnog centra u Prizrenu, mi se nadamo da će taj memorandum koji je potpisan od strane ministra i predsednika opštine Prizren biti ispoštovan do kraja, i da će takođe prestati politikanska zloupotreba gradnja tog centra jer je taj kulturni centar svih Bošnjaka, nije nijedne političke opcije niti stranke.

Kat se tiče dakle jednog veoma važnog pitanja koje ovde spomenuo najmanje dvoje poslanika a to je konačno da počne reparacija izgradnja ili dogradnja betonske zaštitne galerije na

regionalnom putu ER315 blizu Prizrena kod onog čuvenog kanjona gde je 40 bunara ili 40 bunara ili 40 bunara i gde je verovatno trenutno na Kosovu najrežičnija tačka gde ostaje dakle tih regionalni putevi sigurno nema trenutno opasnije mjesta i svih vi makar jednom prošli ondje znate o čemo govori.

Mi godinama u nazad imamo obećanja, i od bivšeg premijera, imali smo obećanje i od aktuelnog premijera, imamo obećanja također s obzirom da smo o tome razgovarali i sa predsednikom Skupštine republike Kosova gospodinom Veseljijem da će konačno početi reparacija tog puta u pravcu odužen 2,5 kilometra.

Mi smo u nazad tri mjeseca intenzivno radili na ovom pitanju sa ministrom infrastrukture gospodinom Žarku i sa ministrom financije Avdullah Hoti.

Postavili smo jedan načelni dogovor sa njima da u ovoj godini, dakle u 2017. godini započne rad sa naciji tog pravca i da se on nastavi u budžetskoj 2018. godini. Košta konačno oko 2,5 miliona ili tri miliona evra ta sanacija, što nisu mala sredstva, međutim uzimajući u obzir da Ministarstvu za infrastrukturu ima po prilično sredstva na raspolaganje, a da je taj put ipak regionalni da je također međunarodni, jer veliki dio ljudi iz doline Tetova koriste taj pravac za Republiku Albaniju, dakle to je međunarodni pravac, tek 50 procenta koristi se za regiju Župa dakle preko 50 procenta ostalih ljudi koji koriste taj put su sa celog Kosova ili iz regije, prema tome do je nacionalni interes Kosova i mi očekujemo da u 2017. godini započnu radovi na tom pravcu.

Zbog toga i ćemo glasati ovaj budžet i tražimo od ministra da u između ova dva čitanja nađe mogućnost da uradi zasebnu stavku u budžetu Republike Kosova za 2017. godinu.

Takođe imamo primedbe na investicije u infrastrukturnih projektima u bošnjačkim sredinama na Kosovu.

Ako pogledate u knjigu budžeta videćete mnogo stavki po svim opštinama što je dobro, međutim na našu žalost, u onim sredinama gde živi Bošnjačka zajednica na Kosovu ne znamo iz koji razloga, možda i propust naših lokalnih predstavnika o tome ćemo kasnije razgovarati ali u svakom slučaju ima mnogo propusta i gotovo u nijednoj sredini nije predviđena adekvatna stavka za investiranje u dakle infrastrukturnim projektima koji su redovna potreba u tim sredinama.

Prema tome mi ćemo u međuvremenu imati i svoj zahtev za neka dodatna sredstva za sredine gde žive Bošnjaci na Kosovu u svim opštinama u Republici Kosova.

Zahvaljujem još jednom i očekujemo da ćemo ovaj budžet pod izglasati i da ćemo ići napred. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë kolegja deputete nuk është, Sali Salihu e ka fjalën, ndërkohë të bëhet gati Teuta Haxhiu.

SALI SALIHU: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar kolegë,

Buxheti i ndarë për bujqësi është ende shumë i vogël në raport me nevojat që ka ky sektor, por edhe në raport me buxhetin e shteteve fqinje, të cilat ndajnë më shumë për këtë sektor.

Pra, me rritjen e vetëm 0.9% të grandeve dhe subvencioneve nga viti paraprak bujqësia e Kosovës nuk mund të jetë e qëndrueshme dhe as e konkurrueshme me bujqësinë e vendeve të rajonit dhe, si pasojë, kemi invazion të importeve të produkteve bujqësore nga vendet fqinje, sidomos nga Maqedonia dhe Serbia, duke i shndërruar kështu produktet e tyre konkurrense kryesore në tregun tonë.

Pra, sot problem kryesor e kemi shitjen e produkteve vendore. Konkurrenca e produkteve të importuara nga kompanitë vendore dhe, në anën tjetër, mungesa e industrisë ushqimore në vend po e shkatërrojnë këtë sektor.

Paramendoni, zoti ministër, se në çfarë gjendje është bujqësia e Kosovës sot. Sot në tregun e Kosovës 100 kilogramë hime apo krunde, ushqim për kafshë, shiten 16 euro, e 100 kilogramë grurë për ushqim të njerëzve shiten 13 euro. Kurrë në histori të njerëzimit nuk kemi dëgjuar që krundet të jenë më shtrenjtë se gruri, kjo po ndodh në Qeverinë tuaj të koalicionit të madh me të gjithë këta ekonomistë, duke filluar nga kryeministri Mustafa, ministri Hoti, ministri Stavileci, ministrja Bajrami dhe ministri Zharku si dhe kolegë të tjerë deputetë të fushës së ekonomisë.

Dhe jam i bindur se asnjëri prej juve, e as ministri i Bujqësisë nuk i dini çmimet se si janë, për shembull, se sa është çmimi i grurit, i misrit dhe i shumë kulturave të tjera bujqësore, të cilat zënë sipërfaqet më të mëdha të tokës bujqësore në Kosovë, e që po rrezikohen të shkatërrohet si sektor.

Pra, ju si ministër ishte dashur t'i takoni kolegët tuaj ekonomistë apo edhe këshilltarët tuaj dhe të analizoni pse po ndodh kjo dhe a mund t'i mbulojnë shpenzimet e prodhimit fermerët kosovarë dhe çka duhet të ndërmerret që të mbrohen këta fermerë.

Asnjë indikator nuk e kemi se investimet në bujqësi janë duke u përkthyer në rritje ekonomike. Prandaj, vetëm shifrat dhe shumat që dedikohet bujqësisë nuk garantojnë zhvillim të bujqësisë, por duhet program me politika adekuate që orientojnë bujqësinë drejt zhvillimit të qëndrueshëm.

Përveç nevojës së investimeve kapitale në ngritjen e kapaciteteve përpunuese, vetë industrisë ushqimore, bujqësisë së Kosovës i duhet edhe politika të mirëfillta për mbrojtjen e prodhimit vendor.

Bujqësia e Kosovës ka nevojë për themelimin e një fondi të veçantë për zhvillimin e saj, ka nevojë për ulje të kostos së prodhimit përmes subvencionimit të imputeve, rritjes së prodhimit të njësive sipas sipërfaqes, rritjes së sipërfaqeve bujqësore nën ujitje, krijimi i një klime të favorshme investuese për të gjithë.

Për të gjitha këto natyrisht që kërkohet një angazhim dhe koordinim më i mirë ndërinstitutional të kryeministrit, për shembull, Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës, Ministrisë së Bujqësisë, Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Tregtisë dhe Industrisë si dhe doganave dhe gjyqësorit, e që në fakt ju nuk e keni.

Po themi koordinim më të mirë ndërinstitutional, sepse çdo vit Kosovës i humbin mesatarisht 1000 hektarë tokë pjellore nga ndërtimet e egra, kemi shkatërrim të shtratit të lumenjve dhe shkatërrim të mijëra hektarëve të pyjeve, duke dëmtuar kështu ekonominë dhe ambientin e vendit tonë dhe askush nuk merr përgjegjësi për këto veprime.

Prandaj, shtrohet pyetja, si mund të shpresohet se kjo Qeveri me njerëz të njëjtë që qeverisën deri më tani, me jokompetencën dhe papërgjegjësinë e tyre kanë vullnet të ndryshojnë gjendjen e rëndë të bujqësisë në Kosovë?

Si përfundim, themi se bujqësia do të vazhdojë të ketë gjendje të rëndë si në vitin që po e lëmë. Prodhimi vendor do të jetë i pambrojtur dhe i pabarabartë në treg, importi nga kompanitë e lidhur me pushtetin do të vazhdojë, duke importuar produkte bujqësore nga Serbi me cilësi të dobët dhe shumë të pasigurta në aspektin e sigurisë ushqimore.

Dhe, tani të nderuar kolegë, dua t'i shtroj disa çështje, me që vij nga komuna e Vitisë, nga regjioni i Anamoravës. Dëshiroj t'i shpreh disa shqetësime të qytetarëve të komunës së Vitisë, të cilët po anashkalohen nga kjo qeveri duke lënë komunën e Vitisë si një oazë të izoluar.

Vitia ka nevojë për disa projekte të rëndësishme kapitale që do t'i hapnin rrugë zhvillimit ekonomik të saj.

Vitia ka nevojë për një sistem të ujitjes, sepse është rajon bujqësor dhe ka burime të mjaftueshme të ujit në Moravën e Epërme.

Vitia ka nevojë për t'u lidhur me Maqedoninë në dy drejtime, njëri nga fshati Debëllde për t'u lidhur me Shkupin, e tjetri nga fshati Letnicë, për t'u lidhur me Kumanovën.

Por, projekti më i rëndësishëm për momentin, e që është lehtë për t'u realizuar është se Vitia ka nevojë për t'u kyçur në autostradën "Arbër Xhaferi" në Gërlicë, e jo për të shkuar katër kilometra mbrapa në fshatin Doganaj të Kaçanikut.

Kjo është kërkesë e qytetarëve të Vitisë, por edhe e Kuvendit Komunal të Vitisë.

Andaj, kërkoj nga ministri Zharku, nga ministri Hoti, nga kryeministri i Kosovës që t'i marrin për bazë kërkesat e qytetarëve të komunës së Vitisë dhe të ndajnë buxhet për të realizuar këtë projekt të rëndësishëm jo vetëm për Vitinë, por edhe fshatrat e mëdha, siç janë Begraca, Kaçaniku i Vjetër, Komogllava, Gërlica dhe Varoshi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Teuta Haxhiu e ka fjalën, ndërkohë po shkojmë prapë me opozitën. Mytaher Haskuka, Albulena Haxhiu, Donika nuk është, Ismajl Kurteshi.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Falë orientimit të politikave dhe planifikimeve buxhetore të gabuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës, buxheti, për fat të keq, edhe në vitin 2017 do të shpenzohet në asfalt.

E them "për fat të keq", sepse me të vërtetë, ky planifikim i mjeteve buxhetore është dizajnuar gabimisht, gjithnjë në dëm të një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik, i cili duket se nuk do të ndodhë asnjëherë përderisa në pushtet të jenë PDK-ja dhe LDK-ja, parti këto që po e ndihmojnë, përkatësisht plotësojnë njëra-tjetrën në ngufatjen e perspektivës dhe shpresës për mijëra qytetarë të Republikës së Kosovës, sidomos të rinjtë.

Këtë pasuri nacionale, pra këta të rinj që po detyrohen ta lëshojnë vendin e tyre çdo ditë e më shumë, e nëse ky trend vazhdon me këto përmasa, vaj halli për këtë vend. Alarmi tashmë ka rënë, ndërsa Qeveria e Kosovës i ka mbyllur sytë e veshët për gjatë rutinës pa alternativë në përditshmërinë e saj të zymtë, sepse ajo tashmë i ka vrarë shpresat e qytetarëve të Kosovës.

Si pasojë e keqmenaxhimit dhe keqqeverisjes Kosova ka shënuar rënie të madhe të investimeve të huaja, të cilat janë më shumë se të domosdoshme.

Rritja ekonomike 3 deri 4% në dy vjetët e fundit dëshmon më së mirë se kjo Qeveri nuk ka bërë orientim të duhur të buxhetit të Kosovës, por besoj fuqishëm se megjithatë një e mirë në këtë vorbull të pakënaqësisë qytetare do të ndodhë, e ajo është se ky planifikim i buxhetit dhe kjo qeverisje në Kosovë i ka ditët e numëruara.

Një gjë të tillë për gjatë gjithë kohës na e kanë dëshmuar edhe vetë partnerët e këtij koalicioni të panatyrshëm qeverisës, të cilët hapur i kanë shfaqur para opinionit pakënaqësitë e tyre rreth shpërndarjes së buxhetit të vitit 2017 dhe ambiciet e secilit për dominim edhe primat në buxhet.

Ndërsa jemi të vetëdijshëm përse ekziston gjithë kjo pakënaqësi dhe gjithë këto ambicie të sëmura për të kontrolluar, përkatësisht manipuluar qytetarin e varfër të Kosovës, gjithnjë në këmbim të votës së tij të çmuar.

Dhe, ky fakt, të nderuar kolegë deputetë, është më shumë se nëpërkëmbje e qytetarit tonë, e dinjitetit dhe e krenarisë, është abuzim me nevojat dhe perspektivën e tij, sepse qytetari sot më shumë se 730 milionë mjete të planifikuara për asfalt, ka nevojë për bukë, për ujësjellës, për kanalizim, pra për infrastrukturë elementare jetësore, ka nevojë për arsim cilësor, shëndetësi të shëndoshë e mbi të gjitha ai ka nevojë për punë.

Ndërsa krijimi i vendeve të reja të punës nuk vjen nga ky orientim i buxhetit, është i papranueshëm ky planifikim, përkundër nevojës për infrastrukturë rrugore, sepse qytetarët më shumë se për këtë kanë nevojë për përkrahjen e ndërmarrje të vogla e të mesme, si parakusht për fuqizimin e sektorit privat, pa të cilin nuk ka zhvillim, sepse në të kundërtën nuk ka perspektivë, nuk ka zhvillim ekonomik, e së këndejmi nuk ka as jetë normale. E në këtë kontekst edhe sjelljet e tij vështirë se mund të jenë njerëzore e në frymë qytetarie për shtetndërtim.

Mendoj gjithashtu se planifikimi i tillë buxhetor për vitin 2017 pasqyron qartë gjendjen e pashpresë të kësaj qeverie. Paraqet mungesën e ideve kreative pra alternativës zhvillimore të saj. Por në vend të kësaj Qeveria e Kosovës me këtë planifikim buxhetor ka zgjedhur vazhdimësinë e korrupsionit, kjo për faktin se kjo metodë e shpenzimit të parasë publike për infrastrukturë rrugore është mënyra “më e mirë”, (e them në thonjëza) për keqpërdorur fondet në dëm të qytetarëve të vendit dhe zhvillimit ekonomik.

Zhvillimi i vërtetë i vendit, me një fjalë shtetndërtimi nënkupton sakrificë edhe në kuptimin e projektimit të ideve kapitale zhvillimore pas studimeve të mirëfillta që do të duhej t'i bënte një qeveri normale.

Në vend të kësaj agjende për këto dy vjet ne kemi parë një qeveri të çorientuar maksimalisht nga kjo rrugë e shenjtë dhe orientimi i saj i pashpjegueshëm drejt shkatërrimit të vendit, fatkeqësisht edhe me çmimin e faljes së territorit.

Gjatë fushatës ju, sidomos LDK-ja, ju ministër Hoti, kishit premtuar rritje pagash po ju citoj: “Minimumin 30%, ndërsa realiteti është deri 43%”. Ju jo vetëm që nuk i rritët pagat, por nuk respektuat as Kontratën kolektive, e cila pra më 1 janar të vitit 2014 do të duhej të hynte në fuqi si e plotë, e theksoj edhe një herë si e plotë. Pra, ajo ndër të tjera parasheh edhe rrezikshmërinë

në punë, pagesën e tri pagave për të pensionuarit që asnjëherë nuk po ndodh, pagesën e udhëtimit dhe të ushqimit, pagesat jubilarë, përderisa pra nuk është paraparë këtë vit as Ligji për arsimtarët e periudhës të viteve '90-ta, edhe pse Qeveria pati premtuar se do ta sjellë në këtë vit.

Buxheti për arsim nuk tregon as tendencën e kësaj Qeverie për ta vendosur ndër prioritetet kryesore që do të duhej të ishte, pra vizioni i vobektë i kësaj Qeverie tregon një realitet që po ndodh, duke mos realizuar investime të nevojshme në arsim.

Në këtë rast, kur flasim për arsimin, unë nuk guxoj pa e përmendur Kampusin Universitar në Gjakovë, edhe pse ekziston projekti dhe lokacioni, asnjëherë pra nuk kishim asnjë interes më të vogël në kësaj Qeverie për të punuar në këtë drejtim në mënyrë që të realizohet një projekt i tillë.

Te shpenzimet kapitale shohim një trend që kanë ulje vit pas viti, në vend se të kenë ngritje.

Sipas Ligjit për arsimin parauniversitar, shkollimi parafillor është i obliguar dhe në Kosovë jo më shumë se 20% e fëmijëve janë të përfshirë në arsimin parauniversitar.

Buxheti për rini në vitin 2017 është më i ulët se në vitin 2016 dhe me tendencë të uljes edhe në vitet në vijim.

Qendrat rinore, unë e di që janë në menaxhim të komunave, por në qoftë se nuk përcillet buxhet në komuna, atëherë si mund të vijë rinia të përfitim, ose realizimi i projekteve të tyre që janë me interes për ta.

Kur jemi te buxheti për diasporën më duhet të them se në këtë rast, në vitin 2017 kjo Qeveri ka paraparë ulje të buxhetit për diasporën në vlerën 8%, pra më i ulët se sa në vitin 2016, përderisa nga diaspora mbushet arka e buxhetit me 18% të hyra.

Qendrat kulturore që janë paraparë edhe me Ligjin për diasporën, sado që janë pak të themeluara, pra vetëm tri sosh, janë paraparë edhe deri 7 të tjera, në fakt edhe këto që janë nuk funksionojnë pikërisht për shkak të mungesës së buxhetit.

Pra, ky buxhet nuk di si mund të quhet buxhet zhvillimor.

Në këtë buxhet nuk pashë që kompleksi memorial në komunën e Gjakovës, pra 27 prilli, që është masakra më e madhe në Kosovë, nuk kam parë që është ndarë as edhe një cent i vetëm, përderisa po e përmend, në fakt, prej 2008 kur unë personalisht kam qenë edhe në udhëheqjen e Komunitetit janë premtuar në vazhdimësi, qoftë nga Hashim Thaçi apo ministri Kuçi, shuma nga 300 mijë euro, asnjëherë nuk u ndanë mjete për t'u finalizuar ky projekt, i cili ka vlerën rreth një milion e 200 mijë euro dhe, në fakt, asnjëherë nuk u nda asnjë cent në këtë drejtim.

Në komunën e Gjakovës janë ndarë disa mjete, po i përmend sa për sy 20 mijë euro, 30 mijë euro, 50 mijë euro në këtë vit, përderisa në vitin 2019 planifikohen disa shuma 200 mijë euro, më 2019 unë jam shumë e sigurt që ju nuk do të jeni, prandaj komuna e Gjakovës nuk mund të trajtohet kësi soji, ministër Hoti.

Gjithashtu është një rrugë që është me interes shumë të madh, pra rruga që lidh fshatrat Smolicë-Bërjanjë-Nivokaz dhe lidh dy komunat, në fakt, komunën e Gjakovës dhe komunën e Junikut, e që ky projekt pra është dorëzuar dy herë, një herë nga komuniteti dhe një herë nga Komuna e Gjakovës dhe arrin shumën prej 950 mijë eurosh, ndërsa kjo Qeveri nuk e ka parë të arsyeshme që në këtë vit të ndajë as edhe një euro të vetme.

Kjo rrugë, në fakt, për të gjithë ata, më duhet ta përmend, që kanë marrë pjesë në bartjen e armatimit nga Shqipëria në Kosovë nuk kanë mundur të shkojnë tjetërkah pa kaluar nëpër këtë rrugë. Pra, pos rëndësisë jetike për qytetarët, kjo rrugë e ka edhe një rëndësi të veçantë në kohën e luftës.

Megjithatë, edhe në fshatin Demjan të komunës së Gjakovës, edhe pse ekziston një marrëveshje mirëkuptimi për bashkëfinancim të infrastrukturës mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe Komunës së Gjakovës, rruga që lidh pjesën qendrore të fshatit Demjan, ajo u fillua, në fakt, dhe u ndërpre në punimet dhe sot gjendja në atë rrugë është tmerruese. Qytetarët e fshatit Demjan që janë në numër shumë të madh detyrohen të shkojnë në Rugovë për të bërë rreth 20 kilometra, në fakt, ku do të kalonin vetëm për 2 300 metra po të realizohej një rrugë e tillë.

Prandaj, unë edhe pyetjet që i kam pasur para ka 4-5 javësh nuk na u dha mundësia t'i bëjmë ato pyetje

(Ndërprerje e incizimit)

KRYETARI: Zonja deputete, a doni të vazhdoni, edhe një minutë, të lutem.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, shumë kryetar!

Pra, edhe në komunën e Deçanit përkundër premtimeve të ministrit Hoti, kryetarit Rasim Selmanaj dhe ministrit të Arsimit për një shkollë në fshatin Lumbardhë, një gjë e tillë nuk po ndodh dhe vërtet edhe qytetarët, edhe të çdo fshati dhe të komunave të Kosovës, të gjithë janë participues të buxhetit të Kosovës, andaj duhet të shihen me interes të gjithë njësoj.

Prandaj, edhe një herë bëj apel që vërtet buxheti të ketë ndarje edhe në komunat e tjera dhe kërkesa që premtohen të realizohen varësisht prej interesave që janë me prioritet. Prandaj, kjo shkollë në Lumbardhë më së paku i përngjan një objekti shkollor

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Ismajl Kurteshi, fjala për ju, ndërkohë të bëhet gati Lahi Brahimaj.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Prioritetet e Ministrisë së Arsimit në nivel kombëtar për periudhën 2017-2019 janë zhvillimi i arsimit parauniversitar, zhvillimi i arsimit të lartë, përmirësimi i praktikave profesionale, përfshirja më e madhe e fëmijëve në institucionet parashkollore e kështu me radhë.

Për realizimin e këtyre projekteve prioritare natyrisht se duhet të rritet buxheti dhe do të duhej menaxhim më i mirë i atij buxheti, e realisht nuk po ndodh asnjëra e as tjetra. Në të vërtetë po ndodh e kundërta. Buxheti i Ministrisë së Arsimit për vitin 2017 planifikohet të jetë 45 milionë e 125 mijë euro, derisa në vitin 2014 buxheti për arsim ishte 50 milionë e 300 mijë euro. Pra, buxheti i vitit 2017 është rreth 5 milionë e 200 mijë euro më i vogël se buxheti i vitit 2014.

Investimet kapitale në vitin 2014 ishin 26 milionë e 325 mijë euro, kurse në vitin 2017 për investime kapitale janë planifikuar vetëm 14 milionë e 825 mijë euro.

Kurse shpenzimet për paga e mëdijte vetëm brenda Ministrisë së Arsimit kanë lëvizur në kahe të kundërt: derisa ato në vitin 2013 ishin diçka mbi 6 milionë euro, në vitin 2014 ishin ngritur në 8 milionë e 641 mijë euro, kurse për vitin 2016 ato planifikohen të dyfishohen, pra shifra në vitin 2016 ishte diku rreth 13 milionë e 411 mijë euro.

Këto të dhëna dëshmojnë se arsimi në Kosovë në vitet në vijim do të vazhdojë të degradohet për shkak të zvogëlimit të buxhetit, në njërin anë dhe menaxhimit të keq, në anën tjetër.

Dyfishimi i buxhetit për paga dhe mëdijte, në njërin anë dhe përgjysmimin e shpenzimeve kapitale.

Për trajnimin e mësuesve që gjatë vitit 2017 do të fillojnë me punë me kurrikulën e re janë ndarë 700 mijë euro, për zhvillim të plan programeve 200 mijë euro, kurse për programet e arsimit bazik 197 mijë euro, gjithsej për përgatitjen e mësuesve dhe hartimin e planeve janë ndarë vetëm një milion euro.

Në vitin 2017 do të ndërtohen vetëm 12 shkolla, edhe pse ministri i Arsimit në një ballafaqim me Komisionin Parlamentar të Arsimit pati deklaruar se në Kosovë janë rreth 20 shkolla që për shkak të vjetërisë mund të shemben çdo moment, kurse në disa shkolla mësimi ende zhvillohet në tri ndërrime.

Në mesin e shkollave që do të ndërtohen në vitin 2017, nuk është planifikuar edhe ndërtimi i shkollës së Haxhajve ku mbi 100 nxënës aktualisht i zhvillojnë mësimet në një objekt

skajshmërisht të degraduar. Në vitin 2017, nuk është paraparë as ndërtimi i Fakultetit të Shkencave Natyrore që mësimet i zhvillon në korridoret e Fakultetit Filologjik.

Buxheti për arsimin e lartë në vitin 2017 do të rritet 9% në krahasim me vitin 2016, ky buxhet do të arrijë 21 milionë e 300 mijë euro ose do të përfshijë 47% të buxhetit të përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit. Kurse, buxheti për arsim parauniversitar nga 35% sa ishte në vitin 2016, në vitin 2017 do të bie në vetëm 31% edhe pse numri i shkollarëve në këtë nivel është katërfish më i madh. Për kategorinë e pagave dhe mëditjeve në vitin 2016 janë shpenzuar 35% e buxhetit të Ministrisë së Arsimit, kurse në vitin 2017 për të njëjtën kategori do të shpenzohen 39% të buxhetit.

Kah po orientohet buxheti gjatë viteve të fundit dëshmojnë edhe të dhënat në vijim: derisa në vitin 2014 për paga dhe mëditje janë shpenzuar 10 milionë e 089 mijë euro, në vitin 2017 për të njëjtin qëllim do të shpenzohen 15 milionë e 931 mijë euro. Ndërsa, për shpenzime kapitale në vitin 2014 janë shpenzuar 25 milionë euro, kurse në vitin 2017 do të shpenzohen vetëm 14 milionë e 800 mijë euro. Gjatë kësaj periudhe buxheti për paga dhe mëditje është rrit për gati 60%, kurse buxheti për shpenzime kapitale pothuajse është përgjysmuar.

Numri i të punësuarve në Ministrinë e Arsimit gjatë vitit 2016, ka qenë mbi numrin e lejuar për 133 të punësuar ose numri i përgjithshëm ka arritur në 2 mijë e 298 të punësuar. Në gjashtë mujorin e parë të vitit 2016, buxheti për paga dhe mëditje është shpenzuar 54%, kurse për shpenzime kapitale vetëm 39%, derisa për subvencione gjendja është edhe më e keqe, janë shpenzuar vetëm 11% të buxhetit të planifikuar. Është e rëndësishme të dihet se 6 milionë e 700 mijë euro të shpenzuara për tekste shkollore dhe 650 mijë euro të shpenzuara për inventar janë llogaritur si investime kapitale edhe pse këto shpenzime nuk i takojnë kësaj kategorie.

Auditori i Përgjithshëm si shqetësim ka ngritur pagesën e orëve të pa mbajtura të mësimit dhe vonesat në përfundimin e projekteve kapitale, si dhe mungesën e mbikëqyrjes së punës gjatë realizimit të këtyre projekteve. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për vitin 2017, buxhetin do ta ketë për 45,4%, më të lartë në krahasim me vitin 2016 ose buxheti do të jetë diku rreth 29 milionë euro. Shpenzimet kapitale priten të rriten në këtë ministri, për 92% krahasuar me këtë vit dhe ato do të jenë rreth 17 milionë euro. Përkundër faktit që buxheti për sektorin e sportit është rritur mbi 100%, infrastruktura në sport mbetet larg plotësimit të kërkesave dhe nevojave të saja.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka paraparë për vitin 2017 ndarjen e rreth 600 mijë euro për renovimin e stadiumit në Gjilan edhe pse nevojë reale e Gjilanit si qendër regjionale dhe kërkesë e kompetentëve të sportit të këtij regjioni është ndërtimi i një stadiumi të ri, i cili do t'i plotësonte nevojat e futbollit të regjionit të Anamoravës.

Buxheti për trashëgiminë kulturore pritet të rritet 25% apo për 4,2 milionë euro edhe pse nevojat në këtë fushë janë shumë më të mëdha. Shqetësimi i auditorit në lidhje me buxhetin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit është mos respektimi i afateve kohore të realizimit të projekteve edhe në fushën e trashëgimisë kulturore.

Buxheti i planifikuar për Ministrinë e Diasporës është shumë më i vogël dhe nuk do të plotësojë as për së afërmi nevojat e organizimit të mësimin shtesë për fëmijët e bashkatdhetarëve tanë në diasporë që do të ndihmonte ruajtjen e identiteti kombëtar të gjeneratës së dytë dhe të tretë në vendet perëndimore të qytetarëve tanë që jetojnë atje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Lahi Brahimaj e ka fjalën, ndërkohë Mytaher edhe ti paske mbetur nga Lëvizja “Vetëvendosje”, edhe më opozitë nuk ka. Deputetë të lajmëruar për fjalë, kërkoj falje, s’ka të opozitës, e kam shkelur krejt Rregulloren edhe s’keni reaguar ju opozita.

LAHI BRAHIMAJ: Opozitë ka pasur Kadri, edhe do të ketë!

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Deputetë të Parlamentit të Kosovës,

Buxheti i qytetarëve të Kosovës po keqpërdoret nga vetë qeveritarët, buxheti po mbushet nga xhepat e...

KRYETARI: Lahi, më fal ose ke diçka se shumë po të ushton mikrofonin, ose shiko telefonin! Faleminderit!

LAHI BRAHIMAJ: Buxheti po mbushet nga xhepat e varfër të qytetarëve të Kosovës, ndërsa as më të voglën keqardhje e keqpërdorni e bëni fushatë nga të ju teket dhe si të ju teket i shpërndani ato mjete.

Duke filluar nga njëanshmëria në komuna, zona duke filluar që nga Klina e gjerë në Gjakovë, sikur e keni harruar se andej duhet të bëhen investime. Tri qeveri janë ndërruar dhe asnjë magjistratë që lidh qytetet kryesore të Dukagjinit me kryeqytetin ende nuk janë përfunduar. Pastaj, nëse e shihni planifikimin për ndërtimin e shkollave në Gjakovë ta zëmë, shkolla fillore në Ponoshec vijnë mësimin rreth 200 nxënës. Aty është një objekt i vjetër më shumë se një gjysmë shekulli, ndërsa ju për ndërtimin e këtij objekti të ri keni ndarë një shumë rreth 100 mijë euro, çka nuk mundet të ndërtohet as me një gjysmë milionë euro.

Mos të flasim për rrugët, të cilat ua keni prerë shiritat në inaugurime ende pa i nisur së ndërtuari. Ta zëmë rruga që niset për të dalë... për të cilën po ashtu i keni ndarë rreth 130 mijë euro dhe sa vite duhet ajo rrugë të përfundojë, ku përafërsisht kushton rreth gjysmë milioni euro. Ose rruga “Petro Nino Luarasi” po ashtu, në Gjakovë e cila do të kushtojë rreth 400 mijë euro, e ju keni ndarë vetëm 50 mijë euro dhe shumë projekte tjera rrugore që janë me shifra milionëshe. Të

gjitha hyrjet dhe daljet në Gjakovë që keni premtuar të dy partitë në pushtet në fushatë që do t'i bëni dhe nuk janë bërë.

Më datën 10 nëntor, unë kam bërë një pyetje parlamentare e deri më sot nuk më është dhënë mundësia që ta parashtroj, për shembull për urën e Rakovinës, e cila është dëmtuar dhe asnjë mjet nuk e keni ndarë për atë urë.

Rruga që lidh fshatin Jabllanicë me Kralan që ishte arterie kryesore që lidhte zonat e Drenicës, Llapit me Dukagjinin dhe shumë ushtarë që sot janë gjallë e në mesin e tyre edhe ju zoti Kadri Veseli keni kaluar më datën 6 shtator kur e keni lëshuar zonën e Dukagjinit keni kaluar asaj rruge. Njëjtë e kemi edhe komunën e Klinës, Pejës, Deçanit, Junikut, po mos të zgjatim më shumë, por të gjitha i kam në detaje që i keni bërë mbrapshtë. Atë që e keni planifikuar në këtë buxhet për zonën e Dukagjinit, çfarë po mendoni se është vend jetim apo vetëm për të marrë buxhetin dhe votën.

Ky është turp! Po ashtu, luftën edhe gjithçka që përmban historia e saj ju me këtë buxhet e përbuzni, duke filluar nga familjet e dëshmorëve që ua keni ndërprerë pensionet, duke i konsideruar vetëm si vlerë materiale e duke harruar që ato familje janë institucion në vete. Invalidëve të UÇK-së, as që nuk mund të punojnë e as shteti nuk u jep atë që e meritojnë, veteranët dhe të cilët po bëni humor çdo ditë duke ua ulur pensionet, duke ju thënë se jeni kaq apo aq veteran, sikur ju të kishit qenë krah për krah me ta, e deri te Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë, të cilët i keni ndarë shumë pak buxhet sa detyra duhet të përfundojë kjo agjenci në ndërtim dhe mbikëqyrjen e memorialëve, komplekseve, varrezave të dëshmorëve dhe martirëve që kanë rënë për lirinë e Kosovës.

E sa buxhet keni paraparë ju për to, ato nuk do t'i dalin as vetëm kompleksit memorial në Koshare që është në ndërtim e sipër e për të tjerat s'po flasim. Shumë memorialë dhe komplekse të luftës së UÇK-së ende ndërtohen, mirëmbahen me vetiniciativën e qytetarëve vullnet mirë se sa për Qeverinë as nuk do të ndërtoheshin as nuk do të kishin mundësinë për mirëmbajtje. Si dhe, rastin e varrezave ku prehet Mujë Krasniqi, komandanti që para pak ditës e përkujtuam. Familjet e tyre në çdo përvjetor dhe pas 17 vjetëve duhet të shkojnë me çizme dhe nuk kanë një guri te varri i tyre e shumica thirrin në merita të tyre e në vlera të tyre.

Ju qeveritarët që jeni pjesë dhe nuk e njihni as luftën që na befasoni me ruajtjen e varreve të armiqve jemi dëshmitarë që po i lejoni të shkatërrohen varret e dëshmorëve të këtij populli e të këtij vendi. 17 vjet pasluftës dhe gati 9 vjet pavarësi ju si Qeveri e Kosovës po dështoni t'i rregulloni varret e dëshmorëve, t'i mirëmbani lapidaret, memorialët e ndërtuara si dhe nuk jeni në gjendje t'i ndërtoni të reja. Në këtë shtet ku në pozita të larta udhëheqje janë disa që krekosen që kanë qenë dhe janë bashkëluftëtarë të disa dëshmorëve, kompleksit dhe memorialët e heronjve

të ndërtuara në fshatin Morinë është në shkatërrim e sipër edhe pa u rivarrosur eshtrat e heronjve që janë paraparë të varrosen aty.

Heronjve të lirisë dhe atyre që ranë në Koshare nuk u janë rregulluar varret ende, të zhvarrosur mbi tre vjet më parë për tu ndërtuar memoriali. Një pjesë e tyre janë rivarrosur, kurse një pjesë e tyre qëndrojnë në Morgun e Prishtinës në pritje që të kryhen punimet dhe të rivarrosen. Pra, gjithandej keni lënë dëshmorë pa varre duke i varrosur kështu një pjesë të madhe të historisë, sepse nuk keni të holla për ata që ranë, po ashtu s'po keni as sy e faqe për familjarët e tyre.

Për çka i keni ato të holla atëherë? Na thoni nëse keni diçka të thoni. Juve jo vetëm që nuk do të duhej ta kalonit ky projektbuxhet po as që nuk do të duhej të vazhdonit të qëndroni aty si do cunga apo degë të thata.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Brahimaj, ta tërhoqa vërejtjen, ... mikrofonin nuk e besoj se gjysma e deputetëve të kanë dëgjuar, por më vinte keq. Ndoshta zëri, por nuk kanë dëgjuar, ta kesh parasysh. Zoti Mytaher Haskuka e ka fjalën.

MYTAHER HASKUKA: Faleminderit!

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Po hyjmë në vitin e tretë të qeverisjes, ku së paku këtë vit unë pritja që Qeveria nuk do të arsyetonte rrethanat e jashtme për mungesën e një buxheti të mirëfilltë që do të ishte në drejtim të zhvillimeve ashtu sipas premtimeve zgjedhore. Pra, së paku këtë vit kemi pritur që një buxhet do të shpjegon se si do të krijon vende të reja të punës së paku 200 mijë vende të premtuara nga partitë në pushtet. Por, edhe pas tre vjetësh buxheti nuk është për zhvillim, as për punësim, por për klientelizëm dhe korrupsion.

Buxheti 2017 është i njëjtë si buxheti i 2016, i cili ishte kopje e buxhetit të vitit 2015 e ky buxhet ishte kopje e buxhetit të Qeverisë Thaçi. Për më tepër, me siguri buxheti origjinal ishte i përgatitur nga të huajt, ngase renditja e akronimeve në mënyrë alfabetike është në versionin anglisht, ndërsa në versionin shqip buxheti dhe radhitja nuk janë alfabetike.

Qeveria Mustafa-Veseli është e njëjtë si ajo e Thaçit, ngase e ka logjikën e njëjtë vetëm kjo në ndërrim të emrave. Logjika e Qeverisë është logjik përvetësimi, pra përvetësohen taksat e qytetarëve ndërmjet dhe ato shpërndahen familjarëve dhe jaranëve nëpërmjet tenderëve të asfaltit. I vetmi dallim ndërmjet buxheteve të mëparshme dhe buxhetit të vitit 2017 është që është rritur borxhi publik. Përderisa qeveritë e mëparshme përvetësonin tatimet tona, kjo Qeveri është duke përvetësuar edhe tatimet e fëmijëve tanë ngase edhe ata është duke i shti në borxhe dhe hipoteka pa i pyetur as ne e as fëmijët tanë.

Çka është më shqetësuese në këtë buxhet është po ashtu, problemi në kalkulime. Çka të presim nga një qeveri e cila gabon në tabelën e parë të buxhetit. Shpresoj që ata kanë gabuar edhe nuk kanë gënjyer, por edhe nëse kanë gabuar edhe nëse kanë gënjyer kjo tregon shumë për këtë qeveri. Në këtë tabelë që është tabela e parë e buxhetit, deficitin primar për vitin 2017 paraqitet të jetë 276 milionë, kur kësaj i shtohet edhe shuma e interesit atëherë deficitin arrin në shumën 299 milionë. Në të njëjtën tabelë po ashtu është dhënë që bruto produkti vendor apo GDP-ja pritet të jetë 6 miliardë e 410 milionë. Ndërsa, në fund thuhet që deficitin si pjesë e bruto produktit vendor është 1,5%, por nëse i pjesëtojmë këto 2 numra, pra nëse pjesëtojmë 299 milionë me 6 miliardë e 410 milionë, atëherë shifra del të jetë 4,67% apo shumë më e lartë se sa 1,5%.

Domethënë, edhe kjo shifër e deficitit si pjesë e bruto produktit është shumë më e lartë se sa në dhjetë vitet e kaluara. Po ashtu, në këtë tabelë ka edhe kalkulime tjera të gabuara ku faktikisht shifrat luajnë, këto mund t'ia dërgoj Qeverisë të shkruara, prandaj nuk duhet të jetë një buxhet me aq shumë gabime, sidomos nëse besojmë që buxhetin e kanë përgatitur akademikët dhe ekonomistët.

Nëse i kthehem temës së buxhetit, ai nuk është për qytetarët, por si thamë për jaranë dhe familjarë. Si mund të shpjegohet ndryshe kjo kur në buxhet kemi vetëm diku rreth 77 projekte të reja të rrugëve vetëm për vitin 2017 dhe nga këto 77 projekte të reja të rrugëve, shuma për shumicën e këtyre rrugëve është 50 mijë deri në 100 mijë për vitin e parë, ndërsa në vitet 2018-2019 parashikohet rritje e këtyre shumave. Kjo tregon me të vërtetë që interesi është që të jepen tenderët në vitin 2017 dhe të merren përqindje nga tenderët, pastaj puna më e madhe të lihet qeverive të ardhshme, të cilët do të kenë problemin e përfundimit të këtyre projekteve që janë klientelistë dhe korruptive.

Njëjtë është edhe për universitetet, si për shembull shikova investimin në Universitetin e Prizrenit për renovim në vitin 2017 shuma është 200 mijë, ndërsa në vitin 2018 parashihet shuma 300 mijë, në vitin 2019 parashihet shuma 600 mijë. Çka do të thotë kjo? Kjo do të thotë se vetëm të japim tenderët, ndërsa paratë e viteve të ardhshme duhet t'i paguajnë qeveritë e ardhshme. Njëjtë është edhe për Universitetin e Pejës: 200 mijë, 380 mijë, 680 mijë në vitin 2019. Universiteti i Gjilanit investimi 250 mijë në vitin 2017, 370 mijë në vitin 2018, ndërsa në vitin 2019 700 mijë euro.

Faktikisht si thashë edhe më përpara kjo është vetëm një buxhet për tenderime edhe për të marrë përqindje të tenderëve.

Si të rregullohet buxheti dhe të kthehet faktikisht prej një buxheti kontabilist i cili i shpërndahet miqve dhe familjarëve në një buxhet zhvillimor, unë besoj që duhet që buxheti të kthehet në buxhet në investim në arsim, investime në aftësimin e fuqisë punëtore, me projekte të përmirësimit të mjedisit të biznesit dhe në projekte zhvillimore në bujqësi dhe prodhimtari.

Mosdija mund të falet, por nëse këto bëhen me vetëdije atëherë kjo nuk është e falshme. Nëse...

KRYETARI: Zoti Haskuka, dëshiron të vazhdosh apo?

MYTAHER HASKUKA: Po, do vazhdoj vetëm desha të marr disa shifra.

Në aspektin e investimeve nëse shikojmë në investimet në subvencione në bujqësi dhe në transfere në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë dhe asaj të Zhvillimit Ekonomik, të gjitha këto shuma kapin më pak se 5% të vlerës së buxhetit të përgjithshëm. Këto projekte mund të kenë ndikimin në zhvillimin e Kosovës, por nëse janë vetëm 5% ndikimi do të jetë shumë i vogël.

Por, edhe nëse e dimë se si po shpërndahen këto subvencione dhe grande, atëherë nuk kemi as të paktën besim që edhe kjo 5% i buxhetit që do të shkojë në prodhimtari do të ketë ndonjë sukses në ngritjen e prodhimtarisë dhe të punësimit në Kosovë. Në aspektin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, të gjitha transferet janë transfere për ndihma sociale, nuk ka kurrfarë transferi në riaftësimin e klasës punëtore ose në atë riaftësimin e fuqisë punëtore ngase transferet në ndihma sociale i mban njerëzit në varfëri nuk i lë të vdesin, por as nuk ju ofron mjete për një jetë të dinjitetshme.

Për një jetë të dinjitetshme atyre duhet punësimi, dhe për punësim duhet aftësim profesional në arsim. Nuk mund të presim tërë kohën që vetëm organizatat ndërkombëtare t'i bëjnë këto. Këto duhet t'i bëjë Qeveria me grandet e saj. Nëse ju nuk mund t'i bëni ose nuk dini si t'i bëni mund të përdorni alternativën e lëvizjes "Vetëvendosje" aty keni shumë programe se çfarë duhet të bëhet në këtë fushë.

Në aspektin e arsimit foli edhe zoti Ismajl Kurteshi, po pothuajse alarmante rezultatet e testit të PISA-t e cila tronditën opinionin e Kosovës. Nxënësit kosovarë dolën në fund të listës, por më keq një nxënës kosovar në moshën 15-vjeçare doli që din 2 vjet e gjysmë më pak se sa një nxënës të moshës së njëjtë në vendet e tjera të botës. Edhe për më tepër një nxënës në Kosovë është plot 7 vjet mbrapa një nxënësi të Singaporit.

Pra, në klasën e fundit të shkollës së mesme një nxënës në Kosovë din më pak se sa një nxënës në klasën e gjashtë në Singapor. Kjo është alarmante, këtu duhet të bëhet një investim shumë më i madh që të përmirësohet arsimi në shkollat tona, por sipas hulumtimeve ne shohim që edukimi shumë varet nga edukimi parashkollor dhe nga puna praktike në shkolla. Ashtu si Komuna e Prishtinës që është duke rritur numrin e institucioneve parashkollore, besoj që kjo duhet të bëhet edhe në gjithë Kosovën dhe të parashihet në investimet kapitale të Qeverisë, po ashtu edhe të bëhet rritja e numrit të laboratorëve nëpër shkolla ashtu sikur Komuna e Prishtinës i ka bërë më shumë se 100 laboratorë vetëm vitin e fundit.

Së fundi, investimet në shkollimin universitar duhet të rriten, ngase ato janë edhe pothuajse të njëjta si në vitin 2014, domethënë jemi tre vjet pas vitit 2014 dhe buxheti është i njëjtë. Në vitin 2014 kemi pasur vetëm një universitet publik atë të Universitetin e Prishtinës, ndërsa tash i kemi gjashtë universitete publike, e kemi: Universitetin e Prizrenit, Universitetin e Pejës, Universitetin e Gjakovës, Universitetin e Mitrovicës, Universitetin e Gjilanit, Universitetin e Prishtinës, por buxheti për arsimin e lartë ka mbetur pothuajse i njëjtë.

Pra, universitetet janë gjashtëfishuar ndërsa buxheti mbetet i njëjtë dhe kjo ka ndikuar në cilësinë në arsim, ku tanimë domethënë jo vetëm që cilësinë në arsim nuk kemi mundur ta mbajmë në nivelin e njëjtë, por ajo ka degraduar edhe më shumë në Universitetin e Prishtinës.

Po ashtu, duhet të kemi më shumë investime në hulumtimet dhe kërkimet shkencore ashtu si parashohin edhe ligjet edhe konventat evropiane, të nënshkruara edhe nga Kosova. Së fundi, unë dua të them se duhet të bëhen investime në këto fusha ngase nëse duam që të kemi një shtet zhvillimor ku kemi luftimin e varfërisë nëpërmjet punësimit dhe ku buxheti nuk është vetëm buxhet për tenderë, por një buxhet për përmirësimin e jetës së qytetarëve për të rritur punësimin dhe për të luftuar varfërinë dhe shpresoj që kjo do të merret parasysh nëse jo tash...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Zonja Flora Brovina e ka fjalën, bëhet gati zonja Kimete Bytyqi.

FLORA BROVINA: Faleminderit, kryetar!

Sot në diskutimet për buxhetin papritmas shëndetësia u bë prioritet dhe kjo shumë mirë, duhet të ndihemi të kënaqur, por fatkeqësisht në të gjitha diskutimet u tha se buxheti ishte i mangët për sektorin e shëndetësisë.

Ne kemi shëndetësi dhe nivel shëndetësor aq sa investojmë, dhe po shihet se investojmë më së paku në regjion. Prandaj, dhe kemi shëndetësi ku duhet të investojmë për mjekime jashtë vendit. Kemi ndërtuar spitale, të cilat kanë mbetur të zbrazëta në territoret ku s'ka as popullatë ose spitali që presin të ndërtohen, sepse janë planifikuar shuma megalomane.

Kemi spitale sikur është Spitali i Vushtrrisë, ku është investuar mirë, por mungon dhe nuk është planifikuar kuadri që do të punojë aty, prandaj nuk janë funksionale. Në anën tjetër kemi planifikime për ndërtimin e spitaleve të reja, siç planifikohet me këtë buxhet ndërtimi i spitalit në Besianë.

Ndërkaq, nuk kemi spital këtu në kryeqytet që duhet të ishte Spitali i Prishtinës, ose përmirësimet e kushteve në Klinikën Hematologjike ku të sëmurët nga leukemia dërgohen jashtë vendit për mjekim. Në spitalet që janë tanimë jo vetëm të Kosovës, por kryejnë shërbime edhe

për regjione të tjera, siç është Spitali i Gjakovës nuk kemi fare investime. Gjithashtu, gjatë monitorimit të Ligjit për shëndetësinë ne vërejtëm se shërbimi shëndetësor për kujdesin e të burgosurve nga Ministria e Drejtësisë është bartur në Ministrinë e Shëndetësisë dhe vërejtëm se nuk ka autoambulancë.

Madje, në Dubravë ku trajtohen ose mbahen 900 të burgosur është vetëm një autoambulancë e cila është tejet e vjetër dhe nuk i plotëson kushtet elementare për bartjen e të sëmurëve urgjent deri në klinikat e Prishtinës. As këtu nuk është paraparë një buxhet.

Tani diskutimit tim duhet t'ia bashkëngjis një informatë për të gjithë ju kolegë të nderuar, dhe kjo është: para disa muajsh në këtë Kuvend ne refuzuam herën e parë një marrëveshje të nënshkruar nga Presidentja e Kosovës dhe Presidenti i Qeverisë Austriake, marrëveshja për kredi shumë të volitshme prej 20 milionë e 600 mijë eurove për investime në kardiokirurgji, sepse 500 mijë euro ishin për ne komisionin dhe për ju deputetë ishte diskutabile.

Megjithatë, ta refuzosh një kredi të tillë, ku kamata është fare simbolike nuk ishte në favor tonin, sepse na duheshin investime në këtë sektor dhe Komisioni për Shëndetësi, insistoi që të kthehet rishtazi në Parlament dhe falënderuar juve, por në rend të parë premtimit të Komisionit për Shëndetësi se do ta monitorojë buxhetin ne ia arritëm që të marrim kredinë e favorshme, por gjatë monitorimit shohim se ato 500 mijë euro nuk na duhen, ndaj e quaj si sukses të monitorimit të buxhetit nga ana e vetë Komisionit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe kështu duhet të monitorohet edhe më tutje buxheti i Kosovës, natyrisht duhet t'i falënderoj edhe ministrit të Shëndetësisë i cili e kuptoi këtë gabim që ka ndodhur, por edhe donatorit domethënë nga vetë Austria.

Diskutimit tim desha t'i bashkëngjis edhe sa i përket ndërtimit të rrugëve, diskutimi që e dha zoti Haradinaj në lidhje me rrugën Plavë-Guci dhe rrugët tjera që për të cilat janë ndarë vetëm 50 mijë euro, sepse për mua është e pakuptueshme ndërtimi i një rruge për 50 mijë euro. Sigurisht është menduar për mirëmbajtjen e rrugëve, por kur është në pyetje rruga që lidh dy shtetet Malin e Zi dhe Kosovën, dhe një rrugë në të cilën personalisht kam qenë e interesuar dhe kam intervenuar në mandatin e kaluar që të hyjë si prioritet për ndërtimin e kësaj rruge, pra Plavë-Guci jam shumë i prekur që kjo nuk është prioritet në asnjë buxhet të kësaj qeverie, sepse ky popull duhet të komunikojë mes veti në pikëpamje kulturore, ekonomike dhe pse jo të thuhet me zë se në Plavë dhe Gusi populli shqiptarë është në fazën e asimilimit. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti.)

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Veton Berisha e ka fjalën.

VETON BERISHA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Meqenëse unë bëj pjesë në grupin e pozitës do të jem më i shkurtër, sepse kështu u morëm vesh.

E përgëzoj Qeverinë për ngritje të buxhetit në 2 miliardë, vërtetë është sukses dhe është për tu përgëzuar. Nuk do të lëshohem në detaje të vogla për shkak se u tha shumëçka këtu, unë jam jurist me profesion dhe nuk mund t'i di shumë efektet ekonomike, të cilat me buxhetin i cili është paraparë që ka mundësi të parashih Kosova, por një gjë e di sigurt se gjendja e komunitetit tim ka mbetë e pandryshuar faktikisht gjatë gjithë kësaj kohe, gjatë gjithë buxheteve të kaluara.

Unë shpreh rezervën time në raport me parashikimin e nenit 12 për shfrytëzimin e mjeteve për komunitete, ku Qeveria të vetmin fakt e parashih mbështetjen e komuniteteve me subvencione dhe këtë të drejtë ia jep Ministrisë për Kthim dhe Komunitete dhe Zyrës së Kryeministrit për Komunitete, zyra dhe ministrinë, të cilat menaxhohen kryekëput nga komuniteti serbë dhe shumë pak mund të kemi qasje.

Shpresoj dhe besoj fuqishëm që do të bëhet vërtetë një plan i cili do ta ndryshojë këtë gjendje dhe do ta ndryshojë qasjen e menaxhimit të këtij fondi, i cili do të jetë në shfrytëzim edhe të komuniteteve tjera dhe shpresoj që ky plan vërtetë të jetë i hartuar mirë dhe i trajtuar mirë. Normalisht me planifikimet e buxhetit kudo paraprakisht hetohet ose vërtetohet gjendja reale mbi të cilat baza duhet edhe të investohet dhe të ndryshohet gjendja. Domethënë, të kapet realiteti i njerëzve dhe mu në ato edhe të planifikohet buxheti. Kjo nuk është bërë sidomos në pjesën time, në komunitetin tim në të cilin unë e përfaqësoj komunitetin egjiptian nuk është bërë një konsultim paraprak se në cilat fusha do të mundte buxheti të ndikojë dhe ta ndryshojë gjendjen.

Dhe vërtet me nenin 12 nuk mund të parashihim shumë çështje, një gjë është shumë e rëndësishme Komisioni i Komuniteteve në kuadër të Kuvendit të Kosovës ka monitoruar Ligjin për shërbyesit civil, neni 11, ku parashih punësimin e komuniteteve në Administratë Publike dhe rekomandimi i dal nga ky grup, nga monitorimi ka dal që Qeveria e Kosovës duhet të parashih buxhet shtesë dhe secila ministri ka kërkuar, secili institucion ka kërkuar buxhet shtesë për punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve dhe plotësimin e vendeve të parapara dhe me këtë rast kërkoj mirëkuptim Qeverisë, që të parashih në planin e buxhetit e parashikim të buxhetit për plotësimin e vendeve të punës për nenin 11, Ligjin për shërbyesit civilë për shkak se është ligj obligativ dhe deri tash ka mbërritur në 6,23 dhe në 5,20% është vetëm me komunitetin serb.

Pra, si rekomandim parashihet mundësia që të jepet mundësia e amendamentimit të projektbuxhetit për punonjësit e shërbimit civil të komuniteteve tjera në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Berisha! Kujtim Paqaku e ka fjalën.

KUJTIM PAQAKU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Duke u bazuar në temën që flitet rreth buxhetit edhe unë kam përgatitur një fjalim të shkurtë, jo fort të gjatë. Po e filloj kështu: unë si pjesëtar i Grupit Parlamentar “6+” në emrin tim flas dhe flas shumë shkurt.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës është një garancë për të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë, por praktika e sotme po tregon diçka tjetër. Përmes praktikës po disfavorizohen pjesëtarët e komuniteteve pakicë si në nivelin qendror ashtu edhe në nivelin lokal. Edhe ky buxhet zhvillimor nuk ka specifika për komunitetin romë me fokus në të gjitha aspektet pothuajse.

Po kanoset rreziku i asimilimit dhe i trashëgimisë kulturore, materiale dhe shpirtërore. Papunësia po jetë çdo ditë e më e madhe. Tani po ballafaqohemi dhe në vitin e ardhshëm me riatdhesimin e dhunshëm të pjesëtarëve të komunitetit ku nuk ka planifikim buxhetor për zhvillim. Do të ndalem edhe tek Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal që duhet më në fund të favorizohet Ligji për shërbimin civil 10% që i takon komuniteteve pakicë, kjo dita –ditës ende nuk po shndërrohet në realitet.

Ministria për Kthim dhe Komunitete ende po ballafaqohet me problemin e komunitetit romë ngase nuk kemi apo thuajse aspak ndërtimin e shtëpive dhe kështu ky buxhet për komunitetin romë është i disfavorshëm, po ashtu edhe në shëndetësi që pjesëtarët e komunitetit romë po kanë nevojë për kurim. Pasi e ceka që nuk ka specifika për komunitetin romë, atëherë do të ndalem edhe te konservimi i trashëgimisë materiale dhe shpirtërore të komunitetit romë. Ky është projekt nacional, nuk ka as investime në infrastrukturën buxhetore.

Ky buxhet na jep shpresa që do të favorizohet edhe për komunitetin romë, ne shpresojmë të jemi të arsyeshëm, shpresojmë të kemi besimin tuaj dhe shpresojmë të jemi të barabartë me komunitetet tjera pa u cilësuar asnjë super komunitet në Kosovë. Andaj, shpresoj që edhe në mirëkuptimin tuaj, të nderuar deputetë të Parlamentit të Republikës së Kosovës. Unë uroj punën për buxhet, uroj Komisionin për Financa dhe ministrin Hoti. Kërkesa ime ka të bëjë me një muze romë, gjegjësisht qendrën kulturore romë ku do të kultivohet pa u asimiluar më askush nga komuniteti romë, të jepet favorizim në etnologji, muzikologji, etnografi e tërë literatura botërore të jetë më në një vend që nga Fan Noli, që nga Çajupi, Migjeni, edhe autorët tjerë evropianë dhe botërorë tanimë duhet të jenë në një vend të përkthyer apo nga autorët, të cilët kanë shkruar për romë ose mbi romët.

Aktivitetet në këtë qendër kulturore ose në këtë muze do të jenë të përfshirë edhe nxënësit e shkollave fillore, edhe ato të mesme, edhe studentët. Andaj, fuqishëm shpresoj që deputetët e

Parlamentit të Republikës së Kosovës do ta favorizojnë më komunitetin romë pa cilësuar asnjë komunitet superior tanimë nuk do dëshiroj të emërtoj atë komunitet, por unë kam besim të madh, sepse kam qenë çdoherë i favorshëm për interesat e Kosovës kur jam ndodhur në takimet ndërkombëtare e tani shpresoj nga ju, të nderuar deputetë, do ta favorizoni edhe komunitetin romë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tash janë edhe 9 deputetë, të gjithë janë të PDK-së. Unë po i lexoj me radhë emrat qysh do t'i thërras: Labinotë Demi Murtezi, Xhevahire Izmaku, Hajdar Beqa, Bekim Haxhiu, Shukri Buja, Abdyl Ymeri, Naim Fetahu, Luljeta Veselaj-Gutaj edhe Nehat Baftiu.

Labinotë Demi Murtezi e ka fjalën! Nuk është Labinota, atëherë Xhevahire Izmaku.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, nënkryetar!

Edhe unë e kam kërkuar fjalën qysh në orën 10:00 të mëngjesit, po më duket që sot i dhatë përparësi opozitës ndoshta edhe keni bërë mirë, këta e kanë vlerësuar atë.

Përshëndetje për ministrat që janë prezentë edhe këta që po doket se po na ikin prej sallë, por më lejoni fillimisht të theksoj që e kam lexuar me vëmendje Projektligjin për buxhetin kuptohet që ne që s'jemi kompetentë në këtë fushë nuk mund edhe t'i lexojmë, t'i kuptojmë komplet domethënë shifrat posaçërisht ato me fontin 8 që janë shkruar, mirëpo ne i përkthejmë tekstin i cili tregon për projektet e planifikuara kështu që më lejoni fillimisht t'i përshëndes dhe t'i përgëzoj për punën e mirë që e kanë bërë profesionale anëtarët e Komisionit për Buxhet, por edhe mënyrën e trajtimit nga ana e Qeverisë.

Por, megjithatë unë do të kem tri çështje: një e cila i përket çështjes nacionale për projektin e digjitalizimit dhe dy të tjera, të cilat i takojnë komunës që përfaqësoj, pra Komunës së Vushtrrisë. Në projektbuxhetin për vitin 2017, edhe këtë vit unë nuk arrita të shoh asnjë cent të ndarë për procesin e digjitalizimit, duke ditur faktin që ne këtë vit në Raportin e progresit morëm përsëri vërejtje që nuk i kemi fuqizuar me mjete financiare, Komisionin e Pavarur për Medie. Komisioni i cili ka me qenë bartës bashkë me Qeverinë në procesin e digjitalizimit, mendoj që duhet të kemi një kujdes të shtuar, sepse askund në botë nuk ndodh që të përfundojë një proces i digjitalizimit pa mjete shtesë.

Pra, në vitin e kaluar e kemi miratuar Ligjin e digjitalizimit, mirëpo në tre mujorin e parë të vitit 2017 detyrimisht Qeveria do të jetë e obliguar që ta miratojë strategjinë dhe strategjia menjëherë detekton një influencë financiare, e cila ka obligim duke ditur që kemi të shumëfishuar industrinë mediale, ta përcjellë hartimin e pakove të licencave për operatorët që do të fitojnë, pra 'permuksa' me të cilët ne do të operojmë për digjitalizim. Kjo nuk bëhet pa para dhe ne nuk kemi ekspertë të kësaj fushe, kështu që jemi të detyruar t'i paguajmë ata ekspertë nga jashtë dhe

të kemi parasysh që do të dalim në një situatë të paparashikuar, Qeveria do të jetë e detyruar të gjejë mjete.

Andaj, ministri Hoti duhet ta ketë në vëmendje këtë gjë.

Tani më lejoni të theksoj për një projekt, i cili ka filluar qysh para katër vjetëve në Komunën e Vushtrrisë. Komuna e Vushtrrisë e ka kërkuar ndërtimin e palestrës së sporteve në fshatin Samadrexhë, është një fshat i cili ka traditë mbi 50-vjeçare të sportit dhe ndërtimi i kësaj palestre është jetike për ata banorë dhe kryesisht ato vajza, të cilat kanë ekipin e hendbollit që përfaqësohet në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Ky projekt pavlerën mbi 1 milion euro. Unë e përgëzoj ministrin Shala, që ka arritur një marrëveshje, memorandum bashkëpunimi, me kryetarin e komunës dhe dëshiroj të theksoj, që kjo marrëveshje është nënshkruar këtë vit, ku parasheh që në vitin 2017 të jepen vlerë mjetesh deri në 450 mijë euro. Mirëpo, unë e shoh këtu që janë vetëm 100 mijë euro dhe me këto 100 mijë euro, përsëri vetëm do të jetë një mashtrim optik për ata sportistë, sepse nuk ka mundësi të realizohet.

Edhe një herë, them që unë e vlerësoj përkushtimin dhe motivimin e ministrit, mirëpo kërkoj që të ketë azhurnitet dhe kjo të përmbillet me mjetet që u duhen për ndërtimin e kësaj palestre, të cilat shkojnë deri në 450 mijë euro. Unë do të jem kujdestare deri në fund e këtij projekti dhe besoj se do ta kem mirëkuptimin edhe të ministrit.

E dyta, është një projekt jashtëzakonisht i rëndësishëm, për të cilin komuna e Vushtrrisë nuk ka mundësi ta realizojë. Pra, janë 15 fshatra që s'kanë një rrugë, mbi 18 fshatra realisht. Është në pyetje rruga që lidh Artakollin me Vushtrrinë, Skenderajn dhe Obiliqin, një rrugë nëpër të cilën kalojnë 10 mijë banorë, pra qarkullojnë në të, 50 vjet askush s'ka pasur mundësi të investojë. Është një rrugë e cila, do t'i përmend me radhë, pra lidh këto fshatra: Mihajliq, Bequk, Strazë, Bivolak, Gllavotin, Zhilivodë, Druarë, Rreznik, Brusnik, Shalcë, Vermicë, Kollë, Bukosh, Beçiq, Galicë, Liqejë, Tarazhë dhe Dubovc. Dhe, komuna e Vushtrrisë i ka kërkuar disa herë që të ketë investim, unë e shoh që s'është as në këtë projektbuxhet, me mirëkuptim, unë nuk do të bëj amendament, por kërkoj që ministri të ketë parasysh që me rishikim, sepse është një rrugë e cila me të vërtetë është shumë jetike për banorët e kësaj ane, pasi që duke ditur faktin se ata banorë merren kryesisht me bujqësi, nuk kanë mundësi të qarkullojnë me mjetet e tyre të punës për t'i bartur edhe produktet bujqësore, po sigurisht shqetësimi im është më i madh për banorët, për fëmijët e vegjël të cilët detyrohen të ecin me çizme të rënda me ujë nëpër ato rrugë. Unë shpresoj se do të kem mirëkuptimin, si deputete, që bashkë me ministrin dhe kryeministrin pasi ta përfundojmë leximin e parë, vetë unë do t'i shoqëroj dhe të shohim me të vërtetë se sa e vështirë është të jetosh në atë pjesë. Pra, kemi në pyetje 18 fshatra që qarkullojnë për 16 kilometra rrugë.

Unë, sigurisht, se do të votoj për, mirëpo me këtë rast do t'i ftoj edhe deputetët e opozitës sepse ka 6 vjet që i përcjell, kurrë asnjëherë s'e kanë votuar, as në parim. Nëse kanë vërejtje, atëherë mund të na shoqërojnë, në këtë rast të votojnë dhe të na shoqërojnë bashkë në punën në vijim. Ndërsa, shpresoj që ministri do ta ketë parasysh kërkesën time për rrugën, e cila lidh këto 18 fshatra. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Hajdar Beqa e ka fjalën, pas tij Bekim Haxhiu.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra, që jeni prezentë dhe kolegët e juaj që janë në bufe,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

E di që ndoshta jemi lodhur, sot ka qenë një ditë e gjatë por Buxheti dhe Ligji për Buxhetin është i rëndësishëm së veçantë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, pa dallim.

Ne në fillim të seancës këtu thamë që është kohë e shkurt të lexohet në mes dy leximeve, por mendoj që ne e kemi pasur nga data 1. 11. 2016 si deputetë, projektligjin për Buxhet, që na ka rreth shtatë javë gati, mund të them, që ta shqyrtojmë dhe unë si deputet e kemi lexuar dhe shqyrtuar këtë projektligj.

Është një projektligj që ndoshta ka kaluar edhe përtej mundësive që i ka Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, duke pasur parasysh edhe mjetet që do t'i shtohen Buxhetit nga AKP-ja, por u tha edhe më herët nga kolegët, që ndoshta duhet të ndërrohet edhe infrastruktura ligjore, që të barten ato mjete nga buxheti i AKP-së në Buxhetin e republikës së Kosovës. Dhe, ne si deputetë mbështetim një gjë të tillë.

Unë i kuptoj prioritetet e Qeverisë dhe i mbështetim, por i kemi disa vërejtje në shpërndarjen e Buxhetit, sepse mundësia për një buxhet më të madh ka qenë e pamundur. Te shpërndarja e Buxhetit ne shpeshherë këtu kemi folur edhe në nivelet lokale edhe në ato qendrore për reforma në administratë dhe digjitalizimin e administratës. U tha edhe më herët, nga kolegja Izmaku, që pa një investim më të madh në IT, në teknologjinë informative, nuk mund të kemi reforma në administratë dhe në këtë kod buxhetor shihet se ka pasur shumë pak mjete për tu arritur objektivat e digjitalizimit të administratës.

U tha që kemi pasur edhe disa kërkesa, nëse mendojmë ta kemi një sistem të drejtësisë më funksional apo transformimin e Ushtrisë, me këtë buxhet është e pamundur të realizohen këto objektiva. Unë kërkoj në këtë rast edhe nga Komisioni për Buxhet, edhe pse ka bërë një punë të madhe, e përshëndesim për angazhimin në vazhdimësi që kanë pasur, por t'i shikojnë kërkesat e shumë institucioneve për t'i mbështetur, sepse janë me rëndësi të veçantë, sepse pa mbështetjen e, për shembull: kërkesave të Ministrisë së Drejtësisë apo të Prokurorisë, gjykatave, pa rritjen e

numrit të prokurorëve dhe të gjykatave, atëherë nuk mund të ankohe mi në ato personalitete atje apo në punën e tyre, sepse kemi lëndë që edhe më shumë se pesë vjet nuk kanë mundur t'i shqyrtojnë me arsyetimin në mungesë të numrit të gjyqtarëve apo të prokurorëve.

Mendoj se është imediate për qytetarët e Republikës së Kosovës, që vendimet të merren më të shpejta dhe të jenë më funksionale, si Institucioni i Drejtësisë. Nëse, ne mendojmë të arrijmë nivelin e duhur të zbatimit të dispozitave ligjore në lëmin e marrëdhënies së punës duhet t'i mbështet komisioni, të shikojë formën për t'i mbështetur edhe kërkesat e Inspektoratit të Punës, duke pasur parasysh se ai inspektorat e ka një gamë të gjerë të mbikëqyrjes së ligjeve, ka shumë kërkesa nga sektori publik, privat, publiko-privat, që duhet edhe të gjithë punëtorët që janë në këto sektorë, që duhet t'i shqyrtojë dhe me numrin që e ka edhe përfshihet në të gjitha regjionet e Republikës së Kosovës, me këtë numër të inspektorëve që ka rreth 50, është e pamundur të mbulojë apo të ketë një punë efikase.

Gjithashtu, ne ankohe mi edhe te Këshilli Mbikëqyrës i Shërbyesve Civilë, që shqyrton ankesat e të gjithë punëtorëve të shërbyesve civilë në Republikë të Kosovës, edhe ata kanë një kërkesë për komisionin. Ne e përkrahim komisionin nëse shikon mundësinë ligjore që edhe këtë kërkesë për pesë punëtorë të rritet numri i këtij këshilli.

Unë nuk do të ndalem shumë në të përgjithshmen për shkak se u tha këtu nga të gjithë kolegët. E kam shqyrtuar me vëmendje edhe buxhetin për komunën e Gjakovës, si një komunë që konsideroj se ka pasur një mbështetje më të dobët krahasuar me komunat tjera në numrin e banorëve apo edhe si regjion, tash siç është Gjakova. Kemi disa projekte, mos t'i citoj, që kanë hyrë, por vlera për 2017-ën është rreth 2 milionë e gjysmë realisht nga qendra po flasim. Atëherë, me këtë shifër është shumë problem të realizohen objektivat e qytetarëve atje apo kërkesat e qytetarëve.

U tha edhe nga disa kolegë, kryesisht të opozitës, është e vetmja komunë që nuk ka hyrje dalje as nga Gjakovë-Klinë, as Gjakovë-Pejë, veç siç ka qenë para 20 vitesh, as Gjakovë që lidhë Rekën e Keqe, Junikun dhe Bajram Currin, as Gjakovë që lidhë Gjakovën me Prizrenin. Do të thotë, është i vetmi qytet që nuk e ka në hyrje një rrugë me katër korsi dhe ne dimë që me këtë buxhet është e pamundur me hy tash, por kërkoj nga ministri i Financave, kryeministri, ministri i Infrastrukturës, të shikojnë mundësinë ligjore me huat, siç kemi pasur praktika edhe më herët, që të hyjë edhe Gjakova në këtë, për arsye se ka pasur kërkesa edhe nga komuna, por edhe nga komuniteti në vazhdimësi.

Të njëjtën kohë kërkoj nga Qeveria që të shikojë nga forma e huamarrjes, se e dimë buxhetin dhe mundësitë e kapacitetet buxhetore të Republikës së Kosovës, ta shikojë mundësinë, ngase jemi i vetmi qytet që është regjion dhe nuk kemi as projekt për momentin nuk ka Qeveria e Republikës

së Kosovës ta lidhë qytetin e Gjakovës apo Komunën e Gjakovës me Prizrenin, ku nga Prizreni të lidhet me Prishtinën dhe me Tiranën.

Andaj, nga këtu kërkoj që të shikojë Qeveria nga ti shikon mundësitë apo me rishikim të Buxhetit apo përmes huamarrjes që këto projekte të realizohen nga viti i ardhshëm, të paktën, të fillojnë dhe të shohin qytetarët.

Do të ndalem edhe në disa rrugë më të vogla, në këtë rast, që nuk u bë rruga Gjakovë-Pejë, siç e thash edhe në fillim, është siç ka qenë para 20 vitesh, nuk u bë asnjë investim edhe mendoj që në këtë rast ministri i Infrastrukturës duhet ta ketë një projekt që është i lidhë dy regjione, që të shikon, ta kemi një projekt për vitin e ardhshëm edhe për këtë rrugë.

U tha edhe nga kolegët, kemi rrugë me interes të veçantë, siç u tha, edhe rruga që lidh Kralanin me Shqiponjën është 4 kilometra, ka qenë kërkesë në komunën e Gjakovës, por në pamundësi buxhetore nuk ka mund të realizohet. Është rruga që lidhë dy komunat Smolicë - Junik. Në buxhetin e Republikës së Kosovës këtë vit rruga është komplet 7 kilometra. Është Smolicë-Junik, kurse ne buxhet nga Juniku deri në Nivokaz është e përfshirë andaj mendoj që edhe për këtë vit ka mundësi ligjore e ta shikojë Qeveria apo Komisioni për Buxhet që edhe këtë kërkesë të komunës së Gjakovës dhe qytetarëve ta fus në Buxhet.

Unë si deputetë nuk e thash këtë në të përgjithshmen, do të konkretizoj, e kam një do ta kem një rekomandim për në mes dy leximeve do ta jap kontributin. Unë e mbështes Buxhetin në lexim të parë, por në lexim të dytë mendoj që duhet me pas disa plotësime ndryshime, sepse kështu konsideroj se nuk është një ndarje e mirë dhe duhet të bëhet një harmonizim më i mirë.

Në 28 fshatra të Rajonit të Rekës së Keqe në komunën e Gjakovës ka mbetur pa përfunduar projekti që ka filluar në 2009-ën në komunën e Gjakovës, do të thotë është për 28 fshatra është imediate. Projekti është realizuar 660 115 euro ndërsa pjesa tjetër është e pamundur të realizohet pa mbështetjen e Buxhetit të Republikës së Kosovës. do ta bëj një amendament sot dhe pres nga Komisioni për Buxhet dhe nga deputetët ta mbështesin këtë amendament. Ne e dimë se ka investime nga donatorët vitin e ardhshëm në komunën e Gjakovës në ujësjellës. Ky investim është investim në gypin apo në shtrirjen e rrjetit vertikal, kurse horizontal është CDI-ja dhe ne konsiderojmë nëse nuk i biem pas këtij projekti ta mbështetim këto 660 mijë euro janë çdo vit duke u amortizuar, sepse është projekt nga viti 2009 dhe dikush duhet të japë përgjegjësi, se o duhet projekti të vazhdojë o duhet ndërprerë dhe në këtë formë, unë në këtë rast pres nga të gjithë ju, kolegë të nderuar të pozitës dhe opozitës, ta mbështesni këtë amendament se është në interesin e 28 fshatrave, të cilët kanë dhënë shumë, edhe heronj, edhe dëshmorë, edhe martirë, për lirinë që ne sot e gëzojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Bekim Haxhiu. Pas tij flet Hatim Baxhaku.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Do të provoj të mos e zgjas, në veçanti të potencoj disa nga ato projekte që ne paraprakisht kemi votuar me projektbuxhetet e viteve të kaluara, në veçanti me projektbuxhetin apo plotësim ndryshimin e Buxhetit të vitit 2016.

Do të doja që sot këtu derisa po ngremë këto shqetësime të ishte ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe ministri i Shëndetësisë, të cilëve edhe u ndajmë mjete buxhetore, paraqesin kërkesa buxhetore dhe ne u ndajmë mjete, ndërsa ata ato mjete nuk i shfrytëzojnë.

Fillimisht, dua të kërkoj edhe llogaridhënie për mosimplementimi e projekteve dhe ndryshimin e tyre, në veçanti për largimin e disa projekteve, të cilat veçse u janë ndarë kodet buxhetore, siç është projekti për restaurimin dhe konservimin e shtëpive muze në Lagjen Jasharaj në Prekaz. Ne kemi ndarë projektbuxhetin për këtë projekt, ndërsa ministria për projektbuxhetin e vitit 2017 e ka larguar në tërësi dhe nuk është në tabelat buxhetore, prandaj kërkoj që i njëjti për vitin 2017 të futet si projekt për fillimin e restaurimit dhe konservimin e shtëpive muze në Lagjen Jasharaj me një shumë prej 150 mijë eurosh, që në tri vitet e ardhshme pastaj ky të jetë në vlerë së paku 1 400 000 euro.

Kërkoj gjithashtu nga administrata e Kuvendit, për shkak se jemi në procedurë të përshpejtuar në trajtim të projektbuxhetit, që të gjitha propozimet tona të merren edhe si amendamente, për arsye se koha është shumë e shkurtër, për t'i bërë ato ne dhe zyrtarisht, ndërsa të ketë mundësi Komisioni për Buxhet dhe Financa, që t'i trajtojë amendamentet dhe propozimet tona, që tani i bëjmë këtu në seancë.

Është shumë shqetësuese se si Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për dy vjet, vitin 2015 dhe 2016, ka pasur në dispozicion 1 200 000 euro për renovimin e Stadiumit Olimpik "Adem Jashari" dhe asnjë nga këto mjete nuk e ka shfrytëzuar. Përkundër asaj që ministria ka kërkuar nga institucionet përkatëse që të vazhdojë me procedura të përshpejtuara për investime në Stadiumin Olimpik "Adem Jashari", asnjë procedurë nuk është zhvilluar nga ministria përkatëse.

Edhe pse, inspektorët e UEFA-s në vizitën që bënë në maj të vitit 2016 dhanë 39 vërejtje për stadiumin "Adem Jashari" dhe bazuar në këtë inxhinierët e ministrisë dhe departamenti i infrastrukturës në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit hartoi projektin detaj për renovimin e Stadiumit Olimpik "Adem Jashari", prapëseprapë ministri Kujtim Shala, nuk ishte i interesuar që ta implementojë këtë projekt, prandaj ne u detyruam që të luajmë ndeshje ndërkombëtare jashtë Kosovës, të luajmë në Shqipëri dhe pritet që edhe vitin e ardhshëm të ndodhë e njëjta gjë, që ndeshjet ndërkombëtare të luhen. Përveç që ky projekt duhet të vazhdojë në vitin 2017 dhe për më keq, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit projektin e Stadiumit

Olimpik “Adem Jashari” e ka planifikuar që ta përfundojë në fund të vitit 2019. Pra, do të thotë ky projekt do të përfundojë në vitin 2019, atëherë kur do të përfundojnë kualifikimet për kampionatin botëror dhe kualifikimet për kampionatin evropian.

Kjo është jashtëzakonisht e papranueshme, tërësisht neglizhente dhe kërkon edhe përgjegjësi dhe llogaridhënie për ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe në veçanti për departamentin e sportit në kuadër të kësaj ministrie.

Gjithashtu, njëri nga projektet i cili ka qenë i planifikuar dhe nuk është trajtuar nga ministria dhe që ka pasur mjete të mjaftueshme për të, ka qenë projekti “Palestra” në Samadrexhë, të cilin e potencoi edhe deputetja Izmaqi dhe mendoj që edhe ky projekt duhet të planifikohet dhe të jetë pjesë e tabelave buxhetore për vitin 2017 dhe të përfundojë brenda vitit 2017, njësoj siç duhet të përfundojë edhe Stadiumi Olimpik “Adem Jashari” brenda vitit 2017, sepse është njëri nga stadiumet më për së afërti i vlerësuar nga instruktorët e UEFA-s, i cili mund të përgatitet për gara ndërkombëtare.

Gjithashtu, ngecjet në investime në dy rrugë, në rrugën magjistrale Prishtinë-Mitrovicë dhe rrugën Komoran-Klinë e Epërme është shqetësuese. Ne kemi miratuar në Kuvend edhe marrëveshjet me Bankën Islamike dhe me bankat tjera për huamarrje për investime në rrugën Prishtinë-Mitrovicë. Në vitin e ardhshëm ne do të fillojmë të paguajmë kamatat për këto hua, edhe pse kemi pasur periudhën trevjeçare të grejs-periudhës dhe brenda kësaj periudhe derisa po shkon dhe po shpenzohet koha e grejs-periudhës nuk ka filluar asnjë investim në këtë pjesë të rrugës për Mitrovicë-Prishtinë, prandaj kërkoj një angazhim më të theksuar të vetë Ministrisë së Infrastrukturës dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, që ky projekt të jetë bashkë me projektin për vazhdimin e rrugës Komoran-Klinë e Epërme.

Një shqetësim yni e jashtëzakonshëm është për buxhetin për shëndetësi. edhe pse është proklamuar në fillim të mandatit të kryeministrit Isa Mustafa, se shëndetësia do të jetë një nga prioritetet në bazë të buxhetit të ndarë për shëndetësi dhe menaxhimit të deritanishëm të këtij sektori, shihet se ne nuk kemi të bëjmë këtu me ndonjë prioritet.

Për shëndetësinë janë ndarë mjete më pak se sa vitet paraprake dhe buxheti që është planifikuar për shëndetësi nuk mjafton as për të realizuar synimet e as nevojat e qytetarëve. Edhe ky buxhet i cili ka qenë për vitin 2016 ka pasur mungesa dhe vërejtjet tona kanë qenë në diskutimin për Buxhetin e vitit 2016. Atëherë i kam thënë ministrit, që ndërhyrjen të cilën e ka bërë duke ia marrë buxhetin Qendrës Klinike Universitare, ka bërë një shkelje dhe pengesë në zhvillimin e shëndetësisë, prandaj këtë vit krahasuar me vitet tjera jo vetëm që kemi pasur mungesa nga barnat e listës esenciale, por këtë vit për herë të parë Shëndetësia Kosovare ballafaqohet edhe me mungesën e ushqimit për pacientët. Kjo nuk ka ndodhur në të kaluarën, kjo ka ndodhur vetëm

falë keqmenaxhimit të ministrit Imet Rrahmanit. Prandaj, kërkoj që vërtet të ketë një qasje më serioze, sa i përket shëndetësisë në Kosovë.

Është proklamuar dhe në fjalën e ministrit Avdullah Hoti, që këtë vit do të fillojmë me sigurime shëndetësore. Nuk duhet mashtruar qytetarët, sepse qytetarët presin vërtet që sigurimet shëndetësore t'i implementojmë. Duhet thënë qartë, këtë vit do të fillojmë me mbledhjen e premiumeve. Sigurime shëndetësore nuk do të ketë, as nuk janë me projektbuxhet e as që mund të implementohet, s'mund të ketë sigurime shëndetësore pa implementimin e SISH-it (Sistemet e Informimit Shëndetësor). Të gjithë ata që kanë vetëm pak njohuri për funksionimin e sistemit shëndetësor, për funksionimin e sigurimeve shëndetësore dhe për AFSH-në, atëherë e dinë se kjo është tërësisht e pamundshme. Do fillohet të mblidhen premiumet, por sigurime shëndetësore, në bazë të tabelave buxhetore, vështirë se do ketë edhe në vitin 2018. Prandaj, gjithsesi kërkoj një vëmendje më të mirë e në veçanti, një përgatitje, që të paktën në plotësim-ndryshimin e buxhetit për vitin 2017 atëherë të mendohet të aranzhohet kjo.

Përderisa, ministri apo Ministria e Shëndetësisë nuk arrin të implementojë sistemin e informimit shëndetësor, le të harrojmë se ne mund të kemi sigurime shëndetësore. Gjithashtu, buxheti për barëra apo për barërat nga lista esenciale do të thotë, është i pamjaftueshëm për të plotësuar nevojat dhe kërkesat e pacientëve e për më keq, edhe ky buxhet që ishte i planifikuar për vitin 2016 u keqmenaxhua nga Ministria e Shëndetësisë dhe ne kemi pasur barëra të cilat janë blerë me çmim edhe 12 herë më shtrenjtë se sa ai që është në tregun e lirë. Prandaj, kërkoj këtu një përgjegjësi më të madhe e në veçanti, një mbikëqyrje nga ana e kryeministrit për dikasterin, të cilin a ka përcaktuar prioritet, por që ministri, vartësi i tij, nuk është duke e trajtuar si të tillë.

Mendoj që brenda vitit 2017 duhet ndarë mjete për funksionimin e odave të mjekëve. Sipas Ligjit të odave të profesionistëve shëndetësorë ka qenë e planifikuar që tri vitet e para të funksionimit të odave të financohen nga buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë, nga buxheti i shtetit dhe brenda kësaj periudhe kohore të ndahen mjetet, të grumbullohen mjetet nga licencimet dhe rilicencimet për funksionimin e odave dhe tek këtë vit, Ministria e Shëndetësisë ka ndarë kodin buxhetor për odat e mjekëve, që mjetet e grumbulluara nga licencimet dhe rilicencimet t'u alokohen atyre.

Tani kanë ardhur në një situatë odat e profesionistëve shëndetësorë që ato janë para falimentimit dhe nëse nuk ka një përkrahje buxhetore për dy vitet e ardhshme ato edhe nuk do të mund të funksionojnë, sepse ajo që është dashur të bëhet nga Ministria e Financave dhe nga Ministria e Shëndetësisë për krijimin e fondit për funksionimin e odave të mjekëve nuk ka ndodhur. Prandaj, kërkoj që për vitin 2017 të gjitha odave, odës së mjekëve, stomatologëve, farmacistëve, fizioterapeutëve, infermierëve dhe mamive tu ndahen për vitin e parë nga 150 mijë euro dhe pastaj për vitin 2018 njëqindmijë dhe pastaj ato të kenë mundësi të funksionimit të tyre.

Përkundër kësaj, atëherë ne do të jemi në situatë që të gjitha odat e mjekëve, edhe pse është detyrim ligjor që ato të funksionojnë, do të jenë të detyruara që të pushojnë aktivitetin e tyre, ose të falimentojnë. Ndoshta, ky është edhe qëllimi i vetë Ministrisë së Shëndetësisë për shkak se shumica e kompetencave që janë në aspektin e organizimit, të funksionimit të odave të ndr...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Ti the shkurt, e përpara e ke dhjetë minuta, ja ku e ke atje kohën, zero e ke. Lexojeni orën vetë, ja ku e keni atje lart. Edhe një minutë!

BEKIM HAXHIU: Dhe, gjithsesi, edhe një nga shqetësimet tona është mungesa e investimeve në spitalin regjional të Prishtinës apo spitalin e Prishtinës. Unë e përgëzoj ministrin që ka pasur gatishmërinë të investojë në spitalin e Podujevës, edhe pse ka ndarë mjetet edhe për QKMF-në në Gjiilan, por gjithsesi ka qenë premtim elektoral i LDK-së, që do të ketë spitalin regjional të Prishtinës. Nëse ka menduar që ai të bartet në Podujevë, mendoj që është një politikë tërësisht e gabuar. Qytetarët e Prishtinës kanë nevojë për atë, prandaj le të fokusohemi te investimet dhe te një politikë shëndetësore shumë, shumë më e mirë.

Sa është buxheti, Arben, 2 miliardë a jo, e di më mirë vetë ministri i Financave, por nëse ti ke 2 miliardë euro e i ke marrë 300 milionë hua, atëherë sigurisht atë treqindmilionëshin ke me e kthye, prandaj është çështje e ministrit të Financave se si ka me ve....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Hatim Baxhaku e ka fjalën. Le të bëhet gati Shukri Buja.

HATIM BAXHAKU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Unë sinqerisht do të flas shumë pak, meqenëse edhe deputetët janë lodhur dhe janë shtjerrë të gjitha gjërat që ka qenë dashtë të diskutohen.

Unë do të prek vetëm dy çështje që mendoj se janë shumë të rëndësishme dhe nuk janë mbuluar me këtë projektligj, ndërsa ka të bëjë me çështjen e dy kategorive shumë të ndjeshme të qytetarëve.

Në këtë projektligj nuk është mbuluar implementimi i Ligjit për paraplegjikët dhe tetraplegjikët, prandaj meqenëse këtu edhe ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale është, mendoj se duhet të na japë një shpjegim se si është paraparë të zgjidhet kjo çështje.

Dhe e detyra, një pjesë e Ligjit për pensionet nga skemat e financuara nga shteti, pensionet invalidor dhe familjare po ashtu, në këtë projektligj nuk janë paraparë të mbulohen me buxhet.

Prandaj, kërkoj nga ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe ministri i Financave që ose të na japin një shpjegim, se si do të mbulohet kjo çështje, ose që të parashohin mjete shtesë, që kjo punë të zgjidhet.

Përndryshe, unë përkrah projektbuxhetin, do ta votoj dhe ftoj të gjithë deputetët që ta votojnë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Shukri Buja e ka fjalën, të përgatitet Abdyl Ymeri.

SHUKRI BUJA: I nderuar kryesues,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Diskutimi im do të duket sikur është diskutim në favor të opozitës, edhe pse opozita sigurisht do t'i gëzohet kësaj dhe do të mendojë se unë do t'i bëj konkurrencë zonjës Safete Hadërgjonaj për zëdhënese të opozitës, por s'është ashtu.

Unë do të diskutoj, për hir të qytetarëve, sepse dihet që opozita adutin kryesor për ta sulmuar, për ta atakuar, Qeverinë dhe pozitën e ka buxhetin dhe ju ishit të papërgatitur. Sot e treguat se jeni të papërgatitur për Buxhetin. Keni pasur diskutime tepër fragmentare, jo përmbajtjesore dhe po më vjen shumë keq që nuk jeni në nivelin e detyrës, si opozitë dhe nuk do të jem zëdhënësi juaj, por do të jem zëdhënësi i qytetarëve.

Më vjen keq, që një pjesë e deputetëve të pozitës të një partie politike i kënduan himne këtij buxheti e nuk është as për ndonjë këngë të mjerë t'i këndohet. Një pjesë e deputetëve kolegë të mi u lëshuat në projekte prej nga vini, projekte elektorale, pa e pasur parasysh se ky buxhet është me rrezik të na e çojë shtetin në shkatërrim.

Unë po i potencoj 5 çështje apo 5 të meta substanciale, që i ka ky buxhet:

1. Në formulimet juridike, të cilat janë në fillim të projektbuxhetit, formulime juridike të cilat kanë prerogativë politikë, neni 24 e kufizon buxhetin e veteranëve, nuk lejon rritjen e buxhetit të veteranëve, po duhet të mbetet në 38 milionë, do të thotë nuk lejon rritje fare.

Në paragrafin e dytë menjëherë e përjashton nenin 18 të Ligjit të veteranëve për t'i dhënë të drejtës vetvetes, përmes votës tonë, që të përcaktojë shumën e pensioneve, të cilat do të merren.

2. është rritja e buxhetit përmes huamarrjes, apo përmes rritjes së borxhit publik.

3. planifikimet në brendi të buxhetit ka shumë të pa adresuara dhe i bënë me qëllim që këto adresime t'ia lënë ministrave të linjës.

4. buxheti është buxhet i shpenzimeve rrjedhëse dhe jo i zhvillimit ekonomik.

5. buxheti është buxhet që nuk mbron shtetin e Kosovës dhe as nuk ka investime në sigurinë e qytetarëve të Kosovës.

Më lejoni, të nderuar deputetë, që secilën nga këto të meta substanciale t'i sqaroj veç e veç.

Te çështja e parë, që pak a shumë e shtjellova, të atakohet Ligji për veteranët e luftës me qëllim që të zvogëlohen pensionet e veteranëve, sepse 38 milionë janë të pamjaftueshëm për pensionet e veteranëve.

Ne po i quajmë pensione e ato, në fakt, nuk janë as ndihma sociale, sepse në Ligjin për veteranë, neni 18, po tentohet të hiqet, thuhet se nuk mund të jenë pensionet më të vogla se sa rroga minimale në Kosovë. Dhe ky nen tentohet të hiqet dhe të marrë kompetenca Qeveria për zvogëlimin pastaj të këtij fondi.

Në çështjen e dytë rritja e buxhetit përmes huamarrjes. 1 725 000 000 është buxheti real i të hyrave për buxhet, ndërsa rreth 300 000 000 janë të huamarrjes. Kur të rriten 300 000 000 e kemi parasysh edhe raportin e auditorit, i cili e jep se Kosova deri në vitin 2016 ka hyrë në borxh publik me 750 000 000 shtuar edhe 300 000 000 kalon në mbi 1 miliard borxh publik. Një miliard borxh publik i bie për kokë banori nga 500 euro në borxh. Për kokë banori - 500 euro borxh.

Në rast se kemi parasysh edhe një çështje tjetër, rrezikshmërinë që të fitohen kontestet në Gjykatën e Arbitrazhit, të cilat rrezikshmëri janë deri në 500 milionë, një miliard e gjysmë. Një miliard e gjysmë mund të jetë borxhi i Kosovës dhe ne me këtë trend jemi duke shkuar rrugës së shtetit të Greqisë, drejt falimentimit financiar të shtetit.

Nën 3, planifikimet e pa adresuara, po qe se shihni në brendi të buxhetit, e keni në Ministrinë e Industrisë një milion euro për zonat ekonomike në Kosovë. Fat i mirë që e kanë potencuar që janë në Kosovë e nuk ishin jashtë Kosovës, se përndryshe ish nënkuptuar athua janë në Kosovë a s'janë. Do të thotë, i kanë lënë mundësi ministrisë së linjës për t'i adresuar për shkaqe elektorale.

Kemi në Ministrinë e Infrastrukturës, po i marr disa shembuj, se ka shumë, në Ministrinë e Infrastrukturës thotë: "... asfaltimin e rrugëve të fshatrave të Gjilanit.", pastaj "...asfaltimin e

rrugëve të qytetit të Gjilanit.”, “...asfaltimin e rrugëve urbane dhe rurale të Vitisë, komunës së Vitisë.”, “...asfaltimin dhe ristrukturimin e rrugëve të komunës së Leposaviqit”, domethënë këto krejt janë të pa adresuara veç se dihet se ka me u shtrua asfalt, po ku, në cilin fshat, në cilën lagje apo në cilën rrugë nuk dihet.

Po ashtu, te çështja e katërt që po e shtroj, po e shkurtoj pak, buxheti është i shpenzimeve rrjedhëse e jo i investimeve apo i zhvillimit ekonomik. Në qoftë se, e shtrojmë në rrafshin e reales buxhetin e Kosovës del 1 725 000 000. Në investime kapitale kemi shtimin, që u tha vazhdimisht, 300 000 000 shtesë, këtu edhe është ai kamuflimi sepse 300 000 000 janë shtuar për investime kapitale dhe në rast se ne e qesim në rrafshin real, do ta shihni se investimet nuk janë me 46% për rritje ekonomike apo investim kapital, po do ta keni për paga dhe mëditje, se shpenzimet rrjedhëse janë paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, komunalit dhe subvencione dhe transfere. Paga dhe mëditje e keni 570 000 000 apo 30% të buxhetit, investime, subvencione dhe transfere i keni 470 000 000 apo rreth 27%, investime kapitale keni 26% apo 453 milionë, po siç u tha këtu, po qe se hiqen ato mbesin në 408 milionë, është përqindja edhe më e ulët, në mallra dhe shërbime 13% apo 197 000 000.

Do të thotë, ky është buxheti real dhe kur të shihet në përqindje del se është investimi më i vogël që ka ndodhur ndonjëherë në përqindje në investime kapitale dhe me këto investime kapitale ne nuk mund të ecim në zhvillim ekonomik, pavarësisht propagandës që thuhet, sepse në qoftë se përllogaritet del që diku 73% apo 74% buxheti i Kosovës është te shpenzimet rrjedhëse.

Prandaj, më lejoni në fund t’ju them, se ne si deputetë duhet ta kemi parasysh se jemi deputetë të Republikës së Kosovës dhe nuk guxojmë të rrezikojmë. Prandaj, duhet tu tregojmë qytetarëve se ky buxhet nuk është në të mirën e tyre, se ky buxhet nuk është për zhvillim ekonomik, se ky buxhet nuk është për mbrojtjen e shtetit të Kosovës, sepse nuk është investuar në mbrojtje, as në siguri, siç u tha edhe më herët. Dhe, ky buxhet nuk është në të mirën e zgjidhjes së çështjes së veteranëve të luftës, nuk është në të mirën e rritjes së pensioneve të tyre, por të zvogëlimit të tyre, prandaj kemi një rrugë, t’i bëjmë thirrje kryeministrit, që për hir të së mirës së qytetarëve të Kosovës ta tërheq këtë projektligj për rishqyrtim dhe ta rishqyrtojë brenda një dhjetëditëshi dhe ta rikthejë në parlament pastaj, në mënyrë që të mos na qesë në pozita të votimit dhe të na qesë në pozita të rënda për hir të qytetarëve.

Në rast se, nuk ndodh kjo nga kryeministri i Kosovës, atëherë të nderuar deputetë na mbetet rruga që ju, me votën tuaj, t’ia riktheni Qeverisë për rishqyrtim dhe ta rregullojmë këtë çështje pa e rrezikuar të mirën e qytetarëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, Abdyl Ameri e ka fjalën.

ABDYL YMERI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ligji për buxhetin është një prej ligjeve më të rëndësishme të shtetit, në të cilin Qeveria i planifikon shpenzimet e saj në vartësi të buxhetit që harton. Ajo programon se sa nga të ardhurat e saj do të shpenzohen për nevoja të ndryshme të shtetit.

Ky buxhet duhet t'i adresojë të gjitha kërkesat dhe nevojat që ka vendi, si dhe të jetë në harmoni me programin qeveritar. Po qe se shikohet struktura dhe përmbajtja e buxhetit në detaje, shihet se projeksionet e buxhetit apo përcaktimi i politikave buxhetore është i orientuar në disa fusha, ku më së tepërmi tek investimet kapitale shkojnë tek autostrada dhe asfaltimi i rrugëve.

Nga 2 miliardë euro të planifikuara, rreth 730 000 000 euro do të shkojnë në investime kapitale dhe kur rritja ekonomike është për këtë vit 4% ndërsa për vitin e ardhshëm 4,4%, që është në progres.

Parametrat tjerë ekonomikë po tregojnë se investimet në shumë fusha po mungojnë dhe investimet rrugore nuk janë i vetmi kriter që të tërheqin investitorët. Ne kemi pasur rënie të madhe të investimeve të huaja, të cilat janë të domosdoshme. Ne kemi investime dhe rritje ekonomike përmes investimeve kapitale të Qeverisë dhe kjo është e nevojshme, është e mirë, por kjo rritje ekonomike po të bëhet edhe përmes sektorëve të tjerë, do të ishte edhe më e mirë.

Unë konsideroj se institucionet qendrore dhe ato lokale, duke parë gjendjen në arsim, sidomos pas testit të PISA-s, pastaj gjendjen në shëndetësinë e Kosovës, është dashur të kemi një orientim më të madh të mjeteve në këta sektorë, si dhe në sektorë të mbrojtjes dhe sigurisë e po ashtu, në sektorët e drejtësisë dhe sidomos në sektorin e zhvillimit ekonomik, me qëllim të përmirësimit të gjendjes në këto fusha vitale për shoqërinë tonë.

Qytetarët tanë, përpos infrastrukturës rrugore kanë nevoja të tjera, që unë konsideroj se në fokus duhet të jetë zhvillimi ekonomik në ngritjen dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, me fuqizimin e sektorit privat dhe krijimin e parakushteve për vende të reja të punës, që janë aq të nevojshme për rininë tonë.

Projektbuxheti për vitin 2017 ka zgjuar kureshtjen më shumë se në vitet tjera, për faktin se është proklamuar një moment i ri i vlerës prej 2 miliardë euro, vlerë e synuar për shumë kohë. Për fillim dhe për secilin me interes duhet bërë të qartë, se vlera e të hyrave nuk është 2 miliardë. 2 miliardë euro janë shpenzimet e buxhetit në fjalë. Të hyrat për vitin në vijim pritet të jenë mbi 1,7 miliard. Diferenca ndërmjet të hyrave dhe të dalave Kosova këtë vit do t'i mbulojë përmes borxheve.

Ajo që është e rëndësishme në këtë projektbuxhet kemi rritje të kategorisë së të hyrave dhe rritje të kategorisë së investimeve kapitale. Koha apo kontratat për projektet kapitale duhet të kufizohen dhe kohëzgjatja e po ashtu, për ndarjen e buxhetit në mënyrë që të finalizohen sa më shpejt, sepse tek investimet kapitale, po qe se shikohen në tabelë shohim se kemi projekte që nga viti 2009. Unë konsideroj, se kësaj praktike duhet t'i jepet fund, sepse projekte të tilla me aq kohëzgjatje të papërfunduar mund të mos jenë edhe cilësore.

Këtu duhet t'i përmend disa projekte prej nga vij unë, si Palestrën Sportive që nga viti 2009, objektet shkollore Hamzë Jashari në Skenderaj, objekti shkollor Dëshmorët e Qavisë në Qirez, objekti shkollor Qubrelë dhe shpresoj që viti 2017 do të jetë viti kur do të përfundojnë këto projekte. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Naim Fetahu e ka fjalën.

NAIM FETAHU: I nderuar kryesues i Kuvendit,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Përpara kemi një projektbuxhet tejet ambicioz në vlerë prej 2 miliardë euro, kemi një buxhet zhvillimor, të cilin duhet të ndalemi dhe të zbërthejmë në pika të shkurta rreth të hyrave dhe shpenzimeve.

Të hyra të rregullta buxhetore për vitin 2017 janë planifikuar për 1 miliardë e 725 milionë euro, që tregon një rritje prej 5,7% në raport me buxhetin e vitit 2016. Pjesa tjetër implementimi i projekteve për vitin 2017 të parapara me financim përmes klauzolës për investime në shumë prej 105 milionë euro dhe përmes të hyrave të njehershme nga privatizimi dhe nga AKP-ja, në shumë prej 88 milionë eurove, si dhe huamarrja që e mbulon pjesën tjetër.

Në kuadër të të hyrave totale për vitin 2017, janë si në vijim:

- të hyra tatimore që pritet të realizohen në shumë prej 1 512 000 000, që tregon një rritje rreth 7% në krahasim me të hyrat e vitit 2016 dhe të hyrat jotatimore që mbeten të njëjta krahasuar me vitin 2016.

Struktura e të hyrave tatimore - të hyrat nga ATK-ja, janë planifikuar të rriten 9% në krahasim me 2016-ën, ndërsa të hyrat nga Dogana janë planifikuar të rriten 6,5% në krahasim me vitin 2016.

Shpenzimet sipas kategorive ekonomike, paga dhe mëditje, do të jenë 570 000 000, apo 3,8% më të larta se në vitin 2016 dhe në këtë përqindje mund të pritet edhe rritja e pagave.

Mallrat dhe shërbimet do të jenë 224 000 000, ose 8,2% më të larta se në vitin 2016.

Subvencionet dhe transferet do të jenë 474 000 000, ose 1,7% më të larta se në vitin 2016.

Shpenzimet kapitale do të jenë 723 000 000, ose 45% më të larta se në vitin 2016 dhe për këtë meriton të përgëzohet Qeveria për një veprim të tillë.

Kur jemi te buxheti për veteranë prej 38 000 000 euro, ne duhet të jemi të kujdesshëm dhe sot t'u themi qartë, e të mos bëjmë sikur bëmë vitin e kaluar, se këtë muaj do t'i paguajmë, muajin tjetër nuk e di si do të veprojmë, por t'u themi qartë veteranëve se do të kenë pagesa të qarta për vitin 2017.

Te buxheti i Ministrisë së Arsimit e Shkencës, buxheti i vitit 2017 nuk garanton ngritjen e cilësisë, sepse shuma e mjeteve të ndara për këtë ministri është më e ulët se sa ajo e vitit 2016. Dhe, si rrjedhojë, do të thotë, nuk garanton cilësinë.

E gjithashtu debatet për punëtorët e arsimit që i kemi bërë në këtë Kuvendit dhe të angazhuar para luftës do të mbeten vetëm debate boshe.

Dua të ndalem si anëtar i Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike edhe te shuma e mjeteve që është ndarë për Ministrinë e Ambientit, për shpronësime. Ministria e Ambientit i ka obligime të pakryera 145 000 000 euro, ndërsa për këtë ministri janë ndarë mjete për këtë qëllim vetëm 27 000 000 për vitin 2017.

Duke pasur parasysh edhe punën e përmbaruesve, ne rrezikojmë që kjo ministri të mbetet pa buxhet, andaj kemi kërkuar edhe nga Komisioni për Buxhet dhe Financa që ta ketë parasysh këtë çështje dhe unë mendoj që buxheti në përgjithësi meriton mbështetjen, me disa përjashtime. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Arben Gashi e ka fjalën, të bëhet gati Luljeta Veselaj-Gutaj.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Unë, në fakt, e kam vetëm një pyetje për ministrin e Punëve të Brendshme, e meqë s'është këtu, atëherë ministri i Financave mund të përgjigjet.

Në programin qeverisë të LDK-së, të propozuar në zgjedhjet e fundit, njëra ndër pikat kryesore ka qenë garantimi i sigurimit shëndetësor dhe jetësor për punonjësit e Policisë së Kosovës.

Meqenëse ky është buxheti i tretë, të cilin e aprovon Kuvendi i Kosovës nën udhëheqjen e LDK-së, pyetja është: Kur mendohet të bëhet siguri shëndetësor dhe jetësor për punonjësit e Policisë së Kosovës? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Gashi! Luljeta Veselaj-Gutaj, të përgatitet Nehat Baftiu.

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: Faleminderit, i nderuar kryesues i seancës!

Përshëndetje, të nderuar ministra,

Përshëndetje, i nderuar kabinet qeveritar,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Në analizën e bërë të Projektligjit për buxhetin të paraparë për vitin 2017 nuk kam vërejtur ndryshime nga vitet e kaluara dhe kam parë se nuk përmbushen kërkesat e qytetarëve të Republikës së Kosovës, ku pjesa më e madhe e kodeve janë të përshkruara nga vitet e kaluara.

Nuk do të zgjas shumë dhe do të përqendrohemi në fushën e arsimit parauniversitar, konkretisht në komunën e Prizrenit dhe në atë të Suharekës.

Meqë këtu e kemi edhe ministrin e Arsimit, dua të theksoj se edukimi i fëmijëve në mënyrë të institucionalizuar është bërë një ndër faktorët kyç të arritjes së cilësisë në arsim, prandaj dua të potencoj që kërkesat e mia janë të adresuara në Ministrinë e Arsimit dhe, e para ka të bëjë me investimet kapitale në arsimin parauniversitar, që ka të bëjë me ndërtimin e çerdheve, të kopshteve nga fondi IPA II.

I nderuar zoti ministër,

Më 24. 4. 2015 ju kam parashtruar pyetje parlamentare për t'i dhënë mbështetje ndërtimit të çerdheve e kopshteve në qytetin e Prizrenit, sepse nevojat dhe kërkesat për të pasur kopshte publike janë jashtëzakonisht të mëdha.

Ne e dimë se Prizreni është qyteti i dytë për nga numri i popullsisë dhe jemi pa asnjë kopsht publik. Edhe ndërtimi i një kopshti është minimumi i mbulimit të kërkesave të qytetarëve, por unë kërkoj që nga këto fonde IPA II të na jepni mbështetje, ashtu sikur jeni zotuar në Kuvend, që të ndërtohen së paku dy çerdhe apo kopshte publike në qytetin e Prizrenit.

Në këtë fushë falënderoj edhe kryetarin e Komisionit të Arsimit, zotin Nait Hasani, për mbështetjen, kolegun Nezir Çoçaj dhe të gjithë deputetët nga regjioni i Prizrenit.

E dyta, ka të bëjë me fushën e arsimit, prapë në arsimin parauniversitar në komunën e Suharekës. Pra, gjatë analizës së Projektligjit për buxhetin, te fusha e arsimit dhe shkencës në komunën e Suharekës nuk parashihet ndërtimi i shkollës fillore, si paralele e ndarë, në Reçan të Suharekës, ku shkolla është në një gjendje të mjerueshme, sepse të gjithë nxënësit e mësimdhënësit, e po ashtu edhe prindërit, kanë parashtruar kërkesë dhe kanë bërë shumë ankesa se gjendja e shkollës është e mjerueshme dhe ku pamundësohet dita-ditës procesi i mësimdhënies në këtë shkollë.

Në pikën e parë pres përgjigjen nga ministri i Arsimit, zoti Bajrami, kurse në pikën e dytë do të procedoj amendament në Komisionin për Buxhet e Financa dhe kërkoj mbështetjen e kolegëve deputetë që të kalojë ky amendament, e këta qytetarë të bëhen me shkollë të re. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Nehat Baftiu.

NEHAT BAFTIU: I nderuar kryesues,

I nderuar kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të nderuar,

Angazhimin tim politik e kam bërë vetëm me një qëllim që shëndetësia kosovare, publike, të ndryshojë.

Duke parë buxhetin për shëndetësi për vitin 2017 jam zhgënjyer dhe jam i bindur se edhe disa vjet nuk do të kemi përmirësime në shërbimet shëndetësore.

Prandaj, fjalimin tim po e filloj me disa fjalë të Steve Jobsit, në ditët e fundit të jetës së tij: “Arrita majat e suksesit në botën e biznesit. Në sy të tjerëve jeta ime ishte epitoma e suksesit. Në këtë moment, i shtrirë në shtrat, i sëmurë, ndërsa reflektoj për jetën time, kuptoj se e gjithë fama dhe pasuria që i kushtova kaq shumë kohë janë zbehur dhe duken të pakuptimta. Të mirat materiale mund të gjenden sërish, edhe pasi të kenë humbur. Por, ekziston diçka që nuk mund të gjendet kurrë, pasi e ke humbur”. Ai, Steve Jobs thotë jeta, ndërsa unë po them shëndeti.

“Kur një njeri shkon në sallën e operacionit, do të kuptojë se ekziston një libër që duhet të përfundojë së lexuari: Libri i jetës së shëndetshme dhe, në fund pyet, cili është shtrati më i shtrenjtë në botë?” Ndërsa unë habitem si ne edhe pas 16 vjetëve nuk e kuptojmë që shëndeti është mbi të gjitha, dhe asnjë qeveri deri sot nuk është marrë me të.

Asnjëherë këto vite të fundit prioritet nuk ka qenë shëndetësia. Pse? Nuk e kuptoj! Çka ka më të vlefshme se shëndeti?

Buxheti i planifikuar për shëndetësi në Kosovë për vitin 2017 nuk parasheh ngritje. Ky buxhet ka mbetur i njëjtë me vitin 2016. Kjo do të thotë se me buxhetin e ndarë për vitin e ardhshëm shëndetësia do të vazhdojë të përballet me shumë sfida, sikur edhe këtë vit.

Pra, nuk do të ketë rritje, edhe pse ishte thënë se shëndetësia do të jetë prioritet i Qeverisë. Po duket se nuk është ashtu.

Do të ishte normale që krahas rritjes së buxhetit si tërësi për vitin 2016 - 1 600 000,00 euro, për vitin 2017 - 2 000 000 000 euro të rritet edhe buxheti për shëndetësi, por kjo nuk po ndodh.

Totali i projekteve kapitale për vitin 2017 është 11 000 000 euro, ndërsa totali i projekteve kapitale për vitin 2016 ka qenë 12 470 000 euro, prandaj kjo tregon se kemi një zvogëlim të mjeteve të destinuara për projekte kapitale në Ministrinë e Shëndetësisë dhe ky është një tregues që jo vetëm shëndetësia nuk po trajtohet me prioritet, por realisht po neglizhohet.

Buxhetit për vitin 2017 i mungon qasja zhvillimore, qasja për përmirësimin e shërbimeve për trajtime të veçanta shëndetësore për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Nuk ka asnjë planifikim ose aktivitet që do të reflektojë në zvogëlimin e numrit të qytetarëve tanë që kërkojnë trajtim në vende të rajonit. Vetëm për 6 muajt e parë të vitit 2016 në Zyrën për trajtime mjekësore jashtë vendit kanë kërkuar ndihmë 960 persona, ndërsa 491 persona kanë marrë, do të thotë 341 000 euro.

Ne do të vazhdojmë të paguajmë një pjesë të shpenzimeve për mjekime jashtë vendit dhe të harxhojmë buxhetin edhe ashtu të varfër. Pra, ideja është që ne duhet të vazhdojmë të paguajmë shpenzime të mjekimit jashtë për ato sëmundje që nuk mund t'i trajtojmë në Kosovë, por në të njëjtën kohë, ne duhet të fillojmë të planifikojmë se si t'i rrisim kapacitetet këtu, si t'i bëjmë klinikat tona më të sofistikuara, si të furnizohemi me aparaturë dhe si t'i ngremë kapacitetet e stafit tonë për fushat që nuk i kemi, ose që janë deficit.

Këto çështje nuk i prek ky buxhet, prandaj mendoj se kjo do të duhej të rishikohet dhe bëhet ndarje e rritje graduale e buxhetit për këtë kategori, në mënyrë që të kemi tendencë të përmirësimit të shërbimeve specifike mjekësore në Kosovë.

Çështja tjetër shqetësuese është lista e barnave esenciale. Kjo listë me barna që nga paslufta asnjëherë nuk ka arritur të përmbushë nevojat e pacientëve 100%. Këtë vit kanë munguar 5 000 000 euro dhe, siç po shihet, me mungesë të barnave ne do të përballemi edhe vitin e ardhshëm. Mungesa e barnave ishte veçanërisht shqetësuese në Qendrën Emergjente dhe në mjekimin intensiv, si qendra terciare referente për tërë Kosovën, ku gjatë gjithë vitit ka pasur mungesë të barnave dhe materialit shpenzues, prandaj kjo duhet të rishikohet e të plotësohen kërkesat nga QKUK-të.

Një problem tjetër është edhe menaxhimi i buxhetit. Buxheti i shëndetësisë gjithsesi duhet të decentralizohet. Decentralizmi prej Ministrisë në QKUK, bile edhe nga QKUK-ja duhet të bëhet decentralizim i brendshëm, që secila klinikë të ketë buxhetin e vet dhe aty për aty t'i plotësojë nevojat e pacientëve. Kjo do të reflektonte në një shfrytëzim sa më racional të buxhetit, sepse do të blihen vetëm ato produkte të cilat konsiderohen të domosdoshme për funksionalizimin normal të institucioneve shëndetësore, në këtë rast të klinikave.

Sipas një njoftimi nga Banka Botërore del se shpenzimet totale shëndetësore dhe pjesa e buxhetit të Qeverisë së Kosovës që ndahet për shëndetësi janë relativisht të ulëta në krahasim me rajonin. Sipas tyre, ka shumë nevojë për rritje të shpenzimit publik për shëndetësi. Madje, në këtë raport thuhet se shpenzimet nga xhepi i qytetarit janë shumë më të larta dhe kjo kontribuon në varfërimin e tyre. Prandaj, ky buxhet duhet të rishikohet.

Është për t'u përshëndetur planifikimi për mbledhjen e premieeve nga Ligji për sigurimet shëndetësore, i cili do të mund të rriste buxhetin për vitin 2017, por kjo është njëherë përnjëherë vetëm planifikim dhe nuk ka asgjë të sigurt.

Komisioni ose personat të cilët kanë punuar në projektimin e buxhetit për shëndetësi...

Ju lus, a më lejoni të flas, apo?

Komisioni për përgatitjen e buxhetit me siguri se ose s'ka pasur asnjë të sëmurë në Qendrën Klinike Universitare, ose nuk e dinë çka është të jesh i sëmurë.

Po i referohem edhe një gjëje që këtu po diskutohet shumë. Fondi Monetar Ndërkombëtar e ka parë buxhetin për shëndetësi, sepse edhe spitali më i varfër te ta e ka këtë buxhet. Dhe, unë nuk e kuptoj Fondin Monetar se si na pengon për ta lënë shëndetësinë në këtë gjendje, edhe 16 vjet pas luftës.

Dhe, krejt e fundit, është se Odat e mjekëve po shuhen, buxhet nuk është ndarë, nuk di çka do të bëhet në të ardhmen. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Blerta Deliu-Kodra e ka fjalën.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, zoti Hamiti!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

U përmendën një pjesë e madhe e projekteve, megjithatë ne si deputetë mendoj që kemi obligim t'i prekim edhe disa projekte të komuniteteve të caktuara, meqë buxheti aktual nuk garanton gjithëpërfshirje dhe me të drejtë u përmend edhe çështja e veteranëve nga zoti Buja.

Mendoj se sfidë kyçe e këtij projektbuxheti do të jetë edhe çështja e pagave të veteranëve dhe ruajtja e dinjitetit të tyre. Besoj se kjo do të rregullohet dhe mendoj që Qeveria do të tregojë një vullnet më të mirë në këtë drejtim.

Po ashtu u përmend edhe çështja e sigurimeve shëndetësore te Policia e Kosovës. Mendoj se Policia e Kosovës mbetet njëri prej institucioneve të vetme thuaja në botë që ende s'ka sigurime

shëndetësore. Në anën tjetër, ne kemi pasur vazhdimisht reagime të sindikatave që kanë kërkuar të ketë sigurim shëndetësor për Policinë, sepse çdoherë e më shumë kemi rritje të rasteve të policëve të rënë në detyrë dhe mendoj që Qeveria duhet ta ketë prioritet në politikat e saj edhe këtë çështje.

Po ashtu mendoj që buxheti, sikur që e përmendi edhe kolegu im, Haxhiu, për rrugën Komoran-Skenderaj-Klinë, sepse është rrugë për të cilën fillimisht janë siguruar 18 000 000 dhe ky buxhet ka rënë së fundi në 5 000 000, mendoj që duhet t'i kushtohet prioritet dhe rëndësi nga Qeveria.

Një diskrepancë e madhe që është vërejtur, për të cilën ministri i Financave do të na sqarojë së fundi, ndërmjet komunave të caktuara, të cilat kanë përfutur buxhet nga niveli qendror dhe besoj se do ta kemi një ekspozë të fundit nga vetë ministri.

Projekti i furnizimit të ujit të pijes nga Mitrovica dhe Skenderaj është me interes jetik për banorët e këtyre dy komunave dhe besoj që edhe ky projekt do të duhej të përfshihej në këtë projektbuxhet.

U përmendën me të drejtë edhe investimet të çështja e shëndetësisë, listat esenciale të barnave, sepse vërtet shëndetësia ka pësuar, të them, një situatë tejet të rëndë. Kemi parë së fundi që kanë munguar në një pjesë të madhe edhe barnat esenciale, e po ashtu investimet do të duhej të orientoheshin edhe në departamente kryesore, në patologji, e pastaj të kemi edhe investime në radiologji, sepse parashihet të ketë investime në aparaturën e re për mamografi, si dhe sistemi i arkivimit të imazheve që do të duhej të jetë projekt shtesë nga Ministria e Shëndetësisë dhe të orientohet në këtë drejtim.

Çështja që dua ta ngre janë strehimoret. Kemi biseduar me ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Komunitat kanë nevojë të kenë një buxhet të destinuar për strehimoret në nivel vendi, sepse numri i rasteve të dhunës në familje po rritet dhe këto strehimore duhet të kenë një funksionalitet të veprimit të tyre.

Një orientim dhe një kërkesë që e kam marrë së fundi është ura në fshatin Grabovc të Poshtëm të Fushë-Kosovës që paraqet rrezik për jetën e banorëve, veçanërisht në kohën me shi, kur këta banorë rrezikohen kur kalojnë në këtë urë. Mendoj se edhe kjo do të duhej të trajtohej me seriozitet.

Po ashtu, edhe rrethrotullimi në Komoran. Mendoj se duhet të bëhet një riorganizim dhe të jetë i shfrytëzueshëm në mënyrë që ta ruajë edhe funksionalitetin e nyjës në Komoran dhe është jetik për ata banorë, për çka na është thënë dhe është kërkuar disa herë.

Nga ministri i Kulturës ndoshta një orientim pak më tepër te projektet kulturore dhe veçanërisht te komuniteti artistik, të cilët më kanë kërkuar që të kërkoj buxhet të destinuar enkas për projekte të tyre kinematografike dhe për projekte të dedikuara për art e kinematografi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Diskutuesja e fundit është deputetja Melihate Tërmkolli.

MELIHATE TËRMKOLLI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

S’e pata ndërmend të diskutoj, thënë të drejtën, por nganjëherë s’ke qare.

Do të flas shumë shkurt, vetëm për dy çështje, dhe ndoshta asnjë minutë s’do të zgjas.

Te shëndetësia! Po thoni që s’ka para mjaft. Unë po ju them, veç hiqni kriminelët, hiqni “llopovat” prej sistemit të shëndetësisë, para do të ketë mjaft.

Ata që e kanë sëmurë edhe shtetin, edhe popullin, hiqni. Dhe, para ka boll. Si t’i hiqni ata, para ka boll për shëndetësi.

Dhe e dyta. Veteranët! Na keni lodhur me veteranë! Të ashtuquajturit “veteranë”! Veteranë, na lodhët me hipokrizi! Hiqni të ashtuquajturit “veteranë” nga listat dhe hiqni të vetëshpallurit veteranë, dhe për veteranët e vërtetë, ata që përnjëmend janë veteranë, e të cilëve ua keni marrë bukën, para ka boll. Dhe, votojeni buxhetin!

KRYESUESI: Fisnik Ismajli e ka fjalën.

FISNIK ISMAJLI: Shkurt do të flas! Nuk kam përgatit fjalim. Është shumë e qartë dhe shihet sa herë që flitet buxheti, shumica e deputetëve flasin më shumë për të bërë fushatë se për të folur për problemet reale.

Po veç po dua t’ua rikujtoj të gjithëve, posaçërisht juve të mazhorancës. Vjet kur kam folur për çështjen e buxhetit, pata folur për teknologjinë informative dhe qysh e asgjë nuk është bërë dhe vazhdon të mos bëhet në këtë fushë sa i përket buxhetit. Shpresoj se ia keni nisur dhe jeni mësuar t’i shfletoni “ajfonët” pa e lëpi gishtin. Vjet veç sa i patët marrë disa “aifonë” të rinj, po shpresoj se sivjet veç ia keni nisur t’i përdorni, dhe shpresoj që tash e tutje do ta dini rëndësinë e teknologjisë informative më shumë se që e keni ditur më herët, edhe pse shpresa që ju ndonjëherë do të ndani buxhet për ta zhvilluar këtë fushë janë shumë të vogla.

Dua të shtoj edhe diçka, sa i përket numrit të njerëzve që kërkojnë shërim jashtë vendit. Unë si person që jam shumë aktiv në Facebook pothuaj se marr kërkesa të shumë qytetarëve, të cilët

kërkojnë për t'u shëruar jashtë vendit, pothuaj se çdo ditë. Njerëz, të cilët lëngojnë nga sëmundje prej më të ndryshmeve dhe të cilët kërkojnë shërim e nuk mund të gjejnë mjete në Kosovë.

Pra, po të ishit ju të hairit, moti kishit ditur të ndani buxhet për këta njerëz. Me krejt respektin për deputetët, për dy rastet e deputetëve që ishin, e u shëruan jashtë vendit, unë mendoj se ka qenë e padrejtë që është ndarë buxheti prej Qeverisë së Kosovës për ta ndihmuar shërimin e tyre dhe janë neglizhuar e injoruar shumë qytetarë të tjerë, të cilët ndoshta edhe kanë më shumë nevojë për këtë ndihmë. Faleminderit!

(Diskutim i dorëzuar me shkrim)

AGIM ALIU: I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuar kryeministër,

Ministra,

Të nderuar deputetë,

Pothuajse një ndër çështjet më të rëndësishme në kuadër të sistemit shtetëror të Republikës së Kosovës pa dyshim se është Ligji i buxhetit, të cilin sot po e trajton për miratim Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe gjithsesi, pa asnjë dyshim, besoj se trajtimi i tij do të bëhet nga ana e institucionit më të lartë legjislativ në mënyrë serioze, ashtu siç edhe është dashur të trajtohet edhe nga sponsorizuesi i tij, respektivisht Qeveria e Republikës së Kosovës.

Konstatimi im se do të duhej trajtuar seriozisht projektbuxheti nga ana e sponsorizuesit të saj ka bazë mbi faktet e vërtetuara në të dhënat e përshkruara në dokumentin të cilin e kemi para veti.

Do të dëshiroja që si deputet i Republikës së Kosovës të kam para veti projektbuxhetin, i cili në përmbajtjen e tij nuk do të kishte diferencën buxhetore në mes të kategorisë së të hyrave dhe shpenzimeve me 15,94%, apo përshkruar në vlerë buxhetore me 275 milionë euro, në favor të shpenzimeve (sqarim krahasues: në vitin që po e lëmë pas kjo diferencë negative ishte vetëm 6%). Pra, qysh sot ne po vërtetojmë një fakt tejet negativ dhe atë se Republika e Kosovës në vitin 2017 do të krijojë borxh saktësisht prej 275 milionë eurosh pa pasur garanci se ky borxh do të ndikojë në rritjen ekonomike.

Gjithsesi, të nderuar deputetë, do të dëshiroja që në kuadër të të hyrave, nënkategoria – tatimet direkte, të ketë vlerë të përafërt planifikuese, me vlerën e planifikuar të tatimit indirekt (akcizë dhe detyrime doganore), sepse vetëm atëherë kur kjo kuotë krahasimore është e përafërt apo në favor të tatimit direkt, do të vërtetojmë faktin se zhvillimi ekonomik ka shënuar rritjen e tij, komuniteti biznesor ka rritur kapacitetet, janë shtuar të ardhurat, është rritur punësimi, është ulur evazioni fiskal, etj. Por, realiteti tashmë i vërtetuar me këtë planifikim buxhetor po tregon të kundërtën. Pra, vlera e tatimit direkt (të ardhurat e korporatave) është planifikuar 84 milionë euro, ndërsa ato nga akciza 422 milionë euro. Pra, vetëm 4,87% në totalin e planifikuar të të hyrave ka pjesëmarrje tatimi direkt, ndërsa 31% tatimi indirekt, fatkeqësisht.

Sa i përket kategorisë buxhetore të shpenzimeve, konstatoj se shpërndarja e vlerës buxhetore nuk krijon përshtypjen se do të kemi rritje të mirëqenies qytetare dhe për këtë dua të jap vetëm një fakt. Shikoni se si është trajtuar në aspektin buxhetor shëndetësia, gjyqësori, arsimi, etj. Pra, nuk do të ketë fonde shtesë për fondin e sigurimeve shëndetësore, nuk do të ketë buxhet të rritur krahasuar me vitin 2016, i nevojshëm për të reformuar sistemin shëndetësor, duke pasur parasysh faktin se gjendja e shëndetësisë dëshmon atë se jemi larg asaj që e dëshiron qytetari ynë. Gjithashtu nuk po vërej zvogëlimin e kategorisë së mallrave dhe shërbimeve, sidomos në nënkategoritë buxhetore, të cilat “përfaqësojnë luksin qeveritar”.

Të nderuar deputetë,

Shpresoj se Ministria e Financave do t'i ketë në konsideratë të gjitha këto shqetësime në funksion të përmirësimit të planifikimeve buxhetore, në mënyrë që në leximin e dytë të Projektbuxhetit të mos kemi fare dilema për miratimin e tij. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri i Financave e ka fjalën.

MINISTRI AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Të nderuar deputetë,

I vlerësoj të gjitha komentet që u dhanë për buxhetin e vitit 2017. Mendoj se me një fakt pajtohem i të gjithë që buxheti i vitit 2017 është shumë më i ndryshëm nga buxheti i viteve paraprake.

Së pari, sepse e bëjmë një kapërcim të madh në totalin e shpenzimeve, dhe në veçanti një rritje e madhe në shpenzimet kapitale prej 46% krahasuar me këtë vit që po e lëmë pas, 2016 dhe 77% krahasuar me fillimin e mandatit të kësaj Qeverie dhe një buxhet që është i qëndrueshëm nga aspekti i të hyrave.

Unë dëgjova shumë komente sa i përket qëndrueshmërisë së të hyrave dhe mënyrën se si financohen këto shpenzime shtesë. Sepse rritja më e madhe e shpenzimeve mbulohet nga të hyrat e rregullta. Ne sot kemi 380 000 000 euro më shumë të hyra të rregullta tatimore për të mbuluar shpenzimet e mëdha prej 2 000 000 000 euro në këtë buxhet.

Në MASHT kemi 2 000 000 buxhet shtesë për arsimin, por cilësia në arsim nuk është problem i buxhetit. Është problem tjetër, të cilin besoj e diskutojmë herëve të tjera.

Tek borxhi publik, u diskutua gjerësisht. Kosova e ka borxhin më të vogël në regjion dhe më gjerë. Shqetësimi më i vogël për Qeverinë, për Ministrinë e Financave dhe për këtë shtet është sa i përket borxhit publik.

Ju e keni aprovuar klauzolën e investimeve në janar të këtij viti kur e kemi ndryshuar Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe tash kjo klauzolë mundëson që ne të hyjmë në hua ndërkombëtare me kushte shumë të volitshme për të financuar projekte për 30 vjetët e ardhshme, siç janë hekurudhat, sisteme e ujitjes së tokave bujqësore dhe të tjera.

Mirëpo, po ju them se, nga këndvështrimi i mënyrës se si po funksionojnë tash tregjet financiare, nuk ka moment më të rëndësishëm në dhjetë vjetët e fundit për të huazuar nga tregjet ndërkombëtare, me norma të interesit që shkojnë 0,5, 1% deri në 1,5%.

Në tre vjetët e fundit kemi negociuar me shumë kujdes çdo marrëveshje. Ju i keni ratifikuar ato dhe keni parë se çfarë norma të interesit kanë qenë para 3 vjetësh dhe çfarë janë sot.

Unë po ju them nga këndvështrimi i një ekonomisti që është momenti ideal për të hyrë në projekte të mëdha kapitale me këto norma të interesit, të cilat jemi duke i negociuar.

Dhe, për këtë, të themi shumë qartë, ka një gatishmëri të madhe të partnerëve tanë ndërkombëtarë, të bankave zhvillimore për të financuar projekte kapitale në Kosovë që nuk ka qenë situata sikur më përpara.

Rritja ekonomike, e keni parë në analizën makroekonomike që është pjesë e buxhetit. Kemi bërë një kapërcim komplet tjetër, sepse tash rritja ekonomike vjen nga sektori privat, nga politikat fiskale që nxisin zhvillimin e sektorit privat dhe në vitin e ardhshëm bëjmë kapërcimin tjetër. Investimet totale që ndodhin në ekonomi, pra publike dhe private, shkojnë në 2 000 000 000 euro, dhe këto do e rrisin ekonominë mbi 4%, siç është planifikuar.

Këtë buxhet mund ta quajmë si të doni, por ky buxhet e stabilizon rritjen dhe e siguron përfundimisht një minimum të rritjes ekonomike prej 4%, me potenciale të rritjes më të mëdha, varësisht prej projekteve të mëdha zhvillimore që mund të fillojnë.

Merrni shifrat. Prodhimi vendor po rritet, pavarësisht problemeve të mëdha që kemi në deficitin tregtar të vendit.

Punësimi po rritet. Merrni shifrat e Trustit Pensional, ku keni mbi 18 000 veta që janë kontribues të rinj në Trustin Pensional gjatë këtij viti.

Të hyrat doganore janë të larta, sepse ne TVSH-në ende po e mbledhim në kufi. Po punojmë shumë në krijimin e kapaciteteve vendore të Administratës Tatimore për të filluar mbledhjen e TVSH-së brenda dhe hapi i parë është krijimi i Agjencisë së përbashkët të hyrave. Ligji është gati dhe shpresoj shpejt do të silltet në Kuvend për të themeluar këtë agjenci dhe për të ngritur sistemin që ne të kalojmë në mbledhjen e TVSH-së brenda vendit.

Mjetet e AKP-së janë rreth 500 000 000 euro që rrinë në Bankën Qendrore të Kosovës.

Unë mendoj që ju duhet të pyesni pse vetëm 88 000 000 i kemi paraparë në këtë buxhet? Pse jo 200, ose 300? E të sigurohemi se të gjitha këto shkojnë vetëm për projekte kapitale, të cilën gjë jemi duke e bërë.

Tek projeksioni i të hyrave: Ky është buxheti më i qëndrueshëm që është aprovuar ndonjëherë në vitet e fundit. Ju e keni parë se në qershor të këtij viti, kur e kemi bërë rishikimin e buxhetit, e kemi rritur projeksionin e të hyrave. Vjet e kemi tejkaluar projeksionin, sivjet gjithashtu e tejkalojmë projeksionin edhe me rritjen e parashikimit që ka ndodhur në qershor me rastin e rishikimit të buxhetit.

Unë thënë të drejtën, nganjëherë çuditëm pse kritikohet buxheti prej 2 000 000 000 dhe pse nuk është ky buxhet 2,5 ose 3 miliardë euro.

Pajtohem se Kosova nuk është parajsë. Është vend në zhvillim. Me plot sfida për të luftuar informalitetin, keqpërdorimet, korrupsionin, me plot sfida për të kthyer borxhet nëpër komuna tash e sa vjet që janë krijuar. Por, është vend me trende pozitive, edhe të rritjes ekonomike, edhe të punësimit.

E ka shportën e konsumatorit më të lirë në 3 vjetët e fundit, me inflacion zero dhe përveç kësaj, për shkak të lirimeve të mëdha që kemi bërë, për shkak të zvogëlimit të TVSH-së nga 16 në 8% për të gjitha shërbimet publike. Në fund të vitit do i keni të dhënat publike që për energji, për ujë dhe për shërbime të tjera publike qytetarët e Kosovës kanë paguar 23 000 000 euro më pak se sa vitin e kaluar.

Nuk ka asnjë presion për rritje të taksave. Pra, buxheti prej 2 000 000 000 nuk e rrit ngarkesën për qytetarët dhe për biznes. S'ka presion për rritje të taksave. Ky buxhet vjen prej rritjes së të hyrave të rregullta, luftimit të informalitetit.

380 000 000 kemi mbledhur më shumë. Rritje ekonomike kemi pasur vetëm 4%. Ka hapësirë për dyfishim të kësaj me mekanizmat që po krijohen në ekonomi.

Ky buxhet është përgatitur me transparencën maksimale të mundshme. Prej prillit e këndej kemi pasur diskutime me të gjitha grupet e interesit. Për herë të parë sivjet edhe me shoqërinë civile kemi kryer diskutime për kornizën buxhetore.

Tash, ashtu si e keni në Projektligjin e buxhetit, shpresoj se do të aprovohet përfundimisht, është planifikuar niveli pesëshifror i Buxhetit, që na mundëson, ju mundëson juve deputetëve që t'i mbikëqyrni shpenzimet që i bën ekzekutivi deri në detale.

Është vendosur një standard shumë i mirë që në baza mujore raportohet nga Ministria e Financave në Qeverinë e Kosovës për shpenzime të secilës organizatë buxhetore. Tash me këtë planifikim pesëshifror do të kemi mundësi të shkojmë në detale se ku po shpenzohen dhe si po shpenzohen taksat e qytetarëve të Kosovës.

Të mos e keni asnjë dyshim se Dogana e Kosovës parashikimin që e ka prej 1 108 000 000 për vitin e ardhshëm do ta arrijë ta realizojë pa asnjë problem. Dhe në këtë 1 108 000 000 është paraparë edhe lirimi që vjen si rezultat i zbatimit të MSA-s.

Po të mos ishte MSA-ja, ne do kishim planifikuar 1,3 miliardë euro nga Dogana e Kosovës.

Struktura e buxhetit është përmirësuar jashtëzakonisht shumë me rritjen e investimeve kapitale. Më përpara ka qenë 72% e shpenzimeve rrjedhëse, tani është 62%. Pjesa tjetër prej 28 në 36 janë shpenzime kapitale që do të jenë në vitin 2017.

Sigurimi shëndetësor: Përfundimisht janë ndarë 17 000 000 për 80 000 veta që janë brenda sektorit publik, përfshirë edhe Policinë e Kosovës.

Më lejoni të them se shpërndarjet e investimeve nëpër sektorë të ndryshëm, nëpër komuna, janë përgjegjësi e ministrave përkatës, në bazë të strategjive përkatëse sektoriale dhe nevojave që ka secila komunë.

Ju falënderoj edhe një herë për të gjitha komentet që i dhatë dhe ju ftoj ta aprovoni këtë projektbuxhet.

(Ndërprerje)

KRYESUESI: Të nderuar deputetë, në sallë i kemi 93 deputetë.

Lus teknikën dhe deputetët të bëhen gati për të votuar.

Tash do të votojmë për miratimin në parim të Projektligjit për Buxhetin e Kosovës për vitin 2017 dhe votojmë tash:

Kanë marrë pjesë në votim 93 deputetë. Dhe, ju që jeni pa kartela votoni për, çka jeni? Jeni 3 për.

Do të thotë 93 deputetë votojnë. Për janë 73, kundër janë 20 dhe 0 abstenim.

Pra, konstatoj se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017.

Faleminderit! Sipas votimit të mëhershëm, sonte do të jetë leximi i dytë i këtij projektligji.

Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e tjera të përhershme që në orën 21:00 të takohemi për të vazhduar punën. Faleminderit!

Për pikat e mbetura do të vazhdojmë nesër, para diskutimit për kufirin.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 22 dhjetor
Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti

KRYESUESI: Të nderuar deputetë!

I hap punimet për vazhdimin e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e filluar më 22 dhjetor 2016.

Fillojmë me pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shërbime

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Procedimi i mëtejshëm është si vijon: së pari Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, pastaj zoti Berisha dhe grupet parlamentare, sipas radhës. Zonja ministre Hykmete Bajrami e keni fjalën.

MINISTRJA HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që në emër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, si sponsorizuese e këtij ligji, të paraqes shkurtimisht arsyen dhe rëndësinë për fushën e rregullimit dhe përmbajtjen e Projektligjit për shërbimet.

Bazuar në nevojën për modernizimin e sektorit të shërbimeve, sektor ky i cili i vetmi ka bilanc tregtar pozitiv, duke marrë parasysh që në vitin 2015 kemi pasur 777 milionë eksport të shërbimeve, ndërkohë që importet kanë qenë vetëm 334 milionë dhe me qëllim të fuqizimit të këtij sektori më tutje për të nxitur zhvillimin ekonomik dhe për të eliminuar barrierat ekzistuese ligjore dhe administrative për ofruesit e shërbimeve, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka hartuar dhe sot para jush propozon Projektligjin për shërbimet.

Arsyeshmëria për këtë ligj është se ky ligj përcakton parimet themelore dhe kriteret të cilat mundësojnë të drejtën e themelimit dhe ushtrimit të aktivitetit të ofruesit të shërbimeve në Republikën e Kosovës, duke garantuar cilësi të lartë të shërbimeve për përfituesit e tyre.

Ky ligj ndihmon eliminimin e barrierave ligjore dhe administrative për ofruesit e shërbimeve. Gjithashtu plotëson një standard të kërkuar nga BE-ja dhe eliminon edhe një pengesë tjetër drejt integritetit të Kosovës në Bashkimin Evropian. Gjithashtu liberalizon tregun në fushën e shërbimeve edhe me vendet e rajonit.

Thjeshtësimi i masave që parashihen në këtë ligj do të bëjë jetën dukshëm më të lehtë për ofruesit e shërbimeve dhe do të rrisë transparencën e bizneseve dhe konsumatorët kur ata ofrojnë dhe përdorin shërbimet.

Rezultati kryesor i arritur me miratimin e këtij ligji pos kompletimit të legjislacionit të sferës së shërbimeve në Kosovë dhe plotësimit të njëres prej kërkesave të procesit të integrimi evropiane është se do të plotësohen edhe kërkesat e tjera, të cilat vijnë nga sektori i bizneseve që merren me ofrimin e shërbimeve në sektorin e ekonomisë.

Projektligji është hartuar në përputhje me procedurat e parapara me Rregulloren e Qeverisë, është marrë deklarata financiare nga Ministria e Financave, deklarata e pajtueshmërisë me legjislacionin e BE-së nga Ministria e Integrimi Evropiane dhe projektligji është komplet i harmonizuar me ‘acquis communautaire’ e BE-së.

Nëpërmjet miratimit të këtij ligji, kjo fushë do të rregullohet sipas praktikave dhe standardeve më të avancuara të BE-së, mirëpo miratimi gjithashtu do të ndikojë edhe te një numër i madh i akteve legjislative, të cilat pas miratimit të këtij ligji duhet të ndryshohen dhe të plotësohen.

Të gjitha këto veprime legjislative duhet të ndërmerren në mënyrë që të përmbushim obligimet e Republikës së Kosovës. të parapara në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit.

Unë, duke pasur parasysh rëndësinë e këtij projektligji edhe për procesin e integrimi, por edhe për operatorët ekonomikë të cilët ofrojnë shërbime sot, ju lus që ta shqyrtoni dhe ta miratoni në këtë seancë dhe gjithashtu pres që me amendamentet tuaja ta pasuroni dhe ta përmirësoni këtë draft të ligjit edhe më tutje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Hap diskutimin e debatit në parim për projektligjin, zoti Rustem Berisha, në emër të Komisionit Funkcional e ka fjalën.

RRUSTEM BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj se Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë Tregti dhe Industri, në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 6 dhjetor të vitit 2016 shqyrtoi në parim Projektligjin nr. 05/L-130 për shërbime.

Me këtë projektligj përcaktohen parimet themelore dhe kriteret që mundësojnë të drejtën e themelimit dhe ushtrimit të aktivitetit për ofruesit e shërbimeve në Republikën e Kosovës, duke garantuar cilësi të lartë të shërbimeve për përfituesit e tyre.

Gjithashtu parashihen modalitetet për thjeshtim të procedurave administrative si dhe krijimin e pikës së vetme të kontaktit që është me rëndësi të veçantë.

Komisioni në mbledhjen e tij gjatë diskutimit në parim pati propozime që të rishikohet arsyeshmëria e theksimit të sektorëve dhe shërbimeve që rregullohen me këtë ligj. Në vend të sektorëve që përjashtohen, sepse është një numër i madh i sektorëve të shërbimeve që përjashtohen me këtë ligj.

Gjithashtu u theksua nevoja që të përkufizohet pika e vetme e kontaktit, pra neni 14 i këtij ligji.

Komisioni kërkon nga Qeveria që në të ardhmen brenda Memorandumit shpjegues që shoqëron projektligjin të ketë një përshkrim të kontekstit që adreson projektligji, në mënyrë që fushëveprimi i projektligjit të bëhet sa më i qartë.

Andaj të nderuar deputetë,

Në bazë të lartcekurave komisioni njëzëri vendosi që Kuvendit t'i rekomandojë miratimin në parim të Projektligjit nr. 05/L-130 për shërbime, ndërsa në mes të dy leximeve do t'i evitojë vërejtjet e theksuar më lart dhe nëpërmjet amendamenteve të komisionit, pra amendamenteve konkrete. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, fjalën e ka zonja Shala-Berisha.

SALA SHALA-BERISHA: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje për dy ministrat,

Të nderuar kolegë deputetë,

Dhe ju të pranishëm,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka analizuar me vëmendje Projektligjin për shërbimet dhe mendon se hartimi i tij ka për qëllim të përcaktojë parimet themelore dhe kriteret që mundësojnë të drejtën e themelimit dhe ushtrimit të aktivitetit për ofruesit e shërbimeve në Republikën e Kosovës, duke garantuar cilësi të lartë të shërbimeve për përfituesit e tyre.

Gjithashtu në këtë projektligj parashihen modalitetet për thjeshtim të procedurave administrative, si dhe krijimi i pikës së vetme të kontaktit, që është shumë me rëndësi.

Hartimi i këtij projektligji është bazuar në nevojën për modernizimin e sektorit të shërbimeve në Kosovë, me qëllim të furnizimit të Sektorit të Shërbimeve në Kosovë për të nxitur zhvillimin ekonomik, duke eliminuar barrierat ligjore dhe administrative për ofruesit e shërbimeve.

Kështu që ky projektligj radhitet një ndër prioritetet e Qeverisë së Kosovës dhe rregullohet, mbrohet dhe zbatohet në dobi dhe të mirën e interesit publik.

Ligji për shërbime merr në konsideratë vënien e kufizimeve të lejuara deri në masën e ruajtjes së ofruesve vendorë të shërbimeve. Në këtë kuadër është marrë parasysh edhe rreziku nga rritja e konkurrencës për ofruesit vendorë të shërbimeve si dhe masave të tjera për forcimin e tregut vendor të ofrimit të shërbimeve.

Krejt në fund Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e mbështet këtë projektligj dhe kontributin e vet do ta japë gjatë fazës së amendamentimit. Ju ftoj ta miratoni të gjithë, kolegë deputetë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, a e do dikush fjalën? S’e ka kërkuar askush. Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, a dëshironi të deklaroheni për ligjin, zoti Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Po, unë bëj pjesë edhe në komisionin ku e kemi shqyrtuar këtë projektligj dhe aty është ngritur edhe diskutimi që të shndërrohet në një lloj të praktikës standarde të komunikimit mes atyre që janë sponsorizues të ligjeve, në këtë rast Qeveria e Republikës së Kosovës edhe prezantimi i ligjeve përpara komisionit.

Neve na ka ngjallur disa probleme për shkak që nuk praktikohet të ketë informacion bazik paraprak për ligjet për fushën që e mbulojnë ato dhe analizë të qartë të gjendjes ekzistuese të asaj fushe.

Për shembull, neve na duhet të dimë më shumë si deputetë se cila është gjendja e fushës së shërbimeve të caktuara në Kosovë? Cila është struktura e shërbimeve? Pastaj çfarë aplikueshmërie ka ligji, cilat janë kufijtë e aplikimit të ligjit nëpër fusha të ndryshme dhe vetëm pastaj mund të kontribuojmë më mirë në shqyrtimin e ligjeve edhe nëpër komisione.

Kur e kemi shqyrtuar këtë projektligj dhe kur e kemi diskutuar këtë çështje janë pajtuar edhe propozuesit lidhur me instalimin e këtyre praktikave në formë të standardizimit të këtyre praktikave dhe jemi pajtuar që herëve të tjera Qeveria të jetë më e kujdesshme në kuptimin e përpilimit të një farë skanimit të gjendjes, le të themi, për fushat të cilat i mbulon ligji në fjalë, e kjo nuk ka ndodhur.

E dyta është, sa i përket emërtimeve. Unë e kam edhe këtë problem. Për shembull, nuk mund ta gjeni në Bashkimin Evropian një ligj me emër të tillë. Për shembull, ju do të jeni shumë më të kujdesshëm në kuptimin e specifikacioneve, domethënë nuk mund të ketë Ligj për shërbime, thjesht Ligj për shërbime. Shërbimet janë njëqind mijë llojesh, ai që i ofron shërbimet mund të

jenë institucione të llojeve të ndryshme dhe karakteri i shërbimeve duhet të përshkruhet me emër ligj. Për shembull, unë po e lexoj këtu. Ne sot do ta miratojmë Projektligjin 05/L-130 për shërbime. Kjo është shumë universale, shumë e gjeneralizuar. Shërbimet, të cilat ofrohen, duhet ta kenë një emër dhe në ligj me emër të përshkruhen edhe institucionet që do t'i ofrojnë këto shërbime, për shembull, kush do t'i ofrojë këto shërbimet, të ceket me emrin e ligjit, emri i ligjit është shumë i rëndësishëm. Nuk mund ta lëmë të papërcaktuar emrin e ligjit, sepse shkakton konfuzion, qoftë edhe për dikë, për shembull, një të huaj i cili do të vijë nga jashtë, hyn në legjislacionin e Kosovës edhe për nevojat e veta e kërkon këtë ligjin në fjalë. A besoni që nuk do të mund ta gjejë këtë ligj, sepse ne ia kemi lënë ligjit emrin universal dhe më të papërcaktueshëm të mundshëm. Domethënë emri duhet të jetë më i gjatë, duhet të specifikohet për çfarë lloje të shërbimeve po flitet dhe duhet të thuhet se kush është ai që do t'i afrojnë këto shërbime.

Pra, në këtë aspekt janë vërejtjet tona, kurse sa i përket shqyrtimit edhe plotësimit me amendamente, ne do ta japim kontributin tonë kur ai të shqyrtohet deri në lexim të dytë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Berisha, në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, e ka fjalën.

ALI BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Ne si Aleancë e kemi shqyrtuar ligjin dhe në parim do ta përkrahim, ndërsa kontributin tonë do ta japim ndërmjet dy leximeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bajrami, në emër të "Nismës", e ka fjalën.

VALDETE BAJRAMI: Faleminderit, zoti kryesues!

Po ashtu edhe "Nisma për Kosovën" do ta përkrahë në parim shqyrtimin e parë të Projektligjit nr. 05/L-130 për shërbime, po ashtu edhe ne i kemi disa vërejtje tona që nga emërtimi i këtij ligji dhe çështje të tjera.

Mirëpo kontributin tonë do ta japim në leximin e dytë. Faleminderit!

KRYESUESI: Lista serbe, nuk dëshiron fjalën. Grupi Parlamentar "6+", as këta nuk dëshirojnë. Atëherë konsideroj që tjerë të paraqitur nuk ka.

Fjalën e ka përfaqësuesja e Qeverisë ose përfaqësuesi i Qeverisë, nëse dëshiron. Nuk e dëshiron ministrja fjalën.

Atëherë po hyjmë në votim. Prej nesh kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të projektligjit. Në sallë janë 63 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Le të lajmërohet kush nuk ka kartelë, 4 veta janë pa kartelë. Edhe një herë e përsëris votimin me elektronikë. Ju lus që të votoni për ose kundër. Në sallë janë 66 deputetë.

Atëherë lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani. Pa kartelë kush është, 1, 2, jeni për. Në rregull. 63 vetë kanë votuar, 2 pa kartelë. Kemi 60 vota me elektronikë, 2 pa kartelë, bëjnë 62 vota për. Konsideroj që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për shërbimet.

Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndihmën shtetërore

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, zotin Osmani, që të paraqesë dhe ta arsyetojë raportin me rekomandime. Atëherë zonja Safete Hadërgjonaj, si zëvendësuese.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për ndihmën shtetërore, në disa takime të mbajtura, ku kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Financave dhe të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, të cilët kanë ofruar sqarime të kërkuara.

Komisioni, pas shqyrtimit të projektligjit ka vlerësuar të nevojshme që të bëhen disa ndryshime të plotësime dhe si rezultat ka propozua 26 amendamente.

Përveç rregullimeve të aspektit formal-juridik, atyre gjuhësore dhe teknike, ndryshimet përmbajtjesore janë:

Në paragrafin 1, të nenit 2 është riformuluar për të përcaktuar nivelin e përputhshmërisë së projektligjit me Rregulloren e Bashkimit Evropian në harmoni me deklaratën e Ministrisë së Integrimit Evropian.

Në amendamentin 8 që i referohet plotësimeve të paragrafit 3 të nenit 8, paragrafi 3 është propozuar që të shtohet teksti “si dhe masat e duhura për evitimin e konfliktit të interesit”. Me këtë plotësim bëhet një harmonizim i këtij projektligji.

Tek paragrafi 8.3, me nenin 9.6, respektivisht nenit 25.4, ku parashihen masat për evitimin e konfliktit të interesit me rastin e organizimit të brendshëm dhe sistematizimit të vendeve të punës për zyrat e Departamentit për Ndihmë Shtetërore dhe të Komisionit për Ndihmë Shtetërore.

Ky ka qenë një propozim i Zyrës së Bashkimit Evropian që është përkrahur nga Komisioni.

Me amendamentin 17, në çështjen që ka të bëjë me interpretimin dhe zbatimin e legjislacionit evropian të energjisë, që ndërlidhet me ndihmën shtetërore, është përcaktuar afati kohor prej 5 ditësh, ku departamenti njofton Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë në formë të shkruar.

Neni 17 është propozuar që të fshihet, pasi mënyra se si është rregulluar në projektligj bie në kundërshtim me nenin 16 dhe krijon konfuzion për shkak të mundësisë së autorizimit të ndihmës shtetërore, e cila paraprakisht është revokuar për shkak të mospërbushjes së kushteve ligjore të parapara me ligj.

Ndryshime ka edhe në nenin 25, ku në dispozita kalimtare është shkurtuar afati i funksionimit të Komisionit për Ndihmë Shtetërore me përbërje të përkohshme deri në fund të vitit 2017. Ndërsa, pas kësaj date Komisioni për Ndihmë Shtetërore përbëhet nga ekspertë të pavarur që zgjidhen nga Kuvendi.

I nderuar nënkryetar,

Kërkoj që të bëhet edhe përmirësimi i një lëshimi teknik, pasi që në tabelën e raportit të komisionit mungon neni i fundit i projektligjit që ka të bëjë me hyrjen në fuqi të ligjit. Nuk është asnjë ndryshim në këtë nen, përveç se është harruar që të bartet në tabelën e raportit. Në versionin në gjuhën serbe është në rregull, kurse në versionin në gjuhën shqipe duhet të rregullohet.

Pra, kërkojmë që me rastin e votimit të projektligjit në tërësi pjesë e votimit të konsiderohet edhe neni 26, me radhë si vijon. Neni 24, ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Pra, vetëm duhet të bëhet përshkrimi i këtij neni, sepse në gjuhën shqipe nuk është i përfshirë, është bërë një gabim teknik.

Komisioni për Buxhet dhe Financa u rekomandon deputetëve që t’i votojnë këto plotësime-ndryshime, të cilat janë bërë në projektligj dhe rekomandimet e Komisionit për Buxhet të miratohen.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë votojmë amendamentet sipas radhës. Janë të gjitha amendamentet që janë miratuar në Komisionin FunkSIONAL.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 12

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 13

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 14

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 15

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 16

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 17

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 18

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 19

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 20

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 21

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 22

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 23

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 24

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 25

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 26

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Në sallë janë 73 deputetë. Kuptohet edhe vërejtjet që i tha deputetja Hadërgjonaj, nënkryetare e komisionit.

Për vëmendje, ju lus që ta keni parasysh që duhet të votoni, për ose kundër. Atëherë, unë edhe një herë po e nxjerr, pot duhet të pyes edhe kush është pa kartelë.

Votojmë tash! Kush është pa kartelë? A jeni për, a kundër? 3 pa kartelë janë për.

Kanë votuar 64 vetë me kartelë, 3 pa kartelë, bëjnë 67. Për kanë votuar 57, me kartelë plus 3, gjithsej 60 deputetë. Kundër 5 dhe 2 abstenime.

Konstatohet që Kuvendi e miratoi Ligjin për ndihmën shtetërore.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për fondet pensionale të Kosovës

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj prapë zonjën Hadërgjonaj në emër të komisionit që ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin me rekomandime.

SAFETE HADËRGJONAJ: Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Projektligjin nr. 05/L-116 për ndryshimin e Ligjit për fondet pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115, dhe Ligjin nr. 04/L-168 në disa takime të rregullta, ku kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Financave dhe Fondit Pensional të Kosovës, të cilët kanë ofruar sqarime të nevojshme për çështjet e ngritura.

Komisioni i ka propozuar 10 amendamente, përveç rregullimit të aspektit formalo-juridik, atij gjuhësor dhe teknik, ndryshimet përmbajtjesore konsiderohen në nenin 2, paragrafi 1. Ndryshimi i propozuar ka të bëjë me atë që anëtarët e bordit emërohen për mandat të plotë dhe si rrjedhojë në rast të emërimit të një anëtarit që do ta zëvendësonte pozitën e anëtarit që largohet për rrethanat e parapara me ligj, atëherë mandati i anëtarit të ri duhet të jetë i plotë.

Kjo për faktin se Bordi i Fondit Pensional është i rëndësishëm dhe anëtarët e zgjedhur duhet të jenë në funksion të plotë në ushtrimin e mandatit të tij.

Paragrafi 2 i nenit 2 është i propozuar të fshihet dhe mbetet teksti si në ligjin bazik. Komisioni ka vlerësuar se përfaqësuesi i Qeverisë e ka një pagë dhe detyrën e tij në bordin drejtues e ushtron sipas detyrës zyrtare të ngarkuar nga kryeministri. Kjo është në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësisë dhe nuk ia kemi lënë mundësinë që të paguhet edhe si pjesëmarrës në mbledhjet e këtij bordi.

Ndryshimet në paragrafin 1 të nenit 4, propozimi ka të bëjë me rritjen e sigurisë ligjore të investimeve të mjeteve pensionale në letrat me vlerë, respektivisht obligacionet më të sigurt financiare të institucioneve kredibile ndërkombëtare. Në paragrafi 1, fjalët “drejtorëve joekzekutivë” është propozuar të zëvendësohet me fjalët “bordi drejtues”, pasi anëtarët e bordit drejtues janë anëtarë në përbërje të komitetit të auditimit të fondit.

Në ndryshimet në nenin 12 është specifikuar që mandati i anëtarëve aktualë të bordit drejtues të vazhdojë deri në skadimin e tyre, të përcaktuar me vendimet e Kuvendit të Kosovës. Ndërkaq, anëtarët e rinj zgjidhen në bazë të mandatit siç është përcaktuar me këtë projektligj. Komisioni i ka shqyrtuar edhe disa amendamente të propozuara nga deputeti Faton Topalli, por këto amendamente të deputetit nuk janë përkrahur nga Komisioni Funksional.

Kërkoj nga deputetët që t'i përkrahin rekomandimet e Komisionit për Buxhet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, vazhdojmë me votimin e amendamenteve veç e veç.

Nga Komisioni Funksional i kemi 4 amendamente, nga zoti Faton Topalli janë propozuar 4 amendamente, pa përkrahjen e Komisionit Funksional.

Amendamenti 1 i deputetit Faton Topalli, pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Votojmë me elektronikë. Votojmë tani!

Në sallë janë 73 deputetë. A ka pa kartelë? I keni në rregull tash?

Atëherë, kanë votuar 68 deputetë. Për janë 21 vota, kundër 41 dhe janë 6 abstenime. Nuk miratohet amendamenti.

Amendamenti 2, janë dy propozime: i pari është i Komisionit Funksional dhe i dyti i deputetit Faton Topalli pa përkrahjen e Komisionit Funksional.

E votojmë amendamentin e Komisionit Funksional. Votojmë tani!

Kanë votuar 61 deputetë. Për janë 54 deputetë, 5 vota janë kundër dhe 2 abstenime. Miratohet!

E fusim në votim edhe amendamentin e zotit Topalli, pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Votojmë tani!

Kanë votuar 67 deputetë. Për janë 18, kundër 40, abstenime 9.
Nuk miratohet!

Amendamenti 3. Janë prapë dy propozime: i Komisionit Funksional dhe i deputetit Faton Topalli, pa përkrahjen e Komisionit Funksional.

Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Ky amendament, propozim i Qeverisë, ka pasur për qëllim që të gjithë anëtarët e bordit të paguhen me një diferencë për anëtarin e bordit që propozohet nga Qeveria. Shuma e mjeteve që shkon për këtë anëtarë të bordit është brenda tarifës që Kuvendi i Kosovës ia lejon Trustit Pensional për menaxhimin e mjeteve.

Pra, këto nuk janë shpenzim të mjeteve të personave që kontribuojnë, që kursejnë në Trustin Pensional dhe është e natyrshme që të gjithë anëtarët e bordit të paguhen ndryshe. Është pak vështirë të kërkohej angazhim i njerëzve në bord. Pra, nuk kërkohej shpenzim shtesë për këta anëtarë të bordit, por brenda tarifës që e ka, që e cakton Kuvendi për Trustin Pensional të kryehen të gjitha pagesat e anëtarëve të bordit.

Tani unë kërkoj që të mos përkrahet ky amendament dhe të mbetet ashtu siç e kemi propozuar dhe si ka qenë në leximin e parë. Faleminderit!

KRYESUESI: Po mendon, të mos votohet asnjëri? Atëherë, e dëgjuat edhe ministrin. Zonja Hadërgjonaj e ka fjalën, në emër të komisionit.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Komisioni për Buxhet dhe Financa në mënyrë unanime ka rekomanduar që ky paragraf të hiqet për arsye se personi i caktuar nga Qeveria për të marrë pjesë është një person i cili nuk ka të drejtë vote dhe nuk e kemi parë të arsyeshme që ta marrë kompensimin për angazhimin e tij në mbledhjet e bordit.

Kështu që komisioni ka vendosur të hiqet paragrafi 2 dhe të mbetet teksti si në ligjin bazik, pasi anëtari i Qeverisë e ka një pagë dhe detyrën e tij në bordin drejtues e ushtron sipas detyrës zyrtare të ngarkuar nga kryeministri. Kjo është edhe në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Prandaj, unë rekomandoj që të qëndrojmë në rekomandimin që e ka dhënë Komisioni FunkSIONal, që neni 2, paragrafi 2, të hiqet.

KRYESUESI: Edhe njëherë ministri e ka kërkuar fjalën, zoti Hoti.

MINISTRI AVDULLAH HOTI: Më lejoni edhe një herë të sqaroj. Kjo nuk ka asnjë lidhje me Ligjin për menaxhimin e financave publike. Ne po e rregullojmë mënyrën se si funksionon Trusti Pensional, si zgjidhen anëtarët e Trustit Pensional dhe si paguhen anëtarët e Trustit Pensional.

Kjo kërkesë për ta paguar një anëtarë të bordit që nuk ka të drejtë vote, por që emërohet nga Qeveria është brenda tarifës që e ka Trusti Pensional. Nuk do të ketë rritje të shpenzimeve të trustit për shkak të kësaj pagese. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani deputetët kanë dëgjuar, unë nuk e besoj që ka nevojë që të sqarohet më, e keni sqaruar edhe më herët. E kanë dëgjuar mendimin e ministrit, mendimin e kryetares së komisionit dhe e keni parë edhe amendamentin e zotit Topalli.

Ne i nxjerrim në votim të dyja amendamentet, në qoftë se nuk doni t'i votoni sipas porosisë së ministrit.

E votojmë amendamentin e tretë të Komisionit FunkSIONal. Votojmë tash, me elektronikë!

Kanë votuar 67 deputetë. Për janë 44, kundër 13, kanë abstenuar 10.

Konsideroj që është miratuar amendamenti i Komisionit FunkSIONal.

E votojmë tani amendamentin e deputetit Faton Topalli, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONal. Votojmë tani!

Kanë votuar 69 deputetë. Për janë 17, kundër 42, kanë abstenuar 10. Nuk miratohet!

Amendamenti 4, i Komisionit FunkSIONal. Votojmë tani!

Kanë votuar 63 deputetë. Për janë 52 deputetë, kundër 8, kanë abstenuar 3.

Miratohet amendamenti 4 i Komisionit Funksional.

Amendamenti 5, i deputetit Faton Topalli, pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Votojmë tani!

Faleminderit! kanë votuar 64 deputetë. Për janë 15, kundër 42, kanë abstenuar 7.

Nuk miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6, i Komisionit Funksional. Kundër s'ka. Abstenim s'ka. Miratohet!

Amendamenti 8, i Komisionit Funksional. Kundër s'ka. Abstenim s'ka miratohet.
Miratohet!

Amendamenti 9. Kundër s'ka. Abstenim s'ka. Miratohet!

Amendamenti 10. Kundër s'ka. Abstenim s'ka. Miratohet!

Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Kanë votuar 70 deputetë. Për janë 58, kundër 10, abstenim 2.

Konstatohet që Kuvendi e miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për fondet pensionale të Kosovës.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sponsorizime dhe donacione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, zotin Nait Hasani, që ta paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime. Zoti Hasani, e keni fjalën!

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje për kryeministrin,

Kabinet qeveritar,

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport ka shqyrtuar Projektligjin për sponsorizime në sport, i cili ka ardhur në komision më 9. 2. 2016, ku kemi mbajtur mbledhje

të komisionit, kemi mbajtur dy dëgjime publike, kemi pasur edhe një vizitë studimore në Frankfurt, në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe të Sportit. E kemi shqyrtuar dhe e kemi analizuar këtë projektligj që është mjaft i rëndësishëm në fushën e sportit në Kosovë.

Kosovës i ka munguar një projektligj i tillë dhe gjatë shqyrtimit, për të cilin kemi pasur edhe debate edhe me Ministrinë e Kulturës, edhe me Ministrinë e Financave, kemi kërkuar dhe po kërkojmë bashkë me të gjithë ata që merren me fushën e sportit, angazhimet në sport, klubet sportive në përgjithësi, edhe të kulturës, kemi kërkuar dhe po kërkojmë që me anë të këtij projektligji, meqë edhe Kosova tashmë është pjesë e Federatës së Futbollit UEFA, klubeve botërore, mundësia e ndërtimit të klubeve dhe stadioneve është një mundësi e mirë që me anë të këtij projektligji të arrijmë qëllimin që edhe futbollistët tanë, klubet tona të jenë pjesë e standardeve të Bashkimit Evropian.

Për ta arritur këtë komisioni e ka shqyrtuar dhe e ka analizuar mjaft mirë këtë projektligj. Ka pasur dhe reagime, por të gjitha këto kemi tentuar t'i bëjmë në të mirën e sportit, të mirën e kulturës, të mirën e së ardhmes së futbollit të Kosovës. Mjaftë talente tona të futbollit janë pjesë e Evropës, e klubeve evropiane që kanë dëshmuar dhe po e dëshmojnë një futboll cilësor.

Por, të gjitha këto i kanë arritur nga jashtë, asnjë nga brenda. Të gjitha ato që i kanë arritur nga jashtë, i kanë arritur nga klubet sportive, të cilat i kanë këto standarde që po kërkojmë ne t'i vendosim edhe në projektligjin tonë. Ato që ne po duam janë lirimi nga tatimi në fitim dhe njohja e sponsorizimit të plotë. Nëse këto i arrijmë me anë të këtij projektligji, ne kemi për t'ua dhënë mundësinë edhe fëmijëve tanë, edhe sportistëve tanë, edhe klubeve tona, edhe stadiumit t'i kemi me standarde evropiane. Në të kundërtën, kemi për t'u thirrur në dëshirat që do ta kemi një sport, do të kemi sportistë, do të kemi stadione, të cilat ende nuk i kemi.

Me këtë projektligj tentojmë t'ua japim mundësinë sponsorizuesve të huaj që të vijnë edhe të ndërtojnë edhe stadione, të ndërtojnë edhe ekipe, për të cilat ne i kemi njerëzit tanë. Prandaj, për ta arritur këtë kemi kërkuar edhe nga Ministria e Financave që të na mbështesë, kemi kërkuar edhe nga Ministria e Kulturës, por kemi kërkuar edhe nga klubet sportive, të cilat janë pjesë e ekipeve të lojërave tona.

Me këtë projektligj, kolegë të nderuar deputetë, dhe ata që na përcjellin - klubet sportive, sportistët, kërkojmë që t'u japim mundësi që të jenë pjesë e ngjarjeve sportive evropiane, edhe Kosova. Stadiumi olimpiq apo stadiumi në Bërnice që po përgatitet të ndërtohet me 25 milionë, ai nuk ka mundësi të ndërtohet edhe 2-3 vjet apo 4 vjet pikërisht vetëm duke u shtyrë, alokuar buxhete ose duke tentuar. Por, Kosovës nuk i mjafton një stadium. Kosovës i duhen 3-4 stadione, që të jetë pjesë e ekipit të UEFA-s.

Për ta arritur këtë duhet të kemi edhe stadione tjera, jo vetëm në Mitrovicë që jemi duke shpenzuar, ose duke dhënë buxhet për ndërtimin e tij, i cili ende nuk është gati. Duhet ta kemi edhe stadiumin e Prishtinës, duhet ta kemi në Ferizaj, apo në Prizren, a në Pejë, duhet të kemi edhe stadione tjera, të cilat do t'i plotësojnë kushtet dhe standardet evropiane.

Për këtë është mundësia që me anë të këtij projektligji t'u japim mundësi të gjithë atyre që janë sportdashës, investitorë, sponsorizues për këtë projektligj. Prandaj, kërkoj nga ju që ta mbështetni këtë projektligj me amendamentet e propozuara nga komisioni, e që me këtë t'i japim mundësi zhvillimit të sportit, zhvillimit të kulturës dhe fëmijëve tanë, që të jenë pjesë e arenës evropiane të futbollit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar për ligjin zoti Haradinaj.

DAUT HARADINAJ: Në parim, ne do ta përkrahim kryesues, por nuk jam duke i replikuar Naitit, por tha për sportistët. Ne edhe kemi sportistë, edhe kemi klube të forta sportive, ndoshta nuk i kemi stadiumet në nivelin e duhur, por megjithatë, jo pse është Kujtim Shala këtu, por me sa e pash ndarjen e buxhetit dje, një shumë bajagi e mirë ishte ndarë për rregullimin e stadioneve.

E tash, çka ndërlidhet me këtë Ligjin për financimin e sportit, ndoshta është dashur Naiti pak të na shpjegojë më shumë detaje, sepse ka shumë të panjohura brenda ligjit. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Shaip Muja e ka kërkuar fjalën.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Unë mendoj që ky ligj i plotëson mjaftueshëm nevojat për situatat çfarë kalon Republika e Kosovës për ta avancuar sportin, por sugjeroj kryesuesin e Komisionit për Sport që të mos e kuptojë sportin vetëm futboll, por sporti në përgjithësi ka edhe disiplina tjera, të cilat janë bile më atraktive dhe që e kanë njohur Kosovën ndërkombëtarisht, siç është Majlinda Kelmendi, e cila nuk është futbolliste, por është xhudiste.

Tjerat janë stadiumet. Lidhur me stadiumet, unë mendoj që nëpërmjet këtij ligji, jo vetëm për stadiumet, por çdo qytet i madh i Republikës së Kosovës duhet ta ketë bile edhe një pishinë olimpike, siç është miratuar në buxhetin e kaluar, por edhe nga një pishinë gjysmë-olimpike për t'i mësuar në not fëmijët. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Por, nuk kemi hapur debat për sportin në Kosovë, e kemi veç ligjin.

Bekim, a deshe edhe ti diçka për të thënë për ligjin?

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Para shqyrtimit ose në fazën e shqyrtimit të çdo projektligji, përveç fjalës së komisionit apo anëtarëve të komisionit, është rendi që edhe grupet parlamentare të deklarohen për mbështetjen e projektligjit.

Ne si komision dhe si grup parlamentar kemi punuar me këtë projektligj, e kemi arritur një konsensus të plotë brenda komisionit sa i përket këtij projektligji. Ky projektligj nuk parasheh vetëm mbështetjen financiare për klubet sportive dhe për ata që merren me sport, por është një mundësi e mirë mu për atë që e tha edhe zoti Haradinaj që deri tani investimet në sport kanë qenë të fokusuara nga investimet qeveritare.

Ndërsa, ky projektligj mundëson që në të ardhmen të shkarkohen investimet apo të shkarkohet Buxheti i Kosovës nga ngarkesa për investime në sport dhe kjo tani të financohet nëpërmjet mënyrës së sponsorizimeve.

Prandaj, ne kemi propozuar që edhe sponsorizimet dhe reklamat të jenë pjesë e këtij projektligji. Kemi hequr nga projektligji dhe kemi ndryshuar titullin e tij për arsye se ka qenë Ligji për sponsorizime dhe donacionet.

Donacionet trajtohen me Ligjin për korporata dhe me ligjet tjera të ministrisë për tatimin korporatave, ligjet e Ministrisë së Financave, prandaj mendoj që është një mundësi e mirë që sot, sa i përket këtij projektligji, vërtet t'i japim një shtytje të madhe zhvillimit të sportit, kulturës dhe rinisë, që është edhe një detyrim, të cilin Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe ne si Parlament e kemi pasur nga debati i parë për sportin, të cilin e kemi mbajtur këtu në Kuvend dhe ku kemi nxjerrë rekomandimet tona, që të kemi Ligjin për sponsorizimet, Ligjin kundër huliganizmit dhe dukurive tjera negative në sport dhe Ligjin për menaxhimin dhe sigurinë e objekteve sportive. Deri më tani...

KRYESUESI: Faleminderit, Bekim! Je jashtë temës, të lutem! Faleminderit! Nuk kemi hapur debat. Vazhdojmë me votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet me vërejtjet e zotit Hasani.

Amendamenti 12

Kundër? Fjalën Naitit, regjia.

NAIT HASANI: Amendamenti 11, paragrafi 2, bashkësponsorizues janë dy apo më shumë persona juridikë ose juridikë, është fjala persona “fizikë ose juridikë”. Domethënë, duhet të shkruhet “fizikë”, ky është ndryshimi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Besoj që pranohet, sepse është vetëm qartësim i asaj. Miratohet me vërejtjet e zotit Hasani.

Amendamenti 12

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 13

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 14

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 15

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 16

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 17. Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa i ka rekomanduar Komisionit Funkcional që të fshihet paragrafi 1 dhe 2, të mbetet teksti i paragrafëve 1 dhe 2 i projektligjit, prandaj kërkoj sqarim nga kryetarët e komisioneve. Zoti Hasani, urdhëro!

NAIT HASANI: Edhe një herë, po kërkoj, nënkryetar, edhe nga ministri edhe nga deputetët, që të votohet amendamenti që e ka bërë Komisioni Funkcional për Arsim dhe t'i jepet mundësia e gjithë sporteve edhe të kulturës, të zhvillohen dhe të lirohet Qeveria nga pagesat që ajo po tenton të bëjë përmirësimin e stadiumeve ose ekipeve sportive. Prandaj, kërkoj që të votohet drejtpërdrejtë amendamenti që e ka propozuar komisioni.

KRYESUESI: Do të thotë, amendamenti 17 ky që është. Zonja Hadërgjonaj, urdhëro!

SAFETE HADËRGJONAJ: Komisioni për Buxhet dhe Financa ka rekomanduar që në amendamentin 17 të Komisionit Funkcional, paragrafi 1 dhe 2 të fshihet dhe të mbetet... Komisioni për Buxhet dhe Financa ka rekomanduar që në amendamentin 17 të Komisionit Funkcional paragrafi 1 dhe 2 të fshihen dhe të mbetet teksti i paragrafëve siç është rregulluar me nenin 12 të Projektligjit.

Përcaktimi i shkallës së tatimeve dhe zbritjeve të lejuara tatimore është rregulluar me ligje të veçanta tatimore për të ardhurat personale dhe të korporatave. Si rrjedhojë, me këtë ligj nuk mund të përcaktohet shkallë apo zbritje tjetër tatimore, nga ajo që është paraparë me ligjet tatimore. Faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë, e votojmë amendamentin 17 të Komisionit Funkcional. Zoti Hoti, dëshironi...?

MINISTRI AVDULLAH HOTI: Më lejoni të sqaroj që çështja e sponsorizimit të aktiviteteve sportive, kulturore, e tjera... është rregulluar në Ligjin për të ardhurat e korporatave në shtator të

vitit të kaluar, kur është aprovuar këtu në Kuvend. Përpara shtatorit 2015 është njohur vetëm 5% e shpenzimeve, që firmat, kompanitë private, kanë mundur të sponsorizojnë çfarëdo aktiviteti kulturor ose sportiv. Me ligjin e ri, që është aprovuar në shtator të vitit të kaluar, ne kemi rritur këtë nga 5 në 10, e kemi rritur nga 5% në 10% të të hyrave të tatueshme plus kemi lënë edhe 10% me udhëzime, me vendime të ministrit të Kulturës ose ministrave tjerë përkatës, pra ka shkuar në 20%, prej 5% në 20%.

E dyta është që të gjitha tatimet dhe lirimet nga tatimet e ndryshme përcaktohen në ligjet bazike, nuk mundet asnjë ligj tjetër të përcaktojë çfarëdo lirimi qoftë. Prandaj, unë e mbështes plotësisht qëndrimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe ju ftoj që ta aprovoni qëndrimin e komisionit. Faleminderit!

KRYESUESI: Për amendamentin 17 edhe zoti Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit!

I nderuar nënkryetar,

I nderuar ministër dhe kryeministër,

Komisioni FunkSIONAL ka punuar dhe esenca e krejt projektligjit është amendamenti 17. Nëse nuk kalon amendamenti 17 atëherë këtë projektligj është mirë me e tërheq në tërësi, sepse nuk vlen pa amendamentin 17, i cili ka pesë paragrafë tjerë, ku parasheh edhe lirimet nga sponsorizimet edhe zbritjet në kulturë, por edhe reklamat. Atëherë, ky ligj nuk vlen asgjë, është kot. Atëherë mund të vlejnjë ligjet të cilat i theksoi ministri i Financave, atëherë projektligji nuk vlen asgjë.

Prandaj, esenca e këtij projektligji është amendamenti 17, përmes të cilit i mundësohet financimi sportit dhe zhvillimit të sportit në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Haxhiu. Edhe një herë Zoti Hasani e ka kërkuar fjalën, sa i përket amendamentit 17.

NAIT HASANI: Faleminderit, edhe një herë nënkryetar!

Në pesë paragrafët e nenit 17, në amendamentin 17, që e kemi bërë ne, në të gjitha këto shpjegohet në mënyrë specifike veprimet të cilat duhet të merren. Lirimet janë për të gjitha fushat e sportit me qëllimin që të lirohet Qeveria nga ngarkesat e financimit të klubeve sportive. Prandaj, po kërkojmë që t'u ndihmojmë edhe Qeverisë në një anë, t'i ndihmojmë edhe sportit dhe kulturës, në anën tjetër.

Prandaj, kërkoj nga deputetët ta votojnë amendamentin që ka propozuar Komisioni FunkSIONAL për Arsim.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, e hedh në votim. Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, zoti Kujtim Shala e ka kërkuar fjalën, meqenëse lidhet edhe me ministrinë dhe dikasterin që e drejton ai.

MINISTRI KUJTIM SHALA: Faleminderit, kryesues!

Unë besoj që ka një keqkuptim, sepse çështja është te objekti i Projektligjit. Ky projektligj nuk i rregullon lehtësirat, sepse s'ka mandat, s'ka fuqi ligjore të bëhet ajo. Janë projektligje tjera të cilat i rregullojnë këto. Me këtë ligj përcaktohen fushat dhe procedurat, nuk mund të ndryshohen nëpërmjet këtij ligji normat të cilat janë përcaktuar me ligjin bazik, që ka të bëjë me tatimin mbi të ardhurat e korporatave.

Do të thotë, ai ligj përcakton që për këto fusha ne mund të shkojmë me lehtësira deri në 20%. S'i përcakton ky ligj, është ligji bazik. Prandaj unë mendoj që ky amendament është problematik në këtë kuptim. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja Haxhiu, e ke fjalën për amendamentin apo e ke shtypur gabimisht. Për amendamentin 17, zonja Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Ne kemi punuar si anëtarë në Komisionin Funksional, është propozimi i të gjithë anëtarëve, pra i komisionit komplet, normalisht se edhe Qeveria e ka pasur përfaqësuesin e vet, kështu që ju lus që ta hidhni në votim.

(Ndërprerje e incizimit)

KRYESUESI: Zoti Ibishi, edhe ti e ke kërkuar fjalën për amendamentin? Zoti Ibishi e ka fjalën.

NUREDIN IBISHI: Unë mendoj që në këtë rast e mbështes ministrin, zotin Shala, për arsye se në këtë ligj nuk mund të përcaktohet lartësia e lehtësimit në tatime. Këtu mund të përcaktohet në këtë ligj, domethënë për sponsorizim të sportit, vetëm konditat apo kushtet në të cilat raste, por jo edhe shuma, kjo shkon në ligjin bazik.

Mendoj që do të bëjmë gabim. Atëherë, do të ketë pasoja të tjera, se nuk mundet një ligj sikur ky të shkojë në përqindje, të ceket, kur e kemi ligjin tjetër bazik. Vetëm desha në këtë ta tërheq vërejtjen.

KRYESUESI: Atëherë, unë mendoj që i keni dëgjuar të gjitha palët, sa i përket ligjit, duke përfshirë edhe dy ministrat. E hedh në votim elektronik... Bekim, ... e hedh në votim elektronik amendamentin 17. Votojmë tash!

Nuk ka kuorum për votim të amendamentit 17. E përsëris edhe një herë, që të mos thoni që ashtu... Ju lus, që të kemi informacion nëse është dikush pa kartelë. Nuk është askush.

Edhe një herë e votojmë amendamentin 17 të Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

Kanë votuar 65 deputetë, për janë 39 deputetë, kundër 13, abstenuan 13. Miratohet amendamenti 17.

Amendamenti 18

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 19

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 20

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 21

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 22

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 23

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Konstatoj që Kuvendi miratoi Ligjin për sponsorizimin në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit.

Ligjin në tërësi... më falni, se s'e kam hedhur ligjin në tërësi.

Amendamentet i kemi miratuar. Ju lus për ndjesë! Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Votojmë tani!

71 deputetë janë në sallë. Faleminderit! Kanë votuar 66 deputetë, për janë 55 deputetë, kundër 5, abstenuan 6. Konstatoj që Kuvendi miratoi Ligjin për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sporteve.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për faljen e borxheve publike

Në bazë të vendimit të seancës plenare, datë 22 dhjetor 2016, procedojmë me shqyrtimin e dytë të projektligjit.

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj zonjën Hadërgjonaj, në emër të Komisionit FunkSIONAL, që të paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për faljen e borxheve, ku ka qenë i pranishëm edhe përfaqësuesi i Ministrisë së Financave dhe i cili ka ofruar sqarimet për dispozitat dhe çështjet tjera të ngritura lidhur me projektligjin.

Në bazë të propozimeve komisioni propozoi edhe tri amendamente, të cilat kërkojmë që të miratohen nga ana e deputetëve.

Ka ndryshime në... është një amendament tek neni 1, është riformuluar me qëllim të qartësisë juridike. Amendamenti 2 që ka të bëjë me nenin 2, është riformuluar përkufizimi i ligjit bazik, qëllimi i këtij ndryshimi është që nga falja e borxheve mund të përfitojnë institucionet shtetërore dhe ndërmarrjet publike nga obligimet e tyre, që janë krijuar si rezultat i këtyre borxheve. Dhe, amendamenti 3, neni 2 i projektligjit është riformuluar, kur është përcaktuar një afat më i gjatë i mundësisë së paraqitjes së kërkesës për faljen e borxheve për personat fizikë dhe juridikë, sipas kushteve të përcaktuara në ligjin bazik.

Kërkoj nga deputetët, që t'i përkrahin këto tri amendamente të Komisionit FunkSIONAL, të cilat i ka rekomanduar në këtë seancë plenare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara, sipas radhës, të paraqitura në raportin e Komisionit FunkSIONAL.

Amendamenti 1.

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Zonja Sala Berisha-Shala për amendamentin e parë.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar!

Te amendamenti i parë unë jam për, mirëpo e kam një plotësim. Më lejoni ta parashtroj këtë kërkesë timen lidhur me shfrytëzimin e dytë të këtij ligji në të mirën e përgjithshme.

Në bazë të nenit 58, paragrafi 2, të Rregullores së Kuvendit, të Projektligjit nr. 05/L-119 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për faljen e borxheve, parashtroj amendament.

Pas nenit 1 të Projektligjit të shtohet nen i ri me tekstin si vijon: “Neni 2, neni 3 i Ligjit bazik dhe paragrafin 1.3, pas fjalisë...

KRYESUESI: Salë, më vjen keq, por nuk mund të bësh amendament tash.

SALA BERISHA-SHALA: Në plotësim është...

KRYESUESI: Jo, jo, jo...!

SALA BERISHA-SHALA: Nënkryetar, po më lejo tash ta kryej deri në fund, pastaj le të vendos seanca.

KRYESUESI: Mundet Qeveria të kërkojë lexim të tretë, e drejta e saj është, por jo kështu. Nen të ri nuk bëj, nuk pranoj unë. S’mundeni të votoni amendament të ri tash, e keni pasur në shqyrtim, pse s’keni bërë amendament?

Fol, fol, se s’ta ndala unë fjalën.

SALA BERISHA-SHALA: Pra, le të vendos seanca. Unë jam e vetëdijshme që nuk mund të bësh amendament direkt në seancë, mirëpo më lejoni ta arsyetoj pse po kërkoj të futet, të plotësohet neni 3 i nenit 2 të Ligjit bazik.

Neni 3 i Ligjit bazik në paragrafin 1.3 pas fjalisë “Doganën e Kosovës”, të shtohet fjala “Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale”.

Arsyetim: Gjatë monitorimit të Ligjit për miniera dhe minerale kemi marrë shkresa dhe jemi takuar me shumë biznese, që ushtrojnë veprimtari minerare dhe në veçanti të argjilës dhe zhavorreve, të cilat kanë ndëshkime dhe dënime, jo vetëm nga ATK-ja, por edhe nga KPMM-ja, por nuk kanë mundur t’i shlyejnë borxhet e vjetra, sepse KPMM është e përjashtuar nga Ligji për faljen e borxheve. Siç e shini në ligjin bazik, domethënë nuk përfshihet KPMM.

Janë listuar institucionet shtetërore, se kush mund të përfitojë si biznesi ashtu edhe qytetari. Unë si deputete nuk kam mundur ta shfrytëzoj rastin, sipas rregullores, të bëj amendament dy javë pas miratimit të këtij projektligji, sepse ne ishim në muajin nëntor kur bënim mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për miniera dhe minerale, ndërkohë që Kuvendi ka miratuar në parim në muajin tetor këtë projektligj.

Andaj, të nderuar deputetë, ju lus të keni mirëkuptim, që sot ta hidhni në votim këtë amendament dhe të njëjtin ta miratoni, sepse do t'i ndihmonim shumë kësaj industrie, e cila është kontribuuese mjaft e madhe në ekonominë e vendit, si dhe Buxhetit të shtetit. Kjo është kërkesa ime. Procedurat e më tutjeshme... kërkoj ata që janë kompetentë të shkojnë më tutje.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar për amendamentin 2, po ende s'kemi shkuar te dyshi, te njëshi jemi. Ta miratojmë të parin.

Votojmë amendamentin 1.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2. Fjalën e ka kërkuar Nait Hasani. 71 veta janë në sallë.

NAIT HASANI: Amendamenti 2, në Komisionin për Buxhet dhe Financa kemi qenë bashkë me ministrin e Financave dhe në këtë amendament është bërë plotësim ndryshimi, është paragrafi 1.6 i amendamentit 2 thotë: "për qëllim të këtij ligji nënkupton të gjithë personat fizikë dhe juridikë (përveç ndërmarrjeve shoqërore nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit), që kanë shumat e borxheve publike të pashlyera ndaj institucioneve shtetërore dhe ndërmarrjeve publike.

Kjo pjesë është e paplotësuar nëse nuk llogaritet edhe te ligji bazik po i njëjti nen, është vetëm paragrafi 1.3, siç e përmendi edhe Sala se janë të gjitha ndërmarrjet atje edhe Dogana e Kosovës, vetëm mungon Komisioni i Pavarur dhe miniera. Prandaj, këtu vetëm kërkohet këtu te 1.3-shi. Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe kjo është e plotë, nëse e përjashtojmë Agjencinë e Privatizimit të gjitha këto të tjerat do të jenë mundësie e faljes së borxheve të cilët u kanë mbetur nëpër gjykata dhe të tjera.

Prandaj, kërkojmë nga deputetët ta votojnë dhe ta shtojnë në Komisionin e Pavarur për Miniera në paragrafin 1.3.

KRYESUESI: Faleminderit! Secili deputet dhe grupet parlamentare dhe grupet e deputetëve munda të bëjnë amendamente në secilin ligj. Sot janë veç tri amendamente që unë do t'i procedoj.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

E votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Unë për qejf nuk mund t'ia jap kurrkujt mundësinë, të lutem! E drejta jote është të bësh amendament kur të kesh qejf ti, në secilin ligj, sot s'mund ta hedh në votim. S'mund ta hedh në votim diçka... nuk kam të drejtë në procedurë me e shti. Unë s'jam këtu mbret. Unë e kam për detyrë t'i zbatoj procedurat, për atë punë jam. Rregullat janë rregulla për të gjithë njësoj.

Edhe një herë e hedh në votim. Shiko, ju si të doni, mund të mos votoni hiq, sa për mua. Unë e kam atë kompetencë me e qit në votim. Edhe një herë e hedh në votim tekstin e projektligjit në tërësi me tri amendamentet e votuara. Votojmë tash!

Nuk ka kuorum, e lëmë për një ditë tjetër. Në rregull është.

10. Shqyrtimi i Projektligjit për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive

Në bazë të vendimit të seancës plenare, datë 22 dhjetor 2016, procedojmë me shqyrtimin e dytë të projektligjit.

Ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL, zotin Nait Hasani, që para deputetëve të arsyetojë raportin me rekomandime.

NAIT HASANI: Komisioni e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe me amendamentet e propozuara për sanksionimin e dhunës në sport kërkon që të paktën të vendosim rregulla për të gjithë ata që janë pjesëmarrës, ndaj ekipeve, klubeve, sportistëve, federatave dhe të gjithë atyre që janë pjesëmarrës në sporte të ndryshme, të kemi edhe rregulla, të cilat duhet t'i respektojmë në bazë të standardeve evropiane.

Në komision janë shqyrtuar dhe janë miratuar amendamentet, prandaj po kërkojmë që këtë projektligj ta miratojmë në Kuvend dhe të kemi siguri në të gjitha fushat e sportit në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tash po vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhës të paraqitura nga Komisioni FunkSIONAL.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 12

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 13

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 14

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 15

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 16

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 17

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 18

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 19

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Në sallë janë 66 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për ta votuar tekstin e projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara dhe votojmë tani:

Nuk ka kuorum për të votuar, prandaj kur të kemi kuorum e votojmë.

11. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për minierat dhe mineralet

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit dhe Kuvendit i ka paraqitur raport me rekomandime.

Fjalën e ka zonja Sala Berisha-Shala në emër të Komisionit FunkSIONAL që të paraqesë dhe ta arsyetojë raportin e komisionit me rekomandime.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Bazuar në Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës, neni 73, ku thuhet se secili komision brenda fushës së përgjegjësisë së tij është i autorizuar ta mbikëqyrë zbatimin e ligjit nga Qeveria, përkatësisht nga dikasteret qeveritare.

Prandaj, bazuar në mandatin e autorizuar nga komisioni parlamentar, Grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit i ka zhvilluar aktivitetet e nevojshme me qëllim të mbledhjes së

informatave dhe të dhënave mbi zbatueshmërinë e ligjit dhe në fund e kemi përgatitur një raport përmbledhës, të cilin po e prezantojmë tani.

Grupi punues ka arritur me sukses t'i përmbyllë aktivitetet e planifikuara në mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për miniera dhe minerale gjatë periudhës korrik - nëntor 2016.

Kemi realizuar vizita në terren, në institucione të ndryshme që janë zbatuese të ligjit, e kështu me radhë.

Qëllimi i mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit është që analiza dhe verifikimi i zbatimit të ligjit, efektet negative apo pozitive, të cilat, më lejoni t'i përmend, se efektet pozitive të zbatimit të këtij ligji janë, për shembull, vetëm në vitin 2016 buxhetit të Kosovës i janë shtuar 31 000 000 nga renta minerare, pa përfshirë taksa të tjera dhe të punësuarit.

Qëllimi tjetër është të shqyrtojë nëse efektet negative janë pasojë e dispozitave të ligjit nga mënyra se si është zbatuar ai, apo të dyja bashkë.

Sfidat në zbatimin e ligjit dhe nxjerrja e rekomandimeve që do të ndihmojnë në zgjidhjen apo përmirësimin e gjetjeve.

Grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit aktivitetet e tij i ka zhvilluar në bazë të planit të veprimit, i cili ka përcaktuar subjektet e përzgjedhura, kohën e realizimit të tyre dhe mënyrën e raportimit.

Grupi punues gjatë procesit të mbikëqyrjes së ligjit i ka realizuar këto aktivitete:

- Takimet e Grupit punues me qëllim të koordinimit dhe planifikimit të aktiviteteve;
- Takimet zyrtare me institucionet përgjegjëse për zbatim të ligjit;
- Takimet nëpër disa komuna;
- Takimet me biznese të operimeve minerare në terren;
- Organizimin e dëgjimit publik;
- Raportimin në mbledhjen e komisionit rreth këtyre aktiviteteve.

Në takimin me Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale këta të fundit kanë dhënë komente e vërejtje lidhur me zbatimin e ligjit, i kanë dorëzuar me shkrim këto komente dhe si rekomandim kanë dhënë se duhet harmonizuar ligjet të cilat ndërlidhen me veprimtarinë minerare, siç është Ligji për miniera dhe minerale, Ligji për tokat bujqësore, Ligji për pyjet, Ligji për parqet nacionale, garancitë bankare për rikultivim të sipërfaqeve, e tjera.

Frytdhënëse kanë qenë sidomos takimet me kryetarët e komunave nëpër të cilat kemi kompani që merren me operime minerare. Kemi pasur takim me Komunën e Obiliqit, që shpresoj se me hyrjen në fuqi të Ligjit të Obiliqit janë plotësuar kërkesat e tyre.

Nga takimi me kryetarin e Komunës së Drenasit ata kanë kërkuar që të ketë bazë ligjore për komunat ku ka veprimtari minerare dhe ta kenë të drejtën e realizimit të taksës për operim, në mënyrë që kjo taksë të shfrytëzohet për investime në mirëqenie sociale dhe rregullim të ambientit. Po ashtu, kanë kërkuar që 20% e vlerës së rentës minerare t'i kthehet komunitetit.

Takim interesant ka qenë edhe ai me kryetarin e Komunës së Deçanit. Përfaqësuesi i kësaj komune si problem ka cekur Ligjin për zona të posaçme, i cili krijon pengesë të madhe për zhvillimin ekonomik lokal, pasi që ky ligj kufizon pjesën më të madhe ku mund të ketë veprimtari të zhvillimit të turizmit, si dhe shfrytëzimin e resurseve minerale.

Nga takimi me Komunën e Pejës janë paraqitur sfidat me të cilat përballen Komuna e Pejës si pasojë e shfrytëzimit minerar nga operatorët e rërës dhe zhavorrit përgjatë lumenjve, duke shfrytëzuar hapësirat brenda lumenjve dhe duke dëmtuar tokën bujqësore. Gjithashtu, të njëjtat shqetësime i kemi pasur edhe në takimin me përfaqësuesit e Komunës së Dardanës.

Kemi pasur takime edhe me kompani që operojnë anekënd Kosovës dhe jemi munduar t'i përmbledhim të gjitha sfidat dhe gjetjet nga këto kompani dhe institucione.

Grupi i punës për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit, gjatë takimeve me institucione dhe grupet e interesit është informuar se në përgjithësi Ligji për miniera dhe minerale është në zbatim, por ka nevojë për koordinim të institucioneve dhe plotësim të ligjit.

Grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit, gjatë vizitave në terren dhe shqyrtimit të dhënave, ka arritur të gjejë me sa vijon:

- Dispozitat e ligjit në përgjithësi janë të zbatueshme. Megjithatë, ende ka vështirësi në zbatim.
- Ekziston disharmoni në mes të ligjeve të cilat ndërlidhen me ushtrimin e veprimtarisë minerare, siç është Ligji për miniera e minerale si ligj bazik, Ligji për tokat bujqësore, Ligji për pyjet, Ligji për parqet nacionale, si dhe Ligji për zonat e caktuara të interesit.

Mandej, sfida tjera janë:

- Garancitë bankare për rikultivimin e tokës, dhe janë barrierë e rëndë për operatorët e veprimtarisë minerare.

- Edhe më tutje ekzistojnë operime ilegale në nxjerrjen e zhavorrit në lumenj dhe në afërsi të tyre, me pasoja tepër të mëdha për ambientin, sidomos gjatë kohës së shfaqjes së vërshimeve, ku degradohet shtrati i lumenjve.
- Mospërfshirja e KPMM-së krahas institucioneve të tjera në Ligjin për faljen e borxheve publike ka ndikuar negativisht te kompanitë të cilat nuk arrijnë t'i fshijnë obligimet që i kanë ndaj KPMM-së.

Ne e patëm një mundësi sot që këtë sfidë ta evitojmë, mirëpo s'ishte disponimi as i udhëheqësit të seancës, e as i deputetëve dhe më lejoni të sqaroj se falja e borxheve duhet të përfshijë borxhet e kompanive të krijuara nga dënimet për veprimtari ilegale dhe dënime mandatare, taksat, kurse nuk përfshihet renta minerare.

Pra, më lejoni t'ju njoftoj se këto kompani janë futur në borxhe gjatë kohës së UNMIK-ut kur dënimet, gjokat, janë shqiptuar paushall, pa matje gjeodezike. Prandaj ka qenë mirë dhe në vullnetin tonë që t'i lirojmë këto kompani dhe t'u japim hapësirë që të merren me veprimtari për t'i ndihmuar edhe buxhetit të Kosovës.

Sfidë tjetër është se ka mungesë të koordinimit të mjaftueshëm në mes të institucioneve përgjegjëse në parandalimin dhe ndalimin e operimeve ilegale. Ka mungesë të dispozitave ligjore për hulumtim dhe shfrytëzim të hidrokarbureve të lëngëta dhe të gazta, përkatësisht naftës dhe gazit.

Nga veprimtaritë minerare komunitetit i krijohen probleme të mëdha në lëvizje, në ambient, në jetën e banorëve dhe në çështje të tjera, por komuniteti nuk përfiton asgjë.

Marrja e lejeve dhe licencave është një proces i ndërlikuar e i stërzgatur dhe kërkon shumë angazhim, sepse shtrihet në shumë institucione.

Ka mungesë të koordinimit dhe bashkëpunimit të mjaftueshëm në mes të institucioneve në lëshimin e lejeve dhe licencave. Për ushtrimin e veprimtarisë minerare në disa zona pengesë të madhe paraqet Ligji për zonat e posaçme. Mungon kompetenca e komunave për të vepruar në parandalimin dhe ndalimin e operimeve ilegale.

Në periudhë të caktuar operatorët në veprimtaritë minerare kanë mbetur pa licencë për shkak të mungesës së bordit të KPMM-së, organ i cili është kompetent për lëshimin e licencave.

Licencat u jepen operatorëve në sipërfaqe deri në 5 hektarë dhe jo më shumë. Ligji i pyjeve kufizon këtë sipërfaqe, që është në disharmoni me kohëzgjatje të licencave që i lëshon KPMM-ja.

Qiraja për Agjencinë e Pyjeve për tërë sipërfaqen është një sfidë tjetër që është marrë licenca, edhe pse resursi mineral shfrytëzohet gradualisht dhe kjo është barrierë që në fillim për operatorët.

Shpronësimi i tokave, për të cilat operatori nuk arrin të bëjë marrëveshje me pronarin e tokës, nuk po gjen zbatim neni 33, paragrafi 2 i Ligjit për shpronësim.

Nuk ka harmonizim të afateve të lejeve dhe licencave të lëshuara nga institucionet e fushave të ndryshme për të njëjtin operator.

Ekzistojnë shumë lloje të taksave dhe kjo paraqet sfidë për operatorët.

Dhe, si konkluzion, duke i marrë parasysh gjetjet nga takimet zyrtare dhe vizitat në terren, Grupi i punës për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit ka arritur t'i identifikojë pikat e lartpërmendura si probleme në zbatimin e këtij ligji.

Duke marrë për bazë problemet e identifikuara, Komisioni Parlamentar për Zhvillim Ekonomik konkludon se ligji është i zbatueshëm, por ka pengesa, për çka duhet ndërmarrë masa konkrete për ndryshim të gjendjes, duke i bërë ndryshimet e nevojshme ligjore apo koordinimin më të mirë të institucioneve përgjegjëse.

Njëkohësisht me qëllim të ndryshimit dhe përmirësimit të gjendjes aktuale dhe me qëllim të rritjes së nivelit të zbatimit të këtij ligji, komisioni i propozon rekomandimet si në vijim:

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës, në afatin prej 3 muajsh të marrë nismën legislative për ndryshimin e Ligjit për miniera apo edhe të bëjë një ligj komplet të ri për çështjet si vijon:

- Garancitë bankare;
 - Kthimin e një pjese të të hyrave nga tantiemat në komunitet dhe përfitimet e tjera të komunitetit;
 - Rregullimi i nxjerrjes dhe shfrytëzimit të hidrokarbureve të lëngëta e të gazta.
- Ne e dimë se kemi pasur kompani të interesuara të hulumtojnë në këtë drejtim, mirëpo nuk është e rregulluar me ligj.
- Thjeshtësimin e lejeve dhe licencave, distancat nga objektet për krijimin e shërbimit të një “One-stop-shop”;
 - Çështjet e shpronësimit në zonat minerare;
 - Masat ndëshkimore;
 - Si dhe të gjitha iniciativat apo nismat ligjore të ndërmarra në Kuvend të përfshihen me një projekt të vetëm;
 - Hartimi i Ligjit të ri për miniera dhe minerale.

2. Qeveria e Republikës së Kosovës në afatin prej 3 muajsh të njoftojë Kuvendin se ka marrë masa për harmonizimin e ligjeve dhe akteve nënligjore që ndërlidhen me ushtrimin e veprimtarisë minerare si vijon:

- Ligji për tokën bujqësore;
Dispozitat që kanë të bëjnë me ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore dhe dispozitat që kanë të bëjnë me dhënien e tokës publike me qira, shih nenin 11 të këtij ligji, si dhe Udhëzimi administrativ nr. 41/2006 dhe nr. 10/2010;
- Ligji për pyjet e Kosovës;
Dispozitat që kanë të bëjnë lidhur me mospërcaktimin e kohëzgjatjes së marrëveshjes për të drejtat pronësore dhe dispozitat lidhur me rikultivimin dhe rehabilitimin e zonës së minierave, nenet 5, 6 dhe 27 të këtij ligji.
- Ligjet për parqet nacionale dhe zonat e mbrojtura;
Këto ligje duhet të harmonizohen me strategjinë minerare 2012/2025.
- Ligji për ujërat e Kosovës;
Dispozitat që kanë të bëjnë me kufizimin e distancave të lumenjve.

3. Qeveria e Republikës së Kosovës, në afatin prej 3 muajsh t'ia dorëzojë Kuvendit një analizë me mundësinë e përmbledhjes së shumë taksave në një taksë të vetme për operatorët minerarë.

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale në afatin prej 3 muajsh t'i paraqesë Kuvendit një plan të veprimit për ndërmarrjen e masave për ndalimin e operimeve ilegale dhe për të arritur këtë qëllim të bashkëpunojë e të koordinojë aktivitetet edhe me institucionet përgjegjëse.

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale në afatin prej 3 muajsh t'i paraqesë Kuvendit një strategji për rritjen e efikasitetit për thjeshtësimin e dhënies së lejeve dhe licencave.

Dhe, krejt në fund, më lejoni t'i falënderoj anëtarët e Grupit punues, Besim Beqaj, Blerim Grainca, Rustem Berisha si dhe deputetin Raif Qela, i cili, edhe pse nuk ka qenë pjesë e Grupit punues, ka qenë mjaft aktiv në vizita në terren dhe takime të ndryshme.

Për më tepër dhe më në detaje nga ky raport, i keni të bashkëngjitur edhe detajet e raportit.

Së fundi, më lejoni të falënderoj edhe stafin mbështetës të Komisionit, i cili ka qenë...

(Ndërprerje)

KRYESUESI: Faleminderit! Grupet parlamentare nuk janë paraqitur për diskutim. Fjalën e ka zoti Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: Unë e falënderoj Grupin punues. Unë dhe Komisioni kemi vlerësuar se është bërë një punë e detajuar dhe e përgjegjshme, e cila ka zgjatur për një kohë.

Duhet të qartësojmë se nevojiten disa harmonizime të shpejta të ligjeve në mënyrë që të zbatohet edhe ky ligj, por të zbatohet edhe Ligji mbi investimet strategjike dhe ligjet e tjera që i kemi miratuar. Do të thotë, kemi harmonizimin e Ligjit të pyjeve, Ligjin për investime strategjike dhe Ligjin për koncesione, për arsye se nëse mbetet në fuqi, atëherë afati që mund të jepet në koncesion apo në qira për pyjet është vetëm 5 vjet, e kjo do të pengojë investimet strategjike ashtu qysh i kemi konceptuar, kështu që disa çështje janë vërtet të ngutshme për t'u shqyrtuar.

E dyta - Komisioni ka menduar, e unë po e theksoj edhe një herë këtë që e tha kryetarja, se kjo çështja 20% e tantumës t'i mbetet komunitetit minerar duhet të vlejë në përgjithësi për të gjitha minierat.

Ne këtë e kemi rregulluar me Trepçën e me Obiliqin, por duhet të vlejë edhe për minierat e tjera.

Çështja e faljes së borxheve apo veprimeve ilegale, dënimeve, është një çështje e ndërlikuar dhe ne në komision nuk e kemi diskutuar. Dhe, në qoftë se ka ndodhur gjithkund, ndoshta duhet të ndodhë edhe këtu, por unë për vete kam dilema, sepse njerëzve që kanë bërë veprimtari ilegale kanë shfrytëzuar në mënyrë ilegale pasurinë shoqërore, e t'u falen borxhet dhe dënimet, për mua është pak problematike, por nëse ka raste të tjera, le të mbetet të shqyrtohet më tutje. Kjo ishte!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Muja.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Unë i lexova rekomandimet e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti e Industri dhe po më befason prezantimi i kryetarit dhe i nënkryetares së nënkomisionit që nuk përmendet iniciativa e nisur nga unë dhe disa deputetë për mbledhjen e taksës minerale, të cilën ne e kemi vlerësuar menjëherë pas aprovimit të Ligjit të Trepçës që të përfitojnë edhe tërë operatorët ku kanë shfrytëzim të mineralit të përfitojë 20% komuniteti, siç është në këtë rast Obiliqi, sepse edhe Ligji për Obiliqin, të cilin e kemi aprovuar, duhet të ndryshohet dhe, në të kundërtën Ligji i Trepçës dhe i Obiliqit janë të paimplementueshëm. Po ashtu edhe te Drenasi duhet të përfitojë 20% komuniteti apo buxheti shtesë i Komunës së Drenasit, e po ashtu edhe Kaçaniku e Hani i Elezit nga taksa që përdoret në prodhimin e çimentos, e po ashtu edhe gurthyesit, të cilët janë në regjionin e çdo komune, ku ata duhet të ndajnë 20%.

Lidhur me këtë dje ka kaluar afati ligjor të interpretimit nga Qeveria dhe shumë shpejt duhet ta sjellë komisioni në miratim vetëm atë nen. Prandaj, nëse ne presim të ndryshojmë krejt Ligjin për miniera dhe minerale, do të zgjasë tërë vitin dhe komunitetet nuk do të përfitojnë nga taksa e mineralit, ndërsa dy ligje, të cilat ne i kemi miratuar këtu në Kuvend, janë ligje të paimplementueshme.

Për çështje të tjera, mendoj se nga aspekti ligjor ne duhet ta trajtojmë edhe problemin e Hadës. Është politizuar shumë problemi i Hadës, duke e përdorur mënyrën si është trajtuar si regjion fizik në minierat e qymyrit në regjionin e Obiliqit dhe unë lus që edhe Komisioni për Zhvillim Ekonomik, po edhe Qeveria në këtë rast që është këtu, ta marrë seriozisht një propozim, të cilin ne jemi duke e propozuar: zhvendosjen urgjente të popullatës në Shkabaj dhe të shihet mundësia që në rast se zgjerohet operatori ekonomik dhe të vlerësohet a ka kushte për jetesë atje? Sepse atje nuk ka kushte për jetesë, atje shkelen të drejtat e njeriut, shkelet Kushtetuta e ligjet për atë komunitet, ato të zhvendosen komplet në Shkabaj dhe të gjenden donatorë, së bashku me Qeverinë, për t'u ndërtuar shtëpi atyre kryefamiljarëve, të cilët janë të rrezikuar nga ndotja e ajrit, të rrezikuar nga mbeturinat të cilat hidhen atje nga Prishtina, janë të rrezikuar nga rrëshqitja e dheut dhe janë të rrezikuar edhe nga pamundësia në investim për kanalizime nga epidemi të ndryshme, për shkak se atje nuk investohet dhe as që ka plan strategjik as komuna, sepse është zonë oazë, të themi, e rrethuar me mihjen sipërfaqësore dhe ne duhet të bisedojmë seriozisht, por jo ta keqpërdorim politikisht, sepse ata qytetarë vërtet kanë nevojë për një shpjegim dhe ju ftoj të merrni vendim të qartë.

Prandaj, e lus komisionin që propozimi dhe iniciativa e ne deputetëve të trajtohet shumë shpejt, të silltet në seancë plenare dhe ta miratojmë për taksën e mineralit, kurse për çështjen e Hadës ftoj që në komisionin tonë, në të cilin është trajtuar kjo temë, të bashkëpunojmë edhe më mirë me komisionet e tjera, por edhe me Qeverinë e përfaqësuesit e Qeverisë, në këtë rast t'u bëjmë zgjidhje njëherë e përgjithmonë qytetarëve të Hadës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Fatmir Rexhepi e ka fjalën.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Sa i përket raportit që u paraqit këtu dhe me rekomandime, unë mendoj se pjesa më e madhe e rekomandimeve u përgjigjen asaj që u tha këtu lidhur me projektligjin dhe zbatimin e tij dhe efektet që i ka pasur në këtë fushë, pavarësisht asaj se rezultatet janë shumë të vogla, dëmet janë shumë të mëdha nga shfrytëzimi i këtyre resurseve.

Ajo që ishte në mesin e rekomandimeve mendoj se nuk i përgjigjet hapësirës së Kosovës, sidomos të shtojmë kërkesa që Kosova të shpohet në tëra anët, në nëntokë e përmbi tokë, sepse

jemi një vend i vogël, me një dendësi të madhe dhe mendoj që ajo i kontribuon shkatërrimeve të mëdha, prandaj iniciativat e tilla unë nuk i përkrah.

Në anën tjetër, më bëri përshtypje kjo që u përmend: insistimi me forcë dhe me kërkesë dy herë, e para dhe pasi të amnistohen, të falen disa borxhe që u cekën këtu për veprimtari ilegale, për operatorë ilegalë, por qoftë edhe ata legalë, të cilët megjithatë po i shfrytëzojnë resurset natyrore, lumenj, kodra, nëntokë e gjithkund, e në anën tjetër, po e shkatërrojnë tërë ambientin, dhe asnjë cent nuk e investojnë në rehabilitimin e ambientit të komuniteteve të tjera.

Prandaj, mendoj se është fare i pavend ky insistim, kështu që e mora fjalën për t'i thënë këto dy gjëra, që të jemi të kujdesshëm në propozime e të mos bëjmë marketing shumë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Berisha e ka fjalën përmbyllëse.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar!

Unë vetëm desha të sqarohemi me disa që po donë të paraqiten si engjëj.

Unë e ngrita një problem, një gjetje që e kemi pasur gjatë monitorimit të ligjit dhe dua të sqarohem edhe me opinionin, sepse as unë nuk jam t'i amnistojmë operimet ilegale.

Këtu është fjala për falje të borxheve për ata operatorë gjatë kohës së UNMIK-ut që u janë shqiptuar gjopa paushall, pa matje gjeodezike, dhe mendoj se koha e UNMIKU-t dihet, është prej vitit 2000 deri në 2008. Prandaj, këta operatorë janë më shumë pjesë e Dukagjinit, ku janë shkatërruar më shumë lumenjtë, duke shfrytëzuar rërën dhe zhavorrin. Dhe, të jemi të qartë në këtë drejtim.

Tjetra. Dua t'i përkujtoj zotit Shaip Muja që e ka marrë një nismë më herët me deputetë për të qenë të përfshira edhe komunat e tjera, ku ka operime minerare me 20%-shin e tantimës, por në qoftë se e kanë dëgjuar me vëmendje, në rekomandimin e parë përmendet edhe ajo, por nuk përmendet emri i Shaip Mujës, e ndoshta ky është një gabim që s'kemi thënë se nisma e tij duhet të përfshihet.

Dhe, më lejoni të përmend se, në fund të pasusit të rekomandimit 1, ku thuhet: "Si dhe të gjitha iniciativat apo nismat ligjore të ndërmerren në Kuvend të përfshihen me një projekt të vetëm - hartimi i ligjit të ri për minierat dhe mineralet", që nënkupton edhe nisma e deputetit Muja me deputetët e tjerë të përfshihen në hartimin e ri të Ligjit për miniera e minerale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Shaip Muja, kundër-replikë!

SHAIP MUJA: Zoti nënkryetar!

Duke u nisur nga praktikat e përpilimit të ligjeve në Kuvendin e Republikës së Kosovës, unë nuk po them se kam nisur një iniciativë e të mbetet meritë imja dhe e deputetëve nënshkrues, por e

kam vlerësuar se është pragmatiste, shpejt e implementueshme. Dhe, nëse ne bëjmë ligj të ri, kjo do të shkojë në 6 muajin e parë të vitit të ardhshëm dhe nuk do të kemi mundësi ta implementojmë.

Prandaj, për atë arsye edhe kam nxituar me kolegët tanë që atë taksën minerale ta përfitojnë komunat në buxhetin e tyre sa më shpejt në vitin kalendarik që vjen. Dhe, për çështjen e rekomandimeve, unë prapë them se për problemin e Hadës, t'i kthehemi edhe një herë, dhe nuk duhet të merret vetëm Komisioni për Mbrojtjen e Ambientit, por të merret edhe Qeveria dhe Komisioni për Zhvillim Ekonomik dhe ne të marrim një qasje serioze karshi atyre qytetarëve.

Për çështjen e rekomandimit, unë mendoj se do të duhej propozuar që edhe nga shqiptimi t'i kemi disa, sepse në "One-Stop-Shop" që përshkruhet këtu, ato të cilat ju i keni kërkuar, kam frikën se ka edhe kuptime të tjera. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Berisha, e kemi përmbyllur tash diskutimin. Fjala e fundit ka qenë e kryetares së komisionit që e ka bërë raportin.

Nuk kemi kuorum për ta votuar këtë dhe nuk e votuam as Shqyrtimin e dytë të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për faljen e borxheve publike dhe, sidoqoftë ne jemi deputetë dhe e kemi për obligim që me mijëra familje që janë duke e pritur miratimin e këtij ligji t'i çlirojmë nga barra që e kanë.

Si duket një pjese të deputetëve më shumë u interesojnë të tjera gjëra, sa për të folur dhe jo për ta miratuar ligjin. Unë mendoj se ky ligj ka qenë dhe është tepër i rëndësishëm për ta miratuar në Kuvendin e Kosovës dhe për t'ia hapur mundësitë edhe Qeverisë të operojë, po edhe qytetarëve që i kanë të lidhura ekonomitë familjare dhe të tjera me këtë ligj, pra për t'u hapur mundësia e prosperimit.

Pra, nuk ka kuorum, vetëm 59 deputetë janë në sallë. Duhet të dimë edhe një gjë, seancë nuk do të kemi deri më 15 janar.

Atëherë, unë e deklaroj të mbyllur këtë seancë. Mirupafshim!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 22 dhe 23 dhjetor
Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

I hap punimet për vazhdimin e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e filluar më 22 dhe 23 dhjetor 2016, me pikat e papërfunduara të rendit të ditës, si vijon:

- Votimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për faljen e borxheve publike

Naït, a e ke kërkuar fjalën? Urdhëro!

NAIT HASANI: Faleminderit kryetar!

Te Projektligji për faljen e borxheve kërkoj që në amendamentin 2, pika 1.3 të futet edhe Komisioni i Pavarur dhe Miniera dhe Minerale.

Përndryshe, ky ligj është i paplotë, nëse i kemi Doganat, e kemi ATK-në dhe të gjitha tjera, prandaj edhe ky është institucion i Kosovës dhe i Kuvendit, prandaj nëse nuk hyn ky atëherë ne do të bëjmë shkelje.

Prandaj, kërkoj që seanca ta votojë këtë shtesë dhe ta plotësojë Projektligjin me të gjitha institucionet e Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, nëse seanca e miraton këtë amendament, e hedh në votim, e nëse s'e pranon atëherë se hedh në votim.

Pra, a e pranoi ta futim në votim këtë amendament, apo jo?

Atëherë, votojmë në mënyrë elektronike, nëse e pranoi e futim në votim. Prandaj, një herë do të votojmë nëse pranohet ky propozim për t'u futur në votim në seancën e sotme, jo për amendament.

Pra, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

A ka që votojnë me dorë? 3 kanë votuar me ngritje dore. Tash, po e pyesim secilin, sepse e kemi rezultatin në mënyrë elektronike.

Pra, cila është vota juaj që votoni me dorë - janë 3 deputetë.

Rrustem Berisha? Për! Emilija Rexhepi? Për! Abdyl...?

Atëherë janë 36 vota me elektronikë për, 3 me dorë që bëjnë 39.

Nga 78 deputetë, kanë votuar 75 në mënyrë elektronike dhe 3 me dorë.
Janë 36 kundër dhe 3 abstenime.

Atëherë, zoti Hasani, a mund të na e lexoni amendamentin, e pastaj e vëmë në votim, me ndryshime.

NAIT HASANI: I nderuar kryetar!

Plotësimi i Ligjit nr. 05/L-043, neni 3, paragrafi 1, pika 1.3, që institucionet shtetërore në plotësim të këtij ligji të përshihet edhe Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale.

Ju njoftojmë se KPM-ja e ka bërë shpalljen publike të listës së përfituesve.

Pra, në ligj është amendamenti 2, që e ka bërë Komisioni për Buxhet dhe është në paragrafin 1.3, pas “Doganës” të shtohet edhe “Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale”.

KRYETARI: Të kemi parasysh, tash shkojmë në votim të amendamentit të propozuar nga deputeti Nait Hasani.

Deputeti Fatmir Rexhepi e ka fjalën.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, kryetar!

Do të flas si deputet. Unë mendoj që kjo kategori nuk duhet përfshirë në amendamente. Edhe gjatë debatit të mëhershëm i kemi shprehur qëndrimet, i kemi dhënë argumentet të cilat unë do t'i përsëris vetëm dy a tri, sepse futja e kësaj kategorie në falje të borxheve për ata operatorë e kompani, ata njerëz që e kanë shkatërruar natyrën, që i kanë shkatërruar lumenjtë, kodrat, malet e rrafshet, gjithkund, pa investuar asnjë cent brenda këtyre periudhave për rehabilitimin e tyre, është një dëm dhe një padrejtësi shumë e madhe.

Prandaj, kjo kategori nuk do të duhej të përshihej dhe mendoj që deputetët nuk duhet ta aprovojnë faljen e borxheve për këto kompani që e kanë shkatërruar natyrën e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar Rexhepi! Tash shkojmë në votim. Lus regjinë e deputetët të përgatiten për votim të amendamentit të propozuar nga zoti Hasani. Për këtë e patëm edhe qëndrimin e një deputeti, zotit Rexhepi. Votojmë tash!

76 deputetë kanë votuar, 35 janë kundër, 11 kanë abstenuar, për janë 30. Nuk kalon ky amendament.

Në seancën e kaluar janë votuar amendamentet e propozuara dhe për votimin e Projektligjit me amendamentet nuk ka pasur kuorum për vendimmarrje, dhe tash e votojmë tekstin e projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Zoti Hasani, tash jemi duke votuar! Urdhëro, për çfarë është fjala?

NAIT HASANI: Faleminderit!

Unë e falënderoj edhe deputetin Rexhepi për arsyeshmërinë që e dha, por ai nuk na tregoi për ato kompanitë që u janë falur borxhet çfarë dëmtimi i kanë bërë buxhetit të shtetit. A i kanë bërë dëm shtetit, apo vetëm Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale ka bërë dëm?

KRYETARI: Faleminderit! Jemi duke e votuar Projektligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara, prandaj lus regjinë e deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Janë 3 votime me dorë. Zoti Berisha, a je për? Atëherë, kanë votuar 84 deputetë. 70 janë për, 12 kundër dhe 2 abstenime.

Konstatoj se Kuvendi e miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për faljen e borxheve.

- Votimi i Projektligjit për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive

Të nderuar deputetë,

Diskutimet lidhur me këtë projektligj kanë përfunduar në seancën plenare të datës 23 dhjetor 2016.

Në seancën e kaluar janë votuar amendamentet e propozuara.

Për votimin e Projektligjit me amendamentet e votuara nuk ka pasur kuorum për vendimmarrje, prandaj tash e votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Kanë votuar 80 deputetë me elektronikë, 2 kanë votuar me ngritje dore, janë 82 vota.

Atëherë konstatoj se me 80 vota për dhe 2 abstenime, Kuvendi e miratoi Ligjin për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive.

- Votimi i raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për miniera dhe minerale

Diskutimet kanë përfunduar në seancën plenare të datës 23 dhjetor 2016.

Tash votojmë rekomandimet e Komisionet lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për miniera dhe minerale.

Lus regjinë e deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Kanë votuar 71 deputetë, 2 me dorë - 73 deputetë. 60 me elektronikë dhe 2 me dorë janë për, 9 kundër dhe 2 abstenime.

Konstatoj se Kuvendi i miratoi rekomandimet e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për miniera dhe minerale.

Mirupafshim në seancën e radhës!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*